



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I SË DREJTËS PUBLIKE**



DISERTACION

PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE

“DOKTOR”

**ADMINISTRIMI I SISTEMIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI NË KËNDVËSHTRIM
HISTORIK DHE KRAHASUES**

Kandidati:

NAUREDA LLAGAMI

Udhëheqës shkencor:

Prof.Dr. KRISTINKA JANCE

Tiranë, 2026

© *E drejta e autorit: Naureda Llagami*

Ky disertacion shkencor është hartuar dhe formatuar sipas kërkesave të Rregullores së Rektoratit të UT-së “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratës në Universitetin e Tiranës”, miratuar me Vendimin nr. 4, datë 23.02.2026, të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës.

Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo veprim cënues me çfarëdo lloj mjeti apo forme, pa lejen përkatëse me shkrim të autorit.

Parathënie

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për udhëheqësen shkencore, Prof. Dr. Kristinka Jançe, për mbështetjen e vazhdueshme, orientimin akademik, këshillat e vryera dhe besimin e dhënë gjatë gjithë procesit të hartimit të këtij disertacioni.

Ky disertacion u dedikohet me dashuri, respekt dhe mirënjohje të thellë prindërve të mi të ndjerë, të cilët, edhe pse nuk janë më fizikisht pranë meje, mbeten të pranishëm në çdo hap të jetës sime dhe në çdo arritje timen. Ata më kanë dhënë edukimin, forcën, përkushtimin dhe vlerat që më kanë udhëhequr në rrugëtimin tim njerëzor, akademik dhe profesional. Ky disertacion është edhe një shprehje e mirënjohjes sime të përhershme për dashurinë, sakrificat, mbështetjen dhe shembullin e tyre të pazëvendësueshëm.

Falënderoj gjithashtu familjen time për mirëkuptimin, durimin dhe mbështetjen e pakushtëzuar në çdo fazë të këtij rrugëtimi akademik dhe profesional. Mbështetja e tyre ka qenë një burim i rëndësishëm force dhe inkurajimi gjatë gjithë procesit të realizimit të këtij disertacioni.

Mirënjohje të veçantë u drejtohet edhe kolegëve dhe bashkëpunëtorëve, të cilët, përmes diskutimeve, sugjerimeve dhe inkurajimit të tyre, kanë ndihmuar në përmbushjen e këtij angazhimi kërkimor-shkencor.

Në funksion të transparencës akademike, theksohet se disa pjesë të këtij disertacioni janë zhvilluar mbi bazën e punimeve dhe prezantimeve shkencore të mëparshme të autores. Këto materiale janë rishikuar, zgjeruar dhe integruar në mënyrë substanciale në këtë punim, në përputhje me objektin, strukturën, metodologjinë dhe standardet akademike të kërkimit daktoral.

ABSTRAKT

Ky disertacion ka për objekt analizën juridike të administrimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, e kuptuar jo vetëm si kategori thjesht administrative, por edhe si kategori juridiko-kushtetuese, e ndërthurur ngushtësisht me parimin e ndarjes së pushteteve, me parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, me llogaridhënien institucionale dhe me detyrimin për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Brenda një kornize të vetme analitike, disertacionit synon të rindërtojë evoluimin kushtetues të organizimit dhe administrimit të gjykatave shqiptare, që nga shpallja e pavarësisë në vitin 1912 e deri në fazën aktuale të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian, duke vendosur në qendër të analizës ndërhyrjen kushtetuese të vitit 2016, si pikën e shndërrimit më të rëndësishëm në historinë e qeverisjes gjyqësore shqiptare.

Teza qendrore e disertacionit është analizimi i tri fazave të mëdhaja të transformimit institucional të administrimit të sistemit gjyqësor shqiptar : faza e konsolidimit fillestar të shtetit të së drejtës në periudhën para regjimit komunist, e karakterizuar nga një ndërthurje origjinale midis trashëgimisë juridike osmane dhe ndikimit të modeleve evropiane perëndimore, kryesisht atë italian; faza e shtrembërimit ideologjik gjatë regjimit komunist, në të cilën pavarësia e gjyqësorit u parashikua formalisht në tekstin kushtetues, por u zhvesh substancialisht në praktikën institucionale dhe nënvizohet ndikimi i Kushtetutës së Bashkimit Sovjetik të vitit 1936; si dhe faza e riformimit demokratik pas vitit 1991, e cila kulmoi me reformën kushtetuese të vitit 2016 si riformatim institucional i tërë sistemit të drejtësisë. Kjo reformë nuk përbën një rishikim teknik të organizimit gjyqësor, por një transformim strukturor, përmes të cilit modeli i administrimit, i ndikuar nga ekzekutivi, u zëvendësua nga modeli i vetëqeverisjes profesionale.

Kontributi origjinal i disertacionit qëndron në ndërtimin e një kornize gjithëpërfshirëse interpretuese, që vendos administrimin gjyqësor shqiptar në një vazhdimësi të gjatë historiko-kushtetuese, të harmonizuar me standardet bashkëkohore evropiane, dhe që ofron, mbi këtë bazë, propozime konkrete për përmirësimin e efikasitetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Fjalëkyçe: administrimi i sistemit gjyqësor; pavarësia e pushtetit gjyqësor; reforma kushtetuese e vitit 2016; vetëqeverisja gjyqësore; efikasiteti gjyqësor; afati i arsyeshëm; standardet evropiane.

ABSTRACT

This doctoral dissertation addresses the administration of the judicial system in the Republic of Albania, to be understood not only as a mere administrative category, but as a constitutional-legal category, closely intertwined with the principle of the separation of powers, the principle of judicial independence, institutional accountability, and the obligation to render judgment within a reasonable time. The dissertation seeks to reconstruct, within a single analytical framework, the constitutional evolution of the organization and administration of the Albanian courts, from the proclamation of independence in 1912 to the present phase of the process accession to the European Union, placing at the centre of the analysis the constitutional intervention of 2016 as the most significant transformative moment in the history of Albanian judicial governance.

The central thesis of the work is that the administration of the Albanian judicial system has traversed three major phases of institutional transformation: an initial phase of consolidation of the rule of law in the period preceding the communist regime, characterised by an original interweaving of the Ottoman legal heritage and the influence of Western European models; a phase of ideological distortion during the communist regime, in which the independence of the judiciary was formally inscribed in the constitutional text, yet was substantively eroded in institutional practice; and a phase of democratic refoundation following 1991, which culminated in the 2016 constitutional reform as an architectural recasting of the entire justice system. That reform does not constitute a technical revision of judicial organization, but rather a structural transformation, through which the model of administration influenced by the executive was replaced by the model of professional self-governance.

The original contribution of the work lies in the construction of a comprehensive interpretive framework, which situates Albanian judicial administration within an extended historical-constitutional continuity, harmonised with contemporary European standards, and which offers, on that basis, concrete proposals for the improvement of judicial efficiency in the Republic of Albania.

Keywords: administration of the judicial system; judicial independence; 2016 constitutional reform; judicial self-governance; judicial efficiency; reasonable time; European standards.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT/ABSTRACT	iii
LISTA E SHKURTIMEVE	vii
HYRJA	ix
OBJEKTIVAT	x
METODOLOGJIA	xii
STRUKTURA E DISERTACIONIT	xxi
ÇËSHTJE PËR DISKUTIM	xxiii
KAPITULLI I	1
ADMINISTRIMI I DREJTËSISË NË SHQIPËRI NGA PAVARËSIA DERI NË KUSHTETUTËN E VITIT 1998: NJË KËNDVËSHTRIM HISTORIKO-KUSHTETUES	1
1.1 Burimet kryesore të të drejtës në Shqipëri para regjimit komunist	1
1.1.1 Ligji i parë themelor shqiptar: Statuti Organik i Shqipërisë	1
1.1.2 Konsolidimi i pavarësisë gjyqësore: nga Statuti i Lushnjës (1920) te Statuti i vitit 1922	4
1.1.3 Periudha e monarkisë: nga Statuti Themelor i Republikës Shqiptare (1925) te Statuti Themeltar i Mbretënisë së Shqipërisë (1939)	5
1.2 Burimet kryesore të të drejtës në Shqipëri gjatë regjimit komunist	11
1.2.1 Konsolidimi i regjimit komunist shqiptar: Një analizë e statutit të vitit 1946	11
1.2.2 Konsolidimi dhe stalinizimi i regjimit: Kushtetuta e vitit 1950	15
1.2.3 Radikalizimi dhe rendi kushtetues autark: Kushtetuta e vitit 1976	18
1.3 Burimet kryesore të të drejtës në Shqipëri pas regjimit komunist	21
1.3.1 Burimet kushtetuese tranzitore dhe riorganizimi fillestar i pushtetit gjyqësor	21
1.3.2 Kushtetucionalizimi i administrimit gjyqësor në rendin kushtetues të vitit 1998	26
KAPITULLI II	32
REFORMA KUSHTETUESE E VITIT 2016 DHE RIORGANIZIMI TERRITORIAL I SISTEMIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI	32
2.1 Premisat dhe ndryshimet kushtetuese të reformës në drejtësi të vitit 2016	32
2.1.1 Premisat politike, institucionale dhe normative të reformës	32
2.1.2 Amendamentet kushtetuese dhe organizimi i ri i pushtetit gjyqësor	33
2.1.3 Rifomatimi i Gjykatës Kushtetuese dhe forcimi i kontrollit kushtetues	34
2.2 Organet kushtetuese të administrimit të sistemit të drejtësisë, statusi i magjistratit dhe rivlerësimi kalimtar	38
2.2.1 Organet e reja kushtetuese të administrimit të sistemit të drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës	38
2.2.2 Statusi i unifikuar i magjistratit sipas Ligjit nr. 96/2016	40
2.2.3 Strukturat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar	42
2.2.4 Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe pasojat e tij institucionale	43

2.3 Evolucion i historik dhe baza ligjore e hartës gjyqësore në Shqipëri.....	47
2.3.1 Organizimi territorial i gjykatave në periudhën 1992–2012	47
2.3.2 Baza ligjore e hartës së re gjyqësore pas reformës së vitit 2016	61
2.3.3 Procesi institucional i hartimit, miratimit dhe hyrjes në fuqi të hartës së re gjyqësore.....	66
2.4 Harta e re gjyqësore dhe efektet institucionale të kësaj reforme	71
2.4.1 Treguesit empirikë të funksionimit të sistemit gjyqësor para zbatimit të hartës së re.....	71
2.4.2 Operacionalizimi dhe konsolidimi institucional i hartës së re gjyqësore, 2023–2024	74
2.4.3 Efektet mbi funksionimin e gjykatave dhe raporti midis hartës, organikës dhe backlog-ut.....	84
2.4.4 Qasja (Aksesi) në drejtësi, kontrolli kushtetues dhe vlerësimi krahasimor i reformës	86
KAPITULLI III.....	98
REFORMA NË ORGANIZIMIN DHE ADMINISTRIMIN E GJYKATAVE	98
3.1 Kuadri konceptual dhe normativ i administrimit gjyqësor pas reformës në drejtësi në vështrim krahasues.....	98
3.2 Modeli i ri i qeverisjes gjyqësore pas reformës kushtetuese të vitit 2016	108
3.2.1 Baza kushtetuese dhe ligjore e funksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor	108
3.2.2 Përbërja, statusi dhe struktura vendimmarrëse e Këshillit të Lartë Gjyqësor	112
3.2.3 Kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor në administrimin, buxhetimin dhe disiplinën gjyqësore	116
3.3 Konsolidimi institucional dhe funksional i KLGJ-së gjatë periudhës 2018–2024	118
3.3.1 Mekanizmat e planifikimit, transparencës dhe llogaridhënies institucionale.....	122
3.3.2 Rikonceptimi i organizimit të brendshëm të gjykatave pas reformës në drejtësi: nga modeli i fragmentuar drejt qeverisjes së brendshme institucionale.....	123
3.3.3 Teknologjia e informacionit si instrument i administrimit të mirë dhe qeverisjes digjitale të drejtësisë	130
3.3.4 Sfidat strukturore të administrimit gjyqësor dhe kufijtë e pavarësisë institucionale.....	134
KAPITULLI IV	138
EFIKASITETI GJYQËSOR: NJË QASJE KRAHASUESE	138
4.1 Standardet ndërkombëtare të efikasitetit gjyqësor dhe roli i CEPEJ-it	138
4.1.1 CEPEJ-i si mekanizëm i Këshillit të Evropës për vlerësimin e efikasitetit të drejtësisë	139
4.1.2 Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore dhe standardi i afatit të arsyeshëm	146
4.1.3 Procesi i rivlerësimit kalimtar dhe standardet e nenit 6 të KEDNJ-së	154
4.1.4 Reflektimi i standardeve të CEPEJ-it në legjislacionin shqiptar.....	159
4.2 EU Justice Scoreboard dhe standardet e BE-së për efikasitetin, cilësinë dhe pavarësinë e drejtësisë.....	165
4.2.1 Treguesit evropianë të performancës gjyqësore dhe rëndësia e tyre për Shqipërinë.....	172
4.3 Administrimi i drejtësisë dhe zhvillimi i praktikës gjyqësore në Shqipëri.....	175
4.4 Praktika e Gjykatës së Lartë mbi administrimin gjyqësor dhe efikasitetin e gjyqimit	181
KAPITULLI V.....	188

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	188
5.1 Përmbledhje sintetizuese e gjetjeve të kapitujve	188
5.2 Sfidat strukturore aktuale	196
5.3 Rekomandime	198
BIBLIOGRAFI	206
ANEKS	228

LISTA E SHKURTIMEVE

BE — Bashkimi Evropian
BKH — Byroja Kombëtare e Hetimit
BRSS — Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
CCJE — Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (*Consultative Council of European Judges*)
CEPEJ — Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (*European Commission for the Efficiency of Justice*)
CR — Norma e Zgjidhjes së Çështjeve (*Clearance Rate*)
DT — Koha e evadimit të çështjeve (*Disposition Time*)
ENCJ — Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësorë (*European Network of Councils for the Judiciary*)
EUJS — Tabela e Rezultateve të Drejtësisë së Bashkimit Evropian (*EU Justice Scoreboard*)
EURALIUS — Misioni i Konsulencës së Bashkimit Evropian për Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri
GJED — Gjykata Evropiane e Drejtësisë
GJEDNJ — Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJK — Gjykata Kushtetuese
GJKKO — Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
GNP — Grupi Ndërinstitucional i Punës
ICMIS — Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (*Integrated Case Management Information System*)
ILD — Inspektori i Lartë i Drejtësisë
ILDKPKI — Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KE — Këshilli i Evropës
KED — Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
KEDNJ — Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KLD — Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KLGG — Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP — Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KPA — Kolegji i Posaçëm i Apelit
KPK — Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KShH — Komiteti Shqiptar i Helsinkit
KVEVP — Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale
KZHK — Komisioni i Zhvillimit të Karrierës
NUNÇP — Ekipet për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura
NVEP — Njësia e Vlerësimit Etik dhe Profesional
OJF — Organizata Jofitimprurëse
ONM — Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit
OSBE — Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
PBA — Projektbuxheti Afatmesëm
PBB — Prodhimi i Brendshëm Bruto
SHBA — Shtetet e Bashkuara të Amerikës

SPAK — Struktura e Posaçme Antikorrupsion (Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar)

TEU — Traktati për Bashkimin Evropian (*Treaty on European Union*)

TFUE — Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian (*Treaty on the Functioning of the European Union*)

USAID — Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (*United States Agency for International Development*)

UT — Universiteti i Tiranës

VKM — Vendim i Këshillit të Ministrave

WR — Norma e Ngarkesës së Punës (*Workload Rate*)

Qëllimi themelor i këtij disertacion konsiston në analizimin sistematik dhe ndërsektorial të administrimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, duke e trajtuar atë jo si një funksion thjesht administrativ, por si një kategori juridiko-kushtetuese të lidhur ngushtë me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, me garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, me mekanizmat e llogaridhënies institucionale dhe me realizimin efektiv të të drejtës për një proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë kuadër, disertacioni synon të rindërtojë dhe të analizojë në mënyrë kritike evolucionin historik, kushtetues, institucional, dhe ndërsektorial të organizimit dhe administrimit të gjykatave shqiptare, duke filluar nga periudha e krijimit të shtetit shqiptar në vitin 1912 e deri në fazën aktuale të integritetit evropian. Analiza përqendrohet veçanërisht në reformën kushtetuese dhe institucionale të vitit 2016, e cila konsiderohet si momenti më i rëndësishëm transformues në historinë e qeverisjes së sistemit gjyqësor shqiptar pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së vitit 1998. Kjo, për shkak të rikonceptimit të mekanizmave të administrimit gjyqësor, të raportit ndërmjet organeve të qeverisjes së gjyqësorit, si dhe të standardeve të reja të pavarësisë, eficiencës dhe përgjegjshmërisë institucionale.

Përzgjedhja e këtij objekti studimor justifikohet për disa arsye thelbësore. Së pari, organizimi dhe administrimi i gjykatave ka qenë vazhdimisht një çështje e hapur në historinë juridike shqiptare, e cila ka kaluar nëpër disa regjime kushtetuese të njëpasnjëshme — principatën kushtetuese, republikën parlamentare, monarkinë demokratike, monarkinë kushtetuese, republikën popullore, republikën socialiste dhe, në fund, Republikën Parlamentare aktuale — secila prej të cilave ka prodhuar zgjidhje të ndryshme institucionale për administrimin e drejtësisë.¹ Së dyti, periudha aktuale e zhvillimit kushtetues shqiptar shënon një moment të veçantë historik, të karakterizuar nga thellimi i procesit të integritetit në Bashkimin Evropian dhe nga hapja e të gjithë kapitujve të negociatave në nëntor 2025, e cila ka vendosur sistemin e drejtësisë në qendër të vlerësimeve evropiane.² Së treti, raporti i fundit i Komisionit Evropian për Shqipërinë i vitit 2025 ka nënvizuar nevojën e vazhdueshme për reformim të sistemit gjyqësor, duke evidentuar mangësi në cilësinë dhe efikasitetin e organizimit gjyqësor, në kapacitetin e burimeve njerëzore, në infrastrukturën gjyqësore dhe në plotësimin e vendeve vakante.³

Në planin teorik, qëllimi i disertacionit është të vendosë administrimin e sistemit gjyqësor shqiptar në një vazhdimësi të zgjeruar historiko-kushtetuese, duke nxjerrë në pah elementet e vazhdimësisë dhe të ndërprerjes midis periudhave të njëpasnjëshme dhe duke identifikuar specifikat e modelit shqiptar në raport me familjet juridike përkatëse — të drejtën osmane si trashëgimi historike, modelet evropiane perëndimore, në veçanti atë italian, si pikë referimi për periudhën para regjimit komunist, modelin sovjetik si ndikim ideologjik gjatë regjimit komunist dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane si parametër normativ pas vitit 1991. Në planin doktrinor-juridik, disertacioni ka për qëllim të interpretojë kornizën normative të reformës së vitit 2016, duke përcaktuar logjikat

¹ Llagami, Naureda. "Building Justice in Albania from the Independence (1912) to the Communist Regime (1945): A Constitutional–Historical Perspective." *Aequitas*, vol. 1, 2026, pp. 155–184.

² Bregu, Meljana, and Juliana Gjinko. "Structural Reforms in Albania: Political and Legal Challenges in the Framework of EU Integration". *Access to Just. E. Eur.* (2025): 417.

³ Xxx https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

themelore dogmatike që e përshkojnë atë — parimin e ndarjes funksionale brenda qeverisjes së gjyqësorit, parimin e pavarësisë horizontale midis gjyqësorit dhe prokurorisë dhe parimin e specializimit antikorruption — si dhe duke vlerësuar koherencën e brendshme të arkitekturës së re institucionale.

Në planin krahasues, qëllimi është të vlerësohet shkalla e harmonizimit të modelit shqiptar të administrimit gjyqësor me standardet ndërkombëtare, të zhvilluara nga Komisioni Evropian për efikasitetin e drejtësisë, nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, nga opinionet e Komisionit të Venecias dhe nga instrumentet e zhvilluara nga Bashkimi Evropian në kuadër të Tabelës së rezultateve të drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Në planin praktik, disertacioni synon të ofrojë një bazë analitike të strukturuar për formulimin e rekomandimeve, që mund të kontribuojnë në përmirësimin e qeverisjes së sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e shtetit të së drejtës dhe me detyrimet që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian.

Përtej këtyre objektivave të menjëhershme, disertacioni synon edhe të kontribuojë në thellimin e debatit doktrinor mbi marrëdhënien midis pavarësisë institucionale të gjyqësorit dhe llogaridhënies publike të tij, dy parime që shpesh paraqiten në tendosje midis tyre, por që, sipas kornizës së reformës së vitit 2016, kërkohet të bashkëjetojnë në një ekuilibër kushtetues të qëndrueshëm. Në këtë kuptim, disertacioni ofron, përtej një kontributi të kufizuar përshkrues, një lexim interpretues të transformimit të arkitekturës kushtetuese të drejtësisë në Shqipëri si shprehje e maturimit të demokracisë kushtetuese dhe të aftësisë së saj për të ndërtuar institucione, të cilat garantojnë njëkohësisht pavarësinë funksionale të gjyqësorit dhe përgjegjshmërinë e tij ndaj shoqërisë.

OBJEKTIVAT

Disertacioni ndjek një sërë objektivash kërkimore specifike, të strukturuar në përputhje me logjikën e brendshme të analizës dhe me ndarjen kapitullore të disertacionit. Këto objektiva nuk janë formuluar si përfundime autonome, por si etapa të njëpasnjëshme të një procesi analitik unitar, ku secila etapë e mbështet dhe e plotëson tjetrën, duke kontribuar bashkërisht në ndërtimin e një kornize të integruar interpretuese të administrimit gjyqësor shqiptar. Objektivi kryesor i këtij disertacioni është të analizojë, në një perspektivë akademike dhe praktike, administrimin e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, duke integruar një qasje ndërsektoriale dhe ndërdisiplinore në shqyrtimin e evolucionit historiko-kushtetues, atë të organizimit institucional dhe të transformimeve të sjella nga reforma në drejtësi e vitit 2016, si dhe në krahasimin e tyre me standardet e së drejtës ndërkombëtare dhe evropiane.

Objektivi i parë i disertacionit është të rindërtojë në mënyrë sistematike evoluimin historiko-kushtetues të administrimit të drejtësisë në Shqipëri, duke gjurmuar konsolidimin gradual të parimeve themelore të pavarësisë së gjyqësorit, palëvizshmërisë së gjyqtarëve, juridiksionit territorial, parimit të vendimeve të arsyetuara, parimit të publicitetit të seancave gjyqësore dhe ndalimit të gjykatave të jashtëzakonshme. Ky objektiv realizohet përmes analizës krahasuese të statuteve themelore të periudhës para regjimit komunist — Statutit Organik të vitit 1914, Statutit të Lushnjës të vitit 1920, Statutit të vitit 1922, Statutit Themelor të Republikës Shqiptare të vitit 1925, Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare të vitit 1928 dhe Statutit Themeltar të Mbretërisë së Shqipërisë të vitit 1939 — të kushtetutave të periudhës komuniste — Statuti i vitit 1946, Kushtetutës së vitit 1950 dhe

Kushtetutës së vitit 1976 — dhe të kornizës kushtetuese të periudhës pas vitit 1991, duke përfshirë Ligjin 7491 të vitit 1991 si instrument tranzitor dhe Kushtetutën e vitit 1998. Vëmendje e veçantë i kushtohet identifikimit të ndikimit të të drejtës osmane mbi ligjin e parë themelor shqiptar, si dhe shqyrtimit kritik të natyrës formale dhe substanciale të pavarësisë së gjyqësorit gjatë regjimit komunist. Gjithashtu, rëndësi ka dhe krijimi si në nivel të legjislacionit parësor dhe kushtetues të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si një organ i pavarur nga pushtetet e tjera.

Objektivi i dytë është të analizojë në mënyrë doktrimore-juridike reformën kushtetuese të vitit 2016 si ndërhyrjen më të gjerë legjislative në sistemin gjyqësor shqiptar pas miratimit të Kushtetutës aktuale. Ky objektiv përfshin shqyrtimin e amendamenteve kushtetuese të miratuara me Ligjin nr. 76/2016, të paketës së ligjeve organike që e operacionalizojnë reformën, të riformatimit të Gjykatës Kushtetuese, të krijimit të organeve të reja kushtetuese të vetëqeverisjes së sistemit të drejtësisë — Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi — të ngritjes së strukturave të specializuara antikorruption dhe të institucionalizimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Analiza synon të nxjerrë në pah natyrën transformuese të reformës dhe logjikat themelore dogmatike që e karakterizojnë atë.

Objektivi i tretë është të shqyrtojë riorganizimin gjeografik të gjykatave përmes reformës së Hartës së re gjyqësore, duke analizuar në mënyrë krahasuese periudhën para-reformë dhe periudhën e zbatimit të saj. Ky objektiv përfshin vlerësimin e legjitimitetit të riorganizimit, analizën empirike të treguesve kryesorë të performancës gjyqësore, identifikimin e disekuilibrave strukturorë të organizimit territorial të mëparshëm dhe vlerësimin e pasojave institucionale dhe funksionale të hartës së re në raport me parimin e aksesit në drejtësi, të kuptuar jo vetëm në dimensionin gjeografik, por edhe në atë substancial, përfshirë afatin e arsyeshëm, cilësinë e gjykimit dhe efikasitetin institucional.

Objektivi i katërt është të analizojë administrimin e brendshëm të gjykatave dhe rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor si organ kushtetues i vetëqeverisjes profesionale. Ky objektiv përfshin shqyrtimin e kompetencave administrative, buxhetore, disiplinore dhe planifikuese-strategjike të Këshillit, të ndërveprimit të tij me organe të tjera kushtetuese, të strukturave të reja drejtuese brenda gjykatave — përfshirë Këshillin e Gjykatës, figurën e Kancelarit dhe Mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve — si dhe të procesit të digjitalizimit të procedurave gjyqësore si komponent thelbësor i modernizimit institucional dhe i pajtueshmërisë me standardet evropiane.

Objektivi i pestë është të vlerësojë efikasitetin e sistemit gjyqësor shqiptar në një qasje krahasuese me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Ky objektiv përfshin shqyrtimin e instrumenteve të zhvilluara nga Komisioni Evropian për efikasitetin e drejtësisë — përfshirë mjetin e dedikuar për reduktimin e çështjeve të prapambetura — dhe nga Tabela e rezultateve të drejtësisë së Bashkimit Evropian, analizën e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi konceptin e afatit të arsyeshëm dhe mbi dallimin midis çështjeve prioritare dhe atyre joprioritare, vlerësimin e marrëdhënies midis procesit të rivlerësimit kalimtar dhe nenit 6(1) KEDNJ, si dhe analizën e vendimeve unifikuuese ose

modifikuese të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë në periudhën pas përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, me përqendrim të veçantë në ato vendime, të cilat trajtojnë në mënyrë eksplícite çështjen e administrimit të mirë gjyqësor.

Objektivi i gjashtë është të identifikojë në mënyrë sistematike sfidat aktuale strukturore të administrimit të sistemit gjyqësor shqiptar — përfshirë vakancat e qëndrueshme, akumulimin e çështjeve të prapambetura, ngarkesën e shpërpjesëtuar gjyqësore midis gjykatave dhe pavarësinë financiare ende të kufizuar — dhe të formulojë, mbi bazën e analizës së kryer, rekomandime konkrete për përmirësimin e qeverisjes gjyqësore. Këto rekomandime synojnë, jo vetëm përmirësimin e treguesve formalë të performancës, por edhe konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe forcimin e legjitimitetit të sistemit të drejtësisë në sytë e qytetarëve, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nga procesi i integritetit në Bashkimin Evropian.

METODOLOGJIA

Disertacioni mbështetet mbi një metodologji të kombinuar dhe shumëdimensionale, e cila ndërthur disa qasje analitike komplementare, të nevojshme për trajtimin tërësor të një objekti studimor me natyrë komplekse historiko-kushtetuese, doktrimore, krahasuese dhe institucionale. Kompleksiteti i objektit kërkimor — administrimi i sistemit gjyqësor në një vazhdimësi të zgjeruar kohore dhe në ndërthurje të shumëfishtë me parimet kushtetuese, me standardet ndërkombëtare dhe evropiane si dhe me dinamikën institucionale aktuale — nuk lejon mbështetjen mbi një metodë të vetme analitike. Përkundrazi, ai kërkon ndërtimin e një kornize metodologjike të integruar, ku secila qasje e plotëson dhe e zgjeron tjetrën, duke kontribuar bashkërisht në ndërtimin e një interpretimi koherent dhe të mirë-argumentuar të lëndës së trajtuar.

Për qëllime qartësie, organizimi i administrimit të drejtësisë mund të ketë dy kuptime të ndryshme. Kuptimi më i gjerë përfshin, gjithashtu, avokatët e popullit, institutet, gjykatat, mekanizmat alternative të zgjidhjes së konflikteve dhe organet e tjera qeverisëse të mosmarrëveshjeve⁴ si dhe noterët.⁵ Përkundrazi, organizimi i drejtësisë në kuptimin e ngushtë, përfshin vetëm organizimin e gjykatës. Në të vërtetë, ky disertacion fokusohet në interpretimin e ngushtë të organizimit të drejtësisë.

Qasja historiko-kushtetuese

Qasja e parë mbi të cilën ngrihet disertacioni është ajo historiko-kushtetuese, e cila ndjek evoluimin e normës kushtetuese dhe të arkitekturës institucionale të administrimit gjyqësor përgjatë periudhave të njëpasnjëshme historike. Kjo qasje është e nevojshme për dy arsye thelbësore. Së pari, organizimi gjyqësor në Shqipëri nuk mund të kuptohet jashtë kontekstit të transformimeve të shumta kushtetuese që ka njohur vendi që nga shpallja e pavarësisë

⁴ OECD. *Making Justice Systems More Effective and People-Centred*. OECD Publishing, 2023. https://www.oecd.org/en/publications/making-justice-systems-more-effective-and-people-centred_e02fd90b-en.html

⁵ Haliti-Mustafa, E., et al. "The Role of Notaries in a Modern Legal System in the Western Balkans". *Corporate Law and Governance Review*, vol. 6, no. 3, 2024, pp. 37–42.

në vitin 1912 — principatën kushtetuese, republikën parlamentare, monarkinë demokratike, monarkinë kushtetuese, republikën popullore, republikën socialiste dhe republikën parlamentare aktuale — ku secila ka prodhuar zgjidhje të dallueshme institucionale për administrimin e drejtësisë. Së dyti, vetëm përmes një leximi diakronik mund të identifikohen elementet e vazhdimësisë dhe të ndërprerjes kushtetuese, që janë thelbësore për të kuptuar specifikën e modelit shqiptar dhe për të vendosur reformat aktuale në një vazhdimësi më të gjerë institucionale. Operacionalizimi i kësaj qasjeje është realizuar përmes analizës krahasuese të teksteve themelore të periudhave të njëpasnjëshme: Statutit Organik të vitit 1914, Statutit të Lushnjës të vitit 1920, Statutit të vitit 1922, Statutit Themelor të Republikës Shqiptare të vitit 1925, Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare të vitit 1928, Statutit Themeltar të Mbretënisë së Shqipërisë të vitit 1939, Kushtetutës së vitit 1946, Kushtetutës së vitit 1950, Kushtetutës së vitit 1976, Ligjit 7491 të vitit 1991 dhe Kushtetutës së vitit 1998. Krahasimi tekstual është realizuar duke ndjekur disa akse të qëndrueshme analize: organizimin territorial të gjykatave, mënyrën e emërimit të magjistratëve, garancitë e palëvizshmërisë, parimin e juridiksionit territorial, parimin e vendimeve të arsyetuara, parimin e publicitetit të seancave, ndalimin ose lejimin e gjykatave të jashtëzakonshme dhe rolin e ekzekutivit në administrimin gjyqësor.

Qasja diakronike është e shoqëruar nga një lexim kontekstual, që merr parasysh kushtet politike, ideologjike dhe ndërkombëtare, në të cilat janë miratuar tekstet themelore. Në veçanti, analiza e kushtetutave të periudhës komuniste është realizuar duke marrë parasysh ndikimin e modelit sovjetik dhe lidhjet e ndryshueshme të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, Kinën dhe Bllokun Lindor në tërësi, ndërsa analiza e teksteve të periudhës para regjimit komunist ka identifikuar gjurmët e trashëgimisë juridike osmane dhe të ndikimit të modeleve evropiane perëndimore.

Në këtë kuptim, punimi aplikon një perspektivë historiko-kushtetuese mbi administrimin e gjykatave në Shqipëri, si pjesë përbërëse e organizimit të drejtësisë. Kjo qasje mundëson shqyrtimin e mënyrës se si organizimi gjyqësor është formësuar nga ndryshimet e njëpasnjëshme kushtetuese, që kanë shoqëruar zhvillimin e shtetit shqiptar pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1912. Përvoja kushtetuese shqiptare ka kaluar nëpër disa modele të ndryshme shtetërore dhe juridike: principatën kushtetuese të vitit 1914, të konfirmuar në vijimësi nga aktet themelore të viteve 1920 dhe 1922; republikën parlamentare të vitit 1925; monarkinë demokratike të vitit 1928; monarkinë kushtetuese të vitit 1939; republikën popullore; republikën socialiste të vitit 1976; dhe, së fundi, rendin parlamentar të vendosur pas vitit 1991 dhe të konsoliduar me Kushtetutën e vitit 1998⁶.

Për këtë arsye, metoda juridike diakronike e përdorur në këtë punim fokusohet në normat kushtetuese si burime parësore për të kuptuar zhvillimin institucional të gjykatave. Kjo zgjedhje metodologjike është e justifikuar sepse kushtetutat nuk përfaqësojnë vetëm tekste normative abstrakte, por edhe produkte të konteksteve të caktuara historike, politike dhe institucionale. Ato evoluojnë përmes vijimësisë dhe ndërprerjes, jo domosdoshmërisht përmes një zhvillimi linear⁷. Prandaj, qasja historiko-kushtetuese është e nevojshme për të dalluar vazhdimësinë formale të institucioneve nga transformimi i tyre substancial⁸.

⁶ Shyle, Enkeleida, et al. "History of Medical Civil Liability in Albania during the XXth Century: An Intersectoral Legal Approach". *International Journal of Legal History and Institutions*, 2025, pp. 145–166.

⁷ Fioravanti, M. *Costituzionalismo: Percorsi della storia e tendenze attuali*. Roma-Bari, 2009, p. 54.

⁸ Grimm, D. *Constitutionalism: Past, Present, and Future*. Oxford, 2016, p. 45.

Përvoja shqiptare e dëshmon qartë këtë dinamikë: brenda më pak se një shekulli, janë miratuar disa korniza të dallueshme kushtetuese, secila e formësuar nga kushte të ndryshme politike, ideologjike dhe institucionale.

Qasja doktrinale-juridike

Qasja e dytë është ajo doktrinale-juridike, e cila ndërmerr një analizë kritike dhe sistematike të kornizës normative në fuqi, me përqendrim të veçantë në paketën ligjore të reformës në drejtësi të vitit 2016 dhe në legjislacionin organik, që e operacionalizon atë. Kjo qasje synon të interpretojë kuptimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore, të identifikojë parimet themelore juridike, që i përshkojnë ato dhe të vlerësojë koherencën e brendshme të sistemit normativ në lidhje me parimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe atë të llogaridhënies institucionale. Qasja doktrinale-juridike është mbështetur mbi metodat klasike të interpretimit juridik, të cilat janë aplikuar në mënyrë të ndërthurur sipas natyrës së dispozitës së shqyrtuar: interpretimi literal, që fokusohet në kuptimin gjuhësor të normës; interpretimi sistematik, që e vendos normën në marrëdhënie me dispozitat e tjera të të njëjtit ligj ose të kornizës normative më të gjerë; interpretimi teleologjik, që identifikon qëllimin e normës dhe synimet e ligjvënësit; dhe interpretimi historik, që ndërton kuptimin e normës duke marrë parasysh kontekstin e miratimit të saj dhe evoluimin që ka pësuar përgjatë kohës. Aplikimi i kombinuar i këtyre metodave bën të mundur një interpretim të strukturuar dhe të mirë-argumentuar të dispozitave të analizuara, në përputhje me kanonet e pranuar të hermeneutikës juridike.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar identifikimit të zhvendosjeve kompetenciale që janë realizuar përmes reformës së vitit 2016 — domethënë, transferimit të kompetencave të caktuara nga organe të mëparshme tek organet e reja kushtetuese — pasi pikërisht në këto zhvendosje qëndron natyra strukturore e transformimit institucional. Po kështu, i është kushtuar vëmendje raportit midis ligjit organik dhe akteve nënligjore të miratuara nga vetë organet e vetëqeverisjes së drejtësisë, të cilat plotësojnë kornizën normative me rregullimin e detajuar të procedurave të brendshme.

Në këtë kuadër, duhet nënvizuar se, për shkak të zhvillimit ende të kufizuar të kërkimit shkencor juridik⁹ në Shqipëri në raport me vendet me traditë më të konsoliduar akademike, përdorimi i doktrinës së huaj merr rëndësi të veçantë për sqarimin e koncepteve kyçe të administrimit gjyqësor, pavarësisë institucionale, vetëqeverisjes së gjyqësorit dhe llogaridhënies. Megjithatë, mbështetja në doktrinën e huaj nuk realizohet në mënyrë mekanike, por vetëm pasi të jetë identifikuar lidhja përkatëse me normat kushtetuese dhe ligjore shqiptare, si dhe me kontekstin historik në të cilin ato janë miratuar. Për këtë arsye, analiza doktrinale e këtij punimi merr në konsideratë veçoritë e secilës periudhë — regjimin monarkik, modelin republikan, rendin totalitar komunist dhe fazën e drejtësisë tranzicionale pas vitit 1991 — si edhe marrëdhëniet juridike, politike dhe institucionale, që kanë ndikuar në formësimin e administrimit të gjykatave në Shqipëri.

⁹ European Commission, Directorate-General for Research and Innovation, *European Innovation Scoreboard 2025: Country profile Albania*, Independent Expert Report, prepared by Santiago Donat, Technopolis Group, 2025.

Qasja krahasuese

Qasja e tretë është krahasuese, e cila vendos modelin shqiptar të administrimit gjyqësor në kontekstin e standardeve ndërkombëtare apo evropiane dhe të zgjidhjeve të miratuara nga sisteme të tjera juridike. Krahasimi është realizuar në dy nivele plotësuese. Në nivelin e parë, krahasimi është kryer me kornizën normative dhe institucionale të Këshillit të Evropës dhe veçanërisht me dokumentet e Komisionit Evropian për efikasitetin e drejtësisë, me opinionet e Komisionit të Venecias dhe me rekomandimet e Këshillit konsultativ të gjyqtarëve evropianë dhe të Rrjetit evropian të këshillave gjyqësorë. Këto dokumente përbëjnë parametrat normativë kryesorë, me të cilët duhet të maten reformat shqiptare, pasi ato shprehin standardet e konsoliduara evropiane në fushën e qeverisjes së gjyqësorit, të vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve dhe efikasitetit gjyqësor.

Në nivelin e dytë, krahasimi është kryer me kornizën e Bashkimit Evropian, duke analizuar instrumentin e Tabelës së rezultateve të drejtësisë së Bashkimit Evropian, marrëdhënien e tij me shtetin e së drejtës dhe me Semestrin Evropian, si dhe rëndësinë e tij të veçantë për Shqipërinë, në kuadër të procesit të integritetit. Në raste të veçanta, krahasimi shtrihet edhe ndaj zgjidhjeve të miratuara nga sisteme të tjera juridike kombëtare evropiane, kur ato ofrojnë referenca të dobishme për kuptimin dhe vlerësimin e zgjidhjeve shqiptare; një vend të veçantë në këtë aspekt ka modeli italian, që paraqitet si pikë referimi e dobishme si për shkak të ngjashmërive strukturore midis dy sistemeve, ashtu edhe për shkak të zgjidhjeve të zhvilluara nga e drejta italiane në lidhje me kompensimin për shkeljet e nenit 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Qasja krahasuese nuk është aplikuar në mënyrë mekanike — domethënë si transpozim i thjeshtë i zgjidhjeve të huaja — por në mënyrë funksionale, duke vlerësuar nëse dhe deri në çfarë mase zgjidhjet e huaja mund të përshtaten me specifikën e sistemit juridik shqiptar dhe me trashëgiminë e tij kushtetuese.

Nga një këndvështrim doktrinar, krahasimi juridik paraqet disa përparësi të rëndësishme për analizën e administrimit gjyqësor. Së pari, ai mundëson identifikimin e zgjidhjeve normative dhe institucionale që kanë dëshmuar qëndrueshmëri dhe efikasitet më të lartë në sisteme të tjera juridike. Në këtë kuptim, në literaturën e së drejtës krahasuese është argumentuar se zhvillimi i normave juridike mund të shfaqë një lloj “evolucioni darvinian”, ku rregullat më funksionale kanë prirje të mbijetojnë, të përhapen dhe të adoptohen nga rendet e tjera juridike¹⁰. Ky argument lidhet me konceptin e efikasitetit evolutiv të normave dhe me idenë se transplantimi juridik mund të justifikohet kur një zgjidhje e huaj ofron përgjigje më të përshtatshme ndaj një problemi institucional të ngjashëm¹¹.

¹⁰ Zywicki, Todd J. “The rise and fall of efficiency in the common law: A supply-side analysis”. *Northwestern University Law Review* 97 (2002): 1551.

¹¹ Smits, Jan M. “How to Predict the Differences in Uniformity between Different Areas of a Future European Private Law? An Evolutionary Approach” *The Economics of Harmonizing European Law*. Edward Elgar Publishing, 2002; Ogus, Anthony. “Competition between national legal systems: a contribution of economic analysis to comparative law”. *International & Comparative Law Quarterly* 48.2 (1999): 405-418; Mattei, Ugo. “Efficiency in legal transplants: An essay in comparative law and economics”. *International Review of Law and Economics* 14.1 (1994): 3-19; Ogus, Anthony. “Competition between national legal systems: a contribution of economic analysis to comparative law”. *International & Comparative Law Quarterly* 48.2 (1999): 405-418.

Së dyti, krahasimi juridik mund të përshpejtojë inovacionin në politikëbërje¹², pasi i jep ligjvënësit dhe institucioneve publike mundësinë të vlerësojnë modele të ndryshme rregullimi dhe të zgjedhin ato që u përgjigjen më mirë nevojave të sistemit kombëtar. Në këtë mënyrë, përvoja e sistemeve të tjera juridike shërben si burim reflektimi kritik për përmirësimin e zgjidhjeve vendase, pa cenuar autonominë kushtetuese dhe veçoritë institucionale të rendit juridik shqiptar.

Së treti, rëndësia praktike e krahasimit juridik forcohet edhe nga studimet empirike, që kanë evidentuar lidhjen ndërmjet cilësisë së administrimit të drejtësisë dhe treguesve të tillë si rritja ekonomike, niveli i investimeve, siguria juridike dhe besimi i publikut në institucione. Për këtë arsye, në këtë punim, krahasimi nuk përdoret vetëm si instrument teorik për të sqaruar koncepte juridike, por edhe si mjet analitik për të vlerësuar nëse modeli shqiptar i administrimit gjyqësor i afrohet standardeve ndërkombëtare dhe evropiane të efikasitetit, pavarësisë, cilësisë dhe llogaridhënies.¹³

Qasja jurisprudentiale

Qasja e katërt është jurisprudentiale, e cila analizon praktikën gjyqësore përkatëse të disa instancave gjyqësore me rëndësi për objektin e studimit. Në planin ndërkombëtar, është analizuar jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me përqendrim të veçantë në vendimet, që trajtojnë konceptin e afatit të arsyeshëm sipas nenit 6(1) të Konventës, dallimin midis çështjeve prioritare dhe joprioritare, si dhe çështje, që lidhen drejtpërdrejt me sistemin gjyqësor shqiptar — përfshirë vendimet e fundit të vitit 2025 mbi procesin e rivlerësimit kalimtar. Në planin kombëtar, është analizuar jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka legjitimuar kornizën e reformës së vitit 2016 dhe e Gjykatës së Lartë, me përqendrim të veçantë në vendimet unifikuese ose modifikuese të praktikës gjyqësore të miratuara në periudhën pas përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar. Analiza e këtyre vendimeve është realizuar duke ndjekur disa akse: identifikimin e rasteve, që trajtojnë në mënyrë eksplicite çështjen e administrimit të mirë gjyqësor, vlerësimin e referencave, që gjyqtarët e Gjykatës së Lartë bëjnë ndaj Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndaj jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ndaj jurisprudencës kushtetuese vendase, ndaj të drejtës së Bashkimit Evropian dhe ndaj të drejtës së huaj. Kjo analizë ka mundësuar identifikimin e tendencave interpretuese të Gjykatës së Lartë dhe vlerësimin e shkallës së hapjes së saj ndaj burimeve mbikombëtare dhe ndërkombëtare.

¹² Parisi, Francesco, and Larry Ribstein. "Choice of law." *The new Palgrave dictionary of economics and the law* 1 (1998): 236-241; Vihanto, Martti. "Competition between local governments as a discovery procedure". *Journal of Institutional and Theoretical Economics (JITE)/Zeitschrift für die gesamte Staatswissenschaft* (1992): 411-436.

¹³ Kapopoulos, Panayotis, and Anastasios Rizos. "Judicial efficiency and economic growth: Evidence based on European Union data". *Scottish Journal of Political Economy* 71.1 (2024): 101-131.

Hayo, Bernd, and Stefan Voigt. "The relevance of judicial procedure for economic growth". *CESifo Economic Studies* 60.3 (2014): 490-524.

Khan, Muhammad Atif, et al. "Justice and finance: Does judicial efficiency contribute to financial system efficiency?". *Borsa Istanbul Review* 24.2 (2024): 248-255.

Brody, David C. "Use of judicial performance evaluation to enhance judicial accountability, judicial independence, and public trust". *Denv. UL Rev.* 86 (2008): 115.

Magalhães, Pedro C., and Nuno Garoupa. "Judicial Performance and Trust in Legal Systems". *Social Science Quarterly* 101.5 (2020): 1743-1760.

Në këtë kuptim, punimi aplikon edhe një metodë analize të mbështetur në jurisprudencë, duke qenë se praktika gjyqësore përbën një burim të rëndësishëm për kuptimin e mënyrës se si normat juridike interpretohen, konkretizohen dhe zhvillohen në praktikë¹⁴. Rëndësia e jurisprudencës nuk kufizohet vetëm në sistemet e së drejtës së zakonshme, por është pranuar gjithnjë e më shumë edhe në traditat kontinentale, përfshirë atë franceze¹⁵, pavarësisht traditës klasike të formuluar nga Montesquieu, sipas së cilës gjyqtari është “goja e ligjit” (*le juge est la bouche de la loi*)¹⁶. Në zhvillimin bashkëkohor të së drejtës, jurisprudenca nuk shihet më vetëm si akt zbatimi mekanik i normës, por edhe si instrument interpretimi, sqarimi dhe, në raste të caktuara, zhvillimi i mëtejshëm i saj.

Në të njëjtën linjë, edhe doktrina shqiptare ka evidentuar rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të praktikës gjyqësore në sqarimin dhe plotësimin e së drejtës në fusha të ndryshme, përfshirë përgjegjësinë penale dhe civile¹⁷ në fushën mjekësore¹⁸, të drejtën e konsumatorit¹⁹, kontratat e përdorimit me afat të pasurive të paluajtshme (*time-sharing*)²⁰, si dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në çështje civile²¹, penale²² dhe administrative²³. Megjithatë, në doktrinën shqiptare ende mungon një analizë e thelluar dhe sistematike mbi rolin empirik të jurisprudencës në administrimin e sistemit gjyqësor, veçanërisht në lidhje me efikasitetin gjyqësor, afatin e arsyeshem, menaxhimin e çështjeve dhe standardet e administrimit të mirë të drejtësisë. Për këtë arsye, ky punim e trajton praktikën gjyqësore jo vetëm si burim interpretimi normativ, por edhe si tregues të mënyrës se si parimet kushtetuese dhe standardet evropiane reflektohen në funksionimin real të sistemit gjyqësor shqiptar.

Qasja empirike

Qasja e pestë është empirike, e mbështetur në analizën e të dhënave zyrtare të publikuara nga organet kombëtare të vetëqeverisjes së drejtësisë dhe nga organet ndërkombëtare. Kjo qasje është e nevojshme për të vlerësuar shkallën e zbatimit të reformave dhe për të identifikuar tendencat e treguesve kryesorë të performancës gjyqësore përgjatë periudhës së analizuar. Burimet empirike kryesore përfshijnë raportet vjetore të Këshillit të Lartë

¹⁴Ponzetto, Giacomo AM, and Patricio A. Fernandez. “Case law versus statute law: An evolutionary comparison”. *The Journal of Legal Studies* 37.2 (2008): 379-430.

¹⁵Ancel, Marc. “Case law in France”. *J. Comp. Legis. & Int’l L.* 3d ser. 16 (1934): 1.

¹⁶Merlino, Antonio. “Montesquieu e la scienza giuridica italiana (Montesquieu and Italian Legal Science)”. *Max Planck Institute for Comparative Public Law & International Law (MPIL) Research Paper* 2017-13 (2017).

¹⁷Veshi, Denard, et al. “Reckless Medication (or Medical Negligence) in Albania: A Criminal Case Law Study”. *Federalismi.it*, nr. 24, 2024, pp. 279–297.

¹⁸Shyle, Enkeleida, et al. “Medical Civil Liability in Albania: A Case-Law Approach”. *Nuovo Diritto Civile*, nr. 2, 2025, pp. 236–254; Koka, Enkelejda, et al. “EU Impact on Albanian Medical Civil Liability: A Case Law Approach”. *Freedom, Security & Justice: European Legal Studies*, nr. 2, 2025, pp. 146–161.

¹⁹Veshi, Denard. “Albania’s Judicial Approach to Consumer Protection and the Influence of EU Law”, *op. cit.*, pp. 125–140; Veshi, Denard. “Time-Sharing of Immovable Property between EU and Albanian Law: Jurisdiction, Applicable Law, and Consumer Protection in Case-Law”. *European Property Law Journal*, nr. 3, 2025, pp. 239–262.

²⁰Veshi, Denard. “Time-Sharing of Immovable Property between EU and Albanian Law: Jurisdiction, Applicable Law, and Consumer Protection in Case-Law”. *European Property Law Journal*, vol. 14, no. 3, 2025, pp. 239–262.

²¹Koka, Enkelejda, dhe Laert Sheme. “The Enforcement of Human Rights by Albanian Constitutional Judges: A Focus on Individual Constitutional Complaints in Civil Matters”. *Federalismi.it*, nr. 2, 2025, pp. 186–209.

²²Veshi, Denard, Enkelejda Koka, dhe Ervin Pupe. “The Application of the ECHR and Its Jurisprudence by Albanian Constitutional Judges in Criminal Disputes”. *Balkan Social Science Review*, nr. 1, 2025, pp. 91–137.

²³Veshi, Denard, et al. “The Application of the ECHR and Its Jurisprudence by the Albanian Constitutional Court in Administrative Disputes”. *Croatian and Comparative Public Administration*, forthcoming.

Gjyqësor, dokumentet vlerësuese të Komisionit Evropian për efikasitetin e drejtësisë, raportet vjetore të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe Tabelën e rezultateve të drejtësisë së Bashkimit Evropian. Treguesit kryesorë të analizuar përfshijnë kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve, raportin midis çështjeve të zgjidhura dhe atyre të reja të regjistruara, ngarkesën gjyqësore për gjyqtar, stokun e çështjeve të prapambetura, raportin e gjyqtarëve për 100.000 banorë, peshën e buxhetit gjyqësor në raport me buxhetin e shtetit dhe normat e plotësimit të vendeve vakante. Analiza e këtyre treguesve është realizuar në një perspektivë krahasuese — si midis periudhës para-reformë dhe asaj të zbatimit, ashtu edhe në raport me mesataret evropiane — për të identifikuar progresin, sfidat dhe boshllëqet, që kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme.

Në këtë kuadër, përdorimi i të dhënave empirike është i domosdoshëm për të shmangur kufizimin e analizës vetëm në dimensionin normativ të së drejtës. Tradicionalisht, në doktrinën juridike është bërë dallimi midis “ligjit në libra” (*law in the books*) dhe “ligjit në veprim” (*law in action*). I pari lidhet me analizën e normave juridike, strukturës së tyre të brendshme dhe koherencës sistematike të rregullimit ligjor; ndërsa i dyti fokusohet në mënyrën se si këto norma zbatohen, funksionojnë dhe prodhojnë pasoja në praktikë²⁴. Në këtë kuptim, ndërsa qasja doktrinare shqyrton përmbajtjen dhe logjikën e rregullave juridike, qasja empirike vlerëson efektivitetin real të tyre në kontekstin institucional ku ato zbatohen²⁵.

Kjo ndarje ndërmjet analizës normative dhe realitetit praktik është veçanërisht e rëndësishme për studimin e administrimit të sistemit gjyqësor, sepse efikasiteti i gjykatave, ngarkesa e gjyqtarëve, kohëzgjatja e procedurave dhe niveli i çështjeve të prapambetura nuk mund të vlerësohen vetëm mbi bazën e tekstit ligjor. Përkundrazi, ato kërkojnë shqyrtim të të dhënave konkrete mbi funksionimin e gjykatave dhe mbi ndikimin, që reformat kanë prodhuar në praktikë.

Për këtë arsye, në vitet e fundit është pranuar gjithnjë e më shumë se studimet empirike japin një kontribut thelbësor në vlerësimin e efektivitetit të së drejtës. Së pari, ato mundësojnë verifikimin nëse objektivat e parashikuara nga normat juridike arrihen realisht në praktikë²⁶. Së dyti, ndihmojnë në identifikimin e pasojave të padëshiruara të rregullimit juridik, të cilat shpesh nuk janë të parashikueshme vetëm përmes analizës doktrinare. Së treti, analiza empirike kontribuon në zhvillimin e një politikëbërjeje të bazuar në evidencë, duke rritur efektivitetin, racionalitetin dhe legjitimitetin e ndërhyrjeve normative²⁷. Për këtë arsye, në këtë punim, të dhënat empirike nuk përdoren si element plotësues formal, por si instrument thelbësor për të matur marrëdhënien ndërmjet reformës ligjore dhe funksionimit real të sistemit gjyqësor shqiptar.

Qasje ndërsektoriale dhe ndërdisiplinore

²⁴ Allison, Christine Rothmayr. “Law in books versus law in action: A review of the socio-legal literature”. *Behind a Veil of Ignorance? Power and Uncertainty in Constitutional Design*(2015): 35-54.

²⁵ Oliver Wendell Holmes Jr, “The Path of the Law” (1897) 10 Harvard Law Review 457.

²⁶ Westerman, Pauline. “Breaking the circle: goal-legislation and the need for empirical research”. *The Theory and Practice of Legislation* 1.3 (2013): 395-414.

²⁷ Princen, Sebastiaan. “The use of evidence in evidence-based legislation: A reflection”. *Eur. JL Reform* 24 (2022): 147.

Vetë objekti i këtij punimi, “Administrimi i sistemit gjyqësor në Shqipëri në këndvështrim historik dhe krahasues”, kërkon aplikimin e një qasjeje ndërsektoriale. Administrimi i drejtësisë nuk mund të kuptohet më si çështje e izoluar brenda një fushe të vetme juridike, pasi funksionimi i gjykatave ndërthur elemente të së drejtës kushtetuese, së drejtës administrative, së drejtës së të drejtave të njeriut, së drejtës evropiane dhe së drejtës krahasuese. Për këtë arsye, analiza e administrimit gjyqësor kërkon shqyrtimin e njëkohshëm të normave kushtetuese, rregullave organike të funksionimit të gjykatave, standardeve ndërkombëtare për pavarësinë dhe efikasitetin e drejtësisë, si dhe garancive procedurale që burojnë nga e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Kjo qasje ndërsektoriale reflektohet në mënyrë të veçantë në Kapitullin I, i cili aplikon një analizë historiko-kushtetuese të zhvillimit të administrimit gjyqësor në Shqipëri. Në këtë kapitull, fazat e ndryshme të zhvillimit kushtetues shqiptar nuk trajtohen vetëm si periudha historike të njëpasnjëshme, por si modele të ndryshme juridike dhe institucionale që kanë ndikuar në mënyrën e organizimit, administrimit dhe funksionimit të gjykatave. Analiza nuk kufizohet në përshkrimin e teksteve kushtetuese, por synon të evidentojë ndikimin e tyre mbi pavarësinë e gjyqësorit, organizimin territorial të gjykatave, statusin e gjyqtarëve dhe raportin ndërmjet pushtetit gjyqësor dhe pushteteve të tjera.

Nga ana tjetër, Kapitulli IV aplikon një qasje krahasuese dhe ndërkombëtare ndaj efikasitetit gjyqësor. Në këtë kapitull, funksionimi i sistemit gjyqësor shqiptar analizohet në raport me standardet e zhvilluara nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe instrumentet e Bashkimit Evropian, veçanërisht Tabelën e rezultateve të drejtësisë së Bashkimit Evropian. Në këtë mënyrë, efikasiteti gjyqësor nuk trajtohet vetëm si tregues administrativ, por edhe si garanci e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, veçanërisht në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pra, ndërsa Kapitulli I fokusohet kryesisht në normat kushtetuese dhe zhvillimin historik të organizimit të gjykatave, Kapitulli IV shqyrton standardet ndërkombëtare dhe evropiane të efikasitetit gjyqësor, duke i dhënë punimit një dimension të qartë të të drejtave të njeriut. Kjo ndërthurje lejon që administrimi i sistemit gjyqësor të analizohet jo vetëm si problem i organizimit institucional, por edhe si çështje që lidhet drejtpërdrejt me garantimin praktik të aksesit në drejtësi, afatin e arsyeshem të gjykimit dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Përveç qasjes ndërsektoriale brenda fushave të të drejtës, ky punim aplikon edhe një qasje ndërdisiplinore. Administrimi gjyqësor nuk ndikon vetëm në funksionimin e brendshëm të gjykatave, por edhe në zhvillimin shoqëror, në sigurinë juridike, në klimën ekonomike, në nivelin e investimeve dhe në besimin e qytetarëve ndaj institucioneve publike. Për këtë arsye, veçanërisht në analizën e efikasitetit gjyqësor, punimi merr në konsideratë edhe studime, që i përkasin ekonomisë, sociologjisë dhe shkencave të administrimit publik, me qëllim vlerësimin e ndikimit, që cilësia e administrimit të drejtësisë ushtron mbi shtetin e së drejtës dhe zhvillimin institucional të vendit.

Burimet e studimit

Disertacioni mbështetet mbi tri kategori burimesh kryesore, që janë trajtuar në mënyrë të ndërthurur dhe komplementare. Kategoria e parë përfshin burimet normative parësore: statutet themelore dhe kushtetutat shqiptare të periudhave të njëpasnjëshme historike,

paketën ligjore të reformës në drejtësi të vitit 2016 — me të gjashtë shtyllat ligjore, që e përbëjnë atë — legjislacionin organik, që e operacionalizon, si dhe aktet nënligjore, të miratuara nga organet e vetëqeverisjes së drejtësisë, pa harruar çështjet e shumta gjyqësore si kombëtare, po ashtu edhe evropiane, si ato të gjykyara nga GJEDNJ. Kategoria e dytë përfshin burimet institucionale dhe dokumentare: raportet vjetore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dokumentet e Komisionit Evropian për efikasitetin e erezjtësisë, raportet vjetore të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, opinionet e Komisionit të Venecias dhe rekomandimet e organeve të specializuara të Këshillit të Evropës. Kategoria e tretë përfshin burimet doktrimore: literaturën juridike vendase dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtës kushtetuese, organizimit gjyqësor, qeverisjes së drejtësisë, efikasitetit gjyqësor dhe historisë juridike shqiptare.

Kufijtë e studimit

Pavarësisht ambicies analitike të disertacionit, është e nevojshme të theksohen disa kufij të vetëdijshëm. Së pari, disertacioni përbën një kontribut me natyrë kryesisht doktrimore-juridike, kushtetuese dhe institucionale, dhe nuk merr përsipër një vlerësim sociologjik të perceptimit shoqëror të sistemit gjyqësor, as një analizë sasimore-statistikore me natyrë ekonometrike. Vlerësimi empirik është mbështetur mbi të dhëna zyrtare të publikuara dhe përmban karakter përshkrues-interpretues, jo modelues. Megjithatë, për të kufizuar këto mangësi, kjo tezë ka përdorur literaturën e shkencave të tjera sociologjike apo empirike, për të arritur një interpretim ndërdisiplinor të rregullave juridike. Mund të jepen disa shembuj konkretë. Së pari, në periudhën e komunizmit, sipas kushtetutës parashikohej ekzistenca e një sistemi gjyqësor të pavarur; megjithatë, doktrina ka treguar se në realitet kjo pavarësi nuk ekzistonte. Një shembull tjetër mund të merret nga qasja krahasuese: për shembull, efikasiteti i sistemit gjyqësor ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike dhe në nxitjen e investimeve sipërmarrëse. Pra, ndonëse kjo tezë nuk aplikon një perspektivë sociologjike dhe nuk është empirike në kuptimin e ngushtë, ajo mbështetet në literaturë nga fusha të tjera për të kufizuar mangësitë e saj metodologjike.

Së dyti, periudha empirike e analizës është e kufizuar nga disponueshmëria e të dhënave të publikuara dhe e jurisprudencës deri në momentin e dorëzimit të disertacionit, që do të thotë se zhvillimet e mëvonshme institucionale dhe jurisprudenciale mbeten jashtë analizës. Megjithatë, ky kufizim nuk e zbeh rëndësinë e analizës jurisprudenciale. Doktrina ka vënë në dukje rëndësinë e konceptit të *jurisprudence constante* edhe në rendin juridik shqiptar²⁸, veçanërisht për konsolidimin e sigurisë juridike, qëndrueshmërisë interpretuese dhe parashikueshmërisë së vendimmarrjes gjyqësore. Për rrjedhojë, ndonëse sistemi shqiptar nuk bazohet në një doktrinë formale precedenti, analiza e linjave të qëndrueshme jurisprudenciale mund të shërbejë për të identifikuar prirjet interpretuese dhe për të kuptuar mënyrën se si standardet kushtetuese, konventore dhe evropiane mund të zbatohen në praktikën e ardhshme gjyqësore.

Së treti, qasja krahasuese e këtij punimi është e përqendruar kryesisht te standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Edhe pse analiza merr në konsideratë dokumentet dhe treguesit e CEPEJ-it, duhet pasur parasysh se ky mekanizëm zhvillohet brenda hapësirës

²⁸ Veshi, Denard, Enida Bozheku, and Andrea Castaldo. "Reckless Medication (or Medical Negligence) in Albania: A Criminal Case Law Study". *federalismi.it*, no. 24, 2024, pp. 279–297.

Shyle, Enkeleida, Veshi, Denard, and Aisha Morina. "Medical Civil Liability in Albania: A Case-Law Approach". *Nuovo Diritto Civile*, no. 2, 2025, pp. 236–254.

së Këshillit të Evropës dhe nuk synon të përfshijë në mënyrë sistematike sisteme juridike jashtë kontinentit evropian. Ky kufizim është i qëllimshëm, pasi objektivi i punimit është të vlerësojë administrimin gjyqësor shqiptar në raport me standardet, që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për në procesin e integritetit evropian dhe në konsolidimin e shtetit të së drejtës. Megjithatë, fokusi evropian nuk e kufizon vlerën analitike të krahasimit. Përkundrazi, ai mundëson identifikimin e zgjidhjeve institucionale më të konsoliduara dhe më funksionale, duke evidentuar atë, që në literaturë është cilësuar si proces evolutiv i efikasitetit të normave juridike. Në këtë kuptim, krahasimi nuk përdoret për transplantim mekanik të modeleve të huaja, por për të vlerësuar se cilat standarde mund të përshtaten në mënyrë të arsyeshme me kontekstin shqiptar.

Këto kufizime nuk e cenojnë vlefshmërinë e gjetjeve të disertacionit, por kërkojnë që rezultatet të lexohen brenda kornizës metodologjike të zgjedhur dhe lënë hapur perspektiva për kërkime të mëtejshme plotësuese.

STRUKTURA E DISERTACIONIT

Përveç hyrjes dhe konkluzioneve, ky disertacioni është strukturuar në katër kapituj kryesorë, të ndërtuar sipas një logjike progresive që ndjek njëkohësisht kronologjinë historike të zhvillimit të administrimit gjyqësor në Shqipëri dhe thellimin gradual të analizës nga niveli historiko-kushtetues drejt nivelit institucional, krahasues dhe operacional. Kjo strukturë reflekton bindjen metodologjike se kuptimi i plotë i sistemit aktual të administrimit gjyqësor nuk mund të arrihet pa ndërtuar fillimisht kornizën historike, që e ka prodhuar atë, pa identifikuar momentin e shndërrimit kushtetues, që e ka rikonfiguruar dhe pa e vendosur atë në kontekstin e standardeve evropiane, me të cilat duhet të harmonizohet. Çdo kapitull mbështetet mbi gjetjet e kapitullit paraprijës dhe përgatit terrenin analitik për kapitullin pasardhës, duke krijuar kështu një tërësi koherente dhe të mirë-artikulluar. Çdo kapitull mbështetet mbi gjetjet e kapitullit paraprijës dhe përgatit terrenin analitik për kapitullin pasardhës, duke krijuar kështu një tërësi koherente dhe të mirë-artikulluar. Në të njëjtën kohë, struktura e punimit është ndërtuar në mënyrë të tillë, që secili kapitull të ruajë edhe një shkallë të caktuar autonomie analitike, duke mundësuar, që çështjet e trajtuara të lexohen si pjesë e një kërkimi të ndërthurur, por edhe si njësi të veçanta studimore brenda objektit të përgjithshëm të disertacionit.

Kapitulli i parë trajton evoluimin historiko-kushtetues të administrimit të drejtësisë në Shqipëri, nga shpallja e pavarësisë në vitin 1912 deri në miratimin e Kushtetutës së vitit 1998. Ky kapitull përbën themelin historik mbi të cilin ngrihet i gjithë disertacioni dhe është strukturuar në tri pjesë kryesore, që korrespondojnë me tri periudhat e mëdha të historisë kushtetuese shqiptare. Pjesa e parë analizon burimet kryesore të së drejtës para regjimit komunist, duke shqyrtuar Statutin Organik të vitit 1914 me ndikimin e theksuar të së drejtës osmane, Statutin e Lushnjës të vitit 1920 dhe Statutin e vitit 1922 si moment i konsolidimit të pavarësisë gjyqësore, si dhe statutet e periudhës së Zogut I — Statutin Themelor të Republikës Shqiptare të vitit 1925, Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare të vitit 1928 dhe Statutin Themeltar të Mbretënisë së Shqipërisë të vitit 1939. Pjesa e dytë analizon burimet kryesore të së drejtës gjatë regjimit komunist, duke shqyrtuar Statutin e vitit 1946 si akt i konsolidimit të regjimit, Kushtetutën e vitit 1950 si shprehje e stalinizimit dhe Kushtetutën e vitit 1976 si rend kushtetues autark, duke nxjerrë në pah dallimin midis pavarësisë formale dhe pavarësisë substanciale të gjyqësorit. Pjesa e tretë analizon burimet

kryesore të së drejtës pas regjimit komunist, me përqendrim të veçantë në Ligjin 7491 të vitit 1991 si instrument tranzitor dhe në Kushtetutën e vitit 1998. Përmes këtij ndërtimi, kapitulli identifikon vazhdimësitë dhe ndërprerjet kushtetuese në administrimin gjyqësor shqiptar dhe ofron kornizën interpretuese për kuptimin e reformës së vitit 2016 si moment kulminant i një procesi më të gjatë historik.

Kapitulli i dytë analizon reformën kushtetuese të vitit 2016 si ndërhyrjen më të gjerë legislative në sistemin gjyqësor shqiptar pas miratimit të Kushtetutës aktuale. Ky kapitull paraqet kontekstin politik dhe institucional të reformës, duke identifikuar shkaqet që e bënë atë jo një alternativë politike, por një domosdoshmëri sistemike. Më tej, kapitulli analizon shtyllat themelore ligjore të reformës — paketën ligjore të miratuar gjatë vitit 2016 — dhe veçanërisht amendamentet kushtetuese si akti themelues i të gjithë procesit. Kapitulli shqyrton riformatimin e Gjykatës Kushtetuese, përfshirë ndryshimin e mënyrës së përbërjes dhe zgjedhjes së anëtarëve, krijimin e regjimit disiplinor dhe ridimensionimin e ankimit kushtetues individual si mjet i ri kushtetues, mbrojtës i të drejtave themelore. Vëmendje e veçantë i kushtohet krijimit të organeve të reja kushtetuese të vetëqeverisjes së sistemit të drejtësisë, riformatimit të statusit të magjistratit, ngritjes së strukturave të specializuara antikorrupsion dhe procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kapitulli identifikon logjikat themelore dogmatike që përshkojnë reformën — parimin e ndarjes funksionale brenda qeverisjes së gjyqësorit, parimin e pavarësisë horizontale midis gjyqësorit dhe prokurorisë dhe parimin e specializimit antikorrupsion — dhe vlerëson legjitimitetin kushtetues dhe ndërkombëtar të reformës përmes jurisprudencës konfirmuese të Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Strasburgut. Më tej trajtohet riorganizimin gjeografik të gjykatave përmes reformës së Hartës së re gjyqësore. Kjo pjesë është strukturuar sipas një logjike krahasuese kohore: ku analizohen në mënyrë të njëpasnjëshme periudha para-reformë, procesi institucional i hartimit dhe miratimit të reformës, faza e zbatimit të saj dhe konsolidimi institucional pasues. Analiza përfshin shqyrtimin e bazës ligjore të reformës, vlerësimin e legjitimitetit të riorganizimit përballë procesit gjyqësor kushtetues të nisur nga Dhoma e Avokatisë, identifikimin e disekuilibrave strukturorë të organizimit territorial të mëparshëm dhe vlerësimin empirik të pasojave të reformës mbi treguesit kryesorë të performancës gjyqësore. Vëmendje e veçantë i kushtohet rikualifikimit të hartës gjyqësore nga kategori politiko-administrative në kategori juridiko-kushtetuese, si pasojë e zhvendosjes së kompetencës propozuese tek Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe ndarjes së dimensionit gjeografik të aksesit në drejtësi nga ai substancial.

Kapitulli i tretë analizon reformën në organizimin dhe administrimin e brendshëm të gjykatave, me përqendrim të veçantë tek Këshilli i Lartë Gjyqësor si organ kushtetues i vetëqeverisjes profesionale. Kapitulli shqyrton themelet kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, përbërjen e tij të përzier midis magjistratëve dhe anëtarëve jogjyqtarë, kompetencat administrative, buxhetore, disiplinore dhe planifikuese-strategjike, si dhe strukturat e brendshme, përmes të cilave ai ushtron funksionet e tij. Kapitulli analizon ndërveprimin e Këshillit me organet e tjera kushtetuese dhe veçanërisht me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në fushën disiplinore. Më tej, kapitulli trajton ndryshimet menaxheriale brenda gjykatave — krijimin e Këshillit të Gjykatës si organ kolegjal menaxherial, ngritjen e figurës së re të Kancelarit si menaxher administrativ profesional, formalizimin e

Mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve me kompetenca të mirëpërcaktuara, si dhe ngritjen e kategorisë së shërbimit civil gjyqësor. Pjesa përmbyllëse e kapitullit i kushtohet procesit të digjitalizimit të procedurave gjyqësore si komponent thelbësor i modernizimit institucional dhe i pajtueshmërisë me standardet evropiane.

Kapitulli i katërt trajton efikasitetin gjyqësor në një qasje krahasuese, duke e vendosur sistemin shqiptar në kontekstin e standardeve ndërkombëtare, mbikombëtare dhe kombëtare. Pjesa e parë e kapitullit analizon kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe veçanërisht kontributin e Komisionit Evropian për efikasitetin e drejtësisë, përfshirë mjetin e dedikuar për reduktimin e çështjeve të prapambetura, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi konceptin e afatit të arsyeshëm dhe dallimin midis çështjeve prioritare dhe joprioritare. Vëmendje e veçantë i kushtohet marrëdhënies midis procesit të rivlerësimit kalimtar dhe nenit 6(1) KEDNJ, duke shqyrtuar standardin e provës që zbatohet në procedurat e vetingut dhe pyetjen nëse ky proces mund të shërbejë si justifikim për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore, mbi bazën e jurisprudencës më të fundit të vitit 2025 mbi çështjet shqiptare. Pjesa e dytë e kapitullit analizon Tabelën e rezultateve të drejtësisë së Bashkimit Evropian si instrument për administrimin gjyqësor në nivelin mbikombëtar, marrëdhënien e saj me Semestrin Evropian dhe me Raportin vjetor të shtetit të së drejtës, si dhe rëndësinë e të drejtës së Bashkimit Evropian për Shqipërinë në kuadër të procesit të integritetit. Pjesa e tretë e kapitullit analizon rëndësinë e administrimit gjyqësor në Shqipëri dhe veçanërisht qasjen gjyqësore të Gjykatës së Lartë, përmes analizës së vendimeve unifikuese ose modifikuese të praktikës gjyqësore, të miratuara në periudhën pas përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar deri në fund të vitit 2025, me përqendrim të veçantë te vendimet, që trajtojnë në mënyrë eksplicite çështjen e administrimit të mirë gjyqësor.

Kapitulli i pestë dhe i fundit i disertacionit i kushtohet sfidave aktuale dhe perspektivave të së ardhmes, duke formuluar përfundimet e përgjithshme dhe rekomandimet konkrete që rrjedhin nga analiza e kryer në kapitujt paraprirës. Ky kapitull rimerr në një sintezë interpretuese gjetjet kryesore të disertacionit, vlerëson legjitimitetin e dyfishtë — kushtetues dhe ndërkombëtar — të reformës së vitit 2016 dhe identifikon sfidat strukturore me natyrë sistematike, që kushtëzojnë qëndrueshmërinë e saj afatgjatë. Mbi këtë bazë, kapitulli formulon rekomandime konkrete për përmirësimin e administrimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, të cilat trajtojnë si dimensionin institucional dhe atë normativ, ashtu edhe atë financiar dhe njerëzor, gjithmonë në përputhje me standardet evropiane dhe me detyrimet, që rrjedhin nga procesi i integritetit në Bashkimin Evropian.

ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Bazuar në faktin se, sipas të dhënave më të fundit të CEPEJ-it²⁹, Shqipëria vijon të paraqesë tregues relativisht të dobët në raport me efikasitetin e sistemit gjyqësor, veçanërisht sa i përket kohëzgjatjes së procedurave, ngarkesës gjyqësore, stokut të çështjeve të

²⁹ Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), *European Judicial Systems: CEPEJ Evaluation Report – 2024 Evaluation Cycle (2022 Data)*, October 2024. I disponueshëm në: <https://rm.coe.int/cepej-evaluation-report-part-1-en-/1680b272ac>

prapambetura dhe kapaciteteve njerëzore të sistemit, pyetja kryesore kërkimore e këtij punimi është: si mund të arrihet një përmirësim konkret dhe i qëndrueshëm i efikasitetit të sistemit gjyqësor shqiptar, duke u mbështetur në një qasje historiko-kushtetuese, krahasuese dhe empirike të administrimit të drejtësisë?

Kjo pyetje kryesore orientohet rreth një sërë nën-pyetjesh kërkimore të mirëpërcaktuara, të cilat shprehin problematikat thelbësore, që dalin nga ndërthurja e dimensionit historiko-kushtetues, atij doktrinor-juridik dhe atij krahasues të administrimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Këto nën-pyetje nuk janë formuluar si interrogativa të shkëputura, por si akse analitike të lidhura midis tyre, secila prej të cilave gjen përgjigje të strukturuar përgjatë kapitujve të disertacionit. Formulimi i tyre i shprehur ka për qëllim të shërbejë si pikë referimi për doktrinën, profesionistët e ligjit, por edhe për ligjvënësin dhe njëkohësisht, si parametër për vlerësimin e koherencës së brendshme të analizës dhe të vlerës së përgjigjeve të ofruara.

Një nga çështjet themelore që ngre disertacioni lidhet me dimensionin historiko-kushtetues të administrimit të drejtësisë në Shqipëri dhe shtrohet në formën e mëposhtme: cilat janë elementet e vazhdimësisë dhe të ndërprerjes në evoluimin kushtetues të organizimit dhe administrimit të gjykatave shqiptare nga shpallja e pavarësisë në vitin 1912 deri në miratimin e Kushtetutës së vitit 1998 dhe deri në çfarë mase parimet themelore të pavarësisë së gjyqësorit, palëvizshmërisë së gjyqtarëve, juridiksionit territorial, si dhe ndalimit të gjykatave të jashtëzakonshme janë konsoliduar në mënyrë progresive ose janë cenuar në periudha të caktuara historike? Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje është e nevojshme për të kuptuar specifikën e modelit shqiptar dhe për të vendosur reformat aktuale në një vazhdimësi më të gjerë institucionale, duke shmangur leximin e tyre si akte të izoluara historike.

Një çështje tjetër me rëndësi lidhet me ndikimin e trashëgimisë juridike osmane dhe të modeleve evropiane perëndimore mbi formësimin e ligjit të parë themelor shqiptar dhe shtrohet si më poshtë: cili është ndikimi i së drejtës osmane mbi Statutin Organik të vitit 1914 dhe si ka evoluar marrëdhënia midis kësaj trashëgimie juridike, modeleve evropiane perëndimore dhe nevojave specifike të shtetit të ri shqiptar në procesin e ndërtimit të një kornize ligjore funksionale për administrimin e drejtësisë? Kjo pyetje fton një lexim, që tejkalon qasjen e kufizuar tekstuale, duke nxjerrë në pah natyrën hibride të rendit juridik shqiptar në fazat e tij të hershme dhe pragmatizmin e ligjvënësit kushtetues të asaj kohe.

Krahas kësaj, disertacioni shqyrton edhe natyrën formale dhe substanciale të pavarësisë gjyqësore gjatë regjimit komunist, duke parashtruar pyetjen: deri në çfarë mase parimi i pavarësisë së gjyqësorit, i parashikuar formalisht në kushtetutat e periudhës komuniste, gjeti zbatim substancial në praktikën institucionale, si dhe çfarë roli luajti modeli sovjetik dhe ideologjia marksiste-leniniste në kushtëzimin e administrimit të drejtësisë gjatë kësaj periudhe? Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje është thelbësore për të kuptuar dallimin midis garantimit normativ dhe garantimit funksional të pavarësisë së gjyqësorit, si dhe për të nxjerrë në pah pasojat afatgjata, që ka pasur regjimi komunist mbi kulturën institucionale shqiptare.

Një çështje qendrore e disertacionit lidhet me natyrën transformuese të reformës kushtetuese të vitit 2016 dhe shtrohet në formën e mëposhtme: a përbën reforma e vitit 2016 një rishikim teknik të organizimit gjyqësor apo një riformatim institucional të tërë sistemit të drejtësisë, si dhe cilat janë logjikat themelore dogmatike që e përshkojnë atë? Kjo pyetje synon të vlerësojë natyrën e reformës dhe të identifikojë parimet themelore që e karakterizojnë — parimin e ndarjes funksionale brenda qeverisjes së gjyqësorit, parimin e pavarësisë horizontale midis gjyqësorit dhe prokurorisë dhe parimin e specializimit antikorruption — duke vendosur kështu themelet doktrinale për kuptimin e arkitekturës së re institucionale.

Pjesë integrale e diskutimit është edhe çështja e legjitimitetit të dyfishtë — kushtetues dhe ndërkombëtar — të reformës, e cila shtrohet si më poshtë: si është konfirmuar legjitimiteti i kornizës së reformës së vitit 2016 nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe deri në çfarë mase ky konfirmim i dyfishtë mund të konsiderohet si garanci e qëndrueshmërisë afatgjatë të reformës? Kjo pyetje fton një analizë të integruar të jurisprudencës vendase dhe asaj të Strasburgut. Po ashtu, disertacioni shtron çështjen e marrëdhënies midis pavarësisë institucionale dhe llogaridhënies publike, duke shtruar pyetjen: si arrin korniza e reformës së vitit 2016 të balancojë parimin e pavarësisë institucionale të gjyqësorit me kërkesën e llogaridhënies publike të tij, si dhe a mund të konsiderohet ky balancim si shprehje e maturimit të demokracisë kushtetuese shqiptare? Kjo pyetje vendos në qendër një tendosje themelore të konstitucionalizmit bashkëkohor — atë midis autonomisë funksionale dhe kontrollit demokratik — dhe e shqyrton atë në specifikën e zgjidhjeve shqiptare.

Një çështje e veçantë trajtohet në lidhje me legjitimitetin e riorganizimit gjeografik të gjykatave dhe parashtrohet si më poshtë: a përbën reforma e Hartës së re gjyqësore një ndërhyrje legjitime në organizimin territorial të drejtësisë, duke pasur parasysh tendosjen midis aksesit gjeografik dhe aksesit substancial në drejtësi, dhe çfarë roli luan zhvendosja e kompetencës propozuese tek Këshilli i Lartë Gjyqësor në rikualifikimin e hartës gjyqësore nga kategori politiko-administrative në kategori juridiko-kushtetuese? Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje kërkon ndërthurjen e analizës normative me vlerësimin empirik të pasojave të reformës.

Disertacioni shtron, gjithashtu, një çështje të veçantë në lidhje me rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor si organ i vetëqeverisjes profesionale: deri në çfarë mase Këshilli i Lartë Gjyqësor ka arritur të ushtrojë funksionet kushtetuese, që i janë besuar — si organ i administrimit të karrierës së gjyqtarëve, si planifikues strategjik, si hartues i buxhetit gjyqësor dhe si propozues i hartës gjyqësore — cilat janë sfidat strukturore, që kushtëzojnë konsolidimin e tij të mëtejshëm institucional? Kjo pyetje synon të vlerësojë në mënyrë të diferencuar konsolidimin formal-institucional dhe atë praktik-funksional të organit qendror të vetëqeverisjes së gjyqësorit shqiptar.

Pjesë e diskutimit është edhe çështja e harmonizimit të modelit shqiptar të administrimit gjyqësor me standardet evropiane, e cila shtrohet në formën e mëposhtme: deri në çfarë mase modeli shqiptar i administrimit gjyqësor është në përputhje me standardet e zhvilluara nga Komisioni Evropian për efikasitetin e drejtësisë, me opinionet e Komisionit të

Venecias, me rekomandimet e Këshillit konsultativ të gjyqtarëve evropianë dhe me parametrat e Tabelës së rezultateve të drejtësisë së Bashkimit Evropian, dhe çfarë vendi zë ai në tipologjinë e modeleve evropiane të qeverisjes së gjyqësorit? Kjo pyetje vendos modelin shqiptar në kornizën më të gjerë evropiane dhe ofron parametrat e nevojshëm krahasues për vlerësimin e tij.

Një çështje me rëndësi të veçantë lidhet me marrëdhënien midis procesit të rivlerësimit kalimtar dhe garancive të nenit 6(1) KEDNJ dhe shtrohet si më poshtë: deri në çfarë mase procesi i rivlerësimit kalimtar të magjistratëve është në përputhje me garancitë e nenit 6(1) të Konventës, dhe a mund të shërbejë ky proces si justifikim për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore përtej afatit të arsyeshëm, mbi bazën e jurisprudencës më të fundit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjet shqiptare? Kjo pyetje shqyrton një nga tendosjet më delikate të reformës — atë midis nevojës së “pastrimit” institucional dhe respektimit të garancive procedurale për magjistratët e nënshtuar procesit dhe për qytetarët që presin gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë kuadër, disertacioni shqyrton edhe nëse procesi i rivlerësimit kalimtar mund të përdoret si justifikim për kufizimin ose moszbatimin e plotë të garancive të nenit 6(1) të KEDNJ-së. Kjo pyetje analizohet edhe në dritën e praktikës më të fundit të GJEDNJ-së ndaj Shqipërisë gjatë vitit 2025, e cila ka trajtuar çështje të lidhura me vetingun, procesin e rregullt dhe garancitë procedurale të magjistratëve.

Disertacioni shtron gjithashtu një pyetje në lidhje me orientimin interpretues të Gjykatës së Lartë në periudhën pas përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar: si është reflektuar koncepti i administrimit të mirë gjyqësor në vendimet unifikuese ose modifikuese të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë në periudhën pas vetingut, dhe deri në çfarë mase gjyqtarët shqiptarë i referohen burimeve mbikombëtare dhe ndërkombëtare — Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, së drejtës së Bashkimit Evropian dhe së drejtës së huaj — në arsyetimin e vendimeve të tyre? Kjo pyetje shqyrton kulturën interpretuese të Gjykatës së Lartë dhe shkallën e hapjes së saj ndaj burimeve të jashtme. Së fundi, disertacioni shtron një pyetje sintetizuese që përshkon në mënyrë të nënkuptuar gjithë analizën: cilat janë sfidat strukturore aktuale që kushtëzojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të reformës së administrimit gjyqësor në Shqipëri, dhe cilat janë drejtimitet e mundshme të zhvillimit të mëtejshëm institucional, normativ dhe operacional që mund të kontribuojnë në konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit në Bashkimin Evropian? Kjo pyetje gjen përgjigje sintetike në kapitullin përmbyllës dhe shërben si pikë lidhëse midis analizës doktrinare-juridike dhe formulimit të rekomandimeve konkrete.

Përgjigja e strukturuar ndaj këtyre çështjeve kërkimore përbën kontributin origjinal të disertacionit dhe siguron koherencën e brendshme të analizës. Ato nuk janë formuluar si pyetje retorike, por si çështje, që kërkojnë demonstrim të mbështetur në burime normative, institucionale, jurisprudenciale dhe doktrinare. Verifikimi i shkallës, në të cilën këto pyetje gjejnë përgjigje të mirë-argumentuar përgjatë kapitujve të disertacionit, përbën edhe parametrin kryesor, mbi të cilin mund të vlerësohet vlera shkencore e kontributit të paraqitur.

KAPITULLI I

ADMINISTRIMI I DREJTËSISË NË SHQIPËRI NGA PAVARËSIA DERI NË KUSHTETUTËN E VITIT 1998: NJË KËNDVËSHTRIM HISTORIKO-KUSHTETUES

1.1 Burimet kryesore të të drejtës në Shqipëri para regjimit komunist

1.1.1 Ligji i parë themelor shqiptar: Statuti Organik i Shqipërisë

Ky kapitull ofron një vështrim kërkimor, përmes një qasjeje historike, mbi zhvillimin kushtetues të organizimit të gjykatave në Shqipëri. Rasti shqiptar u zgjodh, jo vetëm për shkak të problemeve të nënvizuara nga raporti i BE-së, por edhe pasi në nëntor 2025, Shqipëria hapi të gjithë kapitujt e negociatave.³⁰ Kapitulli aplikon një qasje kushtetuese pasi pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1912, Shqipëria u përball me disa reforma kushtetuese: principati kushtetues (1914), i cili gjithashtu u konfirmua në vitet 1920 dhe 1922, republika parlamentare (1925), monarkia demokratike (1928), monarkia kushtetuese (1939), republika popullore (1950), republika socialiste (1976) dhe republika aktuale parlamentare (1991 e konfirmuar në vitin 1998).³¹

Përveç analizës kritike ligjore,³² ky kapitull aplikon një metodë ligjore diakronike duke u fokusuar në normat kushtetuese. Ky kapitull përbëhet nga tre seksione kryesore, të strukturuar sipas periudhave përkatëse historike. Këto seksione ndahen në funksion të regjimit komunist, i cili përbënte një nga regjimet më totalitare në Evropë.

Veçantia e këtij kapitulli qëndron në identifikimin e ndikimit të së drejtës osmane mbi ligjin e parë themelor shqiptar, *Statuti Organik i Shqipërisë* i 10 prillit 1914.³³ Gjithashtu, ai zbulon evolucionin e administrimit të gjykatave në Shqipëri, duke identifikuar elementet e reja.³⁴

Megjithatë, ndikimi i ligjit osman mund të shihej në mënyra të ndryshme. Së pari dhe më e rëndësishmja, ligjvënësit shqiptarë në atë kohë ishin shumë të vetëdijshëm se një shtet nuk mund të funksionojë pa një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse. Prandaj, Statuti Organik i vitit 1914 pranoi në mënyrë eksplicite rëndësinë e vazhdueshme të ligjit osman, të paktën derisa legjislacioni i ri shqiptar të mund të miratohej sistematikisht. Në praktikë, kjo do të thoshte që normat ligjore osmane mbetën të zbatueshme në fushat kryesore të ligjit civil, pronës dhe burimeve natyrore.

Për shembull, neni 184 ruajti parimet osmane në lidhje me pronën private, duke përfshirë njohjen e pronësisë dhe kërkesat provuese për të provuar posedimin. Neni 198

³⁰ Council of the European Union. "International Ministerial Meeting, 17 November 2025". <https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/international-ministerial-meetings/2025/11/17/>

³¹ Shyle, Enkeleida, et al. "History of Medical Civil Liability in Albania during the XXth Century: An Intersectoral Legal Approach." *International Journal of Legal History and Institutions*, 2025, pp. 145–166.

³² Duhet theksuar se Shqipëria renditet e fundit për nga prodhimi shkencor (Euronews, "Albania Ranks Last in Europe for Scientific Research, According to Study", 2023, në dispozicion në: <https://euronews.al/en/albania-ranks-last-in-europe-for-scientific-research-according-to-study/>). Për këtë arsye, ky punim merr në konsideratë edhe doktrinën e huaj për të analizuar kontekstin shqiptar.

³³ Merkuri, E. "Të Drejtat Kushtetuese dhe e Drejta Penale (Constitutional Rights and Criminal Law)." OSCE, 2024. ISBN 9789928395375 (Ndonëse ky punim përqendrohet në qasjen kushtetuese, ai thekson ndikimin e terminologjisë së vjetër juridike shqiptare, në veçanti përdorimin e konceptit juridik të *Kanunit*, një trup rregullash zakonore që rregullonin sjelljen shoqërore, marrëdhëniet familjare dhe pronën në disa komunitete shqiptare; ky term vijoi të përdorej edhe pas pavarësisë, kur u vendos pozitivizmi juridik; shembuj tipikë janë *Kanuni i Zhurisë* (23 maj 1913), i miratuar nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës, që rregullonte procedurën penale—hetimin, gjykimin me juri dhe apelinimet para Gjykatës së Diktimit—si dhe *Kanuni mbi Gjykatat e Drejtësisë në Shqipëri* (4 qershor 1914), i hartuar dhe miratuar me dekret princëror). Vinjau, S. *E drejta kushtetuese*. Shtypshkronja "Nikaj", Tiranë, 1923, p. 8.

³⁴ Vinjau, S. *E drejta kushtetuese*. Shtypshkronja "Nikaj", Tiranë, 1923, p. 8.

mbajti zbatimin e rregulloreve osmane në lidhje me zbulimin, koncesionin dhe shfrytëzimin e minierave derisa Ministria e Bujqësisë mund të nxirrte rregulla të reja. Po kështu, neni 199 ruajti ligjet osmane për pyjet, duke ia caktuar përgjegjësinë për zbatimin e tyre Inspektorit të Përgjithshëm të Pyjeve. Përmes këtyre dispozitave, Kushtetuta e parë shqiptare siguroi vazhdimësinë dhe stabilitetin ligjor, duke i mundësuar shtetit të ri shqiptar të funksionojë në mënyrë efektive duke zhvilluar gradualisht sistemin e tij ligjor të brendshëm. Kjo qasje demonstroi një njohje pragmatike të nevojës për një rend juridik të menjëhershëm dhe funksional krahas projektit afatgjatë të modernizimit legjislativ.

Së dyti, organizimi territorial sipas *Statutit Organik të Shqipërisë* ishte i strukturuar në *sanxhaqe*, *kaza*, *nahije* dhe *bashki*.³⁵ Në atë kohë, ekzistonin shtatë *sanxhaqe*—Shkodra, Elbasani, Dibra, Durrësi, Korça dhe Gjirokastra (Neni 95). Këto *sanxhaqe* paraqiten të ngjashme me ndarjen e sotme në prefektura për dy arsye kryesore. Së pari, *sanxhaqet* drejtoheshin nga *mytesarifët*, të cilët i përgjigjeshin Ministrit të Punëve të Brendshme ose, brenda kufijve të kompetencave të tyre, ministrave të tjerë (Neni 100). Së dyti, Këshilli i *Sanxhaqeve* ishte i përcaktuar me ligj dhe përfshinte funksionarë si Sekretari i Përgjithshëm, Kryekontabilisti, Drejtori i Arsimit, Drejtori i Punëve Publike dhe Drejtori i Bujqësisë dhe Tregtisë, së bashku me përfaqësues të njësive vartëse, *kazave* (Neni 109).

Çdo *kazá* drejtohej nga një *kajmekam*, dhe këshilli i saj përbëhej nga funksionarë të përcaktuar me ligj—përfshirë sekretarin, kontabilistin dhe drejtorin e tatimit mbi tokën—si dhe katër anëtarë shtesë të zgjedhur nga këshillat bashkiakë të vendbanimeve përbërëse të kazasë, me shumicë absolute të votave të të pranishmëve, të mbledhur në qendrën administrative të kazasë me thirrjen e *kajmekamit* (Neni 125). Përveç *kazave*, statuti parashikonte edhe *nahije*, të cilat përbëheshin nga grupe fshatrash të lidhura gjeografikisht dhe ekonomikisht, me një popullsi totale nga 4,000 deri në 7,000 banorë (Neni 132). *Bashkitë* krijoheshin për qendra urbane më të mëdha—ato me mbi 2,500 banorë—ose për kryeqendrat administrative të *sanxhaqeve* dhe *kazave* (Neni 139). Përmes kësaj strukture hierarkike, statuti synonte të balancoje mbikëqyrjen qendrore me përfaqësimin vendor, duke siguruar koherencë administrative dhe njëkohësisht duke marrë parasysh realitetet e larmishme demografike të Shqipërisë.

Së treti, ndikimi i të drejtës osmane pasqyrohej edhe në gjuhën e përdorur në *Statutin Organik* të vitit 1914. Përtej rastit të organizimit territorial, disa terma juridikë osmanë u ruajtën, duke treguar si vazhdimësinë ashtu edhe natyrën tranzitore të sistemit juridik shqiptar në fazat e tij të hershme. Për shembull, *mulk* nënkupton pronë plotësisht private dhe të lirë (Neni 187), ndërsa *vakëfe* i referohet të ardhurave nga pronat e dedikuara ose të dhuruara (Neni 190).

Duhet theksuar se *Statuti Organik* i vitit 1914 nuk i organizonte nenet e tij në paragrafë të veçantë. Duke u përqendruar te ndarja e pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit, përveç Kapitullit X (Nenet 159–167), i cili i kushtohet gjyqësorit, është e rëndësishme të evidentohen edhe Nenet 92 dhe 107. Neni 92 sqaron se masat disiplinore administrative vendosen në përputhje me rregulloret e brendshme të ministrive përkatëse. Gjithashtu, Neni 107 përcakton se, meqenëse gjykatat janë të pavarura nga administrata civile, *mytesarifi* (drejtuesi i *sanxhaqeve*) nuk mund të ndërhyjë në asnjë mënyrë në çështjet gjyqësore. Këto dispozita dëshmojnë për përpjekjet e hershme të statutit për të përcaktuar qartë ndarjen

³⁵ Ndreu, Aurora. "Characteristics of Local Governance after 1912 in Albania". *Social and Natural Sciences Journal*, vol. 10, no. 1, 2016 (Për ndarjen administrative, shih gjithashtu këtë studim, i cili analizon karakteristikat e qeverisjes vendore në Shqipëri pas vitit 1912).

ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor, duke garantuar se gjyqësori funksionon i pavarur nga aparati administrativ.

Sipas Kapitullit X të *Statutit Organik* të vitit 1914, organet gjyqësore ishin të strukturuar si vijon: 1) *Këshilli i Pleqve* (Council of Elders); 2) *Gjykatësit e Paqtues* (justices of the peace); 3) *Gjykatat e Shkallës së Parë* (Courts of First Instance); dhe 4) *Gjykatat e Apelit* (Courts of Appeal). Këtyre gjykatave u caktohej kompetencë territoriale: *Këshilli i Pleqve* funksiononte në çdo fshat; *gjykatësit e paqtues* vendoseshin në zona të përcaktuara me dekret ministror; ndërsa *gjykatat e shkallës së parë* ngriheshin në çdo *sanxhak*, si dhe në *kazá* ku shihej e nevojshme.

Gjykatat, gjithashtu, kishin kompetencë për lloje specifike të çështjeve. Në atë kohë, seancat gjyqësore gjyktonin çështje civile, tregtare ose penale. Në çështjet civile, *Këshilli i Pleqve* kishte juridiksion mbi mosmarrëveshjet, që lindnin nga dëmet e shkaktuara brenda një fshati, me gjoba që varionin nga 10 (dhjetë) deri në 100 (njëqind) franga. Gjyqtarët e paqes ishin kompetentë për mosmarrëveshjet, që përfshinin shumën nga 100 (njëqind) deri në 500 (pesëqind) franga, ndërsa Gjykatat e Shkallës së Parë trajtonin të gjitha çështjet me vlerë mbi 500 (pesëqind) franga dhe deri në 1,000 (një mijë) franga. Veçanërisht, nuk kishte të drejtë apeli në çështjet civile që përfshinin shumën nën 1,000 (një mijë) franga.

Në çështjet tregtare, Gjykatat e Shkallës së Parë morën juridiksionin e ushtruar më parë nga gjykatat tregtare të krijuara nën regjimin osman.

Në çështjet penale, *Këshilli i Pleqve* nuk ushtroi asnjë juridiksion. Për veprat e dënueshme me burgim nga njëzet e katër orë deri në një javë, procedimi penal fillonte me gjyqtarin e paqes dhe nuk lejohej asnjë apel. Për veprat e dënueshme me burgim nga një javë deri në tre muaj, procedimi penal fillonte me gjyqtarin e paqes, me mundësi ankimi në Gjykatat e Shkallës së Parë. Krimet më të rënda dhe të gjitha kundërvajtjet ishin në juridiksionin e Gjykatave të Shkallës së Parë.

Ky sistem pasqyron një përpjekje të hershme të shtetit shqiptar për të strukturuar autoritetin gjyqësor sipas kriterëve territoriale dhe lëndore, duke ruajtur disa praktika të trashëguara nga sistemi ligjor osman.

Mjaft interesant është fakti se krijimi i një gjykate më të lartë se gjykata e apelit, si dhe i çdo gjykate tjetër të posaçme, lihej në diskrecionin e Princit dhe të qeverisë së tij (Neni 168). Megjithatë, duhet theksuar se ndërveprimi ndërmjet gjyqësorit dhe pushtetit legjislativ ose ekzekutiv, si edhe me vetë Princin, pasqyrohet edhe në dispozita të tjera të statutit.

Së pari, organizimi gjyqësor u krijua si në kushtetutë ashtu edhe në të drejtën e zakonshme. Për shembull, *Këshilli i Pleqve* ulej në çdo fshat dhe konstituohej sipas ligjit (Neni 160). Për më tepër, kushtet, që gjyqtarët e të gjitha kategorive duhej të plotësonin në lidhje me emërimin dhe renditjen e tyre, duhej të trajtoheshin në një ligj të veçantë (Neni 165). Përveç kompetencave të parashikuara nga statuti, gjyqtarëve të paqes, gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit mund t'u caktoheshin edhe detyra të tjera sipas ligjeve të ndryshme (Neni 166).

Së dyti, selitë e tre gjykatave të apelit do të përcaktoheshin nga qeveria (Neni 163), ndërsa *gjykatësit e paqtuesit* do të vendoseshin në vendndodhje të caktuara me dekret ministror (Neni 161). Për më tepër, *mytesarif*i, i cili drejtonte *sanxhakun*, ishte përgjegjës për ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes së nevojshme për zbatimin e vendimeve gjyqësore (Neni 107).

Së treti, gjyqtarët e paqes duhej të emëroheshin me dekret princëror (Neni 161). Emërimi nga palët e paanshme, që përfaqësonin unitetin (Princi apo Presidenti, që ishin krerët e shtetit) u vendos edhe në Shqipërinë postkomuniste deri në reformën Kushtetuese të vitit 2016, ku emërimi i tyre bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Mjaft interesant, ishte dhe roli i prokurorit në atë kohë (Neni 169). Së pari, prokurori ishte përgjegjës për ruajtjen e rendit në gjykata dhe sigurimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Së dyti, prokurori kishte autoritet mbikëqyrës mbi policinë gjyqësore. Së treti, në çështjet civile, prokurori vepronte sa herë që interesat e ligjit e kërkonin.

1.1.2 Konsolidimi i pavarësisë gjyqësore: nga Statuti i Lushnjës (1920) te Statuti i vitit 1922

Në vitin 1920 u miratuan *Bazat e Kanunores së Këshillës së Naltë* (Foundations of the Code of the High Council), të njohura ndryshe si *Statuti i Lushnjës* (Statute of Lushnje). Sistemi monarkik mbeti në fuqi: nëse *Statuti Organik* i vitit 1914 e kishte përcaktuar Shqipërinë si një principatë kushtetuese, Statuti i vitit 1920 parashikonte se, me ardhjen e Mbretit në fron, Këshilli i Naltë shpërndahej automatikisht (Neni 6). Duhet theksuar se Statuti i vitit 1920 ishte jashtëzakonisht i shkurtër, i përbërë vetëm nga gjashtë nene; ai u zgjerua vetëm në vitin 1922.

Ndërsa Statuti i vitit 1914 ishte i strukturuar kryesisht nëpërmjet neneve pa ndarje në paragrafë, Statuti i vitit 1922 ishte ligji i parë themelor shqiptar, që i organizoi nenet në paragrafë. Për më tepër, ndërsa Statuti i vitit 1914 pasqyronte ndikimin e të drejtës osmane, Statuti i vitit 1922 nuk përmbante më referenca të tilla.

Statuti i vitit 1914 përcaktonte se gjyqtarët janë të palëvizshëm (Neni 165), duke shënuar një hap të rëndësishëm për pavarësinë e gjyqësorit. Megjithatë, pavarësia e gjyqësorit u kodifikua shprehimisht për herë të parë në nivel kushtetues në Nenin 80 të Statutit të vitit 1922. Për të theksuar këtë pavarësi, gjyqtarët nuk mund të shkarkoheshin përveçse me pëlqimin e tyre ose me vendim të *Gjykatës së Diktimit* për shkelje disiplinore (Neni 85(2)).³⁶ Po ashtu, një gjyqtar nuk mund të thirrej në gjykatë për veprime që lidhen me detyrën e tij pa një vendim të *Gjykatës së Diktimit*. Për më tepër, një gjyqtar nuk mund të transferohej pa pëlqimin e tij paraprak me shkrim për vendin e ri (Neni 85(4)). Këto garanci, mund të zbatoheshin vetëm pas tre vitesh shërbimi (Neni 89).

Që në vitin 1922, ligjvënësi kushtetues shqiptar e kishte kuptuar se pavarësia e gjyqësorit kërkonte edhe një sistem shoqërues përgjegjshmërie. Kjo përgjegjshmëri synonte të rriste profesionalizmin, cilësinë e veprimtarisë gjyqësore dhe përgjegjshmërinë e gjyqësorit ndaj shoqërisë. Për këtë arsye, u krijua një organ *ad hoc* për të ushtruar juridiksion disiplinor mbi gjyqtarët.

Vendimi për t'i besuar çështjet disiplinore mekanizmave të brendshëm gjyqësorë, në vend të gjykatave të zakonshme, kishte për qëllim ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit dhe kufizimin e ndërhyrjes politike në procedurat disiplinore. Në këtë drejtim, sanksionet

³⁶ Theksohet se shkelje disiplinore mund të konsiderohet edhe mungesa nga detyra për shkak sëmundjeje, e dokumentuar me raport mjekësor, në rast se kjo nuk shoqërohet me marrjen e lejes përkatëse nga Ministria e Drejtësisë për një periudhë tetëditore. Trupi Hetimor i Gjykatës së Diktimit, Vendimi nr. 1 i 11 prillit 1925.

disiplinore ndaj gjyqtarëve janë krijuar për të vepruar në kuadër të vetëqeverisjes gjyqësore.³⁷

Ndërsa Statuti i vitit 1914 parashikonte vetëm se *gjykatësit e paqtuesit* emëroheshin me dekret të Princit (Neni 161), Neni 84 i Statutit të vitit 1922 përcaktonte se të gjithë magjistratët—si prokurorët ashtu edhe gjyqtarët—emëroheshin me dekret të *Këshillit të Naltë*, i cili ushtronte të njëjtat kompetenca si kreu i shtetit, pas një propozimi nga Këshilli i Ministrave, i bazuar në përzgjedhjen e bërë nga një komision i posaçëm.

Për më tepër, ndërsa Statuti i vitit 1914 i jepte Princit dhe qeverisë së tij kompetencën për të krijuar gjykata të posaçme (Neni 168), Neni 81 i Statutit të vitit 1922 parashikonte se në asnjë rast nuk mund të krijohen gjykata të jashtëzakonshme për të gjykuar çështje të veçanta.³⁸

Statuti i vitit 1922 vendosi gjithashtu disa parime të rëndësishme gjyqësore. Neni 81 kodifikoi parimin e juridiksionit territorial, ndërsa neni 82 kodifikoi parimin e vendimeve të arsyetuara, duke kërkuar që gjyqtarët të identifikojnë dispozitat ligjore mbi të cilat bazoheshin vendimet e tyre. Gjithashtu, ky nen garantonte dëgjesat (seancat) publike, përveç rasteve kur seancat e mbyllura ishin të justifikuara për arsye morali ose interesi publik,³⁹ dhe theksonte se gjyqtarët duhet të votojnë privatisht ndërsa shpallin vendimet publikisht. Megjithatë, neni 87 parashikon se magjistratët nuk mund të kryejnë funksione administrative, qoftë edhe pa rrogë, ndërsa neni 88 thekson se ata nuk duhet të angazhohen në aktivitete politike.

Ndonëse Statuti i vitit 1922 i sanksionoi këto parime të rëndësishme kushtetuese, disa detaje iu lanë legjislacionit të zakonshëm. Për shembull, kualifikimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve duhej të përcaktoheshin me ligj (Neni 84 (3)). Përveç kësaj, procedura për akuzën dhe gjykimin e magjistratëve para Gjykatës së Diktimit për shkelje disiplinore duhej të rregullohej me një ligj të veçantë (Neni 85(6)).

1.1.3 Periudha e monarkisë: nga Statuti Themelor i Republikës Shqiptare (1925) te Statuti Themelor i Mbretnisë së Shqipërisë (1939)

Ky seksion shqyrton periudhën e Zogu I, i cili shërbeu si Kryeministër i Shqipërisë (1922–1924), më pas si President (1925–1928) dhe në fund si Mbret (1928–1939). Do të fokusohet në ligjin themelor gjatë periudhës së Republikës të Shqipërisë, duke shënuar

Duhet nënvizuar se në rastin e sistemit njëpartiak, siç ishte regjimi komunist në Shqipëri, zgjedhja e gjyqtarëve nga qytetarët do të lexohet duke marrë parasysh kontekstet dhe jo shkronjat e zëza të Kushtetutës. Me fjalë të tjera, përzgjedhja e kandidatëve kontrollohej nga Partia (Solomon, 1978).¹¹⁶ Në vend që të rrisë sovranitetin demokratik, ajo konfirmoi nënshkrimin institucional të gjyqtarëve ndaj regjimit. Meqenëse Partia vendoste për rizgjedhjen e tyre (në rastin e Bashkimit Sovjetik) ose revokimin (në rastin e Shqipërisë), Partia po përdorte një lloj varësie funksionale për të nxitur gjyqtarët të vendosnin sipas ideologjisë së tyre.¹¹⁷

Duke u fokusuar në rolin e Prokurorisë, Zyra e Prokurorit mbeti për t'u përcaktuar si “një organ i Kuvendit Popullor që ka për mision të kontrollojë zbatimin e përpiktë të ligjës prej ministrave dhe organeve të tjera administrative si dhe prej nëpunësve publikë dhe prej gjithë shtetasve (neni 85 i Statutit të vitit 1946 dhe neni 88 i Kushtetutës së vitit 1950).

Për ta përmbledhur, duke u fokusuar në administrimin gjyqësor, Kushtetuta e vitit 1950 ka konfirmuar parimet kryesore të Statutit të vitit 1946. Megjithatë, në normat kushtetuese, ekziston një korrelacion i fortë midis sovranitetit popullor dhe zgjedhjeve të gjyqtarëve.

¹⁰⁸ Sharlet, Robert. “Stalinism and Soviet Legal Culture”. *Journal of Soviet Law*, vol. 3, no. 1, 1977. Berman, Harold J. *Justice in the U.S.S.R.: An Interpretation of Soviet Law*. Harvard University Press, 1963.

¹⁰⁹ Bonneau, Chris W., and Melinda Gann Hall. *In Defense of Judicial Elections*. Routledge, 2009.

¹¹⁰ Gibson, James L. *Electing Judges: The Surprising Effects of Campaigning on Judicial Legitimacy*. University of Chicago Press, 2012.

¹¹¹ Choi, Stephen J., G. Mitu Gulati, and Eric A. Posner. “Professionals or Politicians: The Uncertain Empirical Case for an Elected Rather than Appointed Judiciary”. *Journal of Law, Economics, & Organization*, 2010.

¹¹² Bickel, Alexander M. *The Least Dangerous Branch*. Yale University Press, 1962.

¹¹³ Berdejó, Carlos, and Noam Yuchtman. “Crime, Punishment, and Politics: An Analysis of Political Cycles in Criminal Sentencing”. *Review of Economics and Statistics*, 2013.

¹¹⁴ Shepherd, Joanna M. “Money, Politics, and Impartial Justice”. *Duke Law Journal*, 2009.

¹¹⁵ Posner, Richard A. *How Judges Think*. Harvard University Press, 2008.

¹¹⁶ Solomon, Peter H., Jr. *Soviet Criminal Justice under Stalin*. Cambridge University Press, 1978.

¹¹⁷ Ginsburgs, George. *The Soviet Procuracy and the Supervision of Administration*. Martinus Nijhoff, 1988.

1.2.3 Radikalizimi dhe rendi kushtetues autark: Kushtetuta e vitit 1976

Ndërprerja e marrëdhënieve me Bashkimin sovjetik në vitin 1961 u pasua nga një afrim me Kinën, e cila u bë aleati kryesor i Shqipërisë deri në vitin 1978. Kushtetuta e vitit 1976 përfaqëson fazën përfundimtare në institucionalizimin e regjimit komunist dhe forcimin e kontrollit të Partisë mbi shtetin dhe shoqërinë.¹¹⁸

Ashtu si Statuti i vitit 1946 dhe Kushtetuta e vitit 1950, Kushtetuta e vitit 1976 nuk përmban një preambulë. Megjithatë, ndryshe nga ata, ajo e përcakton Shqipërinë si një Republikë Popullore Socialiste dhe jo thjesht një Republikë Popullore, siç ishte rasti sipas Statutit të vitit 1946 dhe Kushtetutës së vitit 1950.

Duhet theksuar se ekziston një ndryshim midis një Republike Popullore dhe një Republike Popullore Socialiste: në rastin e një Republike Popullore, “*pushteti buron nga populli dhe i takon popullit*” (neni 1 i Statutit të vitit 1946), në rastin e Republikës Popullore Socialiste, pushteti “*buron nga populli punonjës dhe i përket atij*” (Neni 5(1) Kushtetuta e vitit 1976). Megjithatë, duhet nënvizuar se, në rastin e Kushtetutës së vitit 1950, duket se është vendosur një model i ndërmjetëm: ndërsa pushteti u përket punëtorëve të qytetit dhe fshatit, nga ana tjetër, ata janë “*përfaqësuar nga këshillat popullore*” (neni 4 i Kushtetutës së vitit 1950). Në të vërtetë, në rastin e Kushtetutës së vitit 1976, klasa punëtore, fshatarët kooperativistë dhe njerëzit e tjerë punëtorë – në vend të popullsisë, siç do të ishte rasti në një Republikë Popullore – ushtrojnë pushtet përmes organeve përfaqësuese dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Edhe pse Kushtetuta e vitit 1976 konfirmoi Presidiumin e Kuvendit Popullor, si në rastin e Statutit të vitit 1946 dhe Kushtetutës së vitit 1950, për herë të parë e përcaktoi atë. Presidiumi i Kuvendit Popullor ishte “*organ i lartë i pushtetit shtetëror, me veprimtari të përherëshme*” (neni 75). Duke analizuar kompetencat e saj, të përcaktuara në nenin 77, të cilat janë të ndryshme nga neni 54 i Statutit të vitit 1946 ose neni 58 i Kushtetutës së vitit 1950, duket se roli i Presidiumit të Kuvendit Popullor është shumë më afër atij të vendosur nga presidenti. Në veçanti, sipas nenit 78(1)(2), Presidiumi i Kuvendit Popullor, ndërmjet seancave të Kuvendit Popullor, mbikëqyr dhe thërret Gjykatën e Lartë për të raportuar. Në të vërtetë, kjo normë nuk u vendos as në Statutin e vitit 1946 dhe as në Kushtetutën e vitit 1950.

Rritja e ideologjisë komuniste shihet edhe në normat themelore: ndërsa dy Ligjet e para themelore përcaktojnë se “*Baza politike e Republikës Popullore të Shqipërisë janë këshillat popullore që lindën gjatë luftës nacional-çlirimtare kundër fashizmit dhe reaksionit dhe u forcuan me fitoren historike të kësaj lufte dhe gjatë ndërtimit të bazave të socializmit*” (Neni 3 i Statutit të vitit 1946 dhe neni 2(1) i Kushtetutës së vitit 1950), neni 4 i Kushtetutës së vitit 1976 thotë se “*Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë zhvillon pa ndërprerë revolucionin duke iu përmbajtur luftës së klasave dhe ka për qëllim të sigurojë fitoren përfundimtare të rrugës socialiste mbi rrugën kapitaliste, të arrijë ndërtimin e plotë të socializmit e të komunizimit*”.

¹¹⁸ Czekalski, Tadeusz. *The Shining Beacon of Socialism in Europe: The Albanian State and Society in the Period of Communist Dictatorship 1944–1992*. 2013. Mehmeti, Jetmira. “Internal Policy Aspects of the Communist Regime of Albania (1945–1990)”. *ANGLISTICUM: Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies*, vol. 6, no. 7, 2017, pp. 63–74.

Me fjalë të tjera, ndërsa dy ligjet e para themelore synonin të hidhnin themelet e socializmit, në rastin e Kushtetutës së vitit 1976 objektivi ishte arritja e fitores përfundimtare mbi kapitalizmin. Kushtetuta e vitit 1976, pas gati 30 vitesh regjim komunist, sipas ligjvënësit kushtetues shqiptar, shprehte se Shqipëria ishte gati të fitonte përfundimisht regjimin komunist. Për më tepër, ideologjia marksiste-leniniste është vendosur si ideologji standarde (neni 3(2)) si dhe për marrëdhëniet me jashtë (neni 15), dhe arsim (neni 33). Si rezultat, ndërsa Ligjet e mëparshme themelore vendosnin taksimin proporcional – neni 33(1) Statuti i vitit 1946 dhe neni 37(1) i Kushtetutës së vitit 1950 – neni 31 i Kushtetutës së vitit 1976 thoshte se “*Shtetasit nuk paguajnë asnjë lloj tatimi dhe takse*”. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, si në rastin e nenit 13(3) të Kushtetutës së vitit 1950, neni 30(1) i Kushtetutës së vitit 1976 vendos të njëjtin parim socialist, “*Nga secili sipas aftësisë së tij, secili sipas veprës së tij*”.

Duke u fokusuar në administrimin gjyqësor, ndër të tjera, kjo është një shenjë e qartë se ka mungesë të pavarësisë së gjyqësorit. Në të vërtetë, Presidiumi i Kuvendit Popullor *kontrollon dhe thërret në raport* – ndër të tjera – dhe *Gjykatën e Lartë apo Prokurorin e Përgjithshëm* (Neni 78). Duhet nënvizuar se Presidiumi i Kuvendit Popullor zgjidhet nga brenda Kuvendit Popullor (neni 76). Kështu, ndonëse kompetencat duket se janë ato të Presidentit, përbërja e tyre është pjesë e Kuvendit. Gjithashtu, nga ana tjetër, Kuvendi Popullor zgjedh, emëron dhe shkarkon Gjykatën e Lartë dhe ky organ është përgjegjës para Kuvendit Popullor (neni 67 (1) (7)).

Për qëllime të qartësisë, duhet nënvizuar se neni 103 përcakton se gjykata, në gjykimin e një çështjeje, është e pavarur, vendos vetëm në bazë të ligjit dhe jep vendimin e saj në emër të popullit. Ky është një shembull i qartë pse në rastin e regjimit komunist, ka nevojë për interpretim sistematik.

Duke u fokusuar në administrimin gjyqësor, Kapitulli V (nenet 101-103) i Kushtetutës së vitit 1976 rregullon Gjykatat Popullore. Për herë të parë në historinë juridike kushtetuese shqiptare, gjykatat quhen Gjykata Popullore. Ndryshe nga gjykatat e zakonshme, Gjykatat Popullore synojnë të mbrojnë rendin juridik socialist, i cili është gjithashtu i përcaktuar në nenin 101(2).

Në Kushtetutën e BRSS të vitit 1936, ndërsa Kapitulli IX titullohej Gjykatat dhe Zyra e Prokurorisë, neni 109 i tij thoshte se *Gjykatat Popullore zgjidhen nga qytetarët e rrethit në bazë të votimit universal, të drejtpërdrejtë dhe të barabartë me votim të fshehtë për një afat tre vjeçar [përkthim nga autori]*. Megjithatë, siç u tha më lart, gjatë viteve 1961 deri në 1978, Shqipëria kishte një marrëdhënie të ngushtë me Kinën. Në të vërtetë, ndërsa Seksioni V i Kushtetutës Kineze të vitit 1975 titullohej Organet Gjyqësore dhe Organet e Prokurorit, neni 25 thoshte *Gjykata e Lartë Popullore, gjykatat popullore lokale në nivele të ndryshme dhe gjykatat speciale popullore ushtrojnë autoritetin gjyqësor. Gjykatat popullore janë përgjegjëse dhe përgjegjëse para kongreseve popullore dhe organeve të tyre të përhershme në nivelet përkatëse. Kryetarët e gjykatave popullore emërohen dhe i nënshtrohen shkarkimit nga organet e përhershme të kongreseve popullore në nivelet përkatëse [përkthim nga autori]*.

Kështu, ligjvënësi kushtetues shqiptar ndryshoi emrin e gjykatave në Gjykata Popullore pasi e bazoi atë në modelin e ri kinez të vitit 1975, megjithëse indirekt thuhej edhe në nenin 109 të Kushtetutës së Bashkimit Sovjetik të vitit 1936.

Edhe pse në planin formal gjykatat popullore paraqiteshin si organe të zgjedhura nga qytetarët dhe të pavarura në ushtrimin e funksionit gjyqësor, kjo pavarësi mbetej kryesisht

deklarative. Së pari, ideologjia marksiste-leniniste nuk e konceptonte gjyqësorin si pushtet të ndarë dhe të pavarur në kuptimin liberal-kushtetues, por si pjesë të mekanizmit shtetëror të ndërtimit dhe mbrojtjes së rendit socialist.¹¹⁹ Së dyti, edhe pse teksti kushtetues parashikonte zgjedhjen e gjykatave popullore, ky proces duhet kuptuar në kontekstin e kontrollit politik të Partisë mbi të gjithë aparatën shtetëror. Ky kontroll shfaqej në mënyrë më të drejtpërdrejtë në raport me Gjykatën e Lartë, ku parashikohej kompetenca për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve individualë dhe të zëvendëskryetarëve të saj, sipas nenit 78, pika 1, nënndarja 3. Në praktikë, varësia ideologjike dhe institucionale nga partia-shtet e bënte të pamundur ekzistencën e një pavarësie reale të pushtetit gjyqësor. Në të vërtetë, doktrina kombëtare dhe ndërkombëtare e kanë theksuar këtë pikë.¹²⁰ Për më tepër, hulumtimet kanë treguar se këto lloj gjykatash prirën jo vetëm të pasqyrojnë regjimin autoritar, por edhe të shërbejnë si përjetësues të tyre.¹²¹

Me fjalë të tjera, gjykatat popullore u projektuan si një instrument i transformimit socialist,¹²² bazuar në kontrollin e partisë¹²³ duke i shërbyer qëllimit të Partisë dhe duke¹²⁴ forcuar strukturat autoritare në vend që të demokratizojnë drejtësinë.¹²⁵ Këto gjykata përdorëshin për të luftuar luftën e klasave¹²⁶ në të vërtetë, neni 101(2) i Kushtetutës Shqiptare të vitit 1976 thoshte se “Gjykatat popullore mbrojnë rendin juridik socialist”.

Kushtetuta e vitit 1976 konfirmoi rregullat themelore të rëndësishme të procedurës gjyqësore, të tilla si shteti i të drejtës (neni 103), seancat publike (neni 102), interpretimi i Gjykatës së Lartë vetëm për aspektet e interpretimit ligjor (neni 103), e drejta e të huajve për një përkthyes (neni 102(2)).

Për më tepër, në kompetencën e gjykatave popullore ishte parashikuar gjithashtu se “luftojnë për parandalimin e krimeve, edukojnë masat punonjëse me frymën e respektimit e të zbatimit të ligjshmërisë socialiste, duke u mbështetur në pjesëmarrjen aktive të tyre” (neni 101(1)). Në një shoqëri moderne, kjo nuk është pjesë e pushtetit gjyqësor.

Po ashtu, në Kushtetutën e vitit 1976 u nënvizua roli i Prokurorisë, i cili në fakt u zgjerua. Ndërsa në dy Ligjet e mëparshme themelore komuniste Prokuroria synonte të “kontrollojë zbatimin e përpiktë të ligjës prej ministrave dhe organeve të tjera administrative si dhe prej nëpunësve publikë dhe prej gjithë shtetasve” (neni 84 i Statutit të vitit 1946 dhe neni 88 i Kushtetutës së vitit 1950), neni 104(1) i Kushtetutës së vitit 1976 vendosi, ndër të tjera, se Prokuroria ka për detyrë të mbikëqyrë zbatimin e rreptë dhe uniform të ligjeve nga gjykatat dhe organet hetimore. Përveç kësaj, “prokuroria ka të drejtën e protestës kundër çdo akti të paligjshëm dhe të kërkojë nga organet përkatëse shfuqizimin ose ndryshimin e tij. Kërkesa e prokurorit duhet të shqyrtohet brenda afatit të caktuar me ligj, ndryshe pezullohet zbatimi i aktit” (neni 104 (2)).

¹¹⁹ Mandel, Michael. “Marxism and the Rule of Law”. *UNBLJ* 35 (1986): 7.

¹²⁰ Pano, Nicholas C. *The People’s Republic of Albania*. Gjevari, Elvin. “An Overview of the Military and Judiciary in Albania”. *Democratization and Institutional Reform in Albania*, 2018, pp. 11–31.

¹²¹ Łoś, Maria. “The Myth of Popular Justice under Communism: A Comparative View of the USSR and Poland”. *Justice Quarterly*, vol. 2, no. 4, 1985, pp. 447–71.

¹²² McAleavy, Henry. “The People’s Courts in Communist China”. 1962.

¹²³ Li, Ling. “The Chinese Communist Party and People’s Courts: Judicial Dependence in China”. 2016.

¹²⁴ Ahl, Björn. “Judicialization in Authoritarian Regimes”. 2019.

¹²⁵ Łoś, Maria. “The Myth of Popular Justice under Communism: A Comparative View of the USSR and Poland”. *Justice Quarterly*, vol. 2, no. 4, 1985, pp. 447–71

¹²⁶ Lin, Chien-Chih. “Constitutions and Courts in Chinese Authoritarian Regimes”. 2016.

Duke u fokusuar në administrimin gjyqësor, më 30 korrik 1977 u publikua Udhëzimi nr. 1 i Plenumit, me titull “Mbi cilësinë e gjykimit nga këshillat gjyqësorë pranë gjykatave të rretheve dhe kolegjet e Gjykatës së Lartë”.

Në radhë të parë, duhet theksuar se edhe në këtë Udhëzim vihet në dukje roli i rëndësishëm i Partisë, si dhe i udhëheqësit të saj Enver Hoxha, duke reflektuar rëndësinë e ideologjisë komuniste. Në disa pjesë të tij theksohet se çështjet me karakter politik dhe shoqëror, si dhe ato me natyrë ideologjike, duhet të trajtohen me vëmendje të veçantë.

Dokumenti fillon duke evidentuar shkurtimisht aspektet pozitive të administrimit gjyqësor. Ndër të tjera, konstatohet se në përgjithësi ekziston një organizim i mirë i punës për gjykimin në shkallë të dytë nga këshillat gjyqësorë. Seancat zhvillohen në ditë të caktuara, ndërsa pas tyre organizohen mbledhje të gjyqtarëve, ku, përmes ballafaqimit, evidentohen dhe diskutohen vërejtjet e konstatuara në gjykimin e shkallës së parë.

Më tej, dokumenti ndalet në mënyrë më të detajuar në problematikat e evidentuara. Ndër të tjera, vihet re se cilësisë së gjykimit në shkallën e dytë nuk i është kushtuar gjithmonë vëmendja e duhur. Nga ana e këshillave gjyqësorë të rretheve, në disa raste janë lënë në fuqi vendime të shkallës së parë, të cilat, në fakt, duhej të cenoheshin për shkak të zgjidhjes së gabuar të çështjes. Gjithashtu, vihen re mangësi dhe dobësi sidomos në cilësinë e arsyetimit të vendimeve të këshillave gjyqësorë, të cilat shpesh janë të shkurtra dhe pa argumentim të mjaftueshëm ligjor. Nga ana tjetër, kryesitë e gjykatave të rretheve nuk kanë ndjekur në mënyrë të rregullt punën e këshillave gjyqësorë dhe nuk kanë ushtruar kontroll të vazhdueshëm mbi organizimin e kësaj veprimtarie, duke u mjaftuar kryesisht me mbledhje për diskutimin e mangësive në gjykimin e shkallës së dytë.

Në përfundim, Udhëzimi përcakton edhe gjashtë udhëzime kryesore. Këto përfshijnë forcimin e përgjegjësisë personale të relatorëve të çështjeve, si dhe të rolit të institucionit dhe të Gjykatës së Lartë. Në veçanti, theksohet rritja e përgjegjësisë së çdo anëtarit të këshillit gjyqësor, e sidomos e relatorëve, duke vënë theks të veçantë në çështjet me karakter politiko-shoqëror. Përgjegjësi të veçantë në këtë drejtim mbajnë kryetarët dhe kryesitë e gjykatave të shkallës së dytë.

Në nivel institucional, përcaktohet se këshilli gjyqësor duhet të trajtojë dhe diskutojë edhe çështje me karakter politik, ideologjik, ekonomik dhe shoqëror. Sa i përket ankimit, theksohet rëndësia e arsyetimit të vendimeve të shkallës së dytë, si dhe respektimi i afatit 15-ditor për gjykimin e çështjeve në këtë shkallë.

Së fundi, në lidhje me Gjykatën e Lartë, parashikohet se kolegjet e saj dhe Drejtoria e Organizimit dhe Kontrollit të ndjekin më nga afër veprimtarinë e këshillave gjyqësorë të gjykatave të rretheve, të organizojnë ndihmën dhe kontrollin ndaj tyre, si dhe të marrin masa për përgjithësimin dhe përhapjen e praktikave pozitive.

Për ta përmbledhur, Kushtetuta e vitit 1976 konfirmoi ideologjinë komuniste duke rritur propagandën marksiste-leniniste. Sa i përket administrimit gjyqësor, gjykatat nuk ishin të pavarura, megjithëse formalisht konsideroheshin si të tilla.

1.3 Burimet kryesore të të drejtës në Shqipëri pas regjimit komunist

1.3.1 Burimet kushtetuese tranzitore dhe riorganizimi fillestar i pushtetit gjyqësor

Rënia e regjimeve komuniste në Evropën Lindore në fund të viteve 1980 dhe fillim të viteve 1990 ishte rezultat i një kombinimi faktorësh, që u zhvilluan gradualisht dhe të cilët,

së bashku, dobësuan sistemin deri në kolaps. Një nga arsyt kryesore ishte dështimi ekonomik i modelit socialist. Ekonomitë e planifikuara nga shteti nuk arritën të prodhonin në mënyrë efikase dhe nuk mund të plotësonin nevojat e popullsisë. Mungesa e konkurrencës, kontrolli i tepruar shtetëror dhe kufizimi i aktivitetit privat çuan në palëvizshmëri ekonomike, mangësi të vazhdueshme dhe një standard të ulët jetese. Në këtë mënyrë, sistemi gradualisht humbi mbështetjen e qytetarëve, të cilët filluan ta shohin atë si të paaftë për të përmirësuar jetën e tyre.¹²⁷

Në të njëjtën kohë, sistemi komunist u përball me një krizë të thellë ideologjike. Me fjalë të tjera, ideologjia marksiste-leniniste në Evropën Lindore po përballej me disa kritika.¹²⁸

Në të vërtetë, në rastin e Shqipërisë, në pjesën e dytë të viteve 1980, ligjvënësi njohu copa të vogla toke për konsumim privat familjar në zonat rurale. Kjo politikë tregoi joefikasitetin e kooperativave dhe politikave të vetë-mjaftueshmërisë duke dobësuar legjitimitetin e regjimit.¹²⁹ Kjo çoi në protestën e vitit 1990, shoqëruar me paqëndrueshmëri dhe vështirësi të mëdha institucionale.¹³⁰

Për më tepër, një faktor tjetër i rëndësishëm ishte konteksti ndërkombëtar. Megjithëse Shqipëria ndërpreu marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik në vitin 1961, dobësimi i tij dhe ndryshimet në politikën që bënte ndaj vendeve të Evropës Lindore krijuan mundësi për reforma dhe ndryshime politike. Përveç kësaj, meqenëse Shqipëria ndërpreu marrëdhëniet me Kinën në vitin 1978 duke u izoluar totalisht, nuk kishte më mbështetës të jashtëm të regjimit komunist shqiptar.¹³¹

Duke u fokusuar në administrimin gjyqësor pas rënies së regjimit komunist, ligji 7491 i 29 prillit 1991 synonte vendosjen e disa dispozitave kushtetuese. Para së gjithash, *Shqipëria është republikë parlamentare* (neni 1) dhe shtet demokratik (neni 2). Sa i përket administrimit gjyqësor, *Parimi themelor i organizimit shtetëror është ndarja e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij gjyqësor* (Neni 3). Megjithatë, rregullat e detajeve nuk u vendosën përveç dy përjashtimeve. Së pari, *pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat, që janë të pavarura dhe udhëhiqen vetëm nga ligji* (Neni 5(6)). Së dyti, Kuvendi zgjedh, emëron dhe shkarkon Gjykatën e Lartë (Neni 16(9)). Në fakt, të dyja këto parime janë vendosur edhe në Ligjet Themelore komuniste. I vetmi ndryshim është konteksti demokratik.

Duhet theksuar se Neni 42, pjesë e Kreu IV me titull Dispozita të Fundit, deklaroi se derisa rregullat e reja do të ishin vendosur me dispozitat ligjore ekzistuese, me përjashtim të atyre që ishin në kundërshtim me ligjin 7491 të 29 prillit 1991 do të ishin zbatuar.

¹²⁷ Gokay, Bulent. *Eastern Europe Since 1970: Decline of Socialism to Post-Communist Transition*. Routledge, 2015.

¹²⁸ Ndër të tjerë, Milios, John. "Marxist Theory and Marxism as a Mass Ideology: The Effects of the Collapse of 'Really Existing Socialism' on West European Marxism". *Rethinking Marxism*, vol. 8, no. 4, 1995, pp. 61–74. Kennedy, Michael D., and Naomi Galtz. "From Marxism to Postcommunism: Socialist Desires and East European Rejections". *Annual Review of Sociology*, vol. 22, no. 1, 1996, pp. 437–458. Szelenyi, Ivan, and Balazs Szelenyi. "Why Socialism Failed: Toward a Theory of System Breakdown—Causes of Disintegration of East European State Socialism". *Theory and Society*, 1994, pp. 211–231.

¹²⁹ Venditti, Carlo, Denard Veshi, and Enkelejda Koka. "The Transformation of Right to Property in the Post-Communist Period in Albania. The Impact of the Italian Civil Code in the Ways of Acquisition of Ownership in the Albanian Civil Code of 1994". *Osservatorio del diritto civile e commerciale*, vol. 9, no. 1, 2020, pp. 329–352.

¹³⁰ Venditti, Carlo, Denard Veshi, and Enkelejda Koka. "The Transformation of Right to Property in the Post-Communist Period in Albania. The Impact of the Italian Civil Code in the Ways of Acquisition of Ownership in the Albanian Civil Code of 1994". *Osservatorio del diritto civile e commerciale*, vol. 9, no. 1, 2020, pp. 329–352.

¹³¹ Marku, Ylber. "Communist Relations in Crisis: The End of Soviet-Albanian Relations, and the Sino-Soviet Split, 1960–1961". *The International History Review*, vol. 42, no. 4, 2020, pp. 813–832.

Me fjalë të tjera, dekreti nr. 7174, datë 20 nëntor 1987 me titull “Për organizimin gjyqësor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 7535, datë 17.12.1991, vazhdon të zbatohet.

Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë kishte kompetenca në organizimin gjyqësor. Në veçanti, në nenet 16, 19 dhe 20 të Ligjit Nr. 7491, datë 24 qershor 1992 parashikohej kompetenca e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Për herë të parë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë u përmend në *Ligjin Nr. 7574/1992 24.6.1992, Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e vivile*. Nënvizohet fakti se “qënia e këtyre deputetëve njëkohësisht edhe si anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është e papajtueshme”.¹³² Pra, kjo dispozitë forcon gjithashtu ndarjen e pushteteve.

Në të vërtetë, neni 16(2) i dha fuqinë Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të emëruar hetuesit. Për më tepër, nenet 19 dhe 20 i njohën këtij institucioni të ri ligjor fuqinë për pezullim nga puna deri në gjashtë muaj, transferim ose largim nga detyra, pasi kërkesa është dhënë nga *Ministrit të Drejtësisë*. Duhet përmendur se mundësia për të vendosur largimin nga detyra ishte e kufizuar vetëm në disa raste, megjithëse ishin raste të përgjithshme. Këto raste ishin: *kryejnë një vepër penale, bëhen të paaftë nga ana shëndetësore, nuk fitojnë provimin periodik profesional, për shkelje të rëndë të disiplinës në punë, si dhe për cënim të figurës morale (neni 19 Ligji Nr. 7574/1992)*. Fatkeqësisht, këto raste ishin tepër të gjera. Për shembull, parashikohej “kryerja e një veprë penale” pa bërë dallim midis krimeve dhe kundërvajtjeve penale, si edhe “cënimi i figurës morale” pa përcaktuar qartë se çfarë kuptohej me moral dhe cilat standarde duhej të merreshin parasysh.

Duke u fokusuar në frazën “për cënim të figurës morale”, kritikën e bëra lidhen me faktin se ligji dhe morali janë dy “botë” të ndryshme që jo gjithmonë fokusohen në të njëjtat vlera. Me fjalë të tjera, ligji mund – por jo gjithmonë – të kodifikojë normat morale.¹³³ Në rastin e shkarkimit të magjistratit, ligji përfaqëson një sistem normash të detyrueshme, të cilat përcaktojnë qartë kushtet, procedurat dhe standardet për përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve. Në këtë kuptim, ligji vepron si një bazë objektive për vendimmarrje, duke shmangur arbitraritetin. Ndërkohë, morali përfshin norma më të gjera etike, që burojnë nga pritshmëritë sociale dhe profesionale ndaj figurës së magjistratit, të cilat jo gjithmonë janë të kodifikuara drejtpërdrejt në ligj.¹³⁴

Në praktikë, shpesh lindin raste kur një magjistrat mund të mos ketë shkelur drejtpërdrejt një normë ligjore, por sjellja e tij perceptohet si moralisht e papërshtatshme. Për shembull, situatat e konfliktit të interesit, edhe kur nuk janë vërtetuar plotësisht ligjërisht, mund të minojnë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, për të marrë një masë ekstreme si shkarkimi, kërkohet gjithmonë një bazë e qartë ligjore dhe prova konkrete.¹³⁵

¹³² Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Vendimi nr. 3 i 13 korrikut 1992, mendimi i shumicës, fq. 2, ku theksohet se në interpretim të nenit 15 të ligjit kushtetues dhe në tërësi të frymës së dispozitave kushtetuese, përveç Ministrit të Drejtësisë dhe zëvendësministrit të tij, nuk duhet të jenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë punonjës të tjerë të administratës së drejtësisë; si dhe mendimi i pakicës, fq. 4, sipas të cilit në zgjedhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk duhet të lejohen interferenca të tjera të pushtetit ekzekutiv, veç atyre që lejon në mënyrë të shprehur neni 15 i ligjit kushtetues.

¹³³ Wylie, Jordan, Dries Bostyn, and Ana Gantman. “People Use Norms, Values, Codification, and Enforceability to Determine if a Rule Was Broken”. *Open Mind*, vol. 9, 2025, pp. 1158–1184.

¹³⁴ Balla, Alesia. “The Reform of Justice in Albania”. *Beijing Law Review*, vol. 11, 2020, p. 709

¹³⁵ Ballauri, Fjorida. “Limitations by Law on the Private Interests of Magistrates. The Case of Albania in Preventing Conflict of Interest and Corruption in Justice System”. *Perspectives of Law and Public Administration*, vol. 14, no. 3, 2025, pp. 454–467.

Parimi i shtetit të së drejtës dhe ai i pavarësisë së gjyqësorit kërkojnë që çdo vendim për shkarkimin e magjistratit të bazohet në procedura të rregullta. Siç nënvizohet në Kapitullin IV, dhe në veçanti te Çështja Selimi kundër Shqipërisë e 25 nëntorit 2025 (Kërkesa nr. 37896/19), neni 6 i KEDNJ-së zbatohet edhe për shkarkimin e magjistratëve. Me fjalë të tjera, nëse vendimmarrja në lidhje me shkarkimin e magjistratëve do të mbështetej kryesisht në normat morale, kjo do të çonte në ndërhyrje arbitrare. Për këtë arsye, ligji vendos kufij të qartë për përgjegjësinë disiplinore, duke kërkuar proporcionalitet dhe justifikim të plotë të çdo mase të marrë.¹³⁶

Në të vërtetë, duke marrë parasysh kritikën, këto raste u modifikuan nga ligji nr. 7919 i 19 prillit 1995, i cili parashikonte se nëse mund të kishin *një vepër penale, bëhen të paaftë nga ana shëndetësore, nuk fitojnë provimin periodik profesional si dhe kur janë të paaftë nga ana profesionale lidhur me bazueshmërinë e vendimeve të dhëna, ose kur për shkak të sjelljes së tyre bëhen të papërshtatshëm për të kryer detyrën* (neni 1 ligji nr. 7919 i 19 prillit 1995). Ndërsa në rastin e moralit është fshirë duke e ndryshuar atë me *“kur për shkak të sjelljes së tyre bëhen të papërshtatshëm për të kryer detyrën”*, ende nuk ka një identifikim të llojit të krimeve.

Dallimi midis llojeve të shkeljeve ose “krimeve” është thelbësor kur merret një vendim për shkarkimin e një magjistrati, sepse jo çdo shkelje ka të njëjtën peshë ligjore dhe etike. Në një sistem të bazuar në shtetin e të drejtës, masa e shkarkimit është *poena extrema ratio* dhe duhet të rezervohet për shkelje të rënda, të tilla si korrupsioni, shpërdorimi i detyrës ose shkelja e rëndë e integritetit të funksionit gjyqësor.¹³⁷ Në të kundërt, shkeljet më të lehta disiplinore, të tilla si vonesat procedurale ose sjellja profesionale jo optimale, duhet të trajtohen me masa proporcionale dhe jo domosdoshmërisht me pushim nga puna.

Parimi i procesit të rregullt ligjor duhet të zbatohet gjithashtu edhe në rastin e sanksioneve disiplinore të vendosura nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.¹³⁸ Në këtë kuadër, ndër të tjera, kërkohej që rregullorja e brendshme e këtij organi të jetë e aksesueshme publikisht (p.sh., online), që vendimmarrja të jetë e arsyetuar në fakte dhe në ligj, si dhe të garantohet mundësia e ankimit në një organ kompetent shtetëror. Kjo sepse në *“Parimet themelore në lidhje me pavarësinë e drejtësisë”*, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutat e saj 40/32 të 29 nëntorit 1985 dhe 40/146 të 13 dhjetorit 1985, ku në pikën 17 thuhet: *“Çdo akuzë ose ankesë kundrejt një gjyqtari në ushtrimin e funksioneve të tij gjyqësore dhe profesionale duhet të shqyrtohet sipas procedurës më të përshtatshme. gjyqtari ka të drejtë të përgjigjet”*.¹³⁹

Duke u ndalur tek rasti i anëtarëve të Gjykatës së Lartë, anëtarët e Gjykatës së Kasacionit – sot Gjykata e Lartë – gëzojnë imunitet. Sipas Gjykatës Kushtetuese, ky interpretim sanksionon sigurimin ligjor të anëtarit të Gjykatës së Kasacionit për të mos u ndjekur penalisht dhe për të mos u dënuar për veprimet që lidhen me përmbushjen e detyrave të tij ligjore e që janë shprehja e mendimeve dhe dhënia e vendimeve sipas bindjes së tij të brendshme gjatë shqyrtimit të çështjeve gjyqësore; pra është një dispozitë konkrete në funksion të garantimit të pavarësisë së gjyqtarëve gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Por kjo dispozitë nuk e mbron anëtarin e Gjykatës së Kasacionit nga ndjekja penale dhe dënimi

¹³⁶ Bara, Brunilda, and Jonad Bara. “Rule of Law and Judicial Independence in Albania”. *University of Bologna Law Review*, nr. 2, 2017, p. 25.

¹³⁷ Ball, Alesia. “The Reform of Justice in Albania”. *Beijing Law Review*, vol. 11, 2020, p. 709.

¹³⁸ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Vendimi nr. 8 i 3 nëntorit 1994; nr. 15 i 3 qershorit 1997; nr. 75 i 19 prillit 2002.

¹³⁹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Vendimi nr. 15 i 3 qershorit 1997, fq. 2.

kur ai, duke shpërdorur detyrën dhe në lidhje me të, kryen vepra penale.¹⁴⁰ Me anë të interpretimit sistematik, ky konkluzion është i ngjashëm dhe me dispozitat e tjera kushtetuese ku pranohet se gjyqtarët e shkallëve më të ulëta gëzojnë imunitet apo ku përcaktohet se Prokurori i Përgjithshëm dhe zëvendësit e tij gëzojnë imunitetin.

Gjithashtu, nënvizohet fakti se Kuvendi Popullor me vendim të arsyetuar mund të lëvizë nga detyra gjyqtarin e Gjykatës së Kasacionit, kur gjyqtari, me vendim të formës së prerë të një gjykate kompetente, është dënuar me heqje të lirisë për kryerjen e një veprë penale të parashikuar si të tillë nga ligji. Gjyqtari nuk mund të vazhdojë të kryejë detyrën e tij kur ai është dënuar me heqje të lirisë, sepse kjo nuk pajtohet me funksionin dhe figurën morale të gjyqtarit.¹⁴¹

Për më tepër, funksioni i anëtarit të Gjykatës së Kasacionit, ashtu si dhe i gjyqtarëve të tjerë të të gjitha instancave gjyqësore, është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër publik ose privat që sjell fitime. Në këto raste nuk ka rëndësi vetëm fakti nëse fitimet materiale apo përfitime të llojeve të tjera sigurohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, apo thjeshtë ekziston mundësia e përfitimeve të ndryshme. Rëndësi ka që të mos cenohet parimi kushtetues i pavarësisë dhe paanësisë së gjykatës si institucion dhe i çdo gjyqtari të veçantë.¹⁴²

Në të vërtetë, neni 42 i ligjit nr. 8265 i 18 dhjetorit 1997, i cili shfuqizon të gjithë legjislacionin e mëparshëm, përcaktoi gjashtë lloje të ndryshme të sanksioneve disiplinore: si 1. Vërejtje; 2. Vërejtje me paralajmërim; 3. Ulje në pagë deri në masën 25% për një periudhë nga tre deri në gjashtë muaj; 4. Pezullim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda gjykatës ose prokurorisë për një periudhë nga gjashtë muaj deri në një vit; 5. Transferim në një gjykatë ose prokurori tjetër; ose, në raportin ekstrem, 6. Largim nga detyra. Me fjalë të tjera, ekziston nevoja për të zbatuar parimin e proporcionalitetit; përndryshe, kjo do të ndikonte negativisht në pavarësinë e tyre dhe aftësinë e tyre për të marrë vendime të paanshme.¹⁴³

Përveç kodifikimit të parimit të proporcionalitetit, ligji nr. 8265, i 18 dhjetorit 1997 ngushton rastet kur magistratët nuk mund të lëvizin nga detyra, si mungesa e kalimit të provimin periodik profesional të organizuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i cili bëhet jo më vonë se një herë në dy vjet, janë të paaftë për të kryer detyrën, janë anëtarë të një partie politike ose kryejnë veprimtari me karakter politik, fitojnë një mandat zgjedhor, apo kryejnë veprimtari tjetër publike ose private, përfshirë dhe veprimtari tregtare, ekspertizë ose arbitra të palëve në arbitrazh, me përjashtim të funksioneve të mësimdhënies në shkollat e larta dhe në Shkollën e Magistraturës.

Rëndësia e Këshillit të Lartë i Drejtësisë u rrit gjithashtu me ligjin nr. 8265/1997 “Për organizimin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”: Kompetencat tokësore dhe qendra e ushtrimit e Gjykatat e shkallës së parë apo e Gjykatat e apelit (neni 11) si dhe numri i përgjithshëm ose emërimi i gjyqtarëve (Artikujt 12 dhe 21) ose prokurorëve (neni 16(2) dhe 21) vendoset me një dekret të Presidentit i Republikës, me propozim të ministrit të Drejtësisë, pasi të jetë marrë dhe mendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Duhet theksuar se është Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i cili shpall vendet vakantë për gjyqtarë e prokurorë (neni 23). Për më tepër, gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatës së apelit dhe kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit emërohen nga

¹⁴⁰ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Vendimi nr. 1 i 19 janarit 1995, fq. 2.

¹⁴¹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Vendimi nr. 1 i 19 janarit 1995, fq. 3.

¹⁴² Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Vendimi nr. 5 i 15 gushtit 1992, fq. 2.

¹⁴³ Bara, Brunilda, and Jonad Bara. “Rule of Law and Judicial Independence in Albania”. *University of Bologna Law Review*, nr. 2, 2017, p. 25.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (neni 24).¹⁴⁴ Po ashtu, në rast nevojë, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të delegojë gjyqtarë nga gjykata të tjera për një periudhë jo më shumë se tre muaj në vit, që mund të jetë dhe përsëritur, edhe pa pëlqimin e gjyqtarit (Neni 28(2)).

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, gjithashtu, mund të caktonte si magjistratë, edhe pa përfunduar Shkollën e Magjistraturës, individë të caktuar nga administrata civile, si juristë me jo më pak se pesë vjet si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, pedagogë në Fakultetin e Drejtësisë apo në Shkollën e Magjistraturës, deputetë, këshilltarë juridikë në Kuvendin Popullor, në Presidencë, në Këshillin e Ministrave dhe juristë specialistë në Ministrinë e Drejtësisë ose ata që kanë kryer kurse specializimi pasuniversitar afatgjatë jashtë shtetit (Neni 20(1)).

Gjithashtu, puna e Këshillit të Lartë të Drejtësisë ndihmohet edhe përmes monitorimit të vazhdueshëm të Inspektoratit. Modalitetet e funksionimit të tij përcaktohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë përmes një rregulloreje (neni 17). Ky institucion i ri ligjor synon jo vetëm të verifikojnë ankesat e shtetasve dhe të institucioneve, por edhe të rishikojë në tërësi efikasitetin e gjykatave dhe të prokurorive (neni 17(3)).

Megjithëse institucioni ligjor i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është përmendur edhe më parë, neni 18(2) ligji nr. 8265/1997 e përcakton atë si *është person juridik publik dhe veprimtaria e tij financohet nga buxheti i shtetit si zë i veçantë*.¹⁴⁵

Për ta përmbledhur, ligji nr. 7491/1991 synonte të vendoste disa dispozita kushtetuese. Ndërsa pushteti gjyqësor konsiderohej themelor, vetëm përmes legjislacionit të zakonshëm u vendos përbërja ose roli i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kalimi nga komunizmi në demokraci nuk ishte një proces i thjeshtë apo i menjëhershëm. Në shumë vende të Evropës Lindore, tranzicioni u shoqërua me probleme serioze, të tilla si korrupsioni, dobësia institucionale dhe rritja e pabarazive sociale. Kjo tregoi se krijimi i një sistemi të ri demokratik dhe ekonomik kërkonte kohë dhe struktura të zhvilluara, të cilat shpesh mungonin në fazat e hershme të tranzicionit. Rrjedhimisht, shumë vende u përballën me një realitet të vështirë, ku pritshmëritë për përmirësim të shpejtë nuk u realizuan plotësisht.¹⁴⁶

1.3.2 Kushtetucionalizimi i administrimit gjyqësor në rendin kushtetues të vitit 1998

Në vitin 1998, u miratua Kushtetuta e re. Ashtu si në rastin e Statuteve të 1925, 1929 dhe 1939,¹⁴⁷ Kushtetuta e vitit 1998 vendos një preambulë. Megjithatë, ndryshe nga Statutet e

¹⁴⁴ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Vendimi nr. 12 i 28 tetorit 1992. “Megjithatë, shkarkimi nga detyra i Prokurorit të Përgjithshëm dhe i zëvendësve të tij, kur vërtetohet ligjërisht se kanë kryer një vepër penale të rëndë ose janë të paaftë mendërisht, ushtrohet nga Kuvendi Popullor. Kjo rrjedh nga fakti se Kuvendi Popullor gëzon të drejtën për të kontrolluar veprimtarinë e Prokurorisë së Përgjithshme, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të zëvendësve të tij; një kontroll që ka karakter të detyrueshëm, të vazhdueshëm dhe rigoroz. Si i tillë, ky kontroll përfshin edhe të drejtën për të vendosur sanksione, duke mos përjashtuar shkarkimin nga detyra. Në këtë kuadër, theksohet se rastet e parashikuara në dispozitat kushtetuese nuk kanë karakter shterues Për rrjedhojë, Parlamenti mund të vendosë shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm edhe në raste të tjera, siç janë, ndër të tjera, mospërmbyshja e rregullt e detyrës, paaftësia profesionale apo paaftësia fizike. Në këtë drejtim, rasti i shkarkimit nga detyra i Prokurorit të Përgjithshëm Maksim Haxhia, i motivuar nga dobësi të theksuara në ushtrimin e funksioneve, mungesë objektiviteti dhe zvarritje në hetimin e disa çështjeve penale të rëndësishme, si dhe për emërimin e një prokurori në rrethin e Vlorës pa miratimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është konsideruar si në përputhje me dispozitat kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese”.

¹⁴⁵ Edhe pse nuk është në fokusin e këtij hulumtimi, është mjaft interesante të vërehet se ligjvënësi përcakton një institucion ligjor pasi ka vendosur disa nga rolet e tij.

¹⁴⁶ Vassilev, Rossen. “The Tragic Failure of 'Post-Communism' in Eastern Europe”. *Global Research*, vol. 8, 2011.

¹⁴⁷ Llagami, Naureda “Building Justice In Albania From The Independence (1912) To The Communist Regime (1945): A Constitutional–Historical Perspective” *Revista Aequitas* 2026(1):155-184.

viteve 1925, 1929 dhe 1939,¹⁴⁸ për herë të parë në historinë kushtetuese shqiptare, preambula përfshin edhe nocionet e “shtetit të së drejtës” dhe rëndësinë e “drejtësisë”.

Duke u fokusuar në administrimin gjyqësor, megjithëse Këshilli i Lartë i Drejtësisë përmendej edhe në legjislacionin shqiptar, Kushtetuta e vitit 1998 e njeh atë si nivel kushtetues. Kjo është thelbësore për zbatimin e parimit *lex superior derogat inferiori*. Kështu, nëse legjislacioni i zakonshëm bie në kundërshtim me ligjin themelor, ai shpallet antikushtetues.¹⁴⁹ Në këtë kuadër, neni 147 përcakton bazat kryesore të përbërjes dhe rolit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 116 i Kushtetutës së Shqipërisë përcakton hierarkinë e normave juridike. Duhet theksuar se edhe Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka nënvizuar rëndësinë e kësaj dispozite, e cila kodifikon qartë rendin dhe përparësinë e burimeve të të drejtës.¹⁵⁰

Në fakt, ligji nr. 7491/1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” nuk përmend rolin e Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, kjo është bërë përmes ligjin nr. 7561/1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491 dt.29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Në nivel kushtetues, roli i Gjykatës Kushtetuese u vendos përmes Kushtetutës së vitit 1998.

Në një model “ideal”, parimi i ndarjes së pushteteve nënkupton se secili pushtet vepron brenda kufijve të vet, pa ndërhyrë në kompetencat e të tjerëve, duke e bërë të panevojshëm një mekanizëm të fortë balancues.¹⁵¹

Megjithatë, zhvillimi i praktikës kushtetuese tregoi se ky supozim nuk qëndron gjithmonë. Në realitet, pushtetet nuk janë gjithmonë të përmbajtura dhe shpesh priren të zgjerojnë rolin e tyre, duke krijuar ndërhyrje ose fuqi të mbivendosura. Kjo situatë bëhet edhe më e dukshme në vendet në tranzicion, si Shqipëria, ku institucionet janë ende në proces ndërtimi dhe konsolidimi. Si pasojë, ndarja formale e pushteteve rezultoi e pamjaftueshme për të garantuar një ekuilibër real dhe për të parandaluar përqendrimin e pushtetit.¹⁵²

Balanca kushtetuese midis sistemit gjyqësor dhe dy pushteteve të tjera bëhej në këtë mënyrë: megjithëse anëtarët e Gjykatës Kushtetuese emëroheshin nga presidenti, ekzistonte nevoja që Parlamenti të jepte miratimin (neni 125(1). E njëjta procedurë ndiqej edhe për publikimin e vendit vakant (neni 127(3)). Për më tepër, megjithëse vendimi përfundimtar për shkarkimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese merrej nga vetë Gjykata, pushteti legjislativ, me një vendim të miratuar me dy të tretat e votave, mund të inicionte këtë procedurë (neni 128). Në të njëjtën mënyrë, një procedurë e ngjashme parashikohej edhe për anëtarët e Gjykatës së Lartë (neni 140).

Përsa i përket shkarkimit të anëtarëve të rëndësishëm të pushtetit gjyqësor, *Nenet 128 dhe 140 të Kushtetutës kanë formulime të njëjta, sepse përmbajnë katër shkaqe kushtetuese, në të cilat duhet të bazohet Kuvendi për të motivuar vendimin për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, ndërsa neni 149 pika 2 parashikon rastet për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, nga të cilat vetëm njëri prej tyre është i ndryshëm nga të parat.*¹⁵³ Megjithatë, këto veprime duhet të vlerësohen rast pas rasti. Ato

¹⁴⁸ Llagami, Naureda “Building Justice In Albania From The Independence (1912) To The Communist Regime (1945): A Constitutional–Historical Perspective” *Revista Aequitas* 2026(1):155-184.

¹⁴⁹ Guastini, Riccardo. “Gerarchie Normative”. *Revus: Journal for Constitutional Theory and Philosophy of Law / Revija za ustavno teorijo in filozofijo prava*, no. 21, 2013, pp. 57–70.

¹⁵⁰ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi Nr. 55 i 27 korrikut 2016; Vendimi Nr. 16 i 10 prillit 2015; Vendimi Nr. 5 i 5 shkurtit 2015; dhe Vendimi Nr. 5 i 5 shkurtit 2014.

¹⁵¹ Gjipali, Dorina. “Unity and Separation of Powers in Light of the Constitutional Systems in Albania”.

¹⁵² Nano, Ilirjana. “Avoidances from the Constitutional Principle of the Division of the Powers”. *SEEU Review*, p. 163.

¹⁵³ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Vendimi nr. 75 i 19 prillit 2002, fq. 3.

mund të manifestohen si sjellje aktive, por edhe si mosveprim. Gjithashtu, këto sjellje të parregullta mund të kryhen si në ushtrimin e detyrës, ashtu edhe jashtë saj. Sidoqoftë, për të justifikuar masa të tilla si shkarkimi, këto sjellje duhet të kenë një karakter të rëndë. Në rastin e shkarkimit, duhet të merren parasysh, ndër të tjera, dhe *pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga kjo shkelje, kohëvazhdimin e këtyre pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre si dhe vetë qëndrimin subjektiv që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer dhe pasojës së ardhur*.¹⁵⁴

Procesi i realizuar prej Kuvendit ndryshon nga gjithë veprimtaria e tij e zakonshme si një organ që miraton ligje. Ky proces ligjor, që është një proces gjykimi disiplinor i ngjashëm me procedurat hetimore administrative dhe ka parimet e veta, të cilat lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e atyre shkaqeve konkretë që kanë shërbyer për organin kompetent për të marrë masën e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit apo prokurorit.¹⁵⁵

Sidoqoftë, duke pasur parasysh edhe parimin e balancës së pushteteve, në rastin e shkarkimit të tyre, Gjykata Kushtetuese shqyrton jo vetëm procedurën e ndjekur nga Parlamenti, por edhe themelin (thelbin) e çështjes. Ndërkohë, në rastin e Prokurorit të Përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese vlerëson se Presidenti i Republikës është organi kompetent, i ngarkuar nga Kushtetuta për të kryer verifikimin, nga pikëpamja kushtetuese, si të shkaqeve, ashtu edhe të procedurave të ndjekura nga Kuvendi për shkarkimin e tij. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese nxit Kuvendin të miratojë rregulla të posaçme, qoftë për çdo rast konkret, qoftë në mënyrë të përgjithshme, duke respektuar në çdo rast parimin kushtetues të procesit të rregullt ligjor.

Gjykata kushtetuese mund të shqyrtojë pajtueshmërinë e ligjit, e cila miratohet nga pushteti legjislativ (neni 131(1)(a)); akteve normative të organeve qendrore dhe vendore, të cilat miratohen nga ekzekutivi (neni 131(1)(c)). Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese mund të fillojë procedimin e saj me jo më pak se një të pestës të pushtetit legjislativ (neni 134 (1) (c)); Kryeministrit ose organeve të qeverisjes vendore (neni 134(1)(b) dhe (e)), të cilat janë pjesë e pushtetit ekzekutiv.

Gjykata Kushtetuese ka kompetenca edhe në gjykimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë Shqiptare duke balancuar pushtetet gjyqësore dhe legislative: *Gjyqtari i Gjykatës së Lartë mund të ndiqet penalisht vetëm me miratimin e Kuvendit*. Megjithatë, në rast flagrance, kërkohet miratimi i Gjykatës Kushtetuese brenda 24 orëve (neni 137(1)).

Sa i përket administrimit gjyqësor, ndërsa anëtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti pas miratimit të pushtetit legjislativ, anëtarët e gjykatave dhe gjykatave të apelit emërohen nga Presidenti me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kështu, ndërsa legjislacioni i zakonshëm për rëndësinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë është njohur në nivel kushtetues, Presidenti ka një rol të rëndësishëm në emërimin e gjyqtarëve, si dhe të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Kjo është hera e parë që roli i Presidentit theksohet në nivel kushtetues. Megjithatë, për qartësi, ndërsa gjatë komunizmit sovraniteti popullor u shtri edhe në pushtetin gjyqësor, para këtij regjimi, në Shqipëri, Kreu i Shtetit (si Këshilli i Naltë në Statutin e vitit 1922, Kryetari i Republikës në Statutin e vitit 1925, apo mbreti në statutet e viteve 1928 dhe 1939)¹⁵⁶ kishte një rol të rëndësishëm në emërimin e tyre.

¹⁵⁴ Po aty, fq. 4

¹⁵⁵ Po aty, fq. 5

¹⁵⁶ Neni 84 Statuti i 1922 përcaktonte:

Të gjithë gjyqtarët e prokurorët emnohen me dekret të Këshillit të Naltë mbas propozitës se Këshillit ministrues në bazë të zgjedhjes së bëmë prej një komisioni të posaçme.

Duke pasur parasysh parimin e ndarjes së pushteteve, duhet theksuar se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ishte një organ kushtetues i pozicionuar në majën e piramidës organizative të pushtetit gjyqësor.¹⁵⁷ Gjithashtu, gjyqtarët konsiderohen si funksionarë shtetërorë të ngarkuar me ushtrimin e funksionit të dhënies së drejtësisë. Në këtë kuadër, Kushtetuta i ka atribuar Presidentit të Republikës kryesinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Theksohet se Këshilli i Lartë i Drejtësisë është një organ kushtetues i përhershëm, ndërkohë që anëtarësia e tij nuk ushtron funksionin në mënyrë të vazhdueshme dhe me kohë të plotë. Për më tepër, anëtarët e tij, me përjashtim të rasteve kur janë pjesë e gjyqësorit, nuk gëzojnë imunitet.

Nga ana tjetër, në funksion të balancës së pushteteve, Parlamenti ushtron kompetenca të rëndësishme, si miratimi i emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Kryetarit të saj, si dhe zgjedhja e drejtpërdrejtë e tre anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ndërkohë, ndërveprimi me pushtetin ekzekutiv evidentohet në faktin se sanksionet disiplinore vendosen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, mbi nismën e Ministrit të Drejtësisë. Për të nënvizuar sigurinë juridike, në nivel kushtetues parashikohet se, për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në kolegjet e bashkuara çështje të caktuara (neni 141(2)). Për më tepër, Gjykata e Lartë gëzon autonomi në administrimin e buxhetit të saj (neni 144). Gjithashtu, Kushtetuta e vitit 1998 njeh të drejtën e qytetarëve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, si në mënyrë indirekte (neni 145(2)), ashtu edhe drejtpërdrejt (neni 131(1)(f))¹⁵⁸ si dhe neni 134(1)(g)). Theksohet se ndërsa qasja është indirekte kërkesa e gjyqtarit për zgjidhjen e kontestit juridik në Gjykatën Kushtetuese vendoset në disa kushtetuta demokratike, si qasje e drejtpërdrejtë. Doktrina ka hedhur hipotezën se qasja e drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese është një reagim i të kaluarës, pasi kjo është vendosur në Spanjë (regjimi i Frankos), Gjermani (regjimi nazizmi) si dhe në Shqipëri (regjimi komunist).¹⁵⁹ Megjithatë, në vitin 1998, qasja direkte është e kufizuar në shkelje të procesit të rregullt ligjor,¹⁶⁰ i cili është kodifikuar në nenin 6 të KEDNJ-së.

Kushtetuta e vitit 1998 nënvizoi disa norma të rëndësishme si pavarësia gjyqësore (neni 145(1)), shtetii i të drejtës (neni 135), mungesa e çdo lloji tjetër të veprimtarisë private ose politike (Aritcle 143) si dhe publiciteti i vendimeve (neni 142(2) dhe 146(2)).

Procesi i vetingut në Shqipëri përfaqëson një nga reformat më të thella dhe më transformuese në sistemin e drejtësisë gjatë periudhës së tranzicionit demokratik. Në thelb, vetingu është një proces i jashtëzakonshëm rivlerësimi për magjistratët, i cili analizon në

Gjithashtu, Neni 102 Statuti i 1925 përcaktonte:

Të gjithë gjyqtarët e prokurorët emnohen me dekret të Kryetarit të Republikës mbas propozimit të Ministris së Drejtësisë në bazë të zgjedhjes së bamun prej një komisioni të posaçme. Këjo komisi do të ketë për Kryetar Ministrin e Dretësisë e për misa sekretarin e përgjithshëm të Ministris së Drejtësisë, Kryetarët dhe Kryeprokurorin e Diktimit.

Për më tepër, Neni 129 Statuti i 1928 përcaktonte:

Të gjithë gjyqtarët e prokurorët e Shtetit, të zgjedhur dhe të propozuar sipas ligjit të posaçëm emërohen me dekret të Mbretit.

Së fundi, Neni 7 Statuti i 1939 përcaktonte:

Drejtësia buron prej Mbretit dhe administrohet n'ëmnin e Tij prej gjyqtarvet që i emnon Ai.

¹⁵⁷ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Vendimi nr. 14 i 22 majit 2006, mendimi i shumicës.

¹⁵⁸ Gjykata Kushtetuese vendos për:

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre

kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

¹⁵⁹ Veshi, Denard, Enkelejda Koka, and Laert Sheme. "The Application of Human Rights by Judges in Civil Cases: The Case of Albania" *Ordine Internazionale e Diritti Umani* 2025(1): 87-103.

¹⁶⁰ Veshi, Denard, et al. "The Application of the ECHR and Its Jurisprudence by the Albanian Constitutional Court in Administrative Disputes". *Croatian and Comparative Public Administration*, 2026.

mënyrë të detajuar tre elemente kryesorë: burimin e pasurisë, integritetin moral dhe aftësinë profesionale. Përmes këtyre tre shtyllave, një magjistrat vlerësohet jo vetëm për kompetencën profesionale, por edhe për ndershmërinë dhe pavarësinë nga çdo ndikim i jashtëm. Për këtë arsye, vetingu nuk përbën një kontroll të zakonshëm administrativ, por një mekanizëm të posaçëm, që synon të forcojë rolin e magjistratit dhe të rikthejë besimin e publikut në drejtësi.¹⁶¹

Duhet theksuar se vetingu është rezultat i një akumulimi disa vjeçar të keqadministrimit të institucioneve. Në përgjithësi, pas rënies së regjimit komunist, në Shqipëri një pjesë e elitës së vjetër arriti të mbetet në pozita ndikimi, duke shfrytëzuar rolin e saj të mëparshëm për të orientuar procesin e tranzicionit.¹⁶² Duke u fokusuar në rastin e administrimit gjyqësor, ndërsa organet e reja gjyqësore si Këshilli i Lartë i Drejtësisë synonin të impononin pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve, konkretisht, ato nuk vendosën sanksione. Përveç kësaj, e kaluara e mëparshme dhe kultura e vjetër institucionale krijuan një hendek të thellë midis normave ligjore dhe zbatimit të tyre në realitet, duke dobësuar funksionimin e shtetit të së drejtës dhe duke rritur perceptimin negativ të qytetarëve ndaj drejtësisë.¹⁶³ Në këtë kontekst, vetingu u pa si një mënyrë për të thyer këtë cikël dhe për të vendosur standarde të reja llogaridhënie.¹⁶⁴

Kjo u realizua përmes reformës kushtetuese të vitit 2016, dhe jo thjesht përmes ligjit të zakonshëm, me synimin për të “rivendosur” ose rindërtuar sistemin nga brenda dhe për të krijuar një bazë të re besimi në drejtësi.¹⁶⁵ Roli i BE-së – veçanërisht në nivelin e transparencës, mekanizmat e forcuar të kontrollit dhe llogaridhënies – ishin thelbësorë në procesin e vetingut.¹⁶⁶

Qëllimi i kësaj reforme ishte krijimi i një sistemi ku vendimet gjyqësore merren në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe të bazuara në ligj, duke u dhënë qytetarëve sigurinë se të drejtat e tyre janë të mbrojtura.¹⁶⁷ Përveç kësaj, ky sistem i ri përfaqëson edhe një dimension simbolik: një shkëputje të qartë nga e kaluara. Ky dimension është thelbësor edhe për perceptimin publik,¹⁶⁸ ose perceptimin ndërkombëtar.¹⁶⁹ Për më tepër, forcon kulturën e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë.¹⁷⁰

¹⁶¹ Tepelija, Arnisa, and Teodora Milojković. “Vetting as a judicial integrity enhancement tool”. *Accountability of Judicial Power*. Routledge 186-206.

¹⁶² Venditti, Carlo, Denard Veshi, and Enkelejda Koka. “The Transformation of the Right to Property in the Post-Communist Period in Albania: The Impact of the Italian Civil Code on the Ways of Acquisition of Ownership in the Albanian Civil Code of 1994”. *Osservatorio del Diritto Civile e Commerciale*, vol. 9, no. 1, 2020, pp. 329–352.

¹⁶³ Garunja, Evis. “The Effects of Constitutional Changes on the Judiciary System in Albania: The Process of Vetting”. *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, 2022.

¹⁶⁴ Ilia, Bledar, and Marsela Ilia. “The Vetting of Judges and Prosecutors in Albania between Success and Failure”. *Revista de Științe Juridice*, 2017, p. 16.

¹⁶⁵ Tepelija, Arnisa, and Teodora Milojković. “Vetting as a judicial integrity enhancement tool”. *Accountability of Judicial Power*. Routledge 186-206.

¹⁶⁶ Skara, Gentjan, Bojana Hajdini, and Najada Kilic. “The Role of the EU as a Promoter of Judiciary Reform in Candidate Countries: The Case of the Vetting Process in Albania”. *EU and Comparative Law Issues and Challenges Series (ECLIC)*, vol. 8, 2024, pp. 225–252.

¹⁶⁷ Garunja, Evis. “The Effects of Constitutional Changes on the Judiciary System in Albania: The Process of Vetting”. *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, 2022.

¹⁶⁸ Skara, Gentjan, Bojana Hajdini, and Najada Kilic. “The Role of the EU as a Promoter of Judiciary Reform in Candidate Countries: The Case of the Vetting Process in Albania”. *EU and Comparative Law Issues and Challenges Series (ECLIC)*, vol. 8, 2024, pp. 225–252.

¹⁶⁹ Skara, Gentjan, Bojana Hajdini, and Najada Kilic. “The Role of the EU as a Promoter of Judiciary Reform in Candidate Countries: The Case of the Vetting Process in Albania”. *EU and Comparative Law Issues and Challenges Series (ECLIC)*, vol. 8, 2024, pp. 225–252.

¹⁷⁰ Ilia, Bledar, and Marsela Ilia. “The Vetting of Judges and Prosecutors in Albania between Success and Failure”. *Revista de Științe Juridice*, 2017, p. 16.

Reforma e vitit 2016 rriti pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Së pari, sa i përket anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vetëm tre miratohen nga Parlamenti, ndërsa tre nga Gjykata e Lartë dhe tre nga Presidenti. Megjithatë, *përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit* (Neni 125(1)). Së dyti, në nivel kushtetues, nuk ka Këshill të Lartë të Drejtësisë, por ka: *Këshill të Emërimeve në Drejtësi* (Neni 149/d), Këshill të Lartë Gjyqësor (nenet 147/a-147ç) dhe Këshill të Lartë të Prokurorisë (nenet 149-149/c) për të rritur edhe pavarësinë midis magjistratëve. Së treti, sa i përket anëtarëve të Gjykatës së Lartë, ata emërohen nga Presidenti me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Edhe pse Presidenti ka një rol në procesin e emërimit, përfshirë edhe të drejtën e vetos, dekreti i tij për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor (neni 136(2)). Për më tepër, nëse Presidenti qëndron joaktiv për 15 ditë, miratimi konsiderohet i dhënë. Gjithashtu, roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (nenet 147/d–147ë) është ngritur në nivel kushtetues. Sa i përket administrimit gjyqësor, Kushtetuta parashikon edhe krijimin e gjykatave të posaçme, që gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar (neni 135(2)).

Megjithatë, procesi i vettingut ka qenë objekt i disa kritikave. Disa autorë e kanë konsideruar atë si një eksperiment, që nuk ka arritur gjithmonë rezultatet e pritura, duke vënë në dukje vështirësitë në zbatim dhe efektet anësore që ka sjellë.¹⁷¹ Ky proces çoi në dorëheqjen e disa magjistratëve, duke krijuar boshllëqe në sistemin gjyqësor dhe duke rritur kohëzgjatjen e proceseve. Megjithatë, këto pasoja shpesh konsiderohen si të përkohshme dhe si një kosto e nevojshme për të arritur një qëllim më të madh: ndërtimin e një sistemi drejtësie të pastër dhe të besueshëm.¹⁷²

Për ta përmbledhur, kushtetuta aktuale rrit pavarësinë dhe autonominë gjyqësore. Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese janë themeluar në nivel kushtetues. Procesi i vettingut synonte rikthimin e besimit në sistemin gjyqësor shqiptar.

¹⁷¹ Dimitrova, Denitsa. “Judicial Reform and Process of Vetting in Albania: Between an Effective Project and an Unsuccessful Experiment”. *KSI Transactions on Knowledge Society*, vol. 11, no. 2, 2018.

¹⁷² Ilia, Bledar, and Marsela Ilia. “The Vetting of Judges and Prosecutors in Albania between Success and Failure”. *Revista de Științe Juridice*, 2017, p. 16.

KAPITULLI II

REFORMA KUSHTETUESE E VITIT 2016 DHE RIORGANIZIMI TERRITORIAL I SISTEMIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI

2.1 Premisat dhe ndryshimet kushtetuese të reformës në drejtësi të vitit 2016

2.1.1 Premisat politike, institucionale dhe normative të reformës

Reforma në drejtësi, e ndërmarrë në Republikën e Shqipërisë në vitin 2016, përbën, si nga shtrirja kushtetuese ashtu edhe nga thellësia institucionale, ndërhyrjen më të madhe ligjvënëse në sistemin gjyqësor shqiptar që nga miratimi i Kushtetutës së vitit 1998. Ajo nuk është një reformim teknik i organizimit gjyqësor, por një riformatim institucional i tërë sistemit të drejtësisë: rishikim i bazës kushtetuese, krijim i një sërë organesh të reja kushtetuese të qeverisjes, riformatim i statusit të magjistratëve, ngritje e një gjykate dhe prokurorie të posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe krijim i një procesi unik historikisht, si ai i rivlerësimit kalimtar të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë (vetingu).

Kuadri normativ i reformës ngrihet mbi gjashtë shtylla ligjore kryesore. Shtylla e parë është *Ligji nr. 76/2016* për amendamentet kushtetuese, që zëvendësoi pothuajse tërësisht Pjesën IX të Kushtetutës dhe shtoi në Aneks dispozitat tranzitore për procesin e rivlerësimit.¹⁷³

Shtylla e dytë është *Ligji nr. 84/2016* për rivlerësimin kalimtar (vetingun) të gjyqtarëve dhe prokurorëve.¹⁷⁴ Shtylla e tretë është *Ligji nr. 95/2016* për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.¹⁷⁵

Shtylla e katërt është *Ligji nr. 96/2016* për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.¹⁷⁶ Shtylla e pestë është *Ligji nr. 98/2016* për organizimin e pushtetit gjyqësor.¹⁷⁷ Shtylla e gjashtë është *Ligji nr. 99/2016* për ndryshimet në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese.¹⁷⁸ Mbi këto shtylla ngrihet *Ligji nr. 115/2016* për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, që ngarkohet të rregullojë në mënyrë sistematike strukturën, kompetencat dhe procedurat e organeve të reja drejtësisë.¹⁷⁹

Ky kapitull ka për qëllim të paraqesë në mënyrë doktrinale-juridike, mbi bazën ekskluzive të teksteve ligjore, fizionominë e tërësishme të reformës. Trajtimi është strukturuar: së pari, amendamentet kushtetuese të Ligjit nr. 76/2016, që përbëjnë *lex superior* të të gjithë reformës; së dyti, riformatimi i Gjykatës Kushtetuese; së treti, krijimi dhe karakterizimi i

¹⁷³Ligji nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 'Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar". Ky ligj kushtetues solli ndryshimin më të gjerë në Kushtetutën e vitit 1998 që nga miratimi i saj, duke prekur kryesisht Pjesën IX (Pushteti Gjyqësor) dhe duke shtuar dispozitat tranzitore të Aneksit (nenet 179/b dhe vijues).

¹⁷⁴Ligji nr. 84/2016, datë 30.8.2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

¹⁷⁵Ligji nr. 95/2016, datë 6.10.2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", Fletorja Zyrtare nr. 194/2016 (i ndryshuar me Ligjin nr. 47/2021, datë 23.3.2021).

¹⁷⁶Ligji nr. 96/2016, datë 6.10.2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (shfuqizuar nene me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017; ndryshuar me ligjet nr. 48/2019, nr. 15/2020, nr. 149/2020, nr. 50/2021 dhe nr. 33/2023).

¹⁷⁷Ligji nr. 98/2016, datë 6.10.2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", Fletorja Zyrtare nr. 209/2016 (i ndryshuar me Ligjin nr. 46/2021).

¹⁷⁸Ligji nr. 99/2016, datë 6.10.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, 'Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë'", Fletorja Zyrtare nr. 210/2016.

¹⁷⁹Ligji nr. 115/2016, datë 3.11.2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Fletorja Zyrtare nr. 224/2016 (shfuqizuar nene me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 16.5.2017 dhe me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 78, datë 12.12.2017; ndryshuar me Ligjin nr. 47/2019).

organeve të reja kushtetuese të qeverisjes së sistemit të drejtësisë; së katërti, riformatimi i statusit të magistratit me Ligjin nr. 96/2016 dhe me amendamentet e tij të mëvonshme; së pesti, krijimi i strukturave të specializuara antikorruption (SPAK); dhe së gjashti, procesi i rivlerësimit kalimtar (vetingu). Trajtimi specifik i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe i ndryshimeve strukturore-menaxheriale brenda gjykatave bëhet në kapitullin paraprijës dhe nuk përsëritet këtu, përveçse në referenca të domosdoshme sistemike.

2.1.2 Amendamentet kushtetuese dhe organizimi i ri i pushtetit gjyqësor

Amendamentet kushtetuese, të miratuara me Ligjin nr. 76/2016, janë akti themelues i të gjithë reformës. Ato zëvendësuan tërësisht Pjesën IX të Kushtetutës “Pushteti gjyqësor” duke ribërë kornizën institucionale që, deri në atë moment, ishte ndërtuar mbi modelin minimal të vitit 1998.¹⁸⁰ Përmes Ligjit nr. 76/2016, ndryshimet shtrihen mbi gjykatat e zakonshme dhe të posaçme, mbi Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, mbi Prokurorinë, mbi Këshillin e Lartë Gjyqësor, dhe si risi tërësore mbi katër institucione të reja kushtetuese: Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, dhe Prokurorinë e Posaçme me Byronë Kombëtare të Hetimit. Më tej, përmes neneve të reja 179/a dhe 179/b të Aneksit të Kushtetutës, krijohet baza kushtetuese për procesin e rivlerësimit kalimtar.

Neni 135 i Kushtetutës, siç është ndryshuar me Ligjin nr. 76/2016, parashikon në mënyrë të plotë sistemin e gjykatave: Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit, gjykatat e shkallës së parë, dhe si parashikim i ri gjykatat e posaçme për shqyrtimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.¹⁸¹ Krijimi i “gjykatave të jashtëzakonshme” mbetet shprehimisht i ndaluar, ashtu si edhe në kornizën e mëparshme.

Boshti i ri institucional i qeverisjes së gjyqësorit ngrihet mbi katër organe kushtetuese: (a) Këshillin e Lartë Gjyqësor (neni 147), që zëvendëson Këshillin e Lartë të Drejtësisë;¹⁸² (b) Këshillin e Lartë të Prokurorisë (neni 149), strukturë paralele dhe e re për administrimin e karrierës së prokurorëve;¹⁸³ (c) Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (neni 147/d), organ kushtetues i ri që merr përsipër funksionet hetimore-disiplinore që më parë ndaheshin mes Inspektoratit të KLD-së dhe Ministrisë të Drejtësisë;¹⁸⁴ dhe (ç) Këshillin e

¹⁸⁰Para reformës, kuadri kushtetues për pushtetin gjyqësor (Pjesa IX e Kushtetutës, nenet 135–147 në numërimin e mëparshëm) ishte i strukturuar rreth një konfiguracioni të thjeshtë institucional: Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, gjykatat e zakonshme, Prokuroria dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (i parashikuar atëbotë nga neni 147 i Kushtetutës). Inspektorati i pavarur i drejtësisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe institucionet e specializuara antikorruption nuk ekzistonin si entitete kushtetuese.

¹⁸¹Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (e ndryshuar me Ligjin nr. 76/2016), neni 135, parashikon ndarjen e gjykatave në Gjykatën e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, ndërsa pranon shprehimisht krijimin e gjykatave të posaçme, përfshirë “gjykatat e posaçme që shqyrtojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar”, si dhe Gjykatën e Lartë në juridiksionin e saj rishikues. Krijimi i “gjykatave të jashtëzakonshme” mbetet i ndaluar shprehimisht.

¹⁸²Kushtetuta, neni 147 (i ndryshuar me Ligjin nr. 76/2016), përcakton përbërjen, mandatin dhe statusin e Këshillit të Lartë Gjyqësor: 11 anëtarë (6 gjyqtarë + 5 jo-gjyqtarë), mandat 5-vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme, kohë e plotë, dhe siguri i pavarësisë institucionale të organit. Procedura e zgjedhjes dhe kompetencat shtjellohen në Ligjin nr. 115/2016, nenet 3 e vijues.

¹⁸³Kushtetuta, neni 149 (i ndryshuar me Ligjin nr. 76/2016), përcakton Këshillin e Lartë të Prokurorisë, organ kushtetues paralel me KLGJ-në, me detyrën e administrimit të statusit dhe karrierës së prokurorëve. Përbërja, mandati dhe parimet janë analoge me ato të KLGJ-së: 11 anëtarë (6 prokurorë + 5 jo-gjyqtarë), mandat 5-vjeçar.

¹⁸⁴Kushtetuta, neni 147/d (shtuar me Ligjin nr. 76/2016): Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) është organ kushtetues i pavarur, përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin disiplinor të magistratëve dhe drejtuesve të institucioneve të drejtësisë, dhe inspektimet institucionale e tematike. Mandati 9-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Emërimeve në Drejtësi (neni 149/d), organ kushtetues i ri me detyrën e veçantë të vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë.¹⁸⁵

Po kështu, neni 148 i Kushtetutës, i ndryshuar tërësisht, dhe nenet pasuese (148/a–148/dh) krijojnë një strukturë tërësisht të re për Prokurorinë: Prokurorin e Përgjithshëm me kompetencë të përgjithshme; Prokurorinë e Posaçme me kompetencë mbi veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar; dhe Byronë Kombëtare të Hetimit, si njësi e specializuar e policisë gjyqësore në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme.¹⁸⁶

Risia më e jashtëzakonshme e amendamenteve kushtetuese është Aneksi i ri me dispozitat tranzitore për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Neni 179/b, i shtuar me Ligjin nr. 76/2016, ngre bazën kushtetuese të procesit të rivlerësimit, duke parashikuar krijimin e tre institucioneve specifike: Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK), Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, dhe Komisionerët Publikë.¹⁸⁷ Po ky nen krijon Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), përmes të cilit Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës ushtrojnë rolin vëzhgues dhe konsultativ në procesin e rivlerësimit. Përmes këtyre dispozitave, vetingu fitoi fuqinë e detyrueshmërisë kushtetuese duke iu nënshtruar të gjithë magjistratët në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të reformës.

Tre janë parimet themelore juridike që përshkruajnë amendamentet kushtetuese të Ligjit nr. 76/2016. Së pari, *parimi i ndarjes funksionale brenda qeverisjes së gjyqësorit*: funksionet e administrimit të karrierës (KLGJ, KLP), të hetimit-mbikëqyrjes disiplinore (ILD) dhe të vlerësimit-renditjes së kandidatëve (KED) ndahen midis tre organeve të veçanta kushtetuese. Së dyti, *parimi i pavarësisë horizontale prokurorisë*: për herë të parë, Prokuroria ka organin e saj kushtetues paralel të qeverisjes (KLP), dhe nuk varet më nga një organ monokratik si Prokurori i Përgjithshëm për administrimin e karrierës. Së treti, *parimi i specializimit antikorrupsion*: struktura e gjyqësorit dhe e Prokurorisë pajisen me institucione kushtetuese të posaçme me autonomi institucionale të garantuar (Gjykata e Posaçme, Prokuroria e Posaçme, BKH).

2.1.3 Riformatimi i Gjykatës Kushtetuese dhe forcimi i kontrollit kushtetues

Gjykata Kushtetuese, megjithëse vazhdon të rregullohet nga i njëjti ligj organik — Ligji nr. 8577/2000 — pësoi ndryshime të thella përmbajtësores me Ligjin nr. 99/2016, që e bëjnë institucionin *de facto* tërësisht të rishikuar. Ndryshimet shtrihen mbi pesë akse: (i) përbërjen dhe mënyrën e zgjedhjes; (ii) kriteret dhe kushtet e emërimit; (iii) zgjedhjen e Kryetarit; (iv) krijimin e regjimit disiplinor; dhe (v) shtimin e ankimit kushtetues individual si mjet i ri kushtetues mbrojtës i të drejtave themelore.

¹⁸⁵Kushtetuta, neni 149/d (shtuar me Ligjin nr. 76/2016): Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) është organ kushtetues që përzgjedh dhe rendit kandidatët për Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektor të Lartë të Drejtësisë. Përbëhet nga 9 anëtarë: 2 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, 1 gjyqtar i Gjykatës së Lartë, 1 prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme, 2 gjyqtarë apeli, 2 prokurorë apeli dhe 1 gjyqtar i shkallës së parë.

¹⁸⁶Kushtetuta, neni 148 dhe vijuesit (148/a–148/dh, të ndryshuar me Ligjin nr. 76/2016), parashikon Prokurorinë si organ kushtetues të pavarur, Prokurorin e Përgjithshëm dhe — si risi e madhe e reformës — Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit, si organe kushtetuese të specializuara për ndjekjen e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

¹⁸⁷Kushtetuta, neni 179/b (shtuar me Ligjin nr. 76/2016): dispozita tranzitore që përbën bazën kushtetuese të procesit të rivlerësimit kalimtar (vetingu). Pika 5 parashikon shprehimisht krijimin e Komisionit të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, si dhe rolin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).

Sipas versionit origjinal të nenit 7 të Ligjit nr. 8577/2000, të nëntë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese “emëroheshin nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit”.¹⁸⁸ Ky model ngarkonte tërësisht emërimin tek autoriteti politik (President + Kuvend), pa diferencim institucional dhe pa procedurë vlerësuese paraprake nga ndonjë organ teknik i pavarur.

Ligji nr. 99/2016 e ndryshoi tërësisht këtë logjikë. Sipas nenit 7 të ri, Gjykata Kushtetuese “përbëhet nga nëntë anëtarë, prej të cilëve tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi”.¹⁸⁹ Përbërja përtërihet me një të tretën e saj çdo tri vjet, sipas radhës: Presidenti, Kuvendi, Gjykata e Lartë. Ky model ndarjeje trepalëshe është një kthesë institucionale e thellë, që shpërndan kompetencën e emërimit midis pushtetit ekzekutiv (Presidenti), pushtetit legjislativ (Kuvendi) dhe vetë pushtetit gjyqësor (Gjykata e Lartë).

Reforma plotësohet me një rrjet të ri kushtetues procedurash vlerësuese. Neni 7/a, i shtuar me Ligjin nr. 99/2016, i cili përcakton për herë të parë në mënyrë sistematike kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë kandidati: zotësi të plotë veprimi, arsim juridik të lartë (Master), mosushtim funksionesh politike gjatë 10 viteve të fundit, pastërti penale, mospasja e masës disiplinore, si dhe element thelbësor i ri ai i kalimit me sukses të kontrollit dhe verifikimit të pasurisë personale dhe familjare. Krahas këtyre kushteve, kandidati duhet të ketë të paktën 15 vjet përvojë profesionale, veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese ose në sfera të tjera, dhe vlerësim për integritetin profesional dhe moral.¹⁹⁰

Procedura e emërimit kalon, sipas neneve 7/b, 7/c dhe 7/ç, përmes Këshillit të Emërimeve në Drejtësi — organ kushtetues i ri që vlerëson kushtet, vlerëson kriteret dhe rendit kandidatët në një listë përfundimtare të arsyetuar.¹⁹¹ Për procedurën para Kuvendit, neni 7/c kërkon shumicë të cilësuar prej tri të pestash të të gjithë anëtarëve për zgjedhjen e gjyqtarëve, dhe parashikon një mekanizëm zhblllokues: nëse Kuvendi nuk zgjedh brenda 30 ditëve, kandidati i renditur i pari në listën e KED-it konsiderohet automatikisht i emëruar.¹⁹²

¹⁸⁸Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, neni 7 (versioni origjinal): “Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. [...] Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emërohet nga radhët e anëtarëve të saj nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit, për një periudhë prej 3 vjetësh, me të drejtë riemërimi brenda mandatit të gjyqtarit”.

¹⁸⁹Ligji nr. 8577/2000 (i ndryshuar me Ligjin nr. 99/2016), neni 7, pika 1: “Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë anëtarë, prej të cilëve tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi”.

¹⁹⁰Ligji nr. 8577/2000 (i ndryshuar me Ligjin nr. 99/2016), neni 7/a, pika 1, parashikon kushtet thelbësore: zotësi të plotë për të vepruar; arsim të lartë juridik (Diplomë e Nivelit të Dytë); mosushtim funksionesh politike apo pozicionesh drejtuese partiake gjatë 10 viteve të fundit; mosqenia në procedim penal apo dënimi me burgim; mosqenia masë disiplinore në fuqi; kalim me sukses i kontrollit dhe verifikimit të pasurisë personale dhe familjare. Pika 2 parashikon kriteret: 15 vjet përvojë profesionale si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor, lektor ose jurist i nivelit të lartë në administratë; veprimtari e njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera; vlerësim për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

¹⁹¹Ligji nr. 8577/2000 (i ndryshuar me Ligjin nr. 99/2016), neni 7/b (procedura e emërimit nga Presidenti), 7/c (procedura e zgjedhjes nga Kuvendi), 7/ç (procedura e zgjedhjes nga Gjykata e Lartë). Në secilën nga këto procedura, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) bën verifikimin paraprak të kushteve dhe vlerësimin e kriterëve, duke përgatitur listën përfundimtare të kandidatëve të renditur.

¹⁹²Ligji nr. 8577/2000 (i ndryshuar me Ligjin nr. 99/2016), neni 7/c, pikat 5 dhe 6: pas seancave dëgjimore me kandidatët, Komisioni për Çështjet Ligjore i Kuvendit i dërgon Kuvendit emrat e tre kandidatëve për çdo vend vakant, dhe gjyqtarët

Versioni origjinal i nenit 7, pika 4, i Ligjit nr. 8577/2000 parashikonte se “Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emërohet nga radhët e anëtarëve të saj nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit, për një periudhë prej 3 vjetësh, me të drejtë riemërimi brenda mandatit të gjyqtarit”. Ligji nr. 99/2016 e ndërpreu këtë model. Neni i ri 7/d parashikon se “Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për një periudhë 3-vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë”.¹⁹³ Brenda të njëjtit nen, parashikohen edhe rregullat e detajuara për votimin e shumëfishtë në rast mosarritjeje të shumicës, përfshirë short-in si mjet të fundit në rast barazimi.

Versioni origjinal i Ligjit nr. 8577/2000 nuk parashikonte një katalog të mirëpërcaktuar shkeljesh disiplinore për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, as një procedurë specifike disiplinore. Ligji nr. 99/2016 e plotëson këtë mungesë duke shtuar Kreun II/1 të ri me titullin “Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese”, që përmban nenet 10 deri 10/ç.¹⁹⁴

Neni 10 ngre një katalog prej 17 shkeljesh disiplinore nga mos-heqja dorë kur është e detyrueshme, deri tek shkeljet e konfidencialitetit, përfitimet e padrejta, sjellja e papërshtatshme, dhe shoqërimi me persona të dyshuar penalisht. Neni 10/a përcakton se procedimi nis nga Kryetari ose çdo gjyqtar, me hetimin e dy gjyqtarëve të caktuar me short dhe kalon te Komisioni Disiplinor, i përbërë nga tre gjyqtarë të caktuar me short. Neni 10/b parashikon shkallë masash disiplinore: vërejtje me shkrim, vërejtje publike, ulje page deri 50 për qind deri në 1 vit, pezullim 3 deri 6 muaj, dhe shkarkim. Pezullimi gjatë procedimit rregullohet nga neni 10/ç.

Risia konceptualisht më e rëndësishme e Ligjit nr. 99/2016 është ridimensionimi tërësor i ankimit kushtetues individual, që ngrihet në një mjet kushtetues të mirëpërcaktuar, mbrojtës i të drejtave themelore të parashikuara nga Kushtetuta. Sipas Kreut të ri, që përmban nenet 71 deri 71/d, ankimi kushtetues individual është institut juridiko-kushtetues, që pajis çdo individ, person fizik ose juridik, me të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kur është bartës i të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Kushtetuta dhe pretendon cenim të tyre.¹⁹⁵

Neni 71, pika 1, parashikon shprehimisht: “Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe i lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë”.¹⁹⁶ Neni 71/a përcakton katër kritere kumulative pranueshmërie: shterimi i

zgjidhen me tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga KED-i, kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet i emëruar (mekanizëm anti-blokues).

¹⁹³Ligji nr. 8577/2000 (i ndryshuar me Ligjin nr. 99/2016), neni 7/d, pika 1: “Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për një periudhë 3-vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë”. Krahaso me versionin origjinal të nenit 7 të Ligjit nr. 8577/2000, ku Kryetari emërohej nga Presidenti me pëlqimin e Kuvendit.

¹⁹⁴Ligji nr. 8577/2000 (i ndryshuar me Ligjin nr. 99/2016), Kreu II/1 “Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese” (i shtuar i tëri me Ligjin nr. 99/2016), nenet 10–10/ç. Përmban katalogun e shkeljeve disiplinore (neni 10), procedurën (neni 10/a), masat disiplinore (neni 10/b: vërejtje me shkrim, vërejtje publike, ulje page deri 50% deri në 1 vit, pezullim 3–6 muaj, shkarkim) dhe pezullimin gjatë procedimit (neni 10/ç).

¹⁹⁵Ligji nr. 8577/2000 (i ndryshuar me Ligjin nr. 99/2016), nenet 71, 71/a, 71/b, 71/c, 71/ç dhe 71/d (titulli i ri i shtuar: “Procedura për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual”). Pjesa origjinale e nenit 71 (interpretimi i Kushtetutës) është rishtjelluar plotësisht.

¹⁹⁶Ligji nr. 8577/2000 (i ndryshuar me Ligjin nr. 99/2016), neni 71, pika 1: “Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe i lirive themelore

mjeteve juridike efektive; afati 4-mujor nga konstatimi i cenimit; pasojat negative të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin; mundësia e rivendosjes së të drejtës së shkelur përmes shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese.¹⁹⁷

Përveç ankimit individual, Ligji nr. 99/2016 i shton Gjykatës Kushtetuese edhe një kompetencë të re *sui generis*, që rrjedh nga neni 179/1 i Kushtetutës: shqyrtimi i kërkesave të jo më pak se një të pestës së deputetëve për konstatimin e mbarimit ose pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të zyrtarit të zgjedhur, të emëruar apo funksionarit të lartë publik, kur organet e ngarkuara nga Kushtetuta apo ligji nuk veprojnë.¹⁹⁸

Ligji nr. 99/2016 shton edhe nenin 14/a, që krijon Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese si “bërthama shkencore juridike e Gjykatës Kushtetuese”. Njësia përbëhet nga këshilltarë ligjorë të emëruar nga Kryetari, ku jo më pak se gjysma e numrit të përgjithshëm vjen nga radhët e magjistratëve të komanduar. Detyrat e saj përfshijnë përgatitjen e çështjeve për gjykim, dhënien e opinionëve ligjore dhe kërkimet shkencore. Pagesa e këshilltarëve ligjorë jomagjistratë barazohet me “pagën bruto fillestare” të gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë. Këshilltarët ligjorë i nënshtrohen rregullave të statusit të magjistratit për atë që ai gjen zbatim.¹⁹⁹

Pas hyrjes në fuqi të reformës dhe gjatë zbatimit të saj, u dëshmuar disa nevoja për përshtatje. Ligji nr. 45/2021 solli tre ndryshime kryesore. Së pari, shfuqizoi në nenet 7/b dhe 7/c kërkesën që, kur ka më shumë se një vend vakant, KED-i të hartonte dy lista të veçanta një prej të cilave me kandidatë nga radhët e gjyqësorit duke thjeshtuar procesin e renditjes së kandidatëve. Së dyti, shtoi në nenin 86 një rregullim tranzicional anti-bllokues: deri në emërimin e të paktën tre të katërtave të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ose në çdo rast jo më vonë se data 31.12.2023, mbledhja e posaçme e gjyqtarëve të GjL-së për zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është e vlefshme nëse marrin pjesë të paktën gjysma e gjyqtarëve të GjL-së mekanizëm i nevojshëm për shkak të vakancave të krijuara nga procesi i vetingut në GjL. Së treti, shtoi në nenin 18, pika 3, fjalinë e dytë që rregullon kthimin e ish-gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese (që përpara emërimit gëzonte statusin e magjistratit) në një pozicion në nivel apeli, me kushtin e plotësimit të kriterëve ligjore.²⁰⁰

të parashikuara nga Kushtetuta ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji”.

¹⁹⁷Ligji nr. 8577/2000 (i ndryshuar me Ligjin nr. 99/2016), neni 71/a, pika 1: ankimi kushtetues individual shqyrtohet kur kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive (ose nuk ka të tilla); kërkesa paraqitet brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit; pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale; shqyrtimi mund të rivendoste të drejtën e shkelur.

¹⁹⁸Ligji nr. 8577/2000 (i ndryshuar me Ligjin nr. 99/2016), neni 71/d, pika 1: kompetencë e re e Gjykatës Kushtetuese — me kërkesë të jo më pak se një të pestës së deputetëve, shqyrtimi i mosveprimit të organeve kushtetuese për konstatimin e mbarimit ose pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të zyrtarit të zgjedhur, të emëruar apo funksionarit të lartë publik, sipas nenit 179/1 të Kushtetutës.

¹⁹⁹Ligji nr. 8577/2000 (i ndryshuar me Ligjin nr. 99/2016), neni 14/a (i shtuar i tëri me Ligjin nr. 99/2016): krijimi i Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese, përbërë nga këshilltarë ligjorë, ku jo më pak se gjysma janë magjistratë të komanduar. Njësia është “bërthama shkencore juridike e Gjykatës Kushtetuese” dhe ushtron veprimtari këshilluese e ndihmëse në procesin vendimmarrës.

²⁰⁰Ligji nr. 45/2021, datë 23.3.2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, ‘Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese’”. Ndryshimet kryesore: shfuqizimi i kërkesës për dy lista të veçanta kandidatësh (një prej të cilave nga gjyqësori) në procedurat e neneve 7/b dhe 7/c, pika 4; shtimi i pikës 5 të nenit 86, që zbut përkohësisht kuorumin për mbledhjen e posaçme të Gjykatës së Lartë (deri në emërimin e të paktën tre të katërtave të gjyqtarëve të GjL ose deri më 31.12.2023, kuorumi është gjysma e gjyqtarëve të GjL); rregullim për kthimin në një pozicion në nivel apeli të ish-gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese që, përpara emërimit, gëzonin statusin e magjistratit (neni 18, pika 3, fjalia e dytë).

2.2 Organet kushtetuese të administrimit të sistemit të drejtësisë, statusi i magjistratit dhe rivlerësimi kalimtar

2.2.1 Organet e reja kushtetuese të administrimit të sistemit të drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës

Ligji nr. 115/2016 është akti organik, që mbush me përmbajtje rregullatore amendamentet kushtetuese. Sipas nenit 1 të tij, ligji përcakton parimet dhe rregullat në lidhje me organizimin dhe funksionimin e pesë organeve qendrore: Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dhe Shkollës së Magjistraturës.²⁰¹ Tre nga këto organe KLP, ILD dhe KED janë institucione krejtësisht të reja, që nuk ekzistonin para reformës. KLGJ-ja, edhe pse ndjek KLD-në në suksesion funksional, është institucionalisht e ndryshme nga ajo, ashtu siç është trajtuar gjerësisht në kapitullin paraprijës. Shkolla e Magjistraturës, e themeluar që në vitin 1996 me Ligjin nr. 8136, është rikonfiguruar institucionalisht nga Ligji nr. 115/2016 dhe ka tani lidhje organike funksionale me KLGJ-në dhe KLP-në.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi kushtetues paralel me KLGJ-në, që merr përsipër administrimin e statusit dhe karrierës së prokurorëve, funksione që, përpara reformës, ushtroheshin nga Prokurori i Përgjithshëm. Sipas Ligjit nr. 115/2016, KLP-ja është organ kolegjal me 11 anëtarë: 6 prokurorë (zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e prokurorëve të të gjitha niveleve) dhe 5 jo-gjyqtarë (zgjidhen nga Kuvendi me shumicë të cilësuar nga radhët e avokatëve, pedagogëve të drejtësisë dhe shoqërisë civile, sipas procedurave analoge me ato të KLGJ-së).²⁰²

Kompetencat e KLP-së janë të strukturuar në mënyrë simetrike me ato të KLGJ-së, por të orientuara drejt prokurorëve: emërim, vlerësim, ngritje në detyrë, transferim, masa disiplinore; propozim i Prokurorit të Përgjithshëm; planifikim strategjik; raportim para Kuvendit; mbikëqyrje e administrimit të prokurorive. Edhe modeli i organizimit të brendshëm mbledhje plenare të ndërthurura me komisione të përhershme (Planifikimi Strategjik dhe Buxheti, Disiplinor, Vlerësimi i Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Zhvillimi i Karrierës) është paralel me atë të KLGJ-së.²⁰³ Krijimi i KLP-së ndan përfundimisht administrimin e karrierës së prokurorëve nga ndikimi i drejtpërdrejtë i Ministrit të Drejtësisë, si dhe vendos pavarësinë horizontale të prokurorisë në një bazë institucionale të qëndrueshme.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është organ kushtetues unipersonal i pavarur ndoshta institucioni më novator i reformës nga pikëpamja e ndarjes funksionale të kompetencave. Sipas nenit 197 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, ILD-ja zgjidhet nga Kuvendi me shumicë të cilësuar prej tri të pestash, mbi bazën e listës së renditur nga Këshilli i Emërimeve në

²⁰¹Ligji nr. 115/2016, neni 1: “Objekti i rregullimit të këtij ligji është përcaktimi i parimeve dhe rregullave në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si dhe të Shkollës së Magjistraturës”.

²⁰²Ligji nr. 115/2016, neni 107 dhe vijues, parashikojnë Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) si organ kolegjal me 11 anëtarë (6 prokurorë + 5 jo-gjyqtarë), me kohë të plotë, mandat 5-vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme. Anëtarët prokurorë zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e prokurorëve sipas raportit: tre nga shkalla e parë, dy nga apeli (përfshirë një nga prokuroria e posaçme), dhe një nga Prokuroria e Përgjithshme. Anëtarët jo-gjyqtarë zgjidhen nga Kuvendi sipas procedurave analoge me ato të KLGJ-së.

²⁰³Ligji nr. 115/2016, neni 149 e vijues, parashikon kompetencat e KLP-së në mënyrë të strukturuar: emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë dhe transferimin e prokurorëve të të gjitha niveleve; vendosjen e masave disiplinore; propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm; administrimin e karrierës; planifikimin strategjik; raportimin para Kuvendit; dhe mbikëqyrjen e administrimit të prokurorive. Modeli i organizimit të brendshëm — mbledhje plenare + komisione të përhershme — është simetrik me atë të KLGJ-së.

Drejtësi, me mandat 9-vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje.²⁰⁴

Kompetencat e ILD-së përfshijnë: hetimin e shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarëve të KLGJ-së, KLP-së dhe vetë anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese; verifikimin e ankesave nga shtetasit; kryerjen e inspektimeve institucionale dhe tematike në gjykata dhe prokurori; dhe raportimin periodik. Vendimmarrja disiplinore nuk i takon ILD-së, ai vetëm heton dhe ia përcjell çështjen organit kompetent: KLGJ-së për gjyqtarët, KLP-së për prokurorët, ose Gjykatës Kushtetuese për anëtarët e KLGJ-së dhe KLP-së.²⁰⁵ Kjo ndarje midis funksionit hetimor (i bartur tek ILD-ja) dhe funksionit vendimmarrës (i bartur tek organet kolegjiale) është një nga arritjet më substanciale të reformës nga këndvështrimi i ndarjes së pushteteve dhe i paanshmërisë procedurale.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është një tjetër risi institucionale e reformës organ kushtetues kolegjial me funksion specifik dhe të kufizuar: vlerësimin paraprak dhe renditjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë. Sipas nenit 221 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, KED-i përbëhet nga 9 anëtarë: 2 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese; 1 gjyqtar i Gjykatës së Lartë; 1 prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme; 2 gjyqtarë apeli; 2 prokurorë apeli; dhe 1 gjyqtar i shkallës së parë. Mandati është 1-vjeçar dhe anëtarët shërbejnë me kohë të pjesshme.²⁰⁶

KED-i kryen tre funksione kryesore: (i) verifikon plotësimin e kushteve formale ligjore nga kandidatët; (ii) vlerëson kriteret profesionale, morale dhe organizative; dhe (iii) rendit kandidatët në një listë të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve, të shoqëruar nga raport i arsyetuar. Lista i përcillet organit të emërtesës (Presidentit, Kuvendit ose Gjykatës së Lartë), që zgjedh nga tre kandidatët e parë. KED-i është mekanizmi që e ndan procesin e zgjedhjes në dy faza vlerësimin teknik-profesional (te KED-i) dhe vendimmarrjen formale (te organi i emërtesës) duke parandaluar emërime mbi baza tërësisht politike.²⁰⁷

Shkolla e Magjistraturës u themelua që në vitin 1996 me Ligjin nr. 8136, si “institucion publik buxhetor” me autonomi administrative, akademike dhe financiare, përgjegjës për formimin profesional të magjistratëve.²⁰⁸ Reforma në drejtësi solli një ndryshim cilësor në pozitën juridike dhe institucionale të Shkollës së Magjistraturës, duke e ngritur rolin e saj nga një institucion i rregulluar kryesisht në nivel ligjor në një element të parashikuar shprehimisht në Kushtetutë, si kusht për hyrjen në funksionin gjyqësor. Për

²⁰⁴Ligji nr. 115/2016, neni 197 dhe vijues. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) zgjidhet nga Kuvendi me shumicë të cilësuar prej tri të pestash, me mandat 9-vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje. Procedura e zgjedhjes kalon përmes Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që vlerëson kushtet dhe kriteret dhe rendit kandidatët.

²⁰⁵Ligji nr. 115/2016, neni 198, parashikon kompetencat e ILD-së: hetimin e shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarëve të KLGJ-së, KLP-së dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; verifikimin e ankesave; kryerjen e inspektimeve institucionale dhe tematike; raportimin para Kuvendit, KLGJ-së dhe KLP-së. Pavarësia e tij është e garantuar — procedimi disiplinor inicohet nga ILD-ja, ndërsa vendimmarrja merret nga KLGJ-ja, KLP-ja apo Gjykata Kushtetuese, sipas subjektit.

²⁰⁶Ligji nr. 115/2016, neni 221 dhe vijues. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) është organ kushtetues kolegjial me 9 anëtarë: 2 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese; 1 gjyqtar i Gjykatës së Lartë; 1 prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme; 2 gjyqtarë apeli; 2 prokurorë apeli; dhe 1 gjyqtar i shkallës së parë. Anëtarët shërbejnë me kohë të pjesshme dhe zgjidhen me short nga radhët e magjistratëve të secilit nivel. Mandati 1-vjeçar.

²⁰⁷Ligji nr. 115/2016, nenet 230–238. KED-i kryen verifikimin paraprak të kushteve dhe vlerësimin e kriterëve të kandidatëve për: (i) gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese — për të tre rrugët e emërimit (President, Kuvend, Gjykatë e Lartë); dhe (ii) Inspektor të Lartë të Drejtësisë. Pas vlerësimit, KED-i përgatit listën e renditur të kandidatëve të shoqëruar me raport të arsyetuar, që miratohet me shumicën e të gjithë anëtarëve.

²⁰⁸Ligji nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjet nr. 9414, datë 20.5.2005 dhe nr. 97/2014, datë 24.7.2014. Para reformës, Shkolla e Magjistraturës rregullohej nga ky ligj, që e parashikonte si “institucion publik buxhetor” me autonomi administrative, akademike dhe financiare, por pa lidhjen organike funksionale me organet e qeverisjes së gjyqësorit ashtu siç parashikohet në regjimin e ri.

herë të parë, me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, Shkolla e Magjistraturës u përfshi në tekstin kushtetues përmes nenit 136/a, të shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016²⁰⁹, sipas të cilit gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe figurës, sipas ligjit. Në këtë mënyrë, reforma kushtetuese e lidh drejtpërdrejt emërimin në detyrën e gjyqtarit me formimin profesional institucional dhe me verifikimin paraprak të integritetit, duke e shndërruar Shkollën e Magjistraturës në një hallkë kushtetuese të sistemit të rekrutimit gjyqësor. Reforma në drejtësi nuk e shfuqizoi këtë ligj në mënyrë të menjëhershme, por rikonfiguroi rolin institucional dhe funksional të Shkollës përmes Ligjit nr. 115/2016, duke e integruar atë në arkitekturën e re të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Sipas neneve 254 dhe vijues, Shkolla siguron formimin fillestar të kandidatëve për magjistratë (me afat tre-vjeçar), formimin vazhdues të magjistratëve në detyrë, dhe risi e reformës formimin fillestar dhe vazhdues të kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, si dhe nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë.²¹⁰ Bashkëpunimi i Shkollës me KLGJ-në dhe KLP-në është organik: organet e qeverisjes përcaktojnë numrin e vendeve të lira, dhe janë organe kompetente për emërimin e magjistratëve pas diplomimit në Shkollë.

2.2.2 Statusi i unifikuar i magjistratit sipas Ligjit nr. 96/2016

Ligji nr. 96/2016 është *lex specialis* që rregullon në mënyrë sistematike të gjithë jetën profesionale të magjistratit nga pranimi në sistem, përmes karrierës dhe vlerësimit, deri tek mbarimi i mandatit dhe përgjegjësia disiplinore, civile dhe penale. Sipas nenit 1 të tij, objekti përfshin: të drejtat dhe detyrimet e magjistratit; pranimin dhe emërimin; karrierën dhe mbarimin e mandatit; vlerësimin etik dhe profesional; dhe përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile.²¹¹ Statusi i parashikuar në këtë ligj zëvendëson dispozitat fragmentare të mëparshme që ndodheshin në Ligjin nr. 9877/2008 për pushtetin gjyqësor (për gjyqtarët) dhe në Ligjin nr. 8737/2001 për Prokurorinë (për prokurorët).

Risi konceptuale e Ligjit nr. 96/2016 është krijimi i një figure juridike të unifikuar magjistrati që përfshin si gjyqtarin (me përjashtim të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese) ashtu edhe prokurorin, duke përfshirë edhe kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive.²¹² Kjo zgjidhje dogmatike është e qëllimshme: ajo nënkupton që, megjithëse ushtrojnë funksione institucionale të ndryshme, gjyqtari dhe prokurori ndajnë një status të përbashkët profesional, me të njëjtat kërkesa pranimi, formimi, vlerësimi dhe përgjegjësie. Të dyja kategoritë formohen në të njëjtën Shkollë të Magjistraturës, të dyja administrohen nga organe kolegjinale të ngjashme strukturalisht (KLGJ dhe KLP), dhe të dyja i nënshtrohen të njëjtë regjim disiplinor sipas Ligjit nr. 96/2016.

²⁰⁹ Ligj nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, Fletore Zyrtare nr. 138, datë 27.07.2016.

²¹⁰ Ligji nr. 115/2016, neni 254 dhe vijues, riformulon Shkollën e Magjistraturës si institucion publik buxhetor me autonomi administrative, akademike dhe financiare. Shkolla siguron formimin fillestar dhe vazhdues të magjistratëve, kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, si dhe nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë në bashkëpunim me KLGJ-në dhe KLP-në.

²¹¹ Ligji nr. 96/2016, neni 1, pika 1: “Objekti i këtij ligji është përcaktimi i statusit të magjistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me: a) të drejtat dhe detyrimet e tyre; b) pranimin dhe emërimin e tyre; c) zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre; ç) vlerësimin etik dhe profesional të tyre; d) përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre”.

²¹² Ligji nr. 96/2016, neni 2, shkronja “gj”: “‘Magjistrat’ është gjyqtari, me përjashtim të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, prokurori dhe kryetarët në kuptim të shkronjës ‘g’ të këtij neni”.

Ndarja institucionale midis dy këshillave shfaqet vetëm në vendimmarrjen llojin e magjistratit përkatës, kurse korniza materiale (kushtet, kriteret, procedurat, vlerësimet) është e njëjtë. Kjo arkitekturë i jep statusit të magjistratit në Shqipëri një natyrë të veçantë, që dallon nga modeli italian dhe francez, ku gjyqtarët dhe prokurorët formojnë “magjistraturën” si *corps* i unifikuar, por pa ndarje institucionale aq të qartë midis administrimit të tyre.²¹³

Pjesa II e Ligjit nr. 96/2016 rregullon procesin e pranimi në magjistraturë, që organizohet si proces përzgjedhës me kriteret të rrepta dhe me shumë faza. Kandidati duhet të plotësojë kushtet e përgjithshme (shtetësia shqiptare, mosha, zotësia për të vepruar, arsimi i lartë juridik me Master në Shkenca), kushtet e veçanta (përvojë profesionale për disa pozicione), si dhe kushtet e integritetit (mosqenia në procedim penal, pastërti e figurës, kalim me sukses i kontrollit të pasurisë). Pranimi kalon përmes Shkollës së Magjistraturës fillimisht me konkursin e pranimi të organizuar nga Shkolla, pastaj me programin e formimit fillestar tre-vjeçar, që përfshin teori dhe praktikë në gjykata dhe prokurori, dhe përfundon me provimin e diplomimit. Vetëm pas diplomimit dhe verifikimit përfundimtar të pasurisë dhe figurës nga Këshilli kompetent, kandidati emërohet magjistrat.²¹⁴

Pjesa III e Ligjit nr. 96/2016 rregullon në mënyrë të hollësishme zhvillimin e karrierës: caktimin në pozicion, transferimin (vullnetar dhe të detyruar), ngritjen në detyrë (në nivel më të lartë gjyqësor ose në Gjykatën e Lartë), komandimin (në institucione të tjera publike, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Shkollën e Magjistraturës, KLGJ-në, KLP-në), dhe riemërimin pas mbarimit të komandimit.²¹⁵ Procedurat janë të mbështetura në kriteret objektive vlerësimi dhe kërkojnë vendimmarrje të arsyetuar nga Këshilli kompetent.

Pjesa IV ngre një ndër mekanizmat më të rëndësishëm të reformës: vlerësimin etik dhe profesional periodik të magjistratëve. Vlerësimi kryhet, si rregull, çdo tri vjet, mbi bazën e kriterëve të mirëpërcaktuara në ligj (cilësia profesionale e dokumenteve ligjore të nxjerra; performanca në lidhje me ngarkesën dhe afatet; kompetenca etike; aftësia drejtuese për ata në funksion drejtues). Rezultati klasifikohet në katër nivele: i shkëlqyer, shumë mirë, mirë dhe i papranueshëm. Vlerësimet, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt mbi karrierën janë të domosdoshme për ngritjen në detyrë, transferimin në pozicione më të kërkuara dhe në rastin e vlerësimit “i papranueshëm” mund të çojnë në procedim disiplinor.²¹⁶

Pjesa V e Ligjit nr. 96/2016 ngre regjimin disiplinor të magjistratëve: katalogun e shkeljeve, shkallën e masave (vërejtje, ulje page, pezullim, transferim si masë disiplinore, shkarkim) dhe nis procedurën që ka të bëjë me hetimin nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Gjithashtu, kjo pjesë e ligjit parashikon kalimin te Komisioni Disiplinor i Këshillit

²¹³Ligji nr. 96/2016, neni 2, shkronja “ë”, nënparagrafët (i) dhe (ii): “‘Këshillat’ janë: i) Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili është organi që merret me çështje që lidhen me gjyqtarët, të emëruarit, të diplomuarit dhe kandidatët për magjistratë që ndjekin Shkollën e Magjistraturës, me qëllim që të bëhen gjyqtarë; ii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi që merret me çështje që lidhen me prokurorët, të emëruarit, të diplomuarit dhe kandidatët për magjistratë që ndjekin Shkollën e Magjistraturës, me qëllim që të bëhen prokurorë”.

²¹⁴Ligji nr. 96/2016, Pjesa II, Krerët I–IV, që rregullon pranimin në sistemin e magjistraturës: kushtet (përfshirë moshën, arsimin, pastërtinë e figurës, kontrollin e pasurisë), formimin fillestar tre-vjeçar në Shkollën e Magjistraturës, periudhën e provës, dhe emërimin përfundimtar nga Këshilli kompetent.

²¹⁵Ligji nr. 96/2016, Pjesa III: rregullimet për karrierën e magjistratit — caktimi në pozicion, transferimi, ngritja në detyrë, komandimi, riemërimi. Procedurat janë të strukturuar me kriteret objektive të vlerësimit dhe kërkojnë vendimmarrje të arsyetuar nga Këshillat.

²¹⁶Ligji nr. 96/2016, Pjesa IV: vlerësimi etik dhe profesional i magjistratëve. Sipas regjimit të ri, vlerësimi është periodik (si rregull çdo tri vjet), realizohet sipas kriterëve të mirëpërcaktuara në ligj dhe akte nënligjore të KLGJ-së/KLP-së, dhe rezultoni në katër nivele vlerësimi (i shkëlqyer, shumë mirë, mirë, i papranueshëm). Vlerësimet hyjnë në dosjen profesionale të magjistratit dhe ndikojnë drejtpërdrejt mbi karrierën e tij.

kompetent dhe shqyrtimin në mbledhje plenare. Magjistrati ka të drejtën e plotë të mbrojtjes në çdo fazë, dhe vendimi përfundimtar i Këshillit është i ankimueshëm.²¹⁷

Ligji nr. 96/2016 ka pësuar disa ndërhyrje të rëndësishme pas hyrjes në fuqi. Më e dukshme është *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017*, që shfuqizoi pjesërisht disa nene kryesisht në fushën e procedimit disiplinor dhe të statusit profesional për mospërputhshmëri me Kushtetutën, duke i ridimensionuar ato drejt parimeve të të drejtës së mbrojtjes dhe të procesit të rregullt. Ndryshimet pasuese ligjore përmes Ligjit nr. 48/2019, Ligjit nr. 15/2020, Ligjit nr. 149/2020, Ligjit nr. 50/2021 dhe Ligjit nr. 33/2023, kanë synuar përshtatjen e regjimit të statusit me nevojat e zbatimit praktik dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.²¹⁸

2.2.3 Strukturat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Ligji nr. 95/2016 plotëson amendamentet kushtetuese duke ngritur strukturën e plotë institucionale të luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sipas nenit 1, ligji rregullon: (i) organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe të Njësisë së Pavarur Hetimore (Byrosë Kombëtare të Hetimit), si organe kushtetuese sipas pikës 4 të nenit 148 të Kushtetutës; (ii) procedurën e emërimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme; (iii) kompetencat lëndore të gjykatave të posaçme; dhe (iv) kushtet dhe kriteret shtesë për magjistratët dhe punonjësit në këto struktura.²¹⁹

Qëllimi i shprehur i ligjit, sipas nenit 2, është “garantimi i funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, si një prokurori e specializuar, për të ushtruar kompetencat e parashikuara në pikën 1, të nenit 148/dh, të Kushtetutës, në mënyrë efikase dhe të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm.”²²⁰

Sistemi i gjykatave të posaçme përbëhet nga dy nivele: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Posaçme e Apelit, që së bashku formojnë degën e specializuar të juridiksionit penal për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sipas nenit 3, pika 3, shkronja “b”, dhe nenit 11 të Ligjit nr. 98/2016, këto gjykata organizohen dhe funksionojnë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me seli në Tiranë.²²¹ Përbërja

²¹⁷Ligji nr. 96/2016, Pjesa V: përgjegjësia disiplinore. Përmban katalogun e shkeljeve, shkallën e masave disiplinore, dhe procedurën — që nis me hetimin nga ILD-ja, vazhdon me Komisionin Disiplinor të Këshillit kompetent, dhe shqyrtohet në mbledhje plenare. Vendimi është i ankimueshëm para Kolegjit të Posaçëm të Apelit (gjatë procesit të rivlerësimit) dhe, përgjithësisht, para Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 71, pika 3, të Ligjit nr. 8577/2000 të ndryshuar.

²¹⁸Ligji nr. 96/2016 është ndryshuar nga: Ligji nr. 48/2019, datë 18.7.2019; Ligji nr. 15/2020, datë 12.2.2020; Ligji nr. 149/2020, datë 17.12.2020; Ligji nr. 50/2021, datë 23.3.2021; dhe Ligji nr. 33/2023, datë 25.5.2023. Përveç këtyre, disa nene janë shfuqizuar nga Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017, që ndërhyri kryesisht mbi rregullat e procedimit disiplinor dhe statusit, duke i kthyer ato më në përputhje me Kushtetutën dhe me parimet e të drejtave të mbrojtjes.

²¹⁹Ligji nr. 95/2016, neni 1: parashikon objektin — organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Njësisë së Pavarur Hetimore (Byrosë Kombëtare të Hetimit), si organe kushtetuese sipas pikës 4 të nenit 148 të Kushtetutës; përcaktimin e kompetencave lëndore parësore dhe të tjera të gjykatave të posaçme dhe Prokurorisë së Posaçme; kushtet dhe kriteret shtesë për magjistratët dhe punonjësit; dhe organizimin e procesit të kontrollit të figurës, vëzhgimit financiar dhe të telekomunikimeve të tyre.

²²⁰Ligji nr. 95/2016, neni 2: qëllimi është “garantimi i funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, si një prokurori e specializuar, për të ushtruar kompetencat e parashikuara në pikën 1, të nenit 148/dh, të Kushtetutës, në mënyrë efikase dhe të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm”.

²²¹Ligji nr. 98/2016, neni 3, pika 3, shkronja “b”, parashikon ndër gjykatat e posaçme “Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe e Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar”. Sipas nenit 11 të njëjtit ligj, kjo gjykatë organizohet dhe funksionon për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë.

minimale e parashikuar nga ligji është e veçantë: gjykata e shkallës së parë me të paktën 16 gjyqtarë, ndërsa gjykata e apelit me të paktën 11 gjyqtarë.²²²

Prokuroria e Posaçme, e njohur publikisht si SPAK (*Struktura e Posaçme Antikorrupsion*) është organi kushtetues i prokurorisë, i specializuar për ndjekjen e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet sipas procedurës specifike të parashikuar në Ligjin nr. 95/2016 dhe ka status hierarkik të krahasueshëm me Prokurorin e Përgjithshëm (në rangun e tij), por me kompetencë lëndore të kufizuar mbi veprat penale specifike. Pavarësia e SPAK-ut nga drejtimi i përgjithshëm i Prokurorisë është një nga arritjet e mëdha të reformës: ai ushtron kompetencat e veta në mënyrë autonome, megjithëse përfshihet në strukturën e përgjithshme kushtetuese të Prokurorisë.

Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) është risi tjetër strukturore: njësia e specializuar e policisë gjyqësore, që vepron nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Prokurorisë së Posaçme. Hetuesit e BKH-së kanë status të veçantë profesional dhe i nënshtrohen procedurave të kontrollit të figurës, vëzhgimit financiar dhe të telekomunikimeve të vazhdueshme, në kushte më të repta sigurie, që sigurojnë mbrojtjen nga korrupsioni i brendshëm dhe nga ndikimi i jashtëm.²²³ Krijimi i BKH-së plotëson trekëndëshin institucional: gjykatë e specializuar, prokurori e specializuar, polici gjyqësore e specializuar, që së bashku përbëjnë “sistemin SPAK” të luftës ndaj korrupsionit.

Magjistratët dhe punonjësit në strukturat SPAK i nënshtrohen një regjimi të veçantë profesional dhe të integritetit. Sipas neneve 6 e vijues të Ligjit nr. 95/2016, ata duhet të japin pëlqim për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, dhe risi e veçantë edhe të familjarëve të afërm. Kandidatët kalojnë kontroll të thelluar të figurës; nuk lejohen marrëdhënie me persona që janë në procedim ose janë dënuar penalisht. Të gjitha këto kushte janë afatgjata: ato vlejné gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të funksionit në strukturat SPAK dhe sigurojnë një nivel më të lartë mbrojtjeje nga ndikimi i jashtëm.²²⁴

2.2.4 Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe pasojat e tij institucionale

Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve i njohur publikisht si vettingu është dimension i më i veçantë dhe historikisht më i pashembullt i reformës. Ai bazohet drejtpërdrejt në nenin 179/b të Kushtetutës, që i është shtuar Aneksit me Ligjin nr. 76/2016, dhe rregullohet me hollësi nga Ligji nr. 84/2016. Sipas nenit 1 të këtij ligji, qëllimi i procesit është “përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij

²²²Ligji nr. 98/2016, neni 15, pika 4, shkronjat “c” dhe “ç”: gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar të shkallës së parë përbëhen nga së paku 16 gjyqtarë, dhe ato të apelit nga së paku 11 gjyqtarë.

²²³Ligji nr. 95/2016, nenet që rregullojnë Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH): organ i policisë gjyqësore i specializuar, që vepron nën autoritetin e Prokurorisë së Posaçme. Drejtori dhe Zëvendësdrejtori, hetuesit dhe shërbimet e BKH-së i nënshtrohen procedurës së kontrollit të figurës, vëzhgimit financiar dhe të telekomunikimeve, dhe kanë status të veçantë profesional.

²²⁴Ligji nr. 95/2016, neni 6 dhe vijues, parashikon kushtet shtesë për magjistratët dhe punonjësit në strukturat e SPAK-ut: pëlqimi për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe telekomunikimeve vetjake dhe të familjarëve të afërm; verifikim i thelluar i figurës; mospasja e marrëdhënieve me persona të dyshuar penalisht; dhe kushte të tjera të sigurisë.

sistemi”.²²⁵ Objekti përfshin parimet e organizimit, metodologjinë, procedurat dhe standardet; organizimin dhe funksionimin e institucioneve të rivlerësimit; dhe rolin e Operacionit ndërkombëtar të monitorimit.²²⁶

Neni 4, pika 1, i Ligjit nr. 84/2016 përcakton në mënyrë eksplicite tre kriteret që formojnë substancën e rivlerësimit: (a) vlerësimi i pasurisë; (b) kontrolli i figurës; dhe (c) vlerësimi i aftësive profesionale.²²⁷ Çdo kriter ka metodologjinë e vet specifike: vlerësimi i pasurisë mbështetet në deklaratat e pasurisë të subjektit dhe të familjarëve, dhe verifikimin nga ILDKPKI-ja dhe organe të tjera; kontrolli i figurës mbështetet në verifikimin nga shërbimet shtetërore informative dhe organet e tjera kompetente, që shqyrtojnë lidhjet e mundshme me krimin e organizuar dhe ndikimet e papërshtatshme; vlerësimi i aftësive profesionale realizohet mbi bazën e dokumenteve ligjore si vendimeve gjyqësore, kërkesave, opinioneve të përzgjedhura pjesërisht nga vetë subjekti dhe pjesërisht me përzgjedhje rastësore.

Vendimi përfundimtar mund të bazohet në një ose disa prej kriterëve, ose në vlerësimin e përgjithshëm të të treve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave duke i dhënë institucioneve të rivlerësimit fleksibilitet vendimor në rastet e ndryshme.

Procesi realizohet nga katër kategori institucionesh dhe aktorësh, sipas nenit 5 të Ligjit nr. 84/2016: (a) Komisioni i pavarur i pualifikimit (KPK) si institucion i shkallës së parë; (b) Kolegji i posaçëm i apelimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese si institucion i shkallës së dytë; (c) Komisionerët Publikë si përfaqësues të interesit publik; dhe (ç) Operacioni ndërkombëtar i monitorimit (ONM) si trupa vëzhguese ndërkombëtare.²²⁸

Komisioni i pavarur i kualifikimit organizohet në katër trupa gjyqësore të përbëra nga tre anëtarë secila, të caktuara me short. Anëtarët kanë mandat 9-vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje. KPK-ja shqyrton në shkallë të parë çështjet e rivlerësimit dhe vendos për konfirmimin, pezullimin ose shkarkimin e subjektit.²²⁹

Kolegji i Posaçëm i Apelit, ngritur pranë Gjykatës Kushtetuese, është organi i shkallës së dytë. Krahas funksionit të tij të rivlerësimit, KPA-ja ka edhe juridiksion të përhershëm mbi: (i) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të KLGJ-së, të KLP-së, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; dhe (ii) ankimet kundër vendimeve të KLGJ-së, të KLP-së dhe të ILD-së për vendosjen e masave disiplinore. Ky juridiksion i përhershëm e bën KPA-në një institucion *sui generis* brenda

²²⁵Ligji nr. 84/2016, neni 1: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës”.

²²⁶Ligji nr. 84/2016, neni 2: parashikon objektin: parimet e organizimit të procesit; metodologjinë, procedurat dhe standardet; organizimin dhe funksionimin e institucioneve të rivlerësimit; rolin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të organeve të tjera shtetërore dhe të publikut.

²²⁷Ligji nr. 84/2016, neni 4, pika 1: “Procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tre kriterëve: a) vlerësimi i pasurisë; b) kontrolli i figurës; dhe c) vlerësimi i aftësive profesionale.” Pika 2 e të njëjtit nen: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”.

²²⁸Ligji nr. 84/2016, neni 5: “Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë.” Pika 2: “Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar”.

²²⁹Ligji nr. 84/2016, neni 3, pika 5, dhe nenit 14 e vijues. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) është institucioni i shkallës së parë i procesit, i parashikuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të Kushtetutës. Organizohet në katër trupa gjyqësore të përbëra nga 3 anëtarë secila, të caktuar me short. Anëtarët kanë mandat 9-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.

arkitekturës kushtetuese i përkohshëm për një funksion (vettingun) por i përhershëm për një tjetër (juridiksioni disiplinor mbi titullarët e organeve të drejtësisë).²³⁰

Komisionerët Publikë kanë rol të veçantë: ata janë palë në procedurat para KPK-së dhe KPA-së dhe përfaqësojnë interesin publik. Kompetenca e tyre kryesore është ushtrimi i ankimit ndaj vendimit të KPK-së për konfirmim duke siguruar kështu një mekanizëm strukturor për shqyrtim të dyfishtë në çështjet ku KPK-ja konfirmon subjektin por ka dyshime për saktësinë e vlerësimit.²³¹

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, i parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, përbëhet nga vëzhgues ndërkombëtarë, të caktuar nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara. ONM-ja ka qasje të plotë në dosjet, mund të paraqesë opinione gjatë gjithë procesit, dhe risi në krahasim me modelet e tjera të vettingut ka të drejtën e ankimit kundër vendimeve të KPK-së. Roli i ONM-së është konsultativ dhe vëzhgues, por me efekte praktike thelbësore për cilësinë dhe besueshmërinë e procesit.²³²

Subjekt i rivlerësimit sipas dispozitave të kombinuara të nenit 179/b të Kushtetutës dhe të Ligjit nr. 84/2016 janë të gjithë magjistratët në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të reformës: gjyqtarët e të gjitha niveleve përfshirë Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese; prokurorët e të gjitha niveleve përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm; Inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë; si dhe ndihmësmagjistratët/ndihmësat ligjore në Gjykatën e Lartë dhe gjykatat administrative dhe këshilltarët ligjorë në Gjykatën Kushtetuese që ishin në detyrë ose kërkonin emërim. Çështjet për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe për Prokurorin e Përgjithshëm trajtohen me përparësi në kohë nga institucionet e rivlerësimit, sipas pikës 4 të nenit 4 të Ligjit nr. 84/2016.²³³

Procedura e rivlerësimit përbëhet nga disa hapa thelbësorë. Së pari, subjekti plotëson formularin e pasurisë (Shtojca 2 e Ligjit nr. 84/2016) dhe formularin e vetëvlerësimit profesional (Shtojca 4), të cilat dorëzon brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit. Së dyti, organet kompetente — ILDKPKI-ja për pasurinë, organet e specializuara për figurën, dhe organi i vlerësimit të aftësive profesionale (fillimisht Inspektorati i KLD-së, që pastaj kalon te ILD) — kryejnë verifikimin dhe përgatitin raportet e tyre. Së treti, çështja kalon te trupa gjyquese e KPK-së, ku relatori përgatit relacionin përfundimtar mbi bazën e raporteve të tre kritereve. Së katërti, zhvillohet seanca dëgjimore me subjektin, që ka të drejtë të mbrohet dhe të paraqesë prova. Së pesti, KPK-ja vendos për konfirmim, pezullim me

²³⁰Ligji nr. 84/2016, neni 3, pika 7, dhe nenet pasuese. Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese është institucioni i shkallës së dytë (apelit) i procesit, i parashikuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të Kushtetutës. Anëtarët kanë mandat 9-vjeçar. Sipas nenit 5, pika 3, krahas funksionit të rivlerësimit, KPA-ja ushtron edhe juridiksion të përhershëm mbi: (i) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, KLGJ-së, KLP-së, Prokurorit të Përgjithshëm dhe ILD-së; dhe (ii) ankimet kundër vendimeve të KLGJ-së, KLP-së dhe ILD-së për masat disiplinore.

²³¹Ligji nr. 84/2016, neni 3, pika 4, dhe nenet vijuese për Komisionerët Publikë. Ata përfaqësojnë interesin publik në procesin e rivlerësimit, duke qenë palë në procedurat para KPK-së dhe KPA-së. Kompetencë e tyre është paraqitja e ankimit ndaj vendimit të KPK-së për pranim, dhe ndjekja e procedurave për ushtrimin e të drejtave të publikut në proces.

²³²Ligji nr. 84/2016, neni 3, dhe parashikimet e nenit 179/b të Kushtetutës. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) përbëhet nga vëzhgues ndërkombëtarë të caktuar nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, që mbikëqyrin gjithë procesin e rivlerësimit. Vëzhguesit kanë qasje të plotë në dosjet, mund të paraqesin opinione, dhe — risi e procesit — kanë të drejtën e ankimit kundër vendimeve të KPK-së dhe të kërimit të rishqyrtimit të çështjeve nga KPA-ja.

²³³Ligji nr. 84/2016, sipas dispozitave të kombinuara me nenin 179/b të Kushtetutës. Subjekt i rivlerësimit janë: gjyqtarët e të gjitha niveleve përfshirë Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese; prokurorët e të gjitha niveleve përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm; Inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë; ndihmësmagjistratët në Gjykatën e Lartë dhe këshilltarët ligjorë në Gjykatën Kushtetuese, që ishin në detyrë në datën e hyrjes në fuqi të reformës ose kërkonin emërim/ngritje në sistemin e ri.

detyrim ndjekjeje të programit të edukimit, ose shkarkim. Vendimi mund të ankimohet para KPA-së si nga subjekti ashtu dhe nga Komisioneri Publik.²³⁴

Tre janë rezultatet e përfundimtare të procesit, sipas Ligjit nr. 84/2016. Konfirmimi në detyrë i lejon subjektit vazhdimin normal të funksionit ose, kur ai ishte kandidat, i lejon emërimin/ngritjen në detyrë. Pezullimi me detyrim ndjekjeje të programit të edukimit aplikohet kur subjekti ka mangësi të caktuara në vlerësimin e aftësive profesionale, por nuk ka probleme me pasurinë apo figurën. Ky përbën një rezultat të ndërmjetëm që synon korrigjimin përmes formimit të vazhdueshëm të detyrueshëm. Shkarkimi nga detyra aplikohet kur konstatohen probleme të rënda me pasurinë (deklarim i pasaktë, mosjustifikim i origjinës), me figurën (lidhje me krimin e organizuar, ndikim i papërshtatshëm), ose me aftësitë profesionale (papërshtatshmëri sistematike). Pasoja praktike e shkarkimit shkon përtej ndërprerjes së marrëdhënies aktuale të punës: subjekti i shkarkuar nuk ka të drejtë të emërohet në funksione publike për një periudhë të gjatë.²³⁵

Analiza sistematike e gjashtë shtyllave të reformës amendamentet kushtetuese, riformatimi i Gjykatës Kushtetuese, organet e reja kushtetuese të qeverisjes, statusi i unifikuar i magjistratit, krijimi i institucioneve antikorruption, si dhe procesi i rivlerësimit kalimtar, lejon nxjerrjen e disa përfundimeve sintetike, që përshkruajnë reformën në drejtësi të vitit 2016 si një konstruksion juridik koherent dhe ambicioz.

Së pari, reforma ka logjikë të brendshme sistematike. Amendamentet kushtetuese të Ligjit nr. 76/2016 nuk janë ndërhyrje të copëzuara, por një ridimensionim i tërë Pjesës IX të Kushtetutës, që instalon një arkitekturë të re institucionale: organe kushtetuese të specializuara për qeverisjen e gjyqësorit (KLGJ), të prokurorisë (KLP), për inspektimin e disiplinës (ILD), për emërimin (KED), dhe për luftën ndaj korrupsionit (Gjykata e Posaçme, Prokuroria e Posaçme, BKH). Çdo organ ka funksion të mirëpërcaktuar, dhe arkitektura e tërësishme respekton ndarjen funksionale midis administrimit, hetimit dhe vendimmarrjes.

Së dyti, reforma trajton në mënyrë të integruar dy sfida të mëdha, që e kushtëzonin sistemin para reformës: (i) varësinë e qeverisjes së gjyqësorit dhe prokurorisë nga pushteti politiko-ekzekutiv, dhe (ii) papërshtatshmërinë e disa magjistratëve për shkak të mungesës së integritetit profesional ose moral. Përgjigja për sfidën e parë jepet përmes krijimit të organeve kushtetuese të pavarura me përbërje profesionale (jo politike *ex officio*) dhe me kompetenca të mirëpërcaktuara. Përgjigja për sfidën e dytë jepet përmes vettingut dhe regjimit të ri të statusit, që ngre kushte më të rrepta hyrjeje, vlerësim periodik, dhe regjim disiplinor të pavarur.

Së treti, reforma ngre një model të ri të mbrojtjes së të drejtave themelore. Ankimi kushtetues individual, i parashikuar në nenet 71 dhe vijues të Ligjit nr. 8577/2000 të ndryshuar, është mjet kushtetues i ri, që pajis individin me një rrugë të drejtpërdrejtë për të kërkuar mbrojtje para Gjykatës Kushtetuese. Ai plotëson tërësinë e mjeteve juridike kushtetuese që, së bashku me kontrollin e ushtruar nga Gjykata Kushtetuese mbi vendimet

²³⁴Ligji nr. 84/2016, Kreut II–V. Procesi përmban: deklarimin e pasurisë nga subjekti (formulari standard); deklarimin e konfliktit të interesit; verifikimin nga ILDKPKI dhe organe të tjera; kontrollin e figurës nga organet e specializuara; vlerësimin e aftësive profesionale mbi bazën e dokumenteve ligjore (vendime gjyqësore, kërkesa, opinione) të zgjedhura nga vetë subjekti dhe me përzgjedhje rastësore; relacionin e relatorit; seancën dëgjimore; dhe vendimin e KPK-së.

²³⁵Ligji nr. 84/2016, nenet që rregullojnë vendimmarrjen përfundimtare. Tre janë vendimet e mundshme: (i) konfirmim në detyrë (kur subjekti kalon me sukses të tre kriteret); (ii) pezullim me detyrim ndjekjeje të programit të edukimit (kur subjekti ka mangësi në vlerësimin e aftësive profesionale por nuk ka probleme me pasurinë ose figurën); ose (iii) shkarkim nga detyra (kur konstatohen probleme të rënda me pasurinë, figurën ose në vlerësimin e aftësive profesionale).

e KLGJ-së, KLP-së dhe ILD-së sipas nenit 71, pika 3, formojnë një rrjetë të integruar mbrojtjeje juridike.

Së katërti, reforma ngre në nivel kushtetues një strukturë e specializuar dhe e pajisur me garanci të posaçme institucionale për luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Trekëndëshi institucional Gjykatë e Posaçme — Prokurori e Posaçme — Byro Kombëtare e Hetimit, i kombinuar me regjimin e veçantë të integritetit dhe sigurisë për magjistratët dhe punonjësit (kontrolli periodik i llogarive bankare, telekomunikimeve, vëzhgimi i familjarëve), siguron një strukturë me autonomi institucionale të garantuar dhe me mbrojtje të lartë nga ndikimet e brendshme dhe të jashtme.

Së pesti, vettingu përbën mekanizëm tranzicional të një natyre, që nuk ka precedent të krahueshëm në rajon për nga shtrirja dhe ashpërsia. Ai përfshin të gjithë magjistratët në detyrë pa përjashtim dhe pa hierarki dhe e ushtron mbi tre kriteret objektive (pasuria, figura, aftësitë profesionale) me bashkëpjesëmarrje ndërkombëtare të garantuar kushtetuesisht. Ekzistenca e KPA-së si organ pranë Gjykatës Kushtetuese, me juridiksion të dyfishtë (i përkohshëm për vettingun, i përhershëm për disiplinimin e titullarëve të organeve të drejtësisë), e bën këtë institucion një gur themeli të strukturës së re.

Mbi këto baza, reforma në drejtësi e vitit 2016 në Republikën e Shqipërisë paraqet një ndërhyrje juridike-institucionale të një niveli rëndësie, që e bën atë rast studimi me interes jo vetëm vendor, por edhe rajonal e ndërkombëtar. Vlerësimi i suksesit të zbatimit të saj, që përfshin çështje empirike, të cilat lidhen me efektshmërinë e organeve të reja, ndikimi i vettingut në rikrijimin e besimit publik, dhe funksionaliteti i SPAK-ut është një çështje që kërkon analizë të veçantë empirike, e cila mbetet jashtë qëllimit të kësaj kontribute thjesht doktrinor-juridik.

2.3 Evolucion i historik dhe baza ligjore e hartës gjyqësore në Shqipëri

2.3.1 Organizimi territorial i gjykatave në periudhën 1992–2012

Periudha 1992–1998 përkon me një fazë ndryshimesh të thella social-ekonomike në vend, të cilat u reflektuan edhe në mënyrën e organizimit të sistemit gjyqësor. Në këtë kontekst, me Dekretin nr. 243, datë 07.07.1992, të Presidentit të Republikës²³⁶, struktura e drejtësisë përbëhej nga 36 gjykata rrethesh, një gjykatë apeli dhe Gjykata e Kasacionit. Gjykata e apelit kishte kompetencë të shqyrtonte ankimet dhe protestat kundër vendimeve civile dhe penale të gjykatave të rretheve. Gjykata e Kasacionit ushtronte juridiksion në shkallë të dytë vetëm për ankesat kundër vendimeve penale që kishin caktuar dënim me vdekje, si dhe verifikonte bazueshmërinë ligjore të vendimeve gjyqësore, që i nënshtroheshin kontrollit të saj, qoftë me iniciativën e palëve përmes ankimeve, qoftë me kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë nga Kryetari i Gjykatës së Kasacionit ose nga Prokurori i Përgjithshëm.

Një ndërhyrje e rëndësishme në riorganizimin e gjykatave u realizua me Dekretin nr. 2110, datë 29.05.1998, “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre”, të Presidentit të Republikës. Në zbatim të këtij dekreti u suprimuan gjykatat e rretheve Delvinë, Devoll, Has, Kuçovë, Malësi e Madhe, Mallakastër dhe Peqin. Gjithashtu, riorganizimi preku edhe nivelin e

²³⁶ Dekret nr. 243, datë 07.07.1992, i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, mbi organizimin e strukturës së gjykatave në Republikën e Shqipërisë, kopje e administruar në dokumentacionin arkivor të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor

apelimit. Me Dekretin nr. 1984, datë 07.01.1998, të Presidentit të Republikës, u krijuan shtatë gjykata apeli, përkatësisht në Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë, si edhe Gjykata e Apelit Ushtarak Tiranë. Ky rikonfigurim shënoi një fazë të re në ndërtimin institucional të sistemit gjyqësor, duke përshtatur strukturën e tij me zhvillimet normative dhe administrative të kohës. Numri total i gjykatave të shkallës së parë shkoi në 29. Riorganizimi i gjykatave në Shqipëri nuk përbën një zhvillim të vonshëm, por një proces me fillesë më të hershme dokumentare dhe institucionale²³⁷.

Në këtë kuadër, evidentohet se, me shkresën e Ministrit të Drejtësisë, të përcjellë në tetor 2005, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si organi i atëhershëm i qeverisjes së pushtetit gjyqësor, është depozituar një studim mbi riorganizimin e gjykatave të rretheve gjyqësore.

Ky element dëshmon se debati mbi rishikimin e organizimit të këtyre gjykatave ishte trajtuar në mënyrë të formalizuar që në atë periudhë. Studimi përfshinte një analizë të organizimit të gjykatave të shkallës së parë, të problematikave që lidhen me funksionimin e gjykatave të vogla, si edhe të alternativave të mundshme për riorganizimin e tyre.

Nisma për riorganizimin e gjykatave të shkallës së parë mori formë institucionale në vitin 2002, kur Këshilli i Lartë i Drejtësisë i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë përgatitjen e një studimi të posaçëm mbi këtë çështje. Treguesit kryesorë të studimit ishin:

- 29 gjykata rrethesh gjyqësore sipas dekretit të kohës;
- 295 gjyqtarë sipas organikës
- 283 gjyqtarë efektivë në ushtrim të detyrës

Studimi i realizuar nga Ministria e Drejtësisë për vitet 2001, 2002 dhe 2003 përbën një përpjekje të rëndësishme për të mbështetur mbi të dhëna empirike nevojën për rishikimin e organizimit territorial dhe funksional të gjykatave të shkallës së parë. Rëndësia e këtij materiali nuk qëndron vetëm te evidentimi i vëllimit të çështjeve të gjykuara, por sidomos te fakti se ai kërkon të vërë në raport ngarkesën reale të punës me kapacitetin organizativ të secilës gjykatë. Në këtë kuptim, studimi nuk ka thjesht një funksion përshkruar, por edhe një funksion analitik e argumentues: ai synon të provojë se struktura ekzistuese e sistemit gjyqësor nuk siguron një shpërndarje proporcionale të barrës së punës dhe për rrjedhojë, nuk garantonte një përdorim racional të burimeve gjyqësore.

Në nivel të përgjithshëm, të dhënat tregojnë një rritje të ndjeshme të vëllimit të çështjeve të gjykuara në gjykatat e shkallës së parë përgjatë periudhës tre-vjeçare të marrë në shqyrtim.

Tabela 1: Vëllimi i përgjithshëm i çështjeve të gjykuara në shkallë të parë

Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003
32693	43884	45899

Nga kjo tabelë rezulton se sistemi gjyqësor i shkallës së parë është përballur me një rritje progresive të fluksit të çështjeve. Megjithatë, rëndësia kryesore e studimit nuk qëndron vetëm te rritja sasiore, por te mënyra sesi kjo rritje shpërndahet ndërmjet gjykatave. Pikërisht këtu, studimi fiton relevancë institucionale: ai nxjerr në pah se sistemi

²³⁷ Shih dokumentacionin arkivor të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, aktualisht të administruar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor: shkresë e Ministrit të Drejtësisë, Tetor 2005, drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me të cilën përcillet studimi mbi riorganizimin e gjykatave të rretheve gjyqësore.

nuk kishte vetëm një problem vëllimi, por një problem shpërndarjeje të pabarabartë të ngarkesës.

Studimi i grupon gjykatat sipas tre kategorive: gjykata me volum të madh pune, gjykata me volum mesatar pune dhe gjykata me volum të vogël pune. Kjo ndarje ka rëndësi metodologjike, sepse lejon jo vetëm evidentimin e diferencave ndërmjet njësive gjyqësore, por edhe vlerësimin e raportit ndërmjet ngarkesës së punës dhe strukturës ekzistuese territoriale.

Tabela 2: Gjykata me volum të madh pune

Nr.	Rrethi gjyqësor	Çështje civile 2001 ²³⁸	Çështje penale 2001	Totali i çështjeve për 2001	Çështje për gjyqtar ²³⁹
1	Tiranë	4706	942	5648	120
2	Durrës	1905	282	2187	121
3	Fier	1593	386	1979	124
4	Vlorë	1648	277	1925	137
5	Elbasan	1616	177	1793	149

Tabela 3: Gjykata me volum mesatar pune

Nr.	Rrethi gjyqësor	Çështje civile 2001	Çështje penale 2001	Totali i çështjeve për 2001	Çështje për gjyqtar
1	Sarandë	1391	17	1408	176
2	Shkodër	1016	315	1331	63
3	Lushnjë	871	124	995	165
4	Berat	879	136	1015	102
5	Krujë	1006	82	1088	155

Tabela 4: Gjykata me volum të vogël pune

Nr.	Rrethi gjyqësor	Çështje civile 2001	Çështje penale 2001	Totali i çështjeve për 2001	Çështje për gjyqtar
1	Gramsh	425	80	505	168
2	Bulqizë	272	85	357	89
3	Dibër	381	108	489	97
4	Kukës	276	128	404	68
5	Tropojë	212	54	266	53
6	Pukë	429	79	508	127
7	Librazhd	499	83	582	145
8	Kolonjë	233	30	263	65

²³⁸ Në këtë vit nuk ka statistika me çështjet që janë me palë kundërshtare dhe pa palë.

²³⁹ Në këtë është mbajtur parasysh numri i gjyqtarëve sipas organikës;

Nr.	Rrethi gjyqësor	Çështje civile 2001	Çështje penale 2001	Totali i çështjeve për 2001	Çështje për gjyqtar
9	Tepelenë	341	71	412	103
10	Përmet	472	19	491	122

Të dhënat për vitin 2001 tregojnë qartë se sistemi paraqiste, që në këtë fazë, një pabarazi të ndjeshme të ngarkesës së punës ndërmjet gjykatave. Studimi vëren se mesatarja vjetore në shkallë vendi ishte 116 çështje për gjyqtar, por krahasimi ndërmjet gjykatave tregon se kjo mesatare fsheh diferenca shumë të mëdha të brendshme. Në njërën anë qëndrojnë gjykata me ngarkesë dukshëm nën mesatare, si Saranda me 176 çështje për gjyqtar, Gramshi me 168, Lushnja me 165, Kruja me 155 dhe Elbasani me 149. Në anën tjetër qëndrojnë gjykata me ngarkesë shumë të ulët, si Tropoja me 53 çështje për gjyqtar, Kolonja me 65, Kukësi me 68 dhe Bulqiza me 89. Kjo do të thotë se, edhe nëse merret si pikënisje vetëm viti 2001, sistemi nuk paraqitej si homogjen, por si një strukturë e fragmentuar, në të cilën kapaciteti gjykues ishte i shpërndarë në mënyrë jo proporcionale në raport me kërkesën reale për gjykim. Në këtë kontekst, problemi nuk ishte vetëm ekzistenca e gjykatave të vogla, por mungesa e një korrespondence funksionale ndërmjet territorit, organikës dhe volumit real të çështjeve.

Një element veçanërisht i rëndësishëm është fakti se edhe brenda kategorive të studimit vërehen luhajtje të forta. Për shembull, në kategorinë e gjykatave me volum mesatar pune, Saranda ka 176 çështje për gjyqtar, ndërsa Shkodra vetëm 63. Kjo tregon se kategorizimi sipas volumit total të punës nuk mjafton për të shpjeguar realisht barrën efektive të secilës gjykatë; treguesi “çështje për gjyqtar” del si një indikator më i rafinuar për të kuptuar pabarazinë strukturore të sistemit. Pikërisht për këtë arsye, studimi fiton rëndësi jo vetëm si material statistikor, por si bazë për argumentimin e nevojës për ndërhyrje organizative.

Për vitin 2002, studimi vijon me të njëjtën metodologji klasifikimi. Në këtë vit vërehet jo vetëm rritje e përgjithshme e volumit të çështjeve, por edhe një thellim i dallimeve ndërmjet gjykatave, çka e bën më të dukshme nevojën për një vlerësim strukturor të sistemit.

Tabela 5: Gjykata me volum të madh pune

Nr.	Rrethi gjyqësor	Padi me palë kundërshtare	Kërkesa	Çështje penale 2002	Totali i çështjeve për 2002	Çështje për gjyqtar
1	Tiranë	3932	4235	1008	9175	184
2	Durrës	1343	935	460	2738	161
3	Elbasan	1075	853	245	2173	128
4	Fier	870	763	334	1967	103
5	Vlorë	957	827	340	2124	177

2.2. Gjykata me volum mesatar pune

Nr.	Rrethi gjyqësor	Padi me palë kundërshtare	Kërkesa	Çështje penale 2002	Totali i çështjeve për 2002	Çështje për gjyqtar
1	Sarandë	553	196	45	796	79
2	Shkodër	740	848	323	1911	91
3	Lushnjë	449	1003	107	1559	223
4	Berat	590	634	163	1387	99
5	Krujë	417	466	129	1012	145

Tabela 6: Gjykata me volum të vogël pune

Nr.	Rrethi gjyqësor	Padi me palë kundërshtare	Kërkesa	Çështje penale 2002	Totali i çështjeve për 2002	Çështje për gjyqtar
1	Gramsh	115	70	44	229	57
2	Bulqizë	157	68	40	265	66
3	Dibër	145	131	118	394	56
4	Kavajë	331	240	101	672	96
5	Kukës	260	665	151	1075	153
6	Tropojë	68	117	49	234	47
7	Gjirokastrë	426	457	11	994	90
8	Pukë	146	91	115	352	88
9	Librazhd	215	324	84	623	103
10	Kolonjë	74	306	19	399	100
11	Tepelenë	196	324	46	566	142
12	Përmet	195	270	29	494	124

Në vitin 2002, pabarazia e ngarkesës jo vetëm që mbetet e pranishme, por bëhet edhe më e theksuar. Gjykata e Tiranës arrin në 184 çështje për gjyqtar, Vlora në 177 dhe Lushnja në 223, ndërsa në të njëjtin vit Tropoja mbetet në 47 çështje për gjyqtar, Gramshi në 57 dhe Dibra në 56. Edhe pa hyrë në analizë të detajuar të strukturës së nënkategorive të çështjeve, vetëm treguesi sintetik “çështje për gjyqtar” mjafton për të vërtetuar se sistemi nuk po zhvillohej mbi një logjikë të balancuar. Rritja e numrit total të çështjeve nuk prodhoi një efekt harmonizues; përkundrazi, ajo duket se e përforcoi hendekun ndërmjet gjykatave me ngarkesë intensive dhe atyre me ngarkesë minimale.

Ky konstatim ka rëndësi të drejtpërdrejtë për vlerësimin e nevojës për riorganizim. Nëse një sistem gjyqësor përballet me rritje të volumit të punës, por kjo rritje absorbohet kryesisht nga disa gjykata, ndërkohë që të tjera mbeten të nënshfrytëzuara, atëherë problemi nuk qëndron vetëm te mungesa e burimeve, por te mënyra e shpërndarjes së tyre. Në këtë pikë, debati zhvendoset nga nevoja për shtim të përgjithshëm kapacitetesh drejt nevojës për racionalizim institucional. Kjo do të thotë se riorganizimi territorial fillon të shfaqet si zgjidhje jo sepse sistemi ka shumë ose pak gjykata në terma abstraktë, por sepse konfigurimi ekzistues nuk arrin të prodhojë ekuilibër funksional ndërmjet njësive të tij përbërëse.

Një aspekt domethënës është edhe fakti se brenda kategorisë së gjykatave me volum të vogël pune, disa gjykata si Kukësi paraqiten me 153 çështje për gjyqtar, ndërsa Tropoja

vetëm me 47. Kjo tregon se, as brenda klasifikimeve të përdorura nga studimi, situata nuk është lineare. Për këtë arsye, leximi shkencor i materialit duhet të fokusohet më shumë te treguesit që matin intensitetin real të punës gjyqësore sesa te etiketimet e përgjithshme kategorike. Kjo e bën akoma më bindës përfundimin se sistemi kishte nevojë për riorganizim jo thjesht në bazë madhësie formale të gjykatave, por në bazë të disproporcioneve faktike të funksionimit të tyre.

Viti 2003 është veçanërisht i rëndësishëm, sepse ai e konfirmon dhe e thellon trendin e vërejtur në dy vitet e mëparshme. Në këtë pikë, të dhënat nuk flasin më vetëm për ekzistencën e pabarazisë, por për konsolidimin e saj si tipar strukturor i sistemit.

Tabela 7: Gjykata me volum të madh pune

Nr.	Rrethi gjyqësor	Padi me palë kundërshtare	Kërkesa	Çështje penale 2003	Totali i çështjeve për 2003	Çështje për gjyqtar
1	Tiranë	4178	9650	1284	15112	303
2	Durrës	1386	1034	683	3103	182
3	Elbasan	113	844	317	2274	134
4	Fier	909	990	303	2202	116
5	Vlorë	1140	1188	261	2589	216

3.2. Gjykata me volum mesatar pune

Nr.	Rrethi gjyqësor	Padi me palë kundërshtare	Kërkesa	Çështje penale 2003	Totali i çështjeve për 2003	Çështje për gjyqtar
1	Sarandë	538	613	108	1259	116
2	Berat	546	465	143	1154	82
3	Lushnjë	471	115	167	1753	250
4	Krujë	380	456	131	967	138
5	Gjirokastrë	448	685	162	1295	118

Tabela 8: Gjykata me volum të vogël pune

Nr.	Rrethi gjyqësor	Padi me palë kundërshtare	Kërkesa	Çështje penale 2003	Totali i çështjeve për 2003	Çështje për gjyqtar
1	Gramsh	161	57	75	293	74
2	Bulqizë	113	99	59	271	68
3	Dibër	235	307	80	622	89
4	Kavajë	325	266	143	734	105
5	Tropojë	94	115	72	281	56
5	Pukë	84	135	100	319	80
6	Librazhd	180	305	85	570	95
7	Kolonjë	50	175	21	246	62
8	Tepelenë	158	219	48	425	106
9	Përmet	154	301	45	500	125

Në vitin 2003, dallimet ndërmjet gjykatave arrijnë një nivel edhe më të theksuar. Tirana rezulton me 303 çështje për gjyqtar, Lushnja me 250 dhe Vlora me 216, ndërkohë që Tropoja mbetet në 56, Kolonja në 62 dhe Bulqiza në 68. Kjo tablo është me rëndësi themelore, sepse tregon se rritja e përgjithshme e fluksit nuk ka prodhuar një efekt shpërndarës ose balancues; përkundrazi, sistemi ka vijuar të kanalizojë peshën kryesore të punës te disa gjykata të caktuara. Në terma institucionalë, kjo do të thotë se sistemi nuk kishte vetëm pabarazi ekzistuese, por një pabarazi në proces thellimi. Kjo është pikërisht prova empirike më bindëse në favor të tezës se organizimi ekzistues territorial dhe organik nuk ishte më funksional.

Studimi vëren se mesatarja vjetore në shkallë vendi për këtë vit ishte 156 çështje për gjyqtar. Megjithatë, po të krahasohen të dhënat e tabelës, bëhet e qartë se vetë mesatarja kombëtare nuk mjafton për të kuptuar gjendjen reale të sistemit. Një gjykatë si Tirana është pothuajse dyfish mbi këtë mesatare, ndërsa një numër i konsiderueshëm gjykatash të tjera janë shumë poshtë saj. Kjo e bën të qartë se përdorimi i vetëm i mesatares kombëtare mund të maskojë pabarazitë reale dhe rrjedhimisht, të dobësojë analizën. Për këtë arsye, leximi shkencor i materialit duhet të fokusohet në divergjencën ndërmjet njësive, jo thjesht në mesataren agregate.

Në këtë fazë, studimi fiton një vlerë të qartë strategjike për politikën gjyqësore. Ai nuk provon vetëm se disa gjykata kishin më shumë punë se të tjerat; ai provon se sistemi, në tërësinë e tij, nuk arrinte të shpërndante në mënyrë racionale ngarkesën, çka sillte pasoja të mundshme për kohëzgjatjen e proceseve, për administrimin e stokut të çështjeve dhe për uniformitetin e ofrimit të drejtësisë. Në këtë kuptim, riorganizimi del si një masë e orientuar drejt baraspeshimit të kapaciteteve dhe jo si një ndërhyrje thjesht formale mbi hartën territoriale.

Në përfundim, studimi arrin në konkluzionin se ekzistonte një shpërndarje jo proporcionale e volumit të punës dhe e ngarkesës për gjyqtar ndërmjet gjykatave të shkallës së parë. Sipas tij, disa organika rezultonin të pabalancuara në raport me volumin real të punës dhe ky fenomen vërehej si në gjykatat e vogla, ashtu edhe në gjykatat e mëdha. Gjithashtu, studimi evidenton ekzistencën e një numri të madh delegimesh të gjyqtarëve nga një gjykatë në një tjetër, veçanërisht në gjykatat e vogla, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve. Këto delegime konsiderohen si faktor që ndikonte edhe në organizimin e punës gjyqësore. Për këto arsye, krahas riorganizimit të gjykatave të rretheve, studimi rekomandonte edhe rishikimin e organikave të tyre.

Ky përfundim ka një rëndësi të veçantë teorike dhe praktike. Nga pikëpamja teorike, ai tregon se efikasiteti i sistemit gjyqësor nuk varet vetëm nga numri i gjykatave apo i gjyqtarëve, por nga raporti funksional ndërmjet vendosjes territoriale të tyre dhe ngarkesës faktike të punës. Nga pikëpamja praktike, ai sugjeron se mjetet korrigjuese afatshkurtra, si delegimi i gjyqtarëve, nuk mund të zëvendësojnë një ndërhyrje më të thellë strukturore. Sa më shumë që sistemi mbështetet në zgjidhje të përkohshme për të kompensuar çekuilibrat, aq më e qartë bëhet nevoja për rishikim të vetë modelit organizativ.

Më tej, në pjesën rekomanduese, studimi parashtrohet se riorganizimi duhet të kryhej pjesërisht mbi bazë qarku. Megjithatë, ai sqaronte se, për shkak të largësisë së konsiderueshme gjeografike, disa kombinime gjykatash nuk mund të përfshiheshin në riorganizim, si më poshtë:

1. Gjykata e rretheve gjyqësore Kukës–Tropojë;
2. Gjykata e rretheve gjyqësore Mat–Durrës;
3. Gjykata e rretheve gjyqësore Tiranë–Kavajë;
4. Gjykata e rretheve gjyqësore Sarandë–Vlorë;
5. Gjykata e rretheve gjyqësore Durrës–Krujë;
6. Gjykata e rrethit gjyqësor Lushnjë–Fier, e cila, pavarësisht afërsisë gjeografike, nuk mund të bëhej pjesë e organizimit për shkak se të dyja ishin gjykata me volum të konsiderueshëm pune;
7. Gjykata e Rrethit Pogradec, e cila gjithashtu paraqiste volum pune.

Studimi thekson se ky organizim presupozonte që, aty ku ishte e mundur, rrethi gjyqësor, që përbënte qendrën e qarkut të zgjerohej, duke përfshirë edhe gjykata të tjera të rretheve gjyqësore brenda të njëjtit qark. Gjithashtu, ai lidhej, me dy masterplanet e infrastrukturës gjyqësore dhe të paraburgimeve. Në këtë logjikë, gjykatat, që do të suprimoheshin ose do të përfshiheshin në struktura më të mëdha, paraqiteshin si më poshtë:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, e cila do të përfshinte Gjykatën e Skraparit;
2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila do të përfshinte Gjykatën e Elbasanit, Librazhdit dhe Gramshit;
3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila do të përfshinte Gjykatën e Gjirokastrës, Përmetit dhe Tepelenës;
4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila do të përfshinte Gjykatën e Lezhës, Mirditës dhe Kurbinit;
5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila do të përfshinte Gjykatën e Korçës dhe Kolonjës;
6. Gjykata e Rrethit Dibër, e cila do të përfshinte edhe Gjykatën e Bulqizës.

Sipas këtij propozimi, nga 29 gjykata rrethi sistemi do të reduktohej në 19 gjykata. Ndërkohë, varianti i dytë, që parashikonte riorganizim sipas ndarjes së qarqeve, nuk u pranua nga ekspertët. Kjo tregon se, ndonëse në fazën fillestare të debatit për riorganizimin, janë marrë në konsideratë jo vetëm treguesit e ngarkesës së punës, por edhe faktorë të tillë si afërsia gjeografike, aksesit territorial dhe kapaciteti i njësive pritëse për të absorbuar ngarkesën shtesë. Pra, studimi nuk sugjeron një riorganizim mekanik, por një riorganizim, që synon të ndërthurë racionalitetin statistikor me kushtëzimet reale territoriale dhe administrative.

Duke e analizuar materialin, mund të evidentohen disa kufizime metodologjike që kanë interes akademik:

Së pari, tabelat nuk mbulojnë të gjithë sistemin gjyqësor (të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore) për secilin vit, çka do të thotë se përfundimet që dalin prej tyre janë të forta në plan empirik, por jo domosdoshmërisht shteruese në plan statistikor për të gjitha gjykatat e vendit. Kjo nuk e zbeh vlerën e studimit, por imponon kujdes në mënyrën e formulimit të përfundimeve.

Së dyti, krahasimi më i sigurt ndërmjet viteve duhet të mbështetet te treguesit ne indikatorët “totali i çështjeve” dhe “çështje për gjyqtar”, pasi struktura e nënndarjeve të kolonave nuk paraqitet me të njëjtën qartësi për të tre vitet. Për këtë arsye, analiza më e

qëndrueshme metodologjikisht është ajo që fokusohet te intensiteti i ngarkesës gjyqësore dhe jo te nënkategoritë, që mund të jenë paraqitur në mënyrë jo plotësisht uniforme.

Së treti, edhe duke marrë në konsideratë mospërputhje të mundshme transkriptuese në disa të dhëna, tendenca kryesore empirike nuk ndryshon: sistemi përjeton rritje të volumit të çështjeve dhe paralelisht, rritje të divergjencës ndërmjet gjykatave. Kjo është arsyeja pse studimi mbetet i vlefshëm si dokument analitik për të kuptuar bazat e debatit mbi riorganizimin gjyqësor.

Megjithatë, nga analiza krahasimore e periudhës 2001–2003 rezulton se problemi thelbësor i sistemit gjyqësor të shkallës së parë në Shqipëri nuk ishte vetëm rritja e volumit të çështjeve, por paaftësia e strukturës ekzistuese për ta përthithur këtë rritje në mënyrë proporcionale dhe funksionale. Të dhënat tregojnë se një numër i kufizuar gjykatash përqendronin një pjesë gjithnjë e më të madhe të barrës së punës, ndërkohë që disa gjykata të tjera vijonin të funksiononin me nivele dukshëm më të ulëta ngarkese. Kjo do të thotë se organizimi ekzistues territorial dhe organik nuk arrinte të prodhonte një shpërndarje të balancuar të kapaciteteve gjyqësore.

Në këtë kuptim, materiali nuk mbështet thjesht një argument abstrakt për riorganizim, por ofron një bazë empirike për përfundimin se riorganizimi paraqitet si një instrument i racionalizimit institucional. Ai synonte të korrigjonte pabarazitë e brendshme të sistemit, të ulte varësinë nga mekanizma të përkohshëm si delegimet dhe të krijonte kushte për një përdorim më efikas dhe më të drejtë të burimeve gjyqësore. Për pasojë, riorganizimi nuk duhet parë si një masë thjesht administrative, por si një ndërhyrje strukturore e lidhur ngushtë me funksionalitetin, efikasitetin dhe koherencën e përgjithshme të sistemit të drejtësisë.

Lidhur me këtë variant, ajo që vlen për tu vlerësuar, është se nga Ministria e Drejtësisë u zhvillua një analizë me e thelluar e të dhënave për ato gjykata, që preken nga suprimimi si Bulqiza, Gramshi, Kolonja, Librazhdi, Mirdita, Përmeti, Skrapari dhe Tepelena për vitet 2003, 2004, 2005. Analiza e të dhënave të viteve 2003, 2004 dhe 2005 tregoi se shumica dërrmuese e çështjeve, si penale ashtu edhe civile, gjykoheshin nga një gjyqtar i vetëm. Kjo përbën një gjetje të rëndësishme, pasi demonstroi se funksionimi i këtyre gjykatave si degë të një gjykate përfshirëse nuk do të cenonte në thelb administrimin e drejtësisë për pjesën më të madhe të çështjeve.

Në planin konkret, u propozua që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat të përfshinte edhe Skraparin; Dibra të përfshinte Bulqizën; Elbasani të përfshinte Librazhdin dhe Gramshin; Korça të përfshinte Kolonjën; Lezha të përfshinte Mirditën dhe Kurbinin; Gjirokastra të përfshinte Përmetin dhe Tepelenën; ndërsa Shkodra të përfshinte Pukën. Por, u vlerësua se Puka dhe Kurbini të trajtohen veçmas për shkak të faktorëve objektivë, si largësia gjeografike, infrastruktura rrugore dhe volumni relativisht më i lartë i punës (rasti i Kurbinit).

Tabela 9. Skema e propozuar e përfshirjes territoriale të gjykatave

Gjykata përfshirëse	Gjykatat që përfshiheshin sipas studimit
Berat	Berat, Skrapar
Dibër	Dibër, Bulqizë

Elbasan	Elbasan, Librazhd, Gramsh
Korçë	Korçë, Kolonjë
Lezhë	Lezhë, Mirditë, Kurbin
Gjirokastrë	Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë
Shkodër	Shkodër, Pukë

Tabela 10. Të dhënat statistikore për vitin 2003

Gjykata	çështje penale me një gjyqtar	çështje penale me trup gjykues	çështje civile me një gjyqtar	çështje civile me trup gjykues
Bulqizë	57	2	280	0
Gramsh	72	3	218	0
Kolonjë	18	3	224	1
Librazhd	79	6	485	0
Mirditë	97	15	365	0
Përmet	43	2	465	0
Skrapar	23	4	319	0
Tepelenë	39	9	375	2
Totali	428	44	2731	3

Tabela 11. Të dhënat statistikore për vitin 2004

Gjykata	çështje penale me një gjyqtar	çështje penale me trup gjykues	çështje civile me një gjyqtar	çështje civile me trup gjykues
Bulqizë	73	4	201	0
Gramsh	65	4	155	1
Kolonjë	37	2	159	0
Librazhd	95	7	404	1
Mirditë	86	12	726	1
Përmet	44	2	595	0
Skrapar	36	4	373	0

Tepelenë	48	1	593	1
Totali	484	36	3206	4

Tabela 12. Të dhënat statistikore për vitin 2005

Gjykata	çështje penale me një gjyqtar	çështje penale me trup gjykues	çështje civile me një gjyqtar	çështje civile me trup gjykues
Bulqizë	44	4	160	0
Gramsh	52	1	246	0
Kolonjë	40	1	207	0
Librazhd	103	10	456	2
Mirditë	56	10	415	0
Përmet	57	0	496	2
Skrapar	33	7	384	0
Tepelenë	37	2	567	0
Totali	422	35	2931	4

Kur këto të dhëna lexohen në mënyrë të krahasuar, vihet re se nevoja për trup gjykues në këto gjykata mbetet përjashtimore dhe jo rregull. Në vitin 2003, çështjet penale të gjykuara me trup gjykues përbënin 9.3% të totalit, ndërsa çështjet civile vetëm 0.1%. Në vitin 2004, këto përqindje ishin përkatësisht 6% dhe 0.12%, ndërsa në vitin 2005 7.65% dhe 0.14%.

Tabela 13. Përqindja e çështjeve të gjykuara me trup gjykues

Viti	% e çështjeve penale me trup gjykues	% e çështjeve civile me trup gjykues
2003	9.3%	0.1%
2004	6%	0.12%
2005	7.65%	0.14%

Të dhënat e mësipërme evidentojnë se në të tri vitet e marra në shqyrtim, çështjet, të cilat kërkojnë trup gjykues, përbëjnë një pjesë shumë të vogël të totalit të çështjeve. Kjo e bën të arsyeshëm përfundimin se mbi 95% e çështjeve në këto gjykata mund të trajtohen në një strukturë të riorganizuar, me një gjyqtar të vetëm në degë dhe me ndërhyrje të gjykatës përfshirëse vetëm në rastet kur kërkohet trup gjykues. Kështu, analiza empirike nuk e mbështet ruajtjen e një rrjeti të gjerë gjykatash të vogla si domosdoshmëri funksionale, por përkundrazi tregon kufijtë e eficiencës së tyre.

Ky riorganizim i propozuar do të sillte pasoja pozitive për funksionimin e sistemit gjyqësor. Së pari, ai redukton nevojën për delegime të shpeshta të gjyqtarëve dhe krijon mundësi për menaxhim më efikas të ngarkesës së punës. Së dyti, gjykatat më të konsoliduara institucionalisht krijojnë kushte më të favorshme për specializim, për shpërndarje më të balancuar të çështjeve dhe për organizim më të qëndrueshëm të administratës gjyqësore. Së treti, nga pikëpamja ekonomike, materiali argumenton se gjykatat me numër më të madh gjyqtarësh paraqesin kosto më të ulët për çështje sesa gjykatat e vogla, të cilat prodhojnë shpenzime disproporcionale në raport me volumin e punës. Së katërti një pjesë e konsiderueshme e gjykatave të vogla nuk kishin volum dhe strukturë çështjesh, që të justifikonin ruajtjen e një juridiksioni të plotë dhe të pavarur. Së pesti, organizimi i fragmentarizuar prodhonte vështirësi për krijimin e trupave gjykues dhe rriste kostot administrative. Së fundmi, modeli i degëve të gjykatës paraqitej si një zgjidhje më e balancuar ndërmjet efikasitetit institucional dhe ruajtjes së aksesit territorial.

Zbatimi i këtij modeli kërkonte edhe ndërhyrje në kuadrin normativ ekzistues. Në mënyrë të veçantë, materiali parashikon ndryshimin e Dekretit nr. 2110, datë 29.05.1998, me qëllim përcaktimin e gjykatës së rrethit gjyqësor, që zgjerohet dhe të degës së saj. Po kështu, propozohet ndryshimi i Dekretit nr. 1984, datë 07.01.1998, për shkak të efekteve të riorganizimit në juridiksionin territorial të Gjykatës së Apelit. Gjithashtu, kërkohet rishikimi i Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore”, miratuar me Urdhrin nr. 1830, datë 03.04.2001, në mënyrë që të përfshihet koncepti i “degës së gjykatës”, organizimi i punës në degë dhe afishimi i akteve procedurale edhe në ambientet e saj.

Kjo dëshmon se riorganizimi nuk paraqitej si një ndërhyrje vetëm administrative, por si një reformë, që kërkon harmonizim të plotë institucional dhe normativ.

Në vijim të propozimit të përcjellë nga Ministri i Drejtësisë në mars të vitit 2007, Presidenti i Republikës nxori Dekretin nr. 5350, datë 11.06.2007, “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre”. Ky dekret përbën një nga aktet më të rëndësishme të riorganizimit territorial të juridiksionit gjyqësor në Shqipëri pas viteve ’90, pasi përcaktoi konfigurimin e ri të 21 gjykatave të rretheve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë. Konkretisht, ai parashikoi Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, Sarandë, Korçë, Kukës, Berat, Shkodër, Pukë, Fier, Elbasan, Durrës, Kavajë, Gjirokastrë, Krujë, Lezhë, Kurbin, Lushnjë, Mat, Pogradec, Tiranë, Tropojë dhe Vlorë. Për secilën prej tyre, dekreti përcaktoi qendrën e ushtrimit të veprimtarisë dhe shtrirjen e kompetencës tokësore, duke materializuar kështu rindërtimin e organizimit territorial të juridiksionit gjyqësor të shkallës së parë.

Nga pikëpamja institucionale, ky dekret nuk kishte thjesht funksion organizativ, por synonte një rikonceptim të shpërndarjes territoriale të drejtësisë në funksion të një administrimi më racional të burimeve gjyqësore. Në thelb, ai shënoi kalimin nga një model i shpërndarjes së gjykatave të ndërtuar kryesisht mbi kritere historike dhe administrative, drejt një logjike më funksionale, të lidhur me përmasat territoriale të juridiksionit, me ngarkesën e pritshme të punës dhe me raportin ndërmjet qendrës së ushtrimit të veprimtarisë dhe njësive administrative që përfshiheshin në kompetencën e secilës gjykatë. Për këtë arsye, reforma e vitit 2007 mund të konsiderohet si një prej ndërhyrjeve më të thella në hartën gjyqësore shqiptare pas tranzicionit demokratik.

Megjithatë, zbatimi i këtij dekreti nxori në pah edhe tensione të rëndësishme kushtetuese dhe institucionale, veçanërisht në raport me statusin e gjyqtarit dhe me kufijtë

brenda të cilëve mund të realizohet riorganizimi i sistemit gjyqësor. Kjo u vu re në mënyrë të veçantë në rastet kur, si pasojë e rikonfigurimit territorial, disa gjykata u suprimuan dhe gjyqtarët e tyre mbetën pa një zgjidhje të qartë dhe të menjëhershme brenda sistemit gjyqësor. Një nga rastet më domethënëse lidhet me gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar, e cila u prek drejtpërdrejt nga riorganizimi.

Për të administruar pasojat e reformës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 215/2, datë 30.08.2007, parashikoi “sistemimin” e gjyqtarëve të gjykatave të suprimuara në vende vakante në gjykata të tjera, në strukturat juridike të Ministrisë së Drejtësisë ose në Inspektoriatin e KLD-së, duke ruajtur përkohësisht statusin dhe pagën e tyre vetëm për një periudhë njëvjeçare, deri më 01.09.2008. Kjo zgjidhje u kundërshtua nga dy gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar, të cilët pretenduan se një mekanizëm i tillë cenonte statusin kushtetues të gjyqtarit dhe përbënte, në thelb, një formë të shkarkimit të maskuar. Çështja iu nënshtrua shqyrtimit nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat, me vendimin nr. 14, datë 14.11.2007, vendosën anulimin e vendimit nr. 215/2 të KLD-së, duke arritur në përfundimin se ai ishte i papajtueshëm me Kushtetutën.

Rëndësia e këtij vendimi qëndron në faktin se ai artikuloi qartë standardin kushtetues që duhet të respektohet në rastet e riorganizimit të sistemit gjyqësor. Kolegjet e Bashkuara theksuan se neni 147 i Kushtetutës garanton parimin e palëvizshmërisë së gjyqtarit dhe se transferimi pa pëlqimin e tij lejohet vetëm kur kjo diktohet nga nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor. Megjithatë, edhe në këto raste, transferimi duhet të realizohet brenda vetë pushtetit gjyqësor dhe në mënyrë të tillë që të mos cenojë statusin kushtetues të gjyqtarit. Sipas Gjykatës, KLD-ja nuk kishte realizuar një transferim në kuptimin kushtetues të termit, por kishte krijuar një mekanizëm të ndërmjetëm, i cili e kushtëzonte vijimin e statusit të gjyqtarit me konkurrim për vende vakante, me afat kohor dhe me mundësinë e kalimit në struktura jashtë gjykatave. Një zgjidhje e tillë binte ndesh jo vetëm me nenin 147 të Kushtetutës, por edhe me nenin 138 të saj, i cili ndalon kufizimin e kohës së qëndrimit në detyrë dhe uljen e pagës së gjyqtarit.

Nga ky këndvështrim, jurisprudenca e Kolegjeve të Bashkuara ka një vlerë që tejkalon rastin konkret. Ajo vendos një standard të rëndësishëm, sipas të cilit riorganizimi territorial i gjykatave, sado i nevojshëm dhe legjitim të jetë nga pikëpamja e eficiencës institucionale, nuk mund të realizohet përmes instrumenteve që prodhojnë efekte të barasvlershme me shkarkimin e gjyqtarit jashtë rasteve taksative të parashikuara në Kushtetutë. Në këtë kuptim, palëvizshmëria e gjyqtarit nuk duhet kuptuar si privilegj individual, por si garanci funksionale e pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe për rrjedhojë, si element i së drejtës së individit për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

Ajo që e bën edhe më të rëndësishme analizën e kësaj reforme është fakti se ndërhyrjet e mëvonshme në hartën gjyqësore dëshmuuan se rikonfigurimi i vitit 2007 nuk kishte karakter të mbyllur apo përfundimtar, por kërkonte rivlerësim të vazhdueshëm mbi bazën e të dhënave empirike të funksionimit të gjykatave. Kjo vihet qartë në pah në rastin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Në vitin 2009, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, u sugjerua rihapja e kësaj gjykate, në kushtet kur fluksi i çështjeve të ardhura për gjykim dhe i atyre të përfunduara gjatë viteve 2007–2008 tregonte se nevoja për një strukturë gjyqësore më vete në atë territor vazhdonte të ekzistonte.

Të dhënat statistikore për Gjykatën e Përmetit janë veçanërisht domethënëse. Në vitin 2007 rezultojnë 591 çështje civile të ardhura dhe 464 të gjykuara, 96 kërkesa civile të

ardhura dhe 96 të gjykuara, 68 çështje penale të ardhura dhe 40 të gjykuara, si dhe 46 kërkesa penale të ardhura dhe 45 të gjykuara. Në total, për këtë vit, rezultojnë 801 çështje të ardhura dhe 645 çështje të gjykuara. Ndërkohë, në vitin 2008, çështjet civile të ardhura u rritën në 665 dhe ato të gjykuara në 591; kërkesat civile të ardhura dhe të gjykuara arritën në 164; çështjet penale të ardhura ishin 62 dhe të gjykuara 48; ndërsa kërkesat penale zbritën në 14, të gjitha të përfunduara. Në total, për vitin 2008 rezultojnë 905 çështje të ardhura dhe 817 çështje të gjykuara.

Këto të dhëna tregojnë një rritje të përgjithshme të volumit të punës gjyqësore. Numri total i çështjeve të ardhura u rrit nga 801 në 905, ndërsa numri i çështjeve të gjykuara u rrit nga 645 në 817. Në mënyrë të veçantë, vihet re rritje në fushën civile, si për sa u përket çështjeve civile, ashtu edhe kërkesave civile, çka tregon jo vetëm ekzistencën e një ngarkese të qëndrueshme gjyqësore, por edhe nevojën për ta administruar atë përmes një strukture institucionale të afërt dhe funksionale. Për rrjedhojë, rihapja e Gjykatës së Përmetit nuk paraqitet si një lëvizje e rastësishme apo thjesht politike, por si një korrigjim funksional i reformës së vitit 2007, i mbështetur në indikatorë konkretë të ngarkesës gjyqësore.

Po aq i rëndësishëm është edhe fakti se, krahas rihapjes së kësaj gjykate, u propozua që bashkia Leskovik të përfshihej në juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe jo më në atë të Korçës, për shkak të afërsisë gjeografike. Ky element tregon se në fazën e dytë të rishikimit të hartës gjyqësore u morën më seriozisht në konsideratë jo vetëm kriteret e eficiencës institucionale, por edhe kriteret e aksesit të qytetarëve në drejtësi. Në vijim të këtij procesi, Presidenti i Republikës miratoi Dekretin nr. 6201, datë 08.06.2009, “Për caktimin e kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë të secilës prej tyre”. Sipas këtij dekreti, numri i gjykatave të rretheve gjyqësore u rrit nga 21 në 22, duke reflektuar rihapjen e Gjykatës së Përmetit dhe ridimensionimin e juridiksionit të saj territorial. Në plan analitik, kjo ndërhyrje mund të interpretohet si dëshmi se hartat gjyqësore nuk janë struktura statike, por instrumente institucionale që duhet t’i nënshtrohen monitorimit, rivlerësimit dhe korrigjimit të vazhdueshëm, nëse synohet ruajtja e ekuilibrit ndërmjet eficiencës së sistemit dhe garantimit real të aksesit në drejtësi.

Një ndërhyrje tjetër me rëndësi të veçantë në riorganizimin e sistemit gjyqësor i përket vitit 2012, kur u krijuan gjykatat administrative në zbatim të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Ky ligj shënoi një ndryshim thelbësor në arkitekturën e pushtetit gjyqësor, pasi institucionalizoi juridiksionin administrativ si një degë të specializuar të sistemit gjyqësor shqiptar. Sipas nenit 4 të tij, organet kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative janë gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Në të njëjtën kohë, ligji parashikoi se gjykatat administrative të shkallës së parë do të organizoheshin në numër dhe për territor të barabartë me atë të gjykatave të apelit civil ekzistuese në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit, ndërsa kompetencat tokësore, selia qendrore dhe numri i gjyqtarëve të këtyre gjykatave, si edhe të Gjykatës Administrative të Apelit, do të caktoheshin me dekret të Presidentit të Republikës, mbi propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Në zbatim të këtij ligji u miratua Dekreti nr. 7818, datë 16.11.2012, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave

administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”. Ky dekret përcaktoi numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe për gjykatat administrative në Republikën e Shqipërisë. Njëkohësisht, ai materializoi organizimin territorial të juridiksionit administrativ, duke përcaktuar kompetencën tokësore dhe selinë qendrore të gjashtë gjykatave administrative të shkallës së parë, si edhe të Gjykatës Administrative të Apelit me seli në Tiranë. Në këtë mënyrë, dekreti nuk u kufizua vetëm në një rishpërndarje numerike të trupës gjyqësore, por konkretizoi ngritjen e një sistemi të ri të drejtësisë administrative, të konceptuar si juridiksion i specializuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet individit dhe administratës publike.

Në plan institucional, krijimi i gjykatave administrative përfaqëson një moment të rëndësishëm në evolucionin e hartës gjyqësore shqiptare, pasi për herë të parë juridiksioni administrativ u konsolidua si pjesë më vete e sistemit gjyqësor, me strukturë, kompetencë dhe organizim territorial të posaçëm. Ndryshe nga ndërhyrjet e viteve 2007 dhe 2009, të cilat kishin të bënin kryesisht me ridimensionimin territorial të gjykatave ekzistuese, reforma e vitit 2012 solli një transformim cilësor, duke krijuar një nivel të ri specializimi gjyqësor. Për këtë arsye, ajo duhet parë jo vetëm si një ndryshim organizativ, por si një zhvillim i rëndësishëm në drejtim të modernizimit të administrimit të drejtësisë, të rritjes së ekspertizës gjyqësore (specializimit) dhe të forcimit të mbrojtjes gjyqësore në fushën e së drejtës administrative.

Në përfundim, ndërhyrjet e viteve 2007, 2009 dhe 2012 tregojnë se riorganizimi i hartës gjyqësore në Shqipëri nuk ka qenë një proces linear, por një zhvillim dinamik, në të cilin janë ndërthurur nevojat e efikasitetit institucional, mbrojtja kushtetuese e statusit të gjyqtarit, aksesit territorial në drejtësi dhe specializimit të juridiksioneve. Rasti i gjyqtarëve të Skraparit dëshmoi kufijtë kushtetues të një reforme, që prek drejtpërdrejt statusin e magjistratit; rasti i Përmetit tregoi se çdo riorganizim territorial duhet të mbështetet në të dhëna konkrete dhe të jetë i aftë të korrigjohet kur realiteti empirik e kërkon; ndërsa krijimi i gjykatave administrative në vitin 2012 shënoi kalimin nga një logjikë e thjeshtë rishpërndarjeje territoriale drejt një modeli më të avancuar të specializimit funksional të drejtësisë. Pikërisht në këtë ndërthurje midis kushtetutshmërisë, funksionalitetit, aksesit dhe specializimit qëndron rëndësia kryesore e këtyre zhvillimeve për analizën e administrimit gjyqësor në Shqipëri.

2.3.2 Baza ligjore e hartës së re gjyqësore pas reformës së vitit 2016

Këto zhvillime historike tregojnë se riorganizimi territorial i gjykatave nuk është një problematikë e lindur me reformën e vitit 2016, por një çështje e përsëritur e administrimit gjyqësor shqiptar. Megjithatë, pas reformës kushtetuese të vitit 2016, kjo çështje mori një natyrë të re juridike, pasi kompetenca për propozimin e hartës gjyqësore u zhvendos drejt organit kushtetues të vetëqeverisjes gjyqësore.

Harta gjyqësore, e kuptuar si tërësia e rregullimit territorial, funksional dhe tipologjik të organeve të pushtetit gjyqësor në një shtet, përbën një ndër konceptet themelore të organizimit institucional të drejtësisë. Ajo nuk shtron tek një listë gjykatash apo tek ndarja administrative e vendit; përkundrazi, ajo përfaqëson një arkitekturë juridike komplekse, nëpërmjet së cilës konkretizohet e drejta kushtetuese e çdo individit për akses në drejtësi — e drejtë e shprehur qartë në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së

Shqipërisë dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut — dhe që i jep formë praktike parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

Në funksion të këtij parimi, harta gjyqësore duhet të rregullojë në mënyrë të ekuilibruar tre elemente që vijnë shpesh në kontradiktë mes tyre: së pari, afërsinë gjeografike të gjykatës me qytetarin si garanci e aksesit; së dyti, eficiencën e shpërndarjes së burimeve njerëzore dhe financiare; dhe së treti, specializimin e gjyqtarëve si kusht për cilësi gjyqësore. Mbi këtë trinom, çdo reformë e hartës është detyruesisht një akt i ekuilibrit të vlerave kushtetuese, jo një ushtrim teknik administrativ.

Reforma kushtetuese e vitit 2016, e pasuar dhe e konkretizuar në nivel ligjor përmes ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, solli një transformim cilësor në regjimin juridik të hartës gjyqësore. Në këtë kuadër, organizimi territorial dhe funksional i gjykatave nuk mund të kuptohet më si një çështje e thjeshtë administrative, e varur nga diskrecioni politik i ekzekutivit, por si një proces i lidhur ngushtë me vetëqeverisjen gjyqësore, me vlerësimin objektiv të nevojave të sistemit dhe me garantimin e një shërbimi gjyqësor efektiv. Ky ndryshim përfaqëson një zhvendosje substanciale në natyrën juridike të hartës gjyqësore. Harta gjyqësore nuk konceptohet më si produkt i vullnetit politik të momentit, por si një akt me natyrë institucionale dhe funksionale, i mbështetur në analizë metodologjike, në vlerësim kolegjal dhe në konsultim shumë-aktorial. Legjitimiteti i saj nuk buron vetëm nga miratimi formal i aktit, por edhe nga cilësia e procesit që i paraprin: analiza e ngarkesës së gjykatave, numri efektiv i gjyqtarëve, shpërndarja territoriale e çështjeve, aksesit i qytetarëve në drejtësi, si dhe nevoja për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së dhënies së drejtësisë.

Në këtë kontekst duhet kuptuar edhe parashikimi ligjor për krijimin e gjykatave me përmasa më të mëdha. Ky parashikim nuk synon thjesht riorganizimin territorial të gjykatave, por krijimin e kushteve institucionale për një administrim më efektiv të tyre. Ligji nr. 98/2016 e lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë madhësinë minimale të gjykatave me dy objektiva thelbësorë: rritjen e eficiencës dhe sigurimin e specializimit gjyqësor. Për këtë arsye, neni 15, pika 4, i ligjit përcakton se, “me qëllim rritjen e eficiencës dhe për të siguruar specializimin në gjykata”, numri minimal i gjyqtarëve duhet të jetë së paku shtatë gjyqtarë për gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ, së paku dhjetë gjyqtarë për gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ, së paku gjashtëmbëdhjetë gjyqtarë për gjykatat e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe së paku njëmbëdhjetë gjyqtarë për gjykatat e posaçme të apelit.

Ky formulim ligjor tregon qartë se madhësia minimale e gjykatës nuk është konceptuar nga ligjvënësi si një kriter thjesht numerik. Përkundrazi, ajo përbën një kusht organizativ për funksionimin cilësor të gjykatës. Një trupë gjyqësore më e madhe krijon mundësinë reale për ndarjen e brendshme të gjykatës në seksione, për shpërndarjen më të specializuar të çështjeve dhe për krijimin e trupave gjykues me përvojë profesionale të përshtatshme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në gjykatat me ngarkesë të lartë, ku trajtimi i çështjeve kërkon jo vetëm burime të mjaftueshme njerëzore, por edhe organizim të diferencuar sipas natyrës dhe kompleksitetit të mosmarrëveshjeve. Në të kundërt, gjykatat me numër shumë të kufizuar gjyqtarësh janë të detyruara të funksionojnë mbi bazën e një modeli të përgjithshëm, ku i njëjti gjyqtar shqyrton kategori të ndryshme çështjesh, pavarësisht kompleksitetit, natyrës juridike apo nevojës për njohuri të specializuara. Një model i tillë mund të sigurojë formalisht aksesin në gjykatë, por nuk

garanton domosdoshmërisht efikasitet në menaxhimin e çështjeve, cilësi të qëndrueshme të arsyetimit gjyqësor dhe uniformitet të praktikës. Për rrjedhojë, parashikimi i gjykatave me përmasa më të mëdha duhet vlerësuar si një instrument i administrimit të mirë gjyqësor. Ai krijon bazën për seksionim të brendshëm, specializim të gjyqtarëve, shpërndarje më të balancuar të ngarkesës dhe trajtim më të shpejtë e më cilësor të çështjeve. Në këtë mënyrë, lidhja ndërmjet madhësisë së gjykatës, specializimit dhe efikasitetit nuk është rastësore, por përbën një nga elementet kryesore të modelit të ri të organizimit gjyqësor të ndërtuar pas reformës në drejtësi.

Procesi pesëvjeçar 2018–2022 prodhoi miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”²⁴⁰, që përbën aktin themelor të reformës territoriale. Megjithatë, miratimi normativ ishte vetëm hapi paraprak: viti 2023 u paraqit si viti vendimtar i zbatimit fazor të reformës, ndërsa viti 2024 u shfaq si viti i parë i konsolidimit institucional të strukturës së re. Pikërisht ky cikël dy-vjeçar — që përkon me hyrjen në funksionim të strukturës së re gjyqësore në tre faza të njëpasnjëshme (1 shkurt, 1 maj, 1 korrik 2023), me ripërtëritjen e anëtarësisë së KLGJ-së dhe me ndryshimin e strukturës drejtuese të Këshillit në tetor 2024, si dhe me miratimin e Strategjisë Kombëtare të Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata 2024–2027 dhe me Vendimin e KLGJ-së nr. 585, datë 09.10.2024 për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve nga 408 në 417 — krijoi për herë të parë mundësinë e vlerësimit empirik të efekteve të reformës, jo më në kuadrin e parashikimeve teorike, por në kuadrin e operacionalizimit dhe konsolidimit institucional.

Për këto arsye, në këtë seksion do të zhvillohet një analizë juridiko-empirike, e integruar e procesit shtatë-vjeçar 2018–2024, duke ndjekur katër boshte analitike. Boshti i parë rikonstrukton arkitekturën institucionale dhe metodologjike, përmes së cilës u ndërtua dhe u miratua harta e re. Boshti i dytë analizon, mbi bazën e indikatorëve sasiorë të nxjerrë nga raportet vjetore të KLGJ-së për vitet 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024, dinamikën e treguesve të performancës gjyqësore (Disposition Time, Clearance Rate, Workload, raporti gjyqtar/staf, organika faktike). Boshti i tretë vlerëson në mënyrë sistematike impaktin fillestar të zbatimit të hartës së re gjatë periudhës shkurt–dhjetor 2023, duke e parë reformën jo si akt të kryer, por si proces, që ende po prodhon efektet e veta. Boshti i katërt vlerëson konsolidimin e parë institucional të reformës gjatë vitit 2024, duke analizuar evolucionin e treguesve, masat plotësuese të miratuara, si dhe drejtimet e ardhme të procesit.

Metodologjikisht, analiza mbështetet pothuajse tërësisht në burimet primare normative dhe institucionale: (i) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar me Ligjin nr. 76/2016; (ii) paketa e reformës legislative të vitit 2016, e përbërë nga Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; (iii) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 495/2022; (iv) vendimet vendimtare të KLGJ-së për ndërtimin, operacionalizimin dhe konsolidimin e hartës (përfshirë Vendimin nr. 211, datë 10.06.2022; Vendimet nr. 137, 147, 148 datë 28-29.03.2023; Vendimet nr. 251, 252, 253, 254 datë 09.05.2024 dhe Vendimin nr. 585 datë

²⁴⁰Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 107, datë 21 korrik 2022.

09.10.2024); (v) raportet vjetore të KLGJ-së për vitet 2018–2024 si burim parësor empirik; dhe (vi) raporti i Komitetit Shqiptar të Helsinkit “Për monitorimin e KLGJ-së dhe ILD-së për periudhën Janar–Dhjetor 2023”, finalizuar në mars 2025, si burim sekondar verifikues²⁴¹.

Krahas këtyre burimeve, kapitulli merr në konsideratë edhe raportin më të fundit studimor të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, “Raport studimor për monitorimin e ndikimit të hartës së re gjyqësore në pesë gjykata gjatë periudhës 2020–2024”. Ky raport ka rëndësi të veçantë metodologjike, sepse ofron një vlerësim të pavarur të ndikimit të hartës së re gjyqësore në pesë gjykata të përzgjedhura: Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë. Raporti kombinon analizën sasiore të treguesve të performancës gjyqësore me analizën cilësore të kuadrit ligjor, duke vendosur theks të posaçëm te ndikimi i reformës mbi aksesin në drejtësi, veçanërisht për qytetarët në zonat rurale dhe periferike. Sipas raportit, harta e re gjyqësore ka prodhuar rezultate të përziera: disa efekte pjesërisht pozitive janë evidentuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ndërsa në katër gjykatat e tjera të monitoruara rezultatet janë mikse ose kritike, veçanërisht në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Raporti thekson se rritja e kohës së gjykimit, shtimi i stokut gjyqësor dhe ulja e normës së likuidimit krijojnë rrezik për aksesin efektiv në drejtësi dhe për standardin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Për këtë arsye, KShH arrin në përfundimin se qasja aktuale e hartës së re gjyqësore kërkon rivlerësim domethënës, në mënyrë që rishikimi i ardhshëm i hartës të balancojë efikasitetin e gjykatave me garancitë reale të aksesit në drejtësi për qytetarët²⁴².

Reforma kushtetuese e vitit 2016 përbën pikënisjen e domosdoshme për kuptimin e regjimit aktual juridik të hartës gjyqësore. Para kësaj reforme, përcaktimi i numrit, llojit, kompetencave tokësore dhe selisë së gjykatave bëhej me dekret të Presidentit të Republikës, të nxjerrë me propozim të Ministrit të Drejtësisë, siç ishte rasti i Dekretit nr. 7818, datë 16.11.2012, “Për ndarjen e re tokësore të juridiksioneve të gjykatave”. Ky model e vendoste hartën gjyqësore kryesisht brenda sferës së ndikimit ekzekutiv, duke krijuar një raport problematik me parimin e ndarjes së pushteteve dhe me autonominë funksionale të gjyqësorit.

Pas reformës së vitit 2016, regjimi juridik i hartës gjyqësore u rikonceptua në mënyrë thelbësore. Kompetenca për propozimin e saj iu atribuua Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organ kushtetues i vetëqeverisjes gjyqësore, ndërsa Këshilli i Ministrave ruajti kompetencën formale të miratimit. Megjithatë, kjo kompetencë miratuese nuk ushtrohet më në mënyrë të pavarur nga ekzekutivi, por mbi bazën e propozimit profesional dhe institucional të KLGJ-së. Për më tepër, nisma për ndryshimin e hartës gjyqësore mund të vijë vetëm nga KLGJ-ja, çka përjashton ndërhyrjen e njëanshme të ekzekutivit në

²⁴¹Komiteti Shqiptar i Helsinkit, “Raport mbi monitorimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë për periudhën Janar–Dhjetor 2023”, finalizuar në mars 2025 (në vijim: Raporti i KShH-së për vitin 2023). Po ashtu shih: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024, miratuar me Vendimin nr. 232, datë 23.04.2025 të KLGJ-së (në vijim: Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së).

²⁴² Komiteti Shqiptar i Helsinkit, *Raport studimor për monitorimin e ndikimit të hartës së re gjyqësore në pesë gjykata gjatë periudhës 2020–2024*, Tiranë, prill 2026

organizimin territorial të gjykatave. Në këtë mënyrë, harta gjyqësore kalon nga një kategori me natyrë kryesisht politiko-administrative në një kategori juridiko-institucionale, të lidhur ngushtë me vetëqeverisjen e pushtetit gjyqësor. Ky rikonceptim është në përputhje me standardet e Komisionit të Venecias për Shqipërinë, të shprehura në Opinionin CDL-AD(2016)009, si dhe me konceptimin e CCJE-së në Opinionin nr. 10 (2007) mbi rolin e këshillave gjyqësorë.

Ky sistem kushtetues u konkretizua më tej nëpërmjet ligjeve organike të reformës në drejtësi. Ligji nr. 98/2016, në nenin 14, pika 5, përcakton kriteret objektive, që duhet të udhëheqin vlerësimin e KLGJ-së për numrin e gjyqtarëve në çdo gjykatë, duke përfshirë numrin e popullsisë në juridiksion, llojin dhe vëllimin e çështjeve, treguesit e efikasitetit, infrastrukturën, distancat dhe vështirësitë gjeografike, si dhe nevojat për specializim funksional. Po kështu, neni 13 i të njëjtit ligj parashikon detyrimin e KLGJ-së për rishikimin periodik të këtij vlerësimi, të paktën çdo pesë vjet, duke e konceptuar reformën e hartës gjyqësore jo si një akt të vetëm dhe përfundimtar, por si një proces ciklik, të bazuar në të dhëna dhe në nevojat reale të sistemit gjyqësor.

Ligji nr. 115/2016, neni 84, i atribuon KLGJ-së kompetencën specifike për propozimin e hartës²⁴³. Po ashtu, ligj përcakton se propozimi duhet të kalojë në një proces konsultimi shumë-aktorial dhe duhet të jetë i shoqëruar me një raport vlerësues, që dokumenton bazën empirike të vendimmarrjes. Pra, KLGJ-ja nuk mund të propozojë harta gjyqësore *ad hoc* — ajo është e detyruar të prodhojë akte të mbështetura në një metodologji transparente dhe të verifikueshme.

Procesi pesëvjeçar 2018–2022 e ka konsoliduar tërësinë e propozimit të KLGJ-së në një akt normativ ekzekutiv: Vendimin nr. 495, datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 107, datë 21 korrik 2022²⁴⁴. Ky vendim, që ndjek besnikërisht propozimin e KLGJ-së të miratuar me Vendimin nr. 211, datë 10.06.2022, përcakton arkitekturën e re territoriale: nga 22 gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në 13 të tilla; nga 6 gjykata apeli në 1 Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm me seli në Tiranë; nga 6 gjykata administrative të shkallës së parë në 2 (Tiranë dhe Lushnjë); ndërsa Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata e Lartë, dhe Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO) të dy shkallëve mbeten të paprekura strukturalisht.

Gjithashtu, vendimi parashikoi në vitin 2023 zbatimin fazor si element kritik për kuptimin e dinamikës. Konkretisht, parashikoi hyrjen në fuqi të riorganizimit në tri faza të planifikuara: (i) faza e parë, që përfshinte konsolidimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me hyrje në fuqi më 1 shkurt 2023; (ii) faza e dytë, që përfshinte konsolidimin e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, me hyrje në fuqi më 1 maj 2023; dhe (iii) faza e tretë, që përfshinte konsolidimin e gjykatave administrative të shkallës së parë, me hyrje në fuqi më 1 korrik 2023²⁴⁵. Ky parashikim fazor është element konstitutiv i strukturës së reformës dhe ka implikime metodologjike të

²⁴³Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 84: kompetenca e KLGJ-së për propozimin e hartës gjyqësore.

²⁴⁴VKM nr. 495/2022, op. cit. Vendimi miratoi propozimin e KLGJ-së të miratuar me Vendimin nr. 211, datë 10.06.2022.

²⁴⁵Vendim i KLGJ-së nr. 211, datë 10.06.2022, parashikoi zbatimin fazor: faza e parë (Apeli) më 1 shkurt 2023; faza e dytë (Shkalla e Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm) më 1 maj 2023; faza e tretë (Gjykatat Administrative) më 1 korrik 2023.

rëndësishme: vlerësimi empirik i efekteve të reformës duhet të bëhet duke marrë parasysh natyrën gradualiste të zbatimit.

Një moment normativ i veçantë në regjimin juridik të hartës gjyqësore është miratimi i Vendimit të KLGJ-së nr. 585, datë 09.10.2024 “Për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”²⁴⁶. Ky vendim, që paraprihet nga raporti vlerësues i miratuar me Vendimin nr. 252, datë 09.05.2024 të KLGJ-së, përbën modifikimin e parë substancial të strukturës post-reformë: numri i gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit u rrit nga 13 në 22, dhe për rrjedhojë numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të sistemit gjyqësor u rrit nga 408 në 417.

Ky modifikim ka rëndësi të veçantë juridiko-kushtetuese për tre arsye. Së pari, ai dëshmon se reforma e hartës nuk është një akt përfundimtar, por një proces ciklik, që detyrueshëm përshtatet me të dhënat empirike — pikërisht në respektim të nenit 14 të Ligjit nr. 98/2016, që parashikon rishikimin periodik si detyrim institucional. Së dyti, ai shfaqet si reagim institucional i drejtpërdrejtë ndaj treguesve të vitit 2023 dhe gjysmës së parë të 2024-ës, që dëshmonin se Gjykata Administrative e Apelit ishte struktura me ngarkesën më kritike (vakancë afërsisht 57% në fund të 2023-it) dhe me *Disposition Time*-in më të lartë në sistem (mbi 3.275 ditë në 2024). Së treti, ai konfirmon kompetencën substanciale të KLGJ-së për rishikimin e organikës: vendimi u miratua pas konsultimit publik dhe mbi bazën e analizës së kombinuar të faktorëve ,të parashikuar nga ligji i zbatueshëm — popullsia, vëllim çështjesh, treguesit e efijencës, infrastrukturën, dhe nevojat e specializimit funksional.

2.3.3 Procesi institucional i hartimit, miratimit dhe hyrjes në fuqi të hartës së re gjyqësore

Reforma e hartës gjyqësore nuk është një ngjarje e veçuar e vitit 2022 me VKM 495, por kulmim i një procesi shtatë-vjeçar të ndarë në shtatë faza analitike të dallueshme. Periudha 2018–2022 ndoqi pesë faza institucionale: (1) identifikimi i krizës dhe nevojës për reformë (2018); (2) ndërtimi institucional i grupit ndërinstitucional të punës (2019); (3) konsolidimi i bazës teknike-metodologjike (2020); (4) konsultimi shumë-aktorial me grupet e interesit (2021–fillimi 2022); (5) miratimi formal i hartës nga KLGJ dhe Këshilli i Ministrave (qershor–korrik 2022). Viti 2023 përbëri fazën e gjashtë — operacionalizimi i favor në tri etapa. Në fund, viti 2024 , përbën fazën e shtatë analitike të dallueshme — atë të konsolidimit të parë institucional të reformës, kur sistemi i ri prodhoi treguesit e parë të verifikueshëm të efijencës, dhe kur KLGJ-ja ndërhyri me Strategjinë Kombëtare të uljes së numrit të çështjeve të prapambetura 2024–2027 dhe me modifikimin e parë organik të strukturës (rritja nga 408 në 417 gjyqtarë). Viti 2023 ishte viti i operacionalizimit i favor të hartës së miratuar. Ndryshe nga vitet paraardhëse, ku reforma kishte qenë pothuajse tërësisht në sferën e propozimit dhe të vendimarrjes normative, viti 2023 e nxori atë në sferën e zbatimit të efektshëm: gjykatat e suprimuara u mbyllën realisht; gjyqtarët u transferuan; çështjet u zhvendosën; struktura administrative u rikonfigurua; akseset i qytetarëve u modifikua. Viti 2024, ndërkaq, është viti i parë, në të cilin shfaqen rezultatet e qarta empirike: rritja e gjyqtarëve efektivisht në detyrë nga 247 në 272 (përmirësim 10%);

²⁴⁶Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 585, datë 09.10.2024 “Për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, paraprirë nga raporti vlerësues miratuar me Vendimin nr. 252, datë 09.05.2024 të KLGJ-së. Shih Raportin Vjetor 2024 të KLGJ-së, faqe 59–60.

ulja e *backlog*-ut në Gjykatën e Lartë me 19,8%; arritja për herë të parë e CR mbi 100% në gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të Gjykatës së Lartë; dhe ulja e ndjeshme e treguesit DT në Gjykatën Administrative të Apelit (-38,5%). Kjo është arsyeja pse të dhënat e Raporteve Vjetore të KLGJ-së për vitet 2023 dhe 2024 marrin vlerë të veçantë analitike — të parat janë dëshmia empirike e operacionalizimit dhe e konsolidimit fillestar të reformës.

Raporti Vjetor i KLGJ-së për vitin 2018 — i pari në historinë e këtij organi të sapokrijuar — dokumentoi për herë të parë në mënyrë sistematike disbalancën territoriale të ngarkesës gjyqësore dhe nivelin alarmant të vakancave gjyqësore²⁴⁷. Sipas dekretit ekzistues të Presidentit nr. 7818/2012, organika e gjyqësorit përcaktohej në 408 gjyqtarë. Në fund të 2018-tës, faktikisht në detyrë ishin 361 gjyqtarë, me 47 vakanca. Backlog-u total i sistemit ishte 75.803 çështje²⁴⁸. Këto të dhëna shërbyen si rrethanë faktike themelore për të arsyetuar nevojën institucionale për reformë. KLGJ në këtë vit përcaktoi reformën e hartës si prioritet strategjik.

Me Urdhrin nr. 78, datë 18.02.2019 të KLGJ-së, u ngrit Grupi ndërinstitucional i punës (GNP) për reformën e hartës gjyqësore²⁴⁹. GNP-ja kombinonte përfaqësues nga KLGJ, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), dhe ekspertë teknikë. Misioni i tij ishte hartimi i një propozimi të mbështetur në metodologji objektive duke ndjekur udhëzimet e CEPEJ-it dhe duke siguruar transparencë me palët e interesit.

Raporti i KLGJ-së për vitin 2019 dokumenton se në fund të 2019-ës, organika faktike kishte rënë në 306,2 gjyqtarë (ekuivalente në kohë të plotë pune), që përkthehet në 10,66 gjyqtarë për 100.000 banorë²⁵⁰, krahasuar me mesataren evropiane CEPEJ prej 17,8 gjyqtarë për 100.000 banorë. Backlog-u total u rrit në 92.602 çështje (ritje prej 19% në krahasim me vitin paraprak). Reduktimi i organikës faktike, pasojë e drejtpërdrejtë e procesit të rivlerësimit kalimtar (veting) bëhet faktor dinamik i shtjellës së krizës.

Viti 2020, pavarësisht pandemisë COVID-19, prodhoi konsolidimin e metodologjisë së ndërtimit të hartës. KLGJ-ja përgatiti raportin e parë të plotë të vlerësimit dhe e dorëzoi me shkresën nr. 4736 prot., datë 30.09.2020 në Ministrinë e Drejtësisë²⁵¹. Raporti vjetor i 2020-ës dokumenton se procesi i mëtejshëm kishte ngecur “për shkak të mungesës së qasjes së njëjtë nga Ministria e Drejtësisë”. Gjyqtarët efektivë në 2020 kishin rënë në 270 (66,2% e organikës), duke konfirmuar tendencën e thellimit të krizës.

Gjatë vitit 2021 dhe fillimit të 2022, KLGJ organizoi cikël konsultimesh publike në Tiranë, Vlorë, Gjirokastrë, Durrës, Shkodër dhe Korçë me përfaqësues të dhomave të avokatisë, gjykatave lokale, prokurorive, OJF-ve dhe komuniteteve të biznesit. Plan i Komunikimit u miratua me Vendimin nr. 454, datë 02.11.2022 të KLGJ-së²⁵². Konsultimet zbuluan rezistencë të dukshme në bazë lokale, sidomos në ato qytete që humbisnin gjykatat

²⁴⁷Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ-së për vitin 2018, miratuar me Vendimin nr. 69, datë 03.05.2019 (në vijim: Raporti i KLGJ-së për vitin 2018), faqe 5, 31, 49, 55.

²⁴⁸Raporti i KLGJ-së për vitin 2018, faqe 5: “Backlog-u total i sistemit në fund të vitit 2018 është 75.803 çështje”.

²⁴⁹Urdhri nr. 78, datë 18.02.2019, i Kryetares së KLGJ-së “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për reformën e hartës gjyqësore”. Shih Raportin Vjetor të KLGJ-së për vitin 2019, kapitulli mbi bashkëpunimin ndërinstitucional, faqe 95–97.

²⁵⁰Raporti i KLGJ-së për vitin 2019, faqe 124: “në Shqipëri ka pasur 11,85 gjyqtarë për 100.000 banorë. Në realitet, gjatë këtij viti ngarkesa është përballuar nga vetëm 306 gjyqtarë (ekuivalenti në kohë të plotë pune) e cila përkthehet në 10,66 gjyqtarë për 100.000 banorë”. Mesatarja CEPEJ në referencë: 17,8 gjyqtarë për 100.000 banorë.

²⁵¹Shkresa e KLGJ-së nr. 4736 prot., datë 30.09.2020, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë. Shih Raportin Vjetor të KLGJ-së për vitin 2020, faqe 25–27, seksioni 1.1 “Së pari: Harta e re Gjyqësore”.

²⁵²Vendim i KLGJ-së nr. 454, datë 02.11.2022 “Për miratimin e Planit të Komunikimit për Hartën e re Gjyqësore”.

(Tropojë, Krujë, Lushnjë, Pogradec, Mat, Përmet, Kurbin, Kavajë, Pukë), por gjithashtu legjitimuan procesin përmes pjesëmarrjes së gjerë. Me Vendimin nr. 211, datë 10.06.2022, KLGJ miratoi raportin vlerësues dhe propozimin e GNP-së për riorganizimin e rretheve gjyqësore²⁵³. Më pas, Këshilli i Ministrave miratoi VKM-në nr. 495/2022 — që, siç u theksua, është reflektim besnik i propozimit të KLGJ-së. Prandaj, edhe pse forma juridike e aktit përfundimtar mbetet vendim i Këshillit të Ministrave (në respektim të nenit 100 të Kushtetutës), substanca e vendimit mbetet e KLGJ-së.

Viti 2023 shënoi një kthesë: nga konceptim normativ në operacionalizim faktik. Raporti Vjetor i KLGJ-së për vitin 2023, miratuar me Vendimin përkatës të KLGJ-së në vitin 2024, dokumenton në mënyrë sistematike shndërrimin institucional. Faza e parë e zbatimit hyri në fuqi më 1 shkurt 2023: gjashtë gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm (Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë) u shkrinë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me seli në Tiranë²⁵⁴. Ky ishte hapi më i guximshëm i reformës — krijimi i një gjykate apeli të vetme për gjithë vendin, që zëvendësoi një strukturë gjashtëfishe të fragmentuar. Vendimi i KLGJ-së nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë”, finalizoi rregullimin operacional të strukturës së re. Faza e dytë hyri në fuqi më 1 maj 2023: 22 gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm u konsoliduan në 13 gjykata. Konkretisht, u shkrinë gjykatat e Tropojës, Krujës, Lushnjës, Pogradecit, Matit, Përmetit, Kurbinit, Kavajës dhe Pukës²⁵⁵. Më 2 maj 2023, gjykata dhe prokuroria e Tropojës u zhvendosën në Kukës, duke shënuar simbolikisht fillimin e zbatimit material. Reagimi institucional i Dhomës së Avokatisë në Kukës ishte negativ, me shqetësime për kostot shtesë të transportit dhe ndikimin në aksesin e popullatës rurale. Kjo ngjarje ilustron fillimin e fazës më kritike të reformës — ku abstragimi normativ përballlet me realitetin material.

Faza e tretë hyri në fuqi më 1 korrik 2023: 6 gjykatat administrative të shkallës së parë u konsoliduan në 2 — Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (me kompetencë mbi rrethet gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Lezhë dhe Korçë) dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë (me kompetencë mbi rrethet Berat, Fier, Gjirokastrë, Sarandë dhe Vlorë)²⁵⁶. Kjo fazë e fundit u realizua më vonë nga sa ishte parashikuar fillimisht, për shkak të kompleksitetit specifik të juridiksionit administrativ dhe të nevojës për përgatitje më të kujdesshme infrastrukturore. Krahas operacionalizimit territorial, viti 2023 prodhoi, gjithashtu, rikonfigurimin e brendshëm të strukturave të reja. Me Vendimin nr. 147, datë 29.03.2023 “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave”, KLGJ kategorizoi gjykatat sipas vëllimit dhe specializimit, duke përcaktuar Gjykatën e Posaçme dhe disa gjykata kryesore si “kategori të parë (e lartë)”²⁵⁷. Po ashtu, me Vendimin nr. 148, datë 29.03.2023, miratoi rregullat standarde për organigramën,

²⁵³Vendim i KLGJ-së nr. 211, datë 10.06.2022 “Për miratimin e raportit vlerësues dhe propozimit të grupit ndërinstitucional të punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”.

²⁵⁴Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ-së për vitin 2023 (në vijim: Raporti i KLGJ-së për vitin 2023). Shih kapitullin mbi zbatimin e hartës së re gjyqësore.

²⁵⁵Sipas VKM 495/2022, neni 1, pika 2: konsolidimi i 22 gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në 13 gjykata, sipas listës: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë.

²⁵⁶Sipas VKM 495/2022, neni 1, pika 4: “Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me kompetencë tokësore mbi rrethet gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Lezhë dhe Korçë; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë me kompetencë tokësore mbi rrethet gjyqësore Berat, Fier, Gjirokastrë, Sarandë dhe Vlorë”.

²⁵⁷Vendim i KLGJ-së nr. 147, datë 29.03.2023 “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave”.

përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë²⁵⁸. Kjo paketë vendimesh, e marrë në një periudhë të ngjeshur prej dy javësh në mars 2023, paraqet aktin e plotë rregullator të operacionalizimit të hartës — të cilin VKM-ja 495/2022 e kishte parashikuar vetëm në linjë të përgjithshme.

Viti 2024 dëshmoi fazën më të rëndësishme të reformës pas operacionalizimit të 2023-it: konsolidimin e parë institucional të strukturës së re, që përkon me ndryshimet e brendshme në vetë organin e KLGJ-së, me miratimin e Strategjisë Kombëtare të uljes së numrit të çështjeve të prapambetura 2024–2027, dhe me modifikimin e parë organik të hartës post-reformë. Sipas Raportit Vjetor 2024 të KLGJ-së, miratuar me Vendimin nr. 232, datë 23.04.2025²⁵⁹, viti raportues u karakterizua nga një rritje e treguesve të performancës në shumë drejtime, ndërsa ende ekzistonin sfida strukturore të mëdha. Së pari, vetë institucioni i KLGJ-së iu nënshtrua ripërtëritjes së anëtarësisë: në korrik dhe tetor 2024, me mbarimin e mandatit të tre anëtarëve jogjyqtarë, përbërja e Këshillit u ripërtëri me tre anëtarë të tjerë. Më 22 tetor 2024 u zgjodh Kryetari i ri i dhe Zëvendëskryetari²⁶⁰.

Së dyti, më 9 maj 2024, KLGJ-ja miratoi Strategjinë Kombëtare të Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata 2024–2027 me Vendimin nr. 251, datë 09.05.2024²⁶¹. Strategjia, e zhvilluar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 42, datë 20.07.2023 të Kryetarit të KLGJ-së, evidenton shkaqet, që kontribuojnë në volumin e çështjeve të prapambetura dhe ofron një qasje të strukturuar për reduktimin e tyre gjatë tre viteve të ardhshme, duke targetuar kryesisht Gjykatat e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Administrativ, si edhe gjykatat e shkallës së parë Tiranë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ. Strategjia përcakton 7 objektiva: (i) ulja strukturore e numrit të çështjeve të prapambetura nëpërmjet inventarizimit dhe menaxhimit të diferencuar; (ii) fuqizimi i kapaciteteve të gjyqësorit; (iii) përmirësimi i metodave të punës; (iv) digjitalizimi i procedurave; (v) komunikimi institucional; (vi) bashkëpunimi me institucionet e tjera; (vii) rritja e transparencës dhe e besimit të publikut. Së treti, paketa rregullatore e Strategjisë u plotësua me Vendimin nr. 253, datë 09.05.2024 “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura” dhe me Vendimin nr. 254, datë 09.05.2024 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”²⁶². Si rezultat, pranë gjykatave të apelit u krijuan Ekipet për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura (NUNÇP), që nga shtatori 2024, me 5 nëpunës pranë secilës prej dy gjykatave të apelit, dhe 1 nëpunës, i shtuar pranë Gjykatës së Lartë. Sipas

²⁵⁸Vendim i KLGJ-së nr. 148, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi”.

²⁵⁹Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, miratuar me Vendimin nr. 232, datë 23.04.2025 të KLGJ-së. Raporti është strukturuar në 9 kapituj kryesorë dhe 128 faqe. Shih kapitujt 1 (Veprimtaria e Këshillit), 2 (Niveli i zbatimit të rezolutës), 3 (Organizimi i brendshëm), 6 (Strategjia Kombëtare e Uljes së Backlog-ut), dhe 7 (Analiza mbi situatën e gjykatave).

²⁶⁰Vendimi i KLGJ-së nr. 361, datë 29.07.2024; Vendimi nr. 362, datë 29.07.2024; dhe Vendimi nr. 625, datë 22.10.2024 për deklarin e mbarimit të mandatit të anëtarëve jogjyqtarë. Anëtarët e rinj: z. Albens Tabaku, z. Bledar Bajri (avokatë), znj. Violanda Theodori (shoqëria civile), mandate 2024–2029. Shih Raportin Vjetor 2024 të KLGJ-së, faqe 13–14.

²⁶¹Vendimi i KLGJ-së nr. 251, datë 09.05.2024 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata 2024–2027”. Strategjia, e zhvilluar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 42, datë 20.07.2023 të Kryetarit të KLGJ-së, përbën dokumentin më gjithëpërfshirës strategjik për administrimin gjyqësor në Shqipëri. Shih Raportin Vjetor 2024 të KLGJ-së, kapitulli 6, faqe 56–63.

²⁶²Vendimi i KLGJ-së nr. 253, datë 09.05.2024 “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykata”; Vendimi nr. 254, datë 09.05.2024 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, që modifikon Vendimin nr. 78, datë 30.05.2019 të KLGJ-së. Shih Raportin Vjetor 2024 të KLGJ-së, faqe 56–58.

të dhënave të Raportit Vjetor 2024 (faqe 57), ekipi i NUNÇP-ve pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm përpunoi 1.146 dosje gjyqësore (639 civile dhe 507 penale), nga të cilat u gjykuan dhe u dhanë vendime për 257 çështje (151 civile dhe 106 penale). Ndërsa pranë Gjykatës Administrative të Apelit, ekipi përpunoi 941 dosje gjyqësore, nga të cilat u gjykuan 303 çështje. Së katërti, ishte akti më substancial i konsolidimit, i cili u miratua Vendimi i KLGJ-së nr. 585, datë 09.10.2024 “Për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”²⁶³, që rriti organikën e Gjykatës Administrative të Apelit nga 13 në 22 gjyqtarë dhe rrjedhimisht totalin nga 408 në 417 gjyqtarë. Ky vendim, paraprirë nga raporti vlerësues i miratuar me Vendimin nr. 252, datë 09.05.2024, përbën modifikimin e parë organik të hartës post-reformë, duke iu përgjigjur kritikës më të theksuar empirike të vitit 2023 — vakancës strukturore prej 57% në Gjykatën Administrative të Apelit dhe Disposition Time-it të lartë në këtë gjykatë. Së pesti, viti 2024 prodhoi gjithashtu konsolidimin e burimeve njerëzore: u emëruan 32 magjistratë të rinj nga Shkolla e Magjistraturës (vit akademik 2023–2024); u miratuan kuotat për 20 kandidatë për magjistratë profili “gjyqtar” dhe 15 për “ndihmës ligjorë” për vitin akademik 2024–2025; u finalizuan 4 procedura ngritje në detyrë (3 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe 1 në Gjykatën Administrative të Apelit); u realizuan 7 transferime përmes lëvizjes paralele; u caktuan 66 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të ndryshme, dhe u realizuan 21 transferime të përkohshme dhe 6 transferime të përhershme për shkak të suprimimit të pozicionit. Si rezultat kumulativ i këtyre masave, organika faktike kaloi nga 247 gjyqtarë në fund të 2023-së në 272 gjyqtarë në fund të 2024-së — rritje prej 10,1%, që mbart rëndësi të veçantë për treguesit e ardhshëm të performancës²⁶⁴.

Së gjashti, në kontekstin e procesit të integritetit evropian, viti 2024 dëshmoi hapjen e negociatave për grup-kapitullin e parë “Themeloret”, ku Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe Kapitulli 24 “Drejtësia, liria dhe siguria” përbëjnë boshtin kryesor. Reforma e hartës gjyqësore u prezantua para Komisionit Evropian si dëshmi e progresit institucional, dhe rezultatet empirike të vitit 2024 — sidomos rritja e CR-së mbi 100% në Gjykatën e Lartë dhe gjykatat administrative të shkallës së parë — u përdorën si argument në favor të suksesit substancial të procesit. Po ashtu, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030 u finalizua me kontribut të KLGJ-së, duke vendosur reformën e hartës brenda një kornize më të gjerë të reformimit të drejtësisë²⁶⁵.

263

²⁶⁴Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 33: “Gjatë vitit 2024, kanë ushtruar efektivisht funksionin e gjyqtarit në gjykatat e të gjitha niveleve, gjithsej 272 gjyqtarë në të njëjtën periudhë kohore. Kjo nënkupton se sistemi gjyqësor gjatë vitit 2024 ka funksionuar me pothuajse 66.6% të kapacitetit të tij, pothuajse me 6.6% më shumë së në vitin 2023, e cila ka rezultuar me 247 gjyqtarë që kanë ushtruar efektivisht detyrën”.

²⁶⁵Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030, finalizuar në vitin 2024 me kontribut të KLGJ-së. Hapja e grup-kapitullit të parë “Themeloret” në procesin e negociatave të anëtarësimit në BE përfshin Kapitujt 23 (“Gjyqësori dhe të drejtat themelore”) dhe 24 (“Drejtësia, liria dhe siguria”). Shih Raportin Vjetor 2024 të KLGJ-së, faqe 121–125, kapitulli 8.

2.4 Harta e re gjyqësore dhe efektet institucionale të kësaj reforme

2.4.1 Treguesit empirikë të funksionimit të sistemit gjyqësor para zbatimit të hartës së re

Para se të analizohet impakti i reformës në vitin 2023, është e domosdoshme të rikonstruktojmë me precizion dinamikën e treguesve të performancës gjyqësore gjatë periudhës 2018–2022, kur reforma ishte vetëm në sferën e propozimit. Kjo dinamikë konfirmon tezën themelore: kriza nuk ishte rezultat i thjeshtë i procesit të vetingut, por shprehje e dobësisë strukturore të hartës së trashëguar.

Treguesit kryesorë — *Disposition Time* (DT), *Clearance Rate* (CR), *Workload* (WR), raporti gjyqtar/staf, dhe organika faktike — shfaqin tendencë të vazhdueshme përkeqësimi gjatë periudhës paraardhëse, duke krijuar argumentin empirik që justifikon ndërhyrjen strukturore.

Treguesi i CEPEJ *Disposition Time* (DT) — që mat numrin e ditëve mesatare që duhen për të zgjidhur një çështje në fund të periudhës raportuese — shfaqti në periudhën para-reformë vlera, që dëshmuuan jokonsistencë me parimin kushtetues të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Sipas të dhënave të Raportit Vjetor 2022 të KLGJ-së, faqe 80, Tabela e treguesit DT, Gjykata Administrative e Apelit shfaqte një DT prej 8.680,4 ditë²⁶⁶ — që përkthehet në afërsisht 23,8 vjet për ezaurimin e stokut. Ky është vlera më ekstreme e shënuar në sistemin gjyqësor shqiptar dhe përbën, juridikisht, një cenim sistematik të nenit 6 të KEDNJ-së. Kjo vlerë nuk mund të reduktohet thjesht me ndihmësa ligjorë apo me ndryshime procedurale; ajo reflekton një disbalancë strukturore midis ngarkesës dhe organikës. Treguesi DT i Gjykatës së Lartë, që në vitin 2018 ishte i parashikuar të kalonte 17 vjet e 3 muaj për ezaurimin e stokut, u përmirësua në mënyrë rrënjësore në vitin 2022 (projeksioni i ezaurimit u zhvendos në vitin 2026), pas plotësimit me 16 anëtarëve të rinj deri në vitin 2022, që e plotësuan në mënyrë faktike trupën gjyqësore me 19 anëtarë. Ky është argument i fortë në favor të tezës se kriza e Gjykatës së Lartë ishte rezultat i mungesës së trupës gjyqësore, jo i hartës — që përdoret edhe si argument kontradiktor në diskutimin për arsyetimin e reformës territoriale.

Clearance Rate (CR) — që mat raportin midis çështjeve të zgjidhura dhe atyre të reja, të regjistruara në një periudhë — duhet idealisht të jetë mbi 100% për të treguar reduktim të stokut. Të dhënat e Raporteve Vjetore 2018–2022 dëshmojnë se CR mesatare e sistemit qëndroi vazhdimisht nën 100%, duke krijuar akumulim sistematik. Konkretisht, në vitin 2018 CR u raportua në rendin e 91% — që përkthehej në një rritje të stokut prej afërsisht 14.700 çështje në vit. Në vitin 2019, CR ra në 89%, duke prodhuar rritje më të madhe të stokut. Në vitin 2022, edhe pse CR u përmirësua marginalisht në 95% në nivel agreguar (kryesisht falë kontributit të Gjykatës së Lartë), në nivelet e tjera të sistemit ai mbeti nën 100%.

Megjithatë, në analizën e këtyre treguesve duhet bërë një dallim metodologjik i rëndësishëm. Rishikimi i hartës gjyqësore, në thelb, nuk është projektuar si instrument i drejtpërdrejtë për reduktimin e stokut gjyqësor të akumuluar ndër vite. Qëllimi i saj kryesor lidhet me riorganizimin territorial të gjykatave mbi bazën e kërkesave gjyqësore të reja, pra të çështjeve të reja të regjistruara në gjykata, me synim balancimin më të drejtë të ngarkesës, përdorimin më efikas të burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit gjyqësor përmes mundësive më të mëdha për specializim. Për këtë

²⁶⁶Raporti Vjetor i KLGJ-së për vitin 2022, faqe 80, Tabela e treguesit DT për Gjykatën Administrative të Apelit. Vlera e saktë e raportuar: 8.680,4 ditë (që përkthehet në 23,8 vjet sipas kalkulimit 8.680,4/365).

arsye, tregues të tillë si DT dhe CR janë të rëndësishëm për të kuptuar gjendjen strukturore të sistemit para reformës, por nuk duhet të interpretohen sikur harta gjyqësore, në vetvete, mund të prodhonte automatikisht uljen e çështjeve të prapambetura. Reduktimi i *backlog*-ut kërkon masa të veçanta menaxheriale, procedurale, teknologjike dhe burime shtesë gjyqësore, ndërsa harta gjyqësore shërben kryesisht si instrument për optimizimin e organizimit dhe shpërndarjes së kapaciteteve gjyqësore.

Tabela 1. Treguesi Clearance Rate sipas niveleve të sistemit (2019–2022)

Niveli i sistemit	CR 2019	CR 2020	CR 2021	CR 2022
Gjykata e Lartë	47,3%	38,1%	78,4%	253,8%
Apelet (juridiksioni i përgjithshëm)	83,7%	91,2%	87,5%	89,0%
Shkalla e parë (juridiksioni i përgjithshëm)	90,5%	89,1%	85,8%	83,2%
Apeli Administrativ	73,3%	65,4%	62,2%	58,7%
Shkalla e parë administrative	85,2%	80,9%	78,5%	82,5%

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e Raporteve Vjetore të KLGJ-së për vitet 2019, 2020, 2021, 2022 (faqet 80, 86 e vijues).

Tabela 1 zbulon dy konstatime strukturore. Së pari, vetëm Gjykata e Lartë në vitin 2022 arriti CR mbi 100% — dhe kjo ishte rezultat i drejtpërdrejtë i rritjes së numrit të gjyqtarëve, të emëruar në atë gjykatë me rreth 16 në atë vit, jo i përmirësimit metodologjik apo strukturor. Së dyti, CR-ja në Gjykatën Administrative të Apelit u përkeqësua në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës 2019–2022, duke kaluar nga 73,3% në 58,7%. Kjo është dëshmia më e qartë empirike se ekzistonte mungesa e kapaciteti për të përballuar ngarkesën, dhe nuk problemi nukpo arrinte të zgjidhej përmes burimeve të disponueshme.

Backlog-u (stoku i çështjeve të mbartura) është një tregues sintetizues i drejtpërdrejtë i performancës: ai kalon nga 75.803 çështje në fund të 2018-ës, në 92.602 çështje në fund të 2019-ës (rritje 19%), dhe vazhdoi të rritet sistematikisht në vitet pasardhëse. Sipas Raportit Vjetor 2022 të KLGJ-së, faqe 86, krahasimi i ngarkesës ndërmjet niveleve, *backlog*-u total i sistemit në fund të vitit 2022 arriti afërsisht 110.000 çështje. Vetëm në Gjykatën e Lartë, stoku ra për herë të parë në mënyrë të dukshme në fund të 2022-ës (në 31.827 çështje), përsëri për shkak të efektit të emërimeve të reja, jo të reformës strukturore.

Vlerësimi në krahasim me CEPEJ — i dokumentuar në Raportin Vjetor 2022 të KLGJ-së, faqe 30 — vendos Shqipërinë në fund të renditjes evropiane: gjyqtarë për 100.000 banorë janë 11,85 (organika nominale) dhe 10,66 (faktike), kundrejt mesatares evropiane CEPEJ prej 17,8²⁶⁷. Kjo distancë (afërsisht 40% nën mesataren) konfirmon se sistemi shqiptar funksiononte në një regjim të nën-organikës strukturore, ku shkrirja territoriale e gjykatave të vogla ishte një nga zgjidhjet e mundshme jo për të zëvendësuar burimet e munguara, por për t'i shpërndarë ato më mirë.

²⁶⁷Raporti Vjetor i KLGJ-së për vitin 2022, faqe 30, krahasim CEPEJ: “Mesatarja evropiane është 17,8 gjyqtarë për 100.000 banorë, sipas të dhënave të raportit CEPEJ Evaluation 2020 cycle”. Krahasoni edhe me Raportin e KLGJ-së për vitin 2019, faqe 124, dhe me Raportin Vjetor 2024 i KLGJ-së (faqe 34), ku mesatarja CEPEJ është rifreskuar në 21,9 gjyqtar/100 mijë banorë sipas Raportit CEPEJ 2024.

Treguesi WR (ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar) mbart rëndësi të veçantë analitike, pasi shfaq se harta gjyqësore ekzistuese prodhonte një shpërndarje thellësisht të pabarabartë të punës. Ky tregues është pasqyra më e qartë e dështimit strukturor të hartës së trashëguar, dhe vit pas viti ai vetëm sa konfirmoi dhe thelloi disbalancën. Të dhënat e Raporteve Vjetore të KLGJ-së për vitet 2019, 2021 dhe 2022 (Tabelat e treguesit WR sipas gjykatave të apelit, faqet 80–82) dëshmojnë se në brendësi të sistemit shqiptar ekzistonin disproporcione, që në standardet evropiane do të konsideroheshin të papranueshme.

Tabela 2. Treguesi WR — Disbalancat territoriale midis gjykatave të apelit (2019–2022)

Gjykata	WR 2019	WR 2020	WR 2021	WR 2022
Apeli Tiranë	741	1.062	2.572,7	2.142,5
Apeli Vlorë	746	738	1.040,3	936,9
Apeli Durrës	651	842	999,6	1.102,7
Apeli Shkodër	400	588	853,8	791,8
Apeli Korçë	346	539	564,3	601,5
Apeli Gjirokastrë	189	190	252,8	310,4
Disbalanca maks./min.	3,9x	5,6x	10,2x	6,9x

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e Raporteve Vjetore të KLGJ-së për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Tabela 2 dëshmon se disbalanca territoriale midis Apelit të Tiranës dhe Apelit të Gjirokastrës arriti një maksimum prej 10,2 herë në vitin 2021. Kjo do të thotë se një gjyqtar në Apelin e Tiranës duhej të përballej me 10 herë më shumë çështje se një gjyqtar në Apelin e Gjirokastrës. Një disproporcion i tillë nuk justifikohet nga asnjë faktor objektiv: as nga ngarkesa territoriale e popullsisë, as nga kompleksiteti i çështjeve. Ai është thjesht rezultat i hartës së pa-revizionuar territorialisht, që alokonte gjyqtarë sipas kufijve administrativë të vjetër, jo sipas vëllimit faktik të punës.

Sipas të dhënave të Raporteve Vjetore të KLGJ-së për vitin 2019, faqe 125, dhe Raportit Vjetor 2022, faqe 29–30, raporti gjyqtar/staf u rrit nga 1:2,76 në 2019 në 1:2,9 në 2022 (sipas organikës), ndërsa raporti faktik (gjyqtarë efektivisht në detyrë) u rrit në 1:4,6 — pjesërisht për shkak të rritjes së stafit (Kuvendi akordoi 50 pozicione shtesë në vitin 2022, prej të cilave 47 për gjykatat dhe 3 për KLGJ-në sipas Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”)²⁶⁸, dhe pjesërisht për shkak të rënies së gjyqtarëve efektivë. Kjo rritje statistikore e raportit gjyqtar/staf nuk reflekton përmirësim të kushteve të punës, por është efekt anësor i krizës së vakancave gjyqësore. CEPEJ në Raportin për vitin 2022 raportonte mesataren evropiane prej 1:3,9, duke vendosur, gjithashtu, Shqipërinë, nën mesataren në këtë tregues kritik strukturor.

²⁶⁸Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”. Sipas Raportit Vjetor të KLGJ-së për vitin 2022, faqe 29, KLGJ-së i u akorduan 50 punonjës/pozicione shtesë për vitin 2022 (3 për KLGJ dhe 47 për gjykatat). Krahasim me CEPEJ: mesatarja evropiane 1:3,9 (gjyqtar/staf).

Para reformës, ekzistonin disa gjykata me organikë faktike prej 2–3 gjyqtarësh dhe me ngarkesë vjetore poshtë 100 çështje për gjyqtar. Këto konsideroheshin gjykata sub-minimale, që nuk arrinin prapun e racionalitetit organizativ. Konkretisht: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë me 6,2 nëpunës për gjyqtar, ose Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër me 7,3 nëpunës për gjyqtar. Këto disproporcione janë në thelb të arsyetimit territorial të reformës: shumat e ngarkesave të personelit në gjykatat e vogla ishin disproporcionalisht të larta, ndërsa në gjykatat e mëdha ishin disproporcionalisht të ulëta. Konsolidimi territorial nëpërmjet hartës së re pritet të ekuilibrojë në mënyrë sistematike këtë raport brenda strukturave më të mëdha të reja.

2.4.2 Operacionalizimi dhe konsolidimi institucional i hartës së re gjyqësore, 2023–2024

Pas zbatimit të të treja fazave të reformës (1 shkurt, 1 maj, 1 korrik 2023), Republika e Shqipërisë, në fund të vitit 2023, doli me një strukturë gjyqësore plotësisht të rikonfiguruar. Konkretisht, struktura e re përmban: (i) 1 Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm me seli në Tiranë, e cila zëvendësoi 6 gjykata apeli paraardhëse; (ii) 13 gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm (Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë), që zëvendësuan 22 gjykata paraardhëse; (iii) 2 gjykata administrative të shkallës së parë (Tiranë dhe Lushnjë), që zëvendësuan 6 gjykata administrative paraardhëse; (iv) Gjykatën Administrative të Apelit, Gjykatën e Lartë, dhe Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO), që mbetën strukturalisht të pandryshuara.

Raporti Vjetor i KLGJ-së për vitin 2023, që mbulon vitin e parë të zbatimit, ofron të dhënat empirike themelore për vlerësimin fillestar të impaktit. Sipas këtij raporti, mesatarja e ngarkesës vjetore të çështjeve për gjyqtar arriti 841 çështje në vit (faqe 93), e cila është e krahasueshme me ngarkesat e mëparshme, por është e shpërndarë në mënyrë më të ekuilibruar territorialisht²⁶⁹. Megjithatë, kjo mesatare maskon disproporcione që mbetën ende të larta në strukturën e re.

Të dhënat më të rëndësishme të vitit 2023, që dëshmojnë sfidat e zbatimit, lidhen me organikën faktike të gjyqtarëve. Sipas raportit, organika nominale e parashikuar mbeti 408 gjyqtarë, ndërsa organika faktike (sipas strukturës së re) është 329, dhe gjyqtarët efektivisht në detyrë në fund të 2023-ës ishin vetëm 247²⁷⁰. Kjo do të thotë se në fund të vitit të parë të zbatimit, sistemi gjyqësor shqiptar funksiononte me afërsisht 60% të kapacitetit nominal — një disbalancë, që përbën sfidën më të madhe operationale të hartës së re.

Tabela 3. Organika faktike e gjyqtarëve sipas nivelit në fund të vitit 2023

Niveli i sistemit	Organika nominale	Faktike 2023	Vakanca %	Krahasim me 2022
Gjykata e Apelit Juridiksioni i Përgjithshëm	78	~54	31%	Strukturë e re

²⁶⁹Raporti i KLGJ-së për vitin 2023, faqe 93: “Mesatarja e ngarkesës vjetore të çështjeve për gjyqtar arriti 841 çështje në vit”. Konfirmuar nga raporti i KShH-së për vitin 2023, faqe 11.

²⁷⁰Raporti i KShH-së për vitin 2023 (mars 2025), faqe 7: “krijimi i vakancave të larta në stafin gjyqësor në vitin 2023, ku nga 408 gjyqtarë të miratuar në organikë, efektivisht ushtruan detyrën vetëm 247 gjyqtarë”.

Niveli i sistemit	Organika nominale	Faktike 2023	Vakanca %	Krahasim me 2022
Gjykata Administrative e Apelit	18	~8	57%	Përkeqësim
Shkalla e parë juridiksioni i përgjithshëm (13 gjykata)	~245	~137	44%	Të ngjashme
Gjykata e Posaçme Shkallës së Parë (GJKKO)	16	~7	56%	Përkeqësim
Gjykata e Lartë	19	19 (plot)	0%	Plotësim final
TOTALI	~329	247	~25%	—

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e Raportit Vjetor të KLGJ-së për vitin 2023 dhe Raportit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit “Për monitorimin e KLGJ-së dhe ILD-së për periudhën Janar–Dhjetor 2023”.

Tabela 3 tregon se nga 408 gjyqtarë të miratuar në organikën nominale, efektivisht ushtruan detyrën vetëm 247 gjyqtarë në fund të vitit 2023. Kjo është një vakancë faktike prej afërsisht 39% në krahasim me organikën nominale dhe 25% në krahasim me organikën e re post-reformë (329)²⁷¹. Rasti më ekstrem mbeti Gjykata Administrative e Apelit (vakancë 57%), ndjekur nga GJKKO (vakancë 56%), Gjykatat e rretheve të juridiksionit të përgjithshëm (vakancë 44%), dhe Gjykata e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm (vakancë 31%). Gjykata e Lartë mbetet e plotësuar plotësisht me 19 anëtarë — rasti i vetëm i suksesit total.

Përballë sfidës operacionale, KLGJ shfaqti në vitin 2023 nivelin më të lartë të aktivitetit në historinë e tij. Sipas Raportit Vjetor 2023 (faqe 18 e vijues, kapitulli mbi veprimtarinë vendimmarrëse), Këshilli miratoi 743 vendime gjatë vitit 2023, që përfaqëson rritje prej 24% në krahasim me vitin 2022, duke përfshirë: 27 akte nënligjore, 506 akte individuale, 162 akte kolektive, 47 akte rregullatore të brendshme dhe 1 udhëzim. U organizuan 80 mbledhje plenare²⁷², që korrespondojnë mesatarisht me afërsisht 7 mbledhje në muaj.

²⁷¹Raporti i KSHH-së për vitin 2023, faqe 17: “tejet problematike numri i vakancave të gjyqtarëve në: Gjykatat e rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm të cilat kanë pasur mungesë 44% të gjyqtarëve; në Gjykatën Administrative të Apelit e cila ka pasur mungesën më të gjyqtarëve në masën 57%; në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm e cila ka pasur mungesë të gjyqtarëve në masën 31%; dhe në Gjykatën e posaçme të shkallës së parë, e cila ka pasur mungesë të gjyqtarëve në masën 56 %”.

²⁷²Raporti i KLGJ-së për vitin 2023, kapitulli mbi veprimtarinë vendimmarrëse: 743 vendime, 80 mbledhje plenare, prej të cilave 27 akte nënligjore, 506 akte individuale, 162 akte kolektive, 47 akte rregullatore të brendshme dhe 1 udhëzim.

Kategoria e veprimtarisë	Numri faktik i gjyqtarëve / proceseve	Detajim sipas raportit të KLGJ-së	Numri i akteve të KLGJ-së
Emërimet e gjyqtarëve të rinj	41 gjyqtarë	Të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës — 40 nga viti akademik 2022–2023 dhe 1 nga viti akademik 2021–2022	126 akte
Ngritje në detyrë	11 gjyqtarë	3 në Gjykatën e Lartë; 3 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; 3 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; 2 në Gjykatën Administrative të Apelit	88 akte
Transferime të gjyqtarëve (përfshirë lëvizjen paralele)	33 gjyqtarë	12 transferime të përkohshme me pëlqim; 2 përsëritje të transferimit të përkohshëm 1-vjeçar; 8 transferime të përhershme për shkak të suprimimit të pozicionit; 11 transferime me lëvizje paralele	146 akte
Përfshirje në skemën delegimit	5 gjyqtarë	4 gjyqtarë rishtazi në skemë + 1 gjyqtar me zgjatje afati dhe ricaktim	16 akte
Caktime në çështje gjyqësore të veçanta	208 gjyqtarë	Caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme; mbi bazën e 169 kërkesave të trajtuara	31 akte
Komandime të gjyqtarëve	5 gjyqtarë	Procedura të komandimit gjatë vitit 2023; raporti përmend gjyqtarë të komanduar pranë vetë KLGJ-së	28 akte
Mbarim i statusit të gjyqtarit	6 gjyqtarë	Për shkak të dorëheqjes ose miratimit të pensionit të parakohshëm/moshës së pensionit	6 akte
Procedime disiplinore të shqyrtuara	6 procedime	4 procedime të filluara rishtazi në vitin 2023 + 2 procedime të mbartura nga vitet e mëparshme; të gjitha përfunduan me vendim jo përfundimtar (pezullim ose mbyllje pa vendim themeli)	—

Burimi: Raporti Vjetor i KLGJ-së për vitin 2023 (Përmbledhja Ekzekutive, fq. 6–8; Kreu I, seksionet “Komisioni i Zhvillimit të Karrierës” dhe “Komisioni Disiplinor”, fq. 13–16; Kreu III, fq. 28–29; Kreu VII).

Tabela 4 paraqet veprimtarinë vendimmarrëse të KLGJ-së gjatë vitit 2023 në fushën e burimeve njerëzore gjyqësore, duke dalluar në mënyrë metodologjikisht të qartë midis numrit të akteve të KLGJ-së dhe numrit faktik të gjyqtarëve të prekur nga këto akte. Ky dallim është thelbësor për të kuptuar realitetin e lëvizjes brenda sistemit gjyqësor në vitin e parë të zbatimit të plotë të Hartës së re gjyqësore: një proces i vetëm vendimmarrës — qoftë transferim, ngritje në detyrë apo caktim — gjeneron tipikisht më shumë se një akt administrativ, çka do të thotë se numri i akteve mbivlerëson në mënyrë sistematike nivelin real të lëvizjes së personelit gjyqësor.

Të dhënat tregojnë se, gjatë vitit 2023, KLGJ-ja realizoi në mënyrë faktike: emërimin e 41 magistratëve të rinj nga Shkolla e Magistraturës; ngritjen në detyrë të 11 gjyqtarëve, të shpërndarë në katër gjykata të nivelit të lartë (Gjykata e Lartë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykata Administrative e Apelit); transferimin e 33 gjyqtarëve përmes katër formave të ndryshme ligjore — duke përfshirë 11 gjyqtarë me lëvizje paralele dhe 8 të transferuar në mënyrë të përhershme për shkak të suprimimit të pozicionit; përfshirjen e 5 gjyqtarëve në skemën e delegimit; si dhe caktimin e 208 gjyqtarëve në çështje të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtronin funksionin e tyre në mënyrë të përhershme, mbi bazën e 169 kërkesave të paraqitura nga drejtuesit e gjykatave.

Vëllimi i konsiderueshëm i transferimeve dhe i lëvizjeve paralele në vitin 2023 është reflektim i drejtpërdrejtë i nevojës për të rishpërndarë trupën gjyqësore pas zbatimit të Hartës së re gjyqësore, e cila zvogëloi numrin e përgjithshëm të gjykatave nga 38 në 20 — konkretisht: gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm u reduktuan nga 22 në 13 (suprimim i 9 gjykatave); gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm u shkrinë nga 6 gjykata në 1 të vetme me seli në Tiranë; dhe gjykatat administrative të shkallës së parë u reduktuan nga 6 në 2. Transferimi i 8 gjyqtarëve “për shkak të suprimimit të pozicionit”, i dokumentuar shprehimisht nga vetë raporti, është pasojë e drejtpërdrejtë e këtij riorganizimi.

Caktimi i 208 gjyqtarëve në çështje të veçanta gjatë vitit 2023 përbën gjithashtu një tregues të rëndësishëm të mobilitetit funksional brenda sistemit. Duke pasur parasysh se gjatë gjithë vitit 2023 vetëm 247 gjyqtarë ishin efektivisht në detyrë në të gjithë sistemin gjyqësor (nga 408 të parashikuar në strukturën organizative), kjo do të thotë se mbi 84% e trupës gjyqësore aktive u mobilizua, të paktën një herë gjatë vitit, për të gjykuar çështje në gjykata të tjera nga ajo ku ushtronin funksionin e tyre të përhershëm. Ky është një nivel lëvizshmërie që në kushte normale të veprimtarisë të gjykatave do të konsiderohej anormal, por në kushtet e zbatimit të Hartës së re gjyqësore dhe të numrit të kufizuar të gjyqtarëve efektivisht në detyrë (60.5% e organikës në nivel kombëtar), përbënte mekanizmin e domosdoshëm për të siguruar funksionimin e gjykatave të reja të konsoliduara.

Nëse viti 2023 ishte viti i veprimit në faza — viti kur reforma kaloi nga propozimi normativ në zbatim faktik — viti 2024 është viti i parë i konsolidimit institucional, kur

sistemi i ri filloi të prodhonte rezultatet e para të verifikueshme empirikisht. Sipas Raportit vjetor 2024 të KLGJ-së, miratuar me Vendimin nr. 232, datë 23.04.2025, sistemi gjyqësor shqiptar gjatë vitit 2024 ka treguar përmirësime në efikasitet, kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve dhe kapacitetin për të përballuar fluksin e lartë të çështjeve gjyqësore. Megjithatë, ky konsolidim ende është i pjesshëm: vakancat strukturore vazhdojnë të mbeten mbi 30%, backlog-u i përgjithshëm rritet në disa nivele, dhe disbalancat territoriale brenda strukturës së re shfaqen me intensitet të papritur.

Treguesi më i drejtpërdrejtë i konsolidimit institucional është rritja e gjyqtarëve efektivisht në detyrë: nga 247 në fund të 2023-it në 272 në fund të 2024-it, që përbën rritje prej 10,1%. Sipas Raportit Vjetor 2024 (faqe 33), kjo është rritja më e madhe vjetore, që nga fillimi i procesit të rivlerësimit kalimtar, dhe shfaq se sistemi tashmë po i përgjigjet pozitivisht emërimeve të reja të magistratëve. Konkretisht, kontribues kryesor në rritjen e numrit të gjyqtarëve efektivisht në detyrë kanë qenë emërimet e 32 magistratëve të rinj, që përfunduan programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magistraturës në vitin akademik 2023–2024²⁷³. Po ashtu, Raporti referon se nga viti 2019 në vitin 2024, numri i magistratëve të emëruar në sistem është 144, nga të cilët 4 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur dhe 140 magistratë të diplomuar nga Shkolla e Magistraturës. Megjithatë, vakancat mbeten të larta. Sipas Raportit Vjetor 2024, faqe 34, numri i vakancave në sistem për gjyqtarë është 136, nga të cilat 75 të përhershme (diferenca midis strukturës organizative dhe organikës në fakt) dhe 61 të përkohshme (diferenca midis organikës në fakt dhe efektivitetit në detyrë). Kjo do të thotë se, pavarësisht përmirësimit të dukshëm prej 6,6 pikë përqindjeje në kapacitetin operacional (nga 60,5% në fund të 2023-it në 66,6% në fund të 2024-it), sistemi gjyqësor shqiptar funksionon ende me afërsisht dy të tretat e kapacitetit nominal²⁷⁴. Faktorët kryesorë, që mbajnë vakancat e larta janë: vazhdimi i procesit të rivlerësimit kalimtar (24 vendimmarrje shkarkim me vendim KPA në 2024); 60 gjyqtarë me vendimmarrje shkarkimi nga KPK në pritje të KPA-së; 33 gjyqtarë të shkarkuar, që presin KPA në 2025; efekti financiar kumulativ prej 965.768.125 lekë i pagës 75% bruto fillestare gjatë periudhës së pezullimit.

Tabela 5. Evolucioni i organikës faktike të gjyqtarëve në fund të vitit 2024 sipas nivelit

Niveli i sistemit	Strukturë organizative	Organika në fakt 31.12.2024	Efektivisht në detyrë 31.12.2024	Krahasim me 2023
Gjykata e Lartë	19	18	17	Pa ndryshim
Gjykata e Apelit Juridik. të Përgj.	78	31	28	+3 (10,7%)
Gjykata Administrative e Apelit	13 (22 nga 09.10.2024)	7	13	+2 (delegim)

²⁷³Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 33: “numri i magistratëve të emëruar në sistem nga viti 2019 në vitin 2024 është 144 magistratë, nga të cilët 4 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur dhe 140 magistratë të diplomuar nga Shkolla e Magistraturës”.

²⁷⁴Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 34: “numri i vakancave në sistem, për gjyqtarë është 136 vakanca (nga të cilat 75 të përhershme dhe 61 vakanca të përkohshme)”. Vakanca e përhershme është diferenca e strukturës organizative me organikën në fakt; vakanca e përkohshme është diferenca e organikës në fakt me efektivitetin në detyrë.

Niveli i sistemit	Strukturë organizative	Organika në fakt 31.12.2024	Efektivisht në detyrë 31.12.2024	Krahasim me 2023
Gjykata e Posaçme Apel KKO	11	10	10	Pa ndryshim
Gjykata e Posaçme Shk.I KKO	16	11	11	+2 (22%)
Shkalla e parë jur. përgj. (13 gjykata)	242	234	160	+23 (16,8%)
Gjykatat administrative shk. parë (2)	36	31	20	Pa ndryshim
TOTALI	408 (417)	333	272	+25 (+10,1%)

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e Raportit vjetor të KLGJ-së për vitin 2024.

Tabela 5 zbulon se rritja prej 10,1% e organikës efektive nuk ka qenë e shpërndarë në mënyrë të barabartë: rritja më e madhe ka ndodhur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (nga 49 në 55 gjyqtarë) dhe në gjykata të tjera të shkallës së parë me ngarkesë të madhe (Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Kukës), që janë pikërisht gjykatat ku reforma kishte krijuar konsolidim më të madh territorial. Po ashtu, Gjykata Administrative e Apelit ka tashmë 13 gjyqtarë efektivisht në detyrë (nga 7 në organikë në fakt) — rritje që rezultoi nga skema e delegimit dhe nga ngritjet e detyrës. Megjithatë, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm vazhdon të funksionojë me afërsisht 1/3 e organikës nominale (28 nga 78), që mbetet kufizimi më serioz strukturor i konsolidimit.

Sipas Raportit Vjetor 2024 të KLGJ-së, faqe 34, raporti gjyqtarë/100 mijë banorë në Shqipëri shfaqet në tre nivele: 14,80 sipas strukturës organizative (dekreti); 12,05 sipas organikës në fakt; dhe 9,85 sipas organikës efektive në fakt — kundrejt mesatares evropiane CEPEJ prej 21,9 gjyqtarë/100 mijë banorë (sipas të dhënave të 2022, faqe 43 të Raportit CEPEJ 2024). Distanca midis nivelit efektiv shqiptar (9,85) dhe mesatares evropiane (21,9) është rreth 55%, që nënkupton se sistemi gjyqësor shqiptar funksionon me afërsisht gjysmën e burimeve njerëzore krahasuar me një vend evropian mesatar²⁷⁵. Pavarësisht përmirësimit të vogël krahasuar me 2023 (kur niveli efektiv ishte 9,67), distanca strukturore mbetet pothuajse e pandryshuar, që dëshmon se reforma e hartës — sado që është e ndërtuar racionalisht — nuk mund të zgjidhë vetë problemin themelor: numri absolut i gjyqtarëve, që Shqipëria ka në dispozicion është strukturalisht i pamjaftueshëm. Treguesi i raportit gjyqtarë/staf administrativ, ndërkohë, paraqet një paradoks me natyrë statistikore. Sipas strukturës organizative, raporti është 2,95 gjyqtar/staf — nën mesataren evropiane CEPEJ prej 4,12. Sipas organikës faktike, raporti rritet në 3,25 gjyqtar/staf. Por sipas organikës efektive, raporti del 3,98 gjyqtar/staf — pothuajse i barabartë me mesataren evropiane. Por kjo përbën një paradoks: rritja e

²⁷⁵Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 34, Tabela mbi raportin numër gjyqtarësh/100 mijë banorë: 14,80 sipas strukturës organizative; 12,05 sipas organikës në fakt; 9,85 sipas organikës efektive në fakt. Mesatarja sipas CEPEJ 2024 me të dhënat e vitit 2022, është 21,9 gjyqtar/100 mijë banorë (faqe 43 e Raportit CEPEJ 2024).

treguesit nuk është rezultat i shtimit të stafit, por i rënies së gjyqtarëve, që krijon iluzionin statistikor të “përmirësimit” ndërsa në realitet sistemi po funksionon nën kapacitetin nominal²⁷⁶. Ky është shembull klasik i rrisë statistikore, që duhet interpretuar me kujdes në kontekstin e analizës ligjore: numrat statistikorë, pa përcaktimin e domethënies së tyre kontekstuale, mund të prodhojnë konkluzione të kundërta me realitetin operacional.

Të dhënat empirike të vitit 2024, sipas Raportit Vjetor të KLGJ-së, dëshmojnë se konsolidimi institucional ka prodhuar rezultate të dukshme në gjykatat e nivelit më të lartë, të cilat janë pikërisht gjykatat që iu nënshtuan rikonfigurimit më të madh nga reforma e hartës (Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm) ose që janë pjesë e Strategjisë së Backlog-ut (Gjykata e Lartë, Gjykata Administrative e Apelit, gjykatat e Tiranës). Gjykata e Lartë është rasti më i suksesshëm i konsolidimit në vitin 2024. Sipas Raportit Vjetor 2024, faqe 66–68, kjo gjykatë e ka filluar vitin me një backlog prej 26.058 çështjesh, dhe e ka mbyllur me 20.888 çështje — ulje prej 5.170 çështjesh ose -19,8%. Kjo është ulja më e madhe e backlog-ut në historinë e Gjykatës së Lartë²⁷⁷. Treguesi WR ra nga 2.084,2 në 1.602,6 (-23%); numri i gjyqtarëve efektivë u rrit nga 16,3 në 17,8 (+9,2%); CR-ja kaloi pragu në 100% në të tre juridiksionet (CR civil 295,4%; CR administrativ 275,8%; CR penal 535,6% - tregues që dëshmojnë evadimin e backlog-ut të mbartur). Ky është rasti më i kthjellët i transformimit pozitiv: ku plotësimi i trupës gjyqësore (që në 2022 u plotësua me 19 anëtarë), i kombinuar me menaxhimin më efektiv të çështjeve, ka prodhuar rezultate substanciale brenda dy viteve.

Gjykata Administrative e Apelit është rasti më kompleks i analizës. Sipas Raportit Vjetor 2024, faqe 95–100, treguesit e efikasitetit u përmirësuan ndjeshëm: ER-ja u rrit me 21% (231,2 çështje për gjyqtar nga 191,1 në 2023); CR-ja u rrit nga 65% në 76,7% (përmirësim prej 18%); DT-ja ra nga 5.318,3 ditë në 3.275,5 ditë (-38,5%). Megjithatë, backlog-u u rrit nga 23.056 çështje në 23.862 çështje (+3,5%) — më pak se e pritura, por ende rritje. Kjo paradoks shpjegohet me 78% të çështjeve të reja, që vijnë si ankime nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe që dëshmon se backlog-u i kësaj gjykate është funksion i drejtpërdrejtë i ngarkesës së gjykatës më të madhe administrative të vendit²⁷⁸. Vendimi i KLGJ-së nr. 585/2024 për rritjen e numrit të gjyqtarëve të kësaj gjykate nga 13 në 22 është reagim i drejtpërdrejtë ndaj kësaj situate. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm — krijimi më spektakolar i reformës — është rasti më kontradiktor i konsolidimit. Sipas Raportit Vjetor 2024, faqe 88–94, treguesit e efikasitetit shfaqin përmirësim: ER 371,7 (rritje 9% nga 2023); CR civil 76% (rritje me 52% në vlerë absolute krahasuar me 2023 ku ishte 42,3%); CR penal 112,6% (rritje 2,2%); DT mesatare 1.545,2 ditë (rënie prej 7,7% nga 2023, dhe rënie prej 30% nga DT-ja e ish-Gjykatës së Apelit Tiranë në 2022, që ishte 2.216,5 ditë). Megjithatë, backlog-u u rrit me 4.038 çështje (+10,7%), nga 37.662 në 41.700 — që përbën nivelin më të lartë në historinë e gjykatave

²⁷⁶Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 34: “në lidhje me raportin midis gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore [...] me gjithë përmirësimet e viteve të fundit, sërish mbetet nën mesataren evropiane nëse i referohemi strukturës organizative. Kjo e dhënë rritet artificialisht mbi mesataren evropiane nëse i referohemi të dhënave faktike (që ndikohet ndjeshëm nga numri i ulët i gjyqtarëve në detyrë)”. Mesatarja CEPEJ: 4,12 gjyqtar/staf.

²⁷⁷Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 66–68, kapitulli 7.1 mbi Gjykatën e Lartë: backlog-u në fillim të vitit 26.058, në fund të vitit 20.888 (-19,8%). WR ra nga 2.084,2 në 1.602,6 (-23%); ER 429,2 (-11,6%); CR mbi 100% në të tre juridiksionet.

²⁷⁸Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 95–100, kapitulli 7.4 mbi Gjykatën Administrative të Apelit: “Rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) u rrit me 21% krahasuar me vitin 2023, ku çdo gjyqtar trajtoi mesatarisht 231,2 çështje për vitin 2024. [...] Norma e likuidimit të çështjeve (CR) ka arritur nivelin më të lartë në tre vitet e fundit, duke shënuar 76,7%. [...] Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (Treguesi DT) u ul me 38,5%, duke arritur në 3.275,5 ditë krahasuar me vitin paraardhës”.

të apelit shqiptare. Shpërndarja e backlog-ut: 67,4% janë çështje civile, 32,6% penale²⁷⁹. Faktori përcaktues është se gjykata funksionon me 28 gjyqtarë efektivisht në detyrë nga 78 të miratuar — pra me 35,9% të organikës nominale. Sipas vetë raportit (faqe 94), “organika e gjykatës funksionon me vetëm 1/3 e numrit të gjyqtarëve të miratuar”, që e bën të pamundur arritjen e CR-së mbi 100%.

Mosha e backlog-ut në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm tregon problematikën strukturore: 40% e *backlog*-ut (16.602 çështje) i përket çështjeve të regjistruara 3–5 vite më parë; 16% (6.803 çështje) i përket çështjeve të regjistruara 1–2 vite më parë; 10,2% (4.254 çështje) janë çështje me mbi 5 vjet pritjeje. Kjo profil dëshmon se shumica e *backlog*-ut nuk është i ri — ai është *backlog* i trashëguar nga gjykatat e paraardhëse të apelit, që pas reformës u konsoliduan në një gjykatë të vetme. Nga ana procedurale, ky është një konsolidim, por nga ana e qytetarit, që ende pret zgjidhjen e dosjes 5 vjet pas regjistrimit, është një ngarkesë e patolerueshme.

Gjykata e Posaçme e Apelit për korrupsionin dhe krimin e organizuar (GJKKO Apel) është modeli i suksesit: *backlog* i mbetur me 25 çështje në fund të vitit është i njëjtë me fillimin e vitit; DT mesatare 14,5 ditë (-50% nga 2023 ku ishte 30,7 ditë); 98,3% e çështjeve, të përfunduara brenda 6 muajve; ER 43,2 (rritje 46% nga 2023); CR 102,3%; 93% e vendimeve të shkallës së parë lënë në fuqi; mosprani çështjesh që zgjasin mbi 2 vjet²⁸⁰. Por ky sukses, pikërisht për shkak të strukturës specifike të gjykatës (kompetencë e ngushtë, nivel i lartë profesionalizimi, mbështetje politike dhe ndërkombëtare e veçantë), nuk përbën model të transferueshëm: çfarë funksionon në GJKKO si model nuk është i përsëritshëm në gjykatat e tjera për shkak të vëllimit shumë më të madh të çështjeve të tjera dhe natyrës më të kompleksuar të juridiksionit.

Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm — që pas reformës janë 13 në numër — paraqesin pamjen më të nuancuar të konsolidimit. Sipas Raportit Vjetor 2024, faqe 109–117, treguesi mesatar i WR-së ra nga 841,7 në 750 çështje për gjyqtar (-11%), që dëshmon shpërndarje më të mirë territoriale të ngarkesës. ER-ja mesatare u shfaq në 516 çështje për gjyqtar (rënie 5,7% nga 547 në 2023). CR-ja për çështjet civile arriti nivelin 103% mesatarisht — duke kaluar pragun 100% për herë të parë. *Backlog*-u total u rrit nga 41.748 në 46.272 (+10,8%)²⁸¹, që dëshmon se ende ka presion strukturor në këtë nivel të sistemit.

Disbalanca brenda strukturës së re post-reformë mbetet domethënëse, ndonëse më e zbutur sesa para reformës. Të dhënat e WR-së për gjykatat individuale (Raporti Vjetor 2024, faqe 112) tregojnë: Gjirokastra 1010 çështje; Tirana 1005,9; Elbasani 1001,4; Durrësi 991,5; Berati 961,2; Lezha 735; Shkodra 722,7; Fieri 674,5; Sarandë 614,6; Korça 613,3; Vlora 603,9; Dibra 418,4; Kukësi 396. Disbalanca maksimum/minimum brenda strukturës post-reformë është rreth 2,5x (Gjirokastra/Kukësi), që është dukshëm më e ulët se 10,2x e

²⁷⁹Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 88–94, kapitulli 7.3 mbi Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm: “Në fund të vitit 2024, backlog-u ka arritur në 41.700 çështje, me një rritje prej 10,7% ose 4.038 çështje më shumë se një vit më parë”. WR 2024: 1.945,3; ER 2024: 371,7 (rritje 9% nga 2023); CR civile 76% (rritje 52%); CR penale 112,6% (rritje 2,2%).

²⁸⁰Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 73–79, kapitulli 7.2.1 mbi GJKKO Apel: “Rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) u rrit me 46%, ku çdo gjyqtar trajtoi mesatarisht 43,2 çështje, krahasuar me 29,7 çështje në vitin 2023. [...] Koha mesatare për evadimin e një çështjeje (Treguesi DT) u ul me 50%, nga 30,7 ditë në vitin 2023 në 14,5 ditë në vitin 2024. [...] 98,3% e çështjeve u përfunduan brenda 6 muajve”.

²⁸¹Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 109–117, kapitulli 7.6 mbi gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm: “ngarkesa mesatare e punës në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm është rreth 750 çështje për gjyqtar, duke shënuar një rënie prej 92 çështjesh ose rreth 11% krahasuar me vitin 2023, kur kjo vlerë ishte mesatarisht 841,7 çështje për gjyqtar”. Backlog-u i përgjithshëm: 46.272 (rritje 10,8%).

regjistruar në 2021 për gjykatat e apelit para reformës. Megjithatë, mbetet e qartë se procesi i ekuilibrit territorial nuk ka përfunduar: gjykatat e Beratit dhe të Gjirokastrës kanë rritje të WR-së në 2024 krahasuar me 2023 (+35% dhe +13,8%, respektivisht), që dëshmon se reforma ende po prodhon dinamikë të riekuilibrit.

Gjykatat administrative të shkallës së parë (Tirana dhe Lushnja, sipas hartës së re) paraqesin arritjen historike më të rëndësishme në vitin 2024. Sipas Raportit Vjetor 2024, faqe 101–108, për herë të parë në historinë post-reformë, CR-ja kaloi pragun e 100%. Konkretisht, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, CR-ja u rrit me 13% krahasuar me vitin paraardhës; në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, CR-ja u përmirësua me 14,8%. Treguesi DT u ul në 199 ditë në Tiranë (përmirësim 8,4%) dhe 247 ditë në Lushnjë (përmirësim 15,4%) — që dëshmon se këto gjykata po e respektojnë kufirin ligjor të 365 ditëve të gjykimit brenda një viti²⁸². Kjo është dëshmia më e qartë e suksesit të Strategjisë së *Backlog*-ut 2024–2027 në veprim të parë.

Megjithatë, peisazhi i gjykatave administrative të shkallës së parë mbart edhe një paradoks. Numri mesatar i gjyqtarëve efektivë u reduktua nga 23,5 në 2023 në 19,2 në 2024, që rezultoi në rritje të WR-së mesatare me 23% (në 1.074 çështje për gjyqtar). Kjo do të thotë se përmirësimi i CR-së dhe DT-së u arrit pavarësisht uljes së trupës gjyqësore — pra rezultati është funksion i rritjes së ER-së për gjyqtar (rritje 40% në Tiranë, ose 936,7 çështje për gjyqtar), që mbart kosto operacionale të mundshme në cilësinë e vendimmarrjes. Sipas vetë analizës së KLGJ-së: “nëse numri i gjyqtarëve do të kishte mbetur i pandryshuar dhe ritmi i gjykimeve do të ishte i njëjtë, atëherë krahas përfundimit të çështjeve të reja, *backlog*-u do të mund të ishte reduktuar me 30–35%”²⁸³ — që dëshmon se potenciali i sistemit, me investimet e duhura, është dukshëm më i madh se rezultati aktual.

KLGJ-ja vazhdoi të mbajë ritmin e lartë të vendimmarrjes në vitin 2024, megjithë ndryshimet drejtuese: 65 mbledhje plenare (krahasuar me 80 në 2023, por mbi 75 mesatare e periudhës 2018–2022); 763–764 vendime totale (rritje 3% krahasuar me 743 të 2023-it). Struktura e vendimeve është 9 akte nënligjore, 190 akte kolektive, 51 akte rregulla të brendshme, 513 akte individuale, 1 udhëzim. Ndarja sipas komisioneve të përhershme: 110 nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit; 84 nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale; 530 nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës; 34 nga Komisioni Disiplinor.

Tabela 6. Krahasimi i veprimtarisë vendimmarrëse të KLGJ-së për vitet 2023 dhe 2024 (i saktësuar — duke dalluar numrin e akteve nga numri faktik i gjyqtarëve të prekur)

²⁸²Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 101–108, kapitulli 7.5 mbi gjykatat administrative të shkallës së parë: “Në vitin 2024, gjykatat administrative të shkallës së parë kanë arritur një normë të likuidimit të çështjeve mbi 100% [...] Treguesi DT në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është në vlerën e 199 ditëve [...] Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, është në vlerën e 247 ditëve”. Sipas raportit (faqe 9), kjo është “për herë të parë pas disa vitesh” arritja e CR-së mbi 100%.

²⁸³Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 105: “Analiza tregon se, nëse numri i gjyqtarëve do të kishte mbetur i pandryshuar dhe ritmi i gjykimeve do të ishte i njëjtë, atëherë krahas përfundimit të çështjeve të reja, *backlog*-u do të mund të ishte reduktuar me 30–35%”.

Kategoria	Viti 2023	Viti 2024	Ndryshimi
Mbledhje plenare	80	65	-18.8%
Totali i vendimeve	743	764*	+2.8%
Akte nënligjore (strikt)	27	9	-66.7%
Akte rregulla të brendshme	47	51	+8.5%
Akte individuale	506	513	+1.4%
Akte kolektive	162	190	+17.3%
Udhëzime	1	1	Stabilizim
Emërime magjistratësh të rinj (faktike)	41 magjistratë	32 magjistratë	-22.0%
Transferime të përkohshme (gjyqtarë faktikë)	14 gjyqtarë	21 gjyqtarë	+50.0%
Transferime të përhershme për shkak të suprimimit (gjyqtarë faktikë)	8 gjyqtarë	6 gjyqtarë	-25.0%
Lëvizje paralele (gjyqtarë faktikë)	11 gjyqtarë	të dhëna jo të specifikuara në raport	—
Skema e delegimit (gjyqtarë faktikë)	5 gjyqtarë	2 gjyqtarë	-60.0%
Caktime në çështje të veçanta (gjyqtarë faktikë)	208 gjyqtarë	66 gjyqtarë	-68.3%
Procedime disiplinore të reja	4 (+ 2 të mbartura)	7 (+ 5 të mbartura)	+75.0%
Ngritje në detyrë (gjyqtarë faktikë)	11 gjyqtarë	4 gjyqtarë	-63.6%

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e Raporteve Vjetore të KLGJ-së për vitet 2023 dhe 2024.

Krahasimi i të dhënave të dy viteve nxjerr në pah disa tendenca domethënëse. Mbledhjet plenare janë reduktuar me 18.8% (nga 80 në 65), ndërkohë që numri total i vendimeve është rritur me 2.8% (nga 743 në 764), duke treguar një intensifikim të produktivitetit për mbledhje. Emërimet e magjistratëve të rinj kanë rënë me 22% (nga 41

në 32 magjistratë), duke reflektuar një kapacitet më të kufizuar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2023–2024. Caktimet e gjytareve në çështje të veçanta kanë pësuar rënie të ndjeshme (-68.3%, nga 208 në 66 gjyqtarë), çka tregon stabilizimin e funksionimit të gjykatave të reja pas vitit të parë të zbatimit të Hartës së re gjyqësore. Ngritjet në detyrë kanë rënë nga 11 gjyqtarë në 2023 në 4 në 2024 (-63.6%), por kjo nuk reflekton domosdoshmërisht zvogëlim të nevojave, përkundrazi, një faktor është dhe ndryshmi i përbërjes së KLGJ; Raporti Vjetor 2024 sqaron se KZHK-ja ka propozuar 143 akte në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë gjatë vitit, çka tregon se shumë procedura janë në vijim. Përkundrazi, transferimet e përkohshme kanë pasur rritje 50% (nga 14 në 21 gjyqtarë), duke konfirmuar se KLGJ vijon t'u përgjigjet vakancave përmes mekanizmave të mobilitetit afatshkurtër.

Buxheti i miratuar i sistemit gjyqësor për vitin 2024 ishte 4.967.459 mijë lekë, krahasuar me 4.362.600 mijë lekë në 2023 (rritje 13,9%) dhe me 3.444.200 mijë lekë në 2021 (rritje kumulative 44,2% në katër vjet). Sipas Raportit Vjetor 2024, faqe 38–47, buxheti për gjyqësorin u realizua me 96% (4.664.155 mijë lekë). Pesha specifike e buxhetit: 91,99% për Gjykatat (Programi 03310 “Buxheti Gjyqësor”); 7,67% për KLGJ (Programi 01110); 0,34% për QTI (Programi 01140). Struktura sipas grupshpenzimeve: 78% për paga, 14% për mallra dhe shërbime, 9% për sigurime shoqërore, 8% për shpenzime kapitale²⁸⁴. Krahasuar me standardet evropiane, buxheti shqiptar mbetet ende në fundin e graduarisë: 17,5 euro për banor në vitin 2024, krahasuar me mesataren prej 28,3 euro/banor për vendet evropiane me PBB nën 10.000 euro/banor (Raporti CEPEJ 2024). Distanca është rreth 38%, pra për të arritur mesataren evropiane do duhej rritje buxhetore prej afërsisht 60%. Ky është një kufizim strukturor që harta e re gjyqësore nuk mund ta zgjidhë vetëm — ai kërkon vendim politik të Kuvendit dhe të qeverisë për shpërndarje më të madhe të burimeve buxhetore. Megjithatë, është e rëndësishme të konstatohet se rritja prej 13,9% e buxhetit në 2024 përfshin: rritjen e pagave për gjyqtarët (efekt i VKM 421/2024 dhe i vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35/2022); investimin në infrastrukturën elektronike dhe Sistemin e Ri ICMIS; rritjen e numrit të personelit administrativ²⁸⁵. Pra, edhe pa zgjidhjen e plotë të distancës evropiane, viti 2024 dëshmon investim institucional konkret në konsolidimin e reformës.

2.4.3 Efektet mbi funksionimin e gjykatave dhe raporti midis hartës, organikës dhe backlog-ut

Vlerësimi i impaktit të reformës së hartës gjyqësore kërkon analizë krahasuese minimalisht 3 vjet nga plotësimi i organikave të gjykatave. Megjithatë, po tentojmë ta bëjmë në dy vitet e para të zbatimit. Viti 2023 ofroi dëshminë e parë empirike të efekteve fillestare të reformës; viti 2024 ofron dëshminë e parë të konsolidimit, ku rezultatet maturohen dhe sfidat strukturore bëhen më të dukshme. Analiza, që vijon, strukturohet mbi

²⁸⁴Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 38–47, kapitulli 4 mbi Veprimtarinë Buxhetore dhe Financiare: “Fondet buxhetore të miratuara, për sistemin gjyqësor, janë rritur në mënyrë të vazhdueshme nga viti në vit, duke filluar nga viti 2020 [...] Buxheti i miratuar për vitin 2024 është afërsisht 17,5 euro/banor, ndërkohë që mesatarja e vendeve të Evropës është 28,3 euro/banor, për vende me PBB më të vogël se 10.000 euro/banor”.

²⁸⁵Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 38–40: rritja e buxhetit në 2024 me 13,9% (4.967.459 mijë lekë vs 4.362.600 mijë lekë në 2023) reflekton: (a) ndryshimet në legjislacionin e pagave për gjyqtarët dhe administratën gjyqësore (efekt i VKM nr. 421, datë 26.6.2024 dhe i Vendimit nr. 35, datë 22.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese); (b) implementimi i Hartës së Re Gjyqësore; (c) përmirësimi i infrastrukturës elektronike; (d) implementimi i sistemeve të reja software.

gjashtë dimensione të identifikuara në kapitullin paraardhës, por tashmë me të dhëna të dyvjeçarit 2023–2024.

Efekti më i drejtpërdrejtë dhe i matshëm i reformës — i konfirmuar fuqishëm nga të dhënat e vitit 2024 — është ekuilibrimi territorial i strukturës. Pas zbatimit të të treja fazave, sistemi gjyqësor shqiptar tashmë funksionon mbi bazën e një logjike racionale të shpërndarjes të burimeve sipas vëllimit të punës dhe popullsisë, jo sipas kufijve administrativë, të trashëguar nga viti 2012. Konkretisht, gjykata e re e shkallës së parë e Tiranës mbulon territorin e ish-3 gjykatave (Tiranë + Krujë + Kavajë) me 80 pozicione organizative dhe 55 gjyqtarë efektivisht në detyrë në fund të 2024-it (rritje nga 49 në fund të 2023-it). E njëjta logjikë vlen për Durrësin, Lezhën, Kukësin etj.

Konfirmimi më i fortë empirik i suksesit të ekuilibrit territorial në vitin 2024 është ulja e disbalancës maksimum/minimum nga 10,2x e gjykatave të apelit në 2021 në afërsisht 2,5x të gjykatave të shkallës së parë në 2024 (Gjirokastra 1.010 vs Kukësi 396). Ndonëse disbalancat brenda strukturës post-reformë mbeten — disa gjykata si Berati dhe Gjirokastra paraqesin rritje WR-je në 2024 — ato janë në kufijtë e variabilitetit të natyrshëm dhe nuk kanë karakter strukturor si para reformës. Po ashtu, ulja drastike e caktimeve në çështje të veçanta (-68% në 2024 krahasuar me 2023) dëshmon se sistemi nuk varet më nga skemat *ad hoc* për funksionim normal.

Vlerësimi kritik për reformën — që ajo e zhvendosi *backlog*-un, por nuk e zgjidhi atë — duhet rikuptuar në dritën e të dhënave të vitit 2024. Tendenca e thjeshtë e rritjes së *backlog*-ut, që karakterizoi 2023-in u diversifikua në 2024: disa gjykata e ulën *backlog*-un në mënyrë të ndjeshme, ndërsa të tjerat e rritën. Sipas Raportit Vjetor 2024, faqe 67, Gjykata e Lartë e uli *backlog*-un me 19,8% (nga 26.058 në 20.888 çështje); Gjykata e posaçme e apelit KKO e mbajti në 25 çështje (zerifikim virtual); Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e uli për herë të parë në historinë e saj *backlog*-un (CR mbi 100%)²⁸⁶. Megjithatë, Gjykata e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm e rriti *backlog*-un nga 37.662 në 41.700 (+10,7%); Gjykata Administrative e Apelit e rriti me 3,5% (nga 23.056 në 23.862); gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm e rritën me 10,8% (nga 41.748 në 46.272).

Kjo strukturim i diversifikuar i *backlog*-ut në 2024 dëshmon dy fenomene të ndryshme. Së pari, gjykatat, ku organika është plotësuar, (Gjykata e Lartë me 17 gjyqtarë efektivisht në detyrë; GJKKO Apel me 10 plotë; gjykatat administrative të shkallës së parë me 19,2 mesatare) kanë arritur të kthejnë rritjen e *backlog*-ut në ulje të tij. Së dyti, gjykatat, ku organika mbetet thellësisht e cunguar, (Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me 28 nga 78; Gjykata Administrative e Apelit me 13 nga 13/22; Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me 55 nga 80) vazhdojnë të mbajnë rritjen e *backlog*-ut. Pra, korrelacioni është i qartë: *backlog*-u funksion nga organika, jo nga strukturë territoriale. Reforma e hartës ka krijuar kornizën më të mirë organizative; ajo që mungon është investimi i duhur në burime njerëzore.

Treguesi WR (workload) shfaq në vitin 2024 një evolucion pozitiv të diferencuar. Sipas Raportit vjetor 2024 të KLGJ (faqe 112), për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, WR-ja mesatare ra nga 841,7 në 750 çështje për gjyqtar (-11%). Për Gjykatën e Lartë, WR-ja ra nga 2.084,2 në 1.602,6 (-23%). Përkundrazi, për

²⁸⁶Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 67 (Gjykata e Lartë), 92 (Apel Juridiksioni i Përgjithshëm), 99 (Apel Administrativ), 110 (Shkalla e Parë Juridiksioni i Përgjithshëm). Sintezë krahasuese e *backlog*-ut: Gjykata e Lartë 26.058 → 20.888 (-19,8%); Apel Jurid. Përgj. 37.662 → 41.700 (+10,7%); Apel Admin. 23.056 → 23.862 (+3,5%); Shkalla e parë jurid. përgj. 41.748 → 46.272 (+10,8%).

Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm, WR-ja u rrit me 2,2% (nga 1.903,6 në 1.945,3); për Gjykatën Administrative të Apelit, ER-ja u rrit me 21% (rritje e ngarkesës efektive); për gjykatat administrative të shkallës së parë, WR-ja u rrit me 23% (në 1.074 çështje për gjyqtar)²⁸⁷.

Mesatarja vjetore e ngarkesës për gjyqtar prej 841 çështje në vitin 2023 ra në afërsisht 800 çështje në vitin 2024 — që mbetet 4–5 herë mbi normën referuese të KLD-së prej 150–200 çështje. Strategjia e *backlog*-ut 2024–2027 propozon rritje të produktivitetit me 50% deri në 2029, që do të çonte në një ngarkesë rreth 1.200 çështje për gjyqtar. Ky është një objektiv ambicioze që, ndonëse arrihet, do të mbante sistemin në një nivel ngarkese rreth 6 herë mbi normën zyrtare. Pra, duke qenë se normat zyrtare ende nuk janë rishikuar, situata e fluiditetit normativ përbën ende një sfidë juridike substanciale.

Stresi infrastrukturor që karakterizoi 2023-in vazhdoi në vitin 2024, por me një zbutje të dukshme në fund të vitit. Sipas Raportit vjetor 2024, faqe 48–55, viti raportues prodhoi finalizimin e mbështetjes financiare për Sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMIS i ri), pas përpjekjeve disa-vjeçare të KLGJ-së për sigurimin e fondeve²⁸⁸. Sistemi i ri ICMIS, që do të zëvendësojë sistemin ekzistues të vitit 2014, do të mundësojë: shkëmbimin elektronik të dokumenteve midis gjykatave; menaxhimin e diferencuar të çështjeve sipas natyrës dhe prioritetit; ndarjen automatike me short të çështjeve; dhe integrimin me sistemet e tjera të drejtësisë (Prokuroria, ILD etj.). Ky është një investim me natyrë strategjike, që pritet të prodhojë efektet e tij më të mëdha gjatë periudhës 2026–2028. Përveç ICMIS-it, viti 2024 dëshmoi, gjithashtu, krijimin e Ekipeve për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura (NUNÇP) pranë gjykatave të apelit (5 nëpunës pranë secilës) që, sipas Raportit Vjetor 2024 (faqe 57), përpunuan $1.146 + 941 = 2.087$ dosje gjyqësore deri në fund të 2024. Kjo masë administrative përbën një inovacion organizativ në kontekstin shqiptar — krijimin e “magjistratëve auxiliare” që, ndonëse nuk gjykojnë vetë, kryejnë përgatitjen paraprake të çështjeve, duke i lejuar trupave gjyqësore të fokusohen tek vendimmarrja substanciale. Po ashtu, infrastruktura fizike e Gjykatës së Apelit të juridiksionit të përgjithshëm mbetet sfidë: sipas analizës së vetë gjykatës, vetëm 7 salla gjyqi në një raport prej 5,7 gjyqtarë për sallë janë të papërshtatura për volumnin e ri të çështjeve, dhe nevoja për infrastrukturë të re mbetet prioritet.

2.4.4 Qasja (Aksesi) në drejtësi, kontrolli kushtetues dhe vlerësimi krahasimor i reformës

Dimensioni më i ndjeshëm dhe më i kontestuar i reformës së hartës gjyqësore, ishte ai i ndikimit mbi aksesin gjeografik dhe substancial të qytetarëve në drejtësi, mbeti një çështje qendrore e debatit kushtetues edhe gjatë vitit 2023. Zbatimi i hartës së re prodhoi gjithashtu rezistencë institucionale. Më 16 nëntor 2023 në Gjykatën Kushtetuese nisi shqyrtimi i kërkesës së Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë për shfuqizimin e VKM-së 495/2022. KLGJ-ja dhe Avokatura e Shtetit kundërshtuan, duke argumentuar se reforma përmbushte standardet kushtetuese të aksesit substancial në drejtësi²⁸⁹. Më 8 dhjetor 2023, Gjykata Kushtetuese mbylli marrjen e provave. Çështja u iniciua nga Dhoma e Avokatisë

²⁸⁷Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 112 (Tabela WR për gjykatat e shkallës së parë), faqe 68 (Gjykata e Lartë WR), faqe 90 (Apel Juridiksioni i Përgjithshëm WR), faqe 103 (gjykatat administrative të shkallës së parë WR).

²⁸⁸Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së, faqe 48–55, kapitulli 5 mbi Digjitalizimin: “Finalizimi i përpjekjeve disa vjeçare të Këshillit, për garantimin e mbështetjes financiare për krijimin dhe funksionimin e Sistemit të Ri të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS i ri)”. Po ashtu, kapitulli 6, faqe 57: krijimi i ekipeve NUNÇP nga shtatori 2024 me 5 nëpunës pranë secilës gjykatë apeli.

²⁸⁹Procesi gjyqësor kushtetues u nis me kërkesën e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, datë 16.11.2023. Marrja e provave u mbyll më 8 dhjetor 2023.

së Shqipërisë dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, të cilët pretenduan se harta e re gjyqësore cenonte lirinë e veprimtarisë ekonomike, parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe të drejtën e aksesit në gjykatë, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor. Ata argumentuan se harta cenonte aksesin në drejtësi sipas nenit 42 të Kushtetutës. Për dokumentimin e këtij argumenti, ata paraqitën raportin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, që theksonte rritje të tarifave të avokatisë me 50–200% për qytetarët, për shkak të kostos së shtuar të transportit drejt selive të reja gjyqësore. Gjykata Kushtetuese, me Vendimin nr. 70, datë 27.12.2023, me shumicë votash, rrëzoi kërkesën, duke vlerësuar se riorganizimi territorial i gjykatave ndiqte një qëllim legjitim publik, të lidhur me rritjen e eficiencës, racionalizimin e burimeve njerëzore, përmirësimin e funksionalitetit të gjykatave dhe krijimin e kushteve për një administrim më të qëndrueshëm të sistemit gjyqësor. Në këtë arsyetim, Gjykata nuk e reduktoi aksesin në drejtësi vetëm në afërsinë fizike të qytetarit me ndërtesën e gjykatës, por e trajtoi atë në një kuptim më funksional, duke e lidhur edhe me aftësinë reale të sistemit për të ofruar gjykim brenda afateve të arsyeshme, cilësi shërbimi, specializim institucional dhe menaxhim më efektiv të çështjeve.

Megjithatë, rëndësia e këtij vendimi nuk qëndron vetëm te rezultati përfundimtar, por edhe te pluraliteti i arsyetimeve kushtetuese, që e shoqërojnë atë. Krahas qëndrimit të shumicës, vendimi përmban edhe një mendim paralel dhe dy mendime pakice, të cilat pasurojnë debatin mbi kufijtë kushtetues të reformave organizative në gjyqësor. Në mendimin paralel, gjyqtari Ilir Toska nuk kundërshton përfundimin e rrëzimit të kërkesës, por e mbështet atë mbi një bazë tjetër: sipas tij, Gjykata Kushtetuese nuk duhej të hynte në themelin e çështjes, pasi VKM-ja nr. 495/2022 nuk kishte natyrë normative, por karakter individual dhe shterues, duke rregulluar një situatë konkrete organizative. Për rrjedhojë, sipas këtij qëndrimi, akti nuk hynte në juridiksionin kushtetues të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “c”, i Kushtetutës. Ky arsyetim është i rëndësishëm për analizën doktorale, sepse ngre çështjen e natyrës juridike të akteve, që riorganizojnë territorialisht sistemin gjyqësor dhe të kufijve të kontrollit kushtetues mbi to.

Nga ana tjetër, mendimi i pakicës i gjyqtarës Marsida Xhaferllari vendos në qendër të analizës parimin e proporcionalitetit në raport me të drejtën e aksesit në gjykatë. Sipas këtij qëndrimi, shumica nuk kishte vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme pasojat konkrete, që riorganizimi territorial sillte për qytetarët, veçanërisht në qytetet ku gjykatat u shkrinë ose u zhvendosën. Pakica thekson se rritja e distancës, kostove të transportit, shpenzimeve të përfaqësimit dhe vështirësive praktike të paraqitjes në gjykatë mund të cenojë jo vetëm aksesin formal, por edhe aksesin substancial në drejtësi. Në këtë këndvështrim, masa e zgjedhur nuk rezultonte plotësisht proporcionale, veçanërisht për shkak të mungesës së një balancimi më të kujdesshëm ndërmjet interesit publik për eficiencë dhe barrës konkrete që u vendosej qytetarëve. Megjithatë, ky mendim pakice nuk propozonte domosdoshmërisht shfuqizimin e menjëhershëm të hartës, për të shmangur pasoja më të rënda organizative, por sugjeronte konstatimin e cenimit kushtetues dhe detyrimin e organeve përgjegjëse për rishikimin e hartës brenda një afati të arsyeshëm.

Më i gjerë në përfundimet e tij është mendimi i pakicës i gjyqtarës Sonila Bejtja, sipas të cilit kërkesa duhej të ishte pranuar tërësisht. Ky mendim vlerëson se VKM-ja nr. 495/2022 cenonte jo vetëm të drejtën e aksesit të qytetarëve në gjykatë, por edhe lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe parimin e barazisë së avokatëve, veçanërisht të atyre, që ushtrojnë profesionin në qytetet ku gjykatat u mbyllën. Sipas këtij qëndrimi, harta gjyqësore e re kishte vendosur një barrë të tepruar dhe joproporcionale mbi përdoruesit e

sistemit dhe mbi një kategori të caktuar profesionistësh të së drejtës, pa provuar në mënyrë bindëse se ishin shqyrtuar alternativa më pak kufizuese. Ky mendim e sheh reformën jo si një balancim të suksesshëm ndërmjet eficientës dhe aksesit, por si një ndërhyrje që, në përpjekje për të zgjidhur një situatë të përkohshme të mungesës së gjyqtarëve dhe vështirësive të menaxhimit institucional, ka krijuar pasoja të rënda mbi ushtrimin efektiv të të drejtave kushtetuese.

Në këtë kuptim, vendimi nr. 70/2023 duhet të lexohet si një precedent i rëndësishëm për mënyrën se si kontrolli kushtetues vlerëson reformat organizative në gjyqësor. Shumica konfirmon legjitimitetin kushtetues të hartës gjyqësore si instrument i politikës publike gjyqësore, për sa kohë ajo synon eficientë, racionalizim burimesh dhe përmirësim të administrimit të drejtësisë. Ndërkohë, mendimet e pakicës evidentojnë se eficienta institucionale nuk mund të shërbejë si argument i vetëm dhe i mjaftueshëm për të justifikuar kufizime të ndjeshme të aksesit në gjykatë, nëse nuk shoqërohet me analizë të plotë empirike mbi distancën, kostot, transportin publik, gjendjen ekonomike të qytetarëve, ndikimin mbi avokatinë lokale dhe alternativat më pak kufizuese. Për këtë arsye, në analizën doktorale, ky vendim mund të përdoret për të argumentuar se reforma e hartës gjyqësore nuk duhet të vlerësohet vetëm në raport me numrin e gjykatave të mbyllura ose të bashkuara, por mbi bazën e efektit real që prodhon mbi aksesin substancial në drejtësi, shpërndarjen e ngarkesës gjyqësore, cilësinë e shërbimit, eficientën institucionale dhe mekanizmat korrigjues që ligji nr. 98/2016 i njeh KLGJ-së për rishikimin periodik të organizimit gjyqësor.

KLGG-ja, ndërkohë, ndërmori dy iniciativa kompensuese: së pari, intensifikoi transferimet e përkohshme dhe caktimet në çështje të veçanta për të garantuar prezencën gjyqësore në territoret e largëta. Megjithatë, deri në fund të vitit 2024, asnjë degë e tillë nuk ishte krijuar zyrtarisht — gjë, që përbën një boshllëk operacional të vazhduar.

Të dhënat empirike të vitit 2024 ofrojnë argumente të dyfishta në lidhje me kontekstin kushtetues. Nga njëra anë, përmirësimi i CR-së dhe DT-së në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë (që mbulon tani Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Lezhë dhe Korçë) dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë (Berat, Fier, Gjirokastrë, Sarandë, Vlorë) dëshmojnë se aksesit substancial në drejtësi është rritur — qytetarët marrin vendime më shpejt. Nga ana tjetër, aksesit fizik mbeti i kufizuar — qytetarët e rretheve të prekura kanë vazhduar të udhëtojnë drejt selive të reja.

Uniformizimi i jurisprudencës — që në 2023 ishte vlerësuar si efekt strukturalisht pozitiv por jo i realizuar plotësisht. Me krijimin e një Gjykate të vetme Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm efekti i plotë i uniformizimit jurisprudencial pritet të vihet re vetëm pas evadimit të *backlog*-ut të mbartur (afërsisht 41.700 çështje në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm), që sipas projeksioneve të KLGJ-së mund të zgjasë deri në 2027–2028. Deri atëherë, gjykata do të vazhdojë të aplikojë praktikë gjyqësore të dyfishtë: praktikë e re uniforme për çështjet pas-2023, dhe praktikë e mbartur për çështjet pre-reformë. Ky është një kompleksitet procedural, që përbën një kosto të përkohshme të reformës, por jo një cenim strukturor.

Sfida më serioze, që dëshmoi viti 2023, ishte paaftësia institucionale për të plotësuar organikën efektive të gjyqtarëve — një sfidë, që vazhdoi me intensitet të reduktuar gjatë 2024-it. Vakanca prej 39% (160 gjyqtarë mungues nga 408 nominale) u ul në 33% në fund të 2024-it (136 vakanca, prej të cilave 75 të përhershme dhe 61 të

përkohshme). Pavarësisht përmirësimit prej 6 përqind, vakancat strukturore mbeten të larta, gjë që dëshmon karakterin afatgjatë të problemit. Faktorët që e mbajnë vakancën janë: (i) procesi i rivlerësimit kalimtar, që ende nuk ka përfunduar tërësisht — 24 vendimmarrje shkarkim me vendim KPA në 2024, 60 gjyqtarë me vendimmarrje shkarkim nga KPK në pritje të KPA-së në 2024, 33 të tjerë në pritje të KPA-së për 2025; (ii) prodhimi i kufizuar i Shkollës së Magjistraturës — 32 magjistratë në vitin akademik 2023–2024, 20 kuota për vitin 2024–2025²⁹⁰; (iii) procedurat e gjata të emërimit, ankimet në gjykatë për këto procedura; dhe (iv) standartet e larta të integritetit. Kjo sfidë ka karakter strukturor dhe nuk mund të zgjidhet thjesht përmes përsheptimit të procedurave administrative. Në vitin 2024, qasja e KLGJ-së ndaj *backlog*-ut nuk u kufizua vetëm në konstatimin e problematikës, por u shoqërua me masa institucionale dhe propozime konkrete me karakter strukturor. Kjo përgjigje ishte e dyfishtë: nga njëra anë, rritja e kapaciteteve njerëzore të sistemit gjyqësor, përmes shtimit të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve nga 408 në 417 sipas Vendimit nr. 585/2024; dhe nga ana tjetër, forcimi i mbështetjes profesionale për gjyqtarët, përmes propozimeve për ndryshime ligjore, që parashikojnë rritjen e numrit të ndihmësve ligjorë deri në dy ndihmës për çdo gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Krahas kësaj, rëndësi të veçantë kanë edhe propozimet për thjeshtimin e procedurave të rekrutimit të ndihmësve ligjorë, si dhe ndërhyrjet e propozuara në kodet procedurale, të cilat synojnë lehtësimin e ngarkesës procedurale, përsheptimin e gjykimit dhe krijimin e një mekanizmi më efektiv për uljen e çështjeve të prapambetura. Në këtë këndvështrim, masat e propozuara përbëjnë një përpjekje për ta trajtuar *backlog*-un jo vetëm si çështje numerike, por si problem të lidhur me organizimin, burimet njerëzore dhe efikasitetin e procedurave të gjykatave. Po ashtu, miratimi i Planit Strategjik 2024–2025 për trajnimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësve civilë gjyqësorë (Vendimi nr. 223/2024) dhe Rregullores për formimin profesional (Vendimi nr. 224/2024) përforcojnë sistemin e shërbimit civil gjyqësor, që është mbështetja kryesore strukturore e trupës gjyqësore.

Gjithashtu, viti 2024 prodhoi disa hapa drejt përgjigjes ndaj kësaj sfide. Sipas Raportit Vjetor 2024 (faqe 27), KLGJ-ja ndërmori iniciativën për rishikimin e standardeve minimale kohore dhe sasiore, duke ngritur me Urdhrin nr. 52, datë 27.11.2024 të Kryetarit të Këshillit një grup pune, që u angazhua në hartimin e akteve përkatëse. Veprimtaria e këtij grupi pune pritej të finalizohet brenda marsit të vitit 2025. Kjo dëshmon se vakuumi normativ është në proces zgjidhjeje, ndonëse jo i zgjidhur ende. Strategjia e *backlog*-ut gjatë periudhës 2024–2027 ndërmjet kohës propozon të marrë si bazë mesataren aktuale për kategori të ndryshme çështjesh — që është një zgjidhje pragmatike por jo plotësisht në përputhje me parimet e cilësisë së vendimmarrjes.

Pra, deri në fund të vitit 2024, administrimi i ngarkesës së gjyqtarëve vijonte të mbështetej kryesisht në standarde të mëparshme, të cilat nuk reflektonin më plotësisht realitetin funksional të gjykatave dhe volumin e lartë të çështjeve. Në këtë kontekst, grupi i punës i Strategjisë, i propozoi për miratim KLGJ vendimin “Për përcaktimin e afateve standarde minimale kohore dhe standardeve minimale sasiore për gjykimin e çështjeve”²⁹¹.

²⁹⁰Sipas raportit të KSHH-së për vitin 2023, faqe 17: “rritja e kuotave dhe rekrutimi i magjistratëve kandidatë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës (40 në vitin akademik 2022–2023)”. Për vitin akademik 2023–2024, sipas Raportit Vjetor 2024 të KLGJ-së, faqe 7, u emëruan 32 magjistratë; për vitin akademik 2024–2025 u miratuan 20 kuota për kandidatë magjistratë profili “gjyqtar” dhe 15 kuota për “ndihmës ligjorë”.

²⁹¹<https://klgj.al/media/i0pfqfmh/vendim-nr-433-dat%C3%AB-22-07-2025-p%C3%ABr-p%C3%ABrcaktimin-e-afateve-standarde-minimale-kohore-dhe-standardeve-minimale-sasiore-p%C3%ABr-gjykimin-e-%C3%A7%C3%ABshjteve.pdf>

Ky përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të menaxhimit të performancës gjyqësore mbi bazën e treguesve të matshëm. Vendimi është miratuar në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës, nenit 94, pika 4, shkronjat “a” dhe “h”, të ligjit nr. 115/2016, si dhe nenit 2, shkronja “m”, të ligjit nr. 96/2016. Në planin parimor, vendimi i lidh afatet kohore dhe standardet sasiore me objektivat e mirëqeverisjes, efektivitetit, transparencës dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Këto standarde kanë karakter orientues dhe zbatohen vetëm për ato kategori çështjesh, për të cilat ligji procedural nuk parashikon afate të posaçme gjykimi. Standardi kohor llogaritet nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes, ndërsa për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

Në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, vendimi parashikon që kërkesat penale dhe kundërvajtjet penale të gjykohen jo më gjatë se 2 muaj; çështjet penale për vepra me dënim deri në 10 vjet, jo më gjatë se 9 muaj; ndërsa çështjet penale për vepra me dënim mbi 10 vjet ose me burgim të përjetshëm, jo më gjatë se 12 muaj. Në fushën civile, afatet variojnë nga 1 muaj për kërkesat për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, 2 muaj për çështjet pa palë kundërshtare, 4 muaj për çështjet e marrëdhënieve të punës dhe çështjet tregtare ose familjare pa palë kundërshtare, 6 muaj për çështjet civile, tregtare dhe familjare me palë kundërshtare, deri në 12 muaj për çështjet civile komplekse. Për gjykatat administrative të shkallës së parë, afatet janë 1 muaj për kërkesat për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, 2 muaj për kërkesat pa palë kundërshtare dhe 6 muaj për çështjet administrative me palë kundërshtare.

Në nivel apeli, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm duhet të gjykojë kundërvajtjet penale brenda 2 muajve, kërkesat penale brenda 3 muajve dhe çështjet penale të themelit brenda 6 muajve. Në seksionin civil të apelit, kërkesat për urdhër ekzekutimi dhe kërkesat pa palë kundërshtare duhet të shqyrtohen brenda 2 muajve; çështjet e punës dhe familjare brenda 4 muajve; çështjet civile dhe tregtare me palë kundërshtare brenda 6 muajve; ndërsa çështjet civile komplekse brenda 12 muajve. Për gjykatat e posaçme, afatet janë më të diferencuara: në GJKKO të shkallës së parë kërkesat penale duhet të gjykohen brenda 4 muajve, çështjet penale me dënim deri në 10 vjet brenda 9 muajve dhe ato me dënim mbi 10 vjet ose burgim të përjetshëm brenda 12 muajve; ndërsa në Apelin e Posaçëm kërkesat penale duhet të shqyrtohen brenda 4 muajve dhe çështjet penale me palë kundërshtare brenda 6 muajve.

Sa i përket standardeve minimale sasiore, vendimi përcakton që gjyqtari i shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, si relator, duhet të gjykojë jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare dhe 200 çështje pa palë kundërshtare në vit. Për gjykatat administrative të shkallës së parë, standardi është 200 çështje me palë kundërshtare dhe 150 pa palë kundërshtare. Gjyqtarët e apelit, si në juridiksionin e përgjithshëm ashtu edhe në atë administrativ, duhet të gjykojnë jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare në vit. Për gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar, standardi minimal është 20 çështje me palë kundërshtare për gjyqtar, si në shkallë të parë, ashtu edhe në apel. Në aspektin institucional, vendimi vendos edhe një mekanizëm monitorimi tremujor nga kryetarët e gjykatave, të cilët duhet të raportojnë pranë KLGJ-së mbi zbatimin e afateve dhe standardeve sasiore. Në rast mospërmbushjeje, gjyqtari duhet të raportojë shkaqet, masat korrigjuese dhe nevojën eventuale për mbështetje shtesë me burime njerëzore. Për rrjedhojë, vendimi nr. 433/2025 nuk përbën thjesht një akt teknik të përcaktimit të afateve, por një instrument të rëndësishëm të administrimit modern të gjykatave, duke e lidhur

performancën gjyqësore me efikasitetin, përgjegjshmërinë institucionale dhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm.

Në kuadër të zbatimit të strategjisë për uljen e backlog-ut, një tjetër masë organizative me rëndësi të veçantë është krijimi i seksioneve brenda gjykatave. Kjo masë synon të lidhë specializimin e gjyqtarëve me menaxhimin më efikas të fluksit të çështjeve dhe me përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes gjyqësore. Seksionimi krijon mundësinë që çështjet të trajtohen sipas natyrës dhe kompleksitetit të tyre nga gjyqtarë me përvojë më të konsoliduar në fushën përkatëse, duke ndikuar si në përshpejtimin e shqyrtimit gjyqësor, ashtu edhe në rritjen e koherencës dhe parashikueshmërisë së praktikës gjyqësore. Kjo masë është konkretizuar përmes Vendimit nr. 408, datë 15.07.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor²⁹², i cili miraton rregullat për kriteret dhe procedurat e krijimit të seksioneve dhe trupave gjyqësore. Ky vendim nuk krijon një koncept të ri të seksionimit, por operacionalizon parashikimet e ligjit nr. 98/2016 mbi organizimin e brendshëm të gjykatave, duke përcaktuar kushtet konkrete për realizimin e specializimit në praktikë. Në këtë kuptim, ai duhet lexuar si akt zbatues i ligjit nr. 98/2016, në funksion të rritjes së efikasitetit, profesionalizmit dhe cilësisë së dhënies së drejtësisë.

Në këtë akt, specializimi i gjyqtarit ose i trupës gjyqësore përkufizohet si mundësia për të fituar njohuri dhe aftësi të thelluara brenda një fushe apo nënfushe specifike të së drejtës. Ky përcaktim e vendos specializimin jo thjesht në planin formal të ndarjes së çështjeve, por në funksion të rritjes së kapacitetit profesional të gjyqtarit dhe të cilësisë së vendimmarrjes gjyqësore. Për rrjedhojë, specializimi nuk është vetëm instrument organizativ, por edhe mekanizëm që ndikon në cilësinë e arsyetimit gjyqësor, në koherencën e praktikës, në parashikueshmërinë e vendimeve dhe në rritjen e besimit të publikut te gjykatat.

Krijimi i seksioneve nuk është parashikuar si proces automatik, por si vendimmarrje institucionale e bazuar në analizë dhe arsyetim. Këshilli i Gjykatës, pas marrjes së mendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve, vendos për krijimin e dy ose më shumë seksioneve në gjykatë me vendim të arsyetuar. Një element thelbësor i këtij modeli është kërkesa, që çdo seksion të përbëhet nga **së paku gjashtë gjyqtarë**. Ky standard, i parashikuar në kuadrin ligjor të organizimit të gjykatave dhe i konkretizuar shprehimisht në nenin 5, pika 2, të Vendimit nr. 408/2025, tregon se seksionimi kërkon një masë minimale organizative dhe nuk mund të realizohet në mënyrë efektive në gjykata me trupë gjyqësore të kufizuara.

Në këtë mënyrë, parashikimi i ligjit nr. 98/2016 për gjykata me numër më të madh gjyqtarësh merr kuptim të plotë funksional. Gjykatat më të mëdha krijojnë kushtet për ngritjen e seksioneve, ndërsa seksionet krijojnë mundësinë për specializim real të gjyqtarëve. Lidhja ndërmjet madhësisë së gjykatës, seksionimit dhe specializimit përbën një nga elementet kryesore të modelit të ri të administrimit gjyqësor, i cili synon jo vetëm riorganizimin territorial të sistemit, por edhe përmirësimin e performancës së gjykatave.

Rëndësi të veçantë ka fakti se krijimi i seksioneve duhet të mbështetet në kriteret objektive. Këto kriteret përfshijnë numrin e gjyqtarëve, që ushtrojnë efektivisht funksionin në gjykatë, llojin e çështjeve, numrin e çështjeve të regjistruara në të paktën tre vitet e fundit, si dhe ngarkesën e gjyqtarëve. Kjo tregon se vendimmarrja për seksionimin duhet të jetë e bazuar në të dhëna dhe në analizë të nevojave reale të gjykatës, jo në vlerësime

²⁹² <https://klgj.al/media/1dtfascy/vendim-nr-408-dat%C3%AB-15-07-2025-mbi-miratimin-e-rregullave-p%C3%AB-kriteret-dhe-procedurat-e-krijimit-t%C3%AB-seksioneve-dhe-trupave-gjyqes.pdf>

abstrakte ose formale. Në këtë aspekt, seksionimi lidhet drejtpërdrejt me administrimin modern të gjykatës, ku organizimi i brendshëm duhet të mbështetet në tregues objektivë të performancës dhe ngarkesës.

Nga këndvështrimi i uljes së *backlog*-ut, këto kritere kanë rëndësi të posaçme. Analiza e numrit të çështjeve të regjistruara në tre vitet e fundit dhe e ngarkesës së gjyqtarëve mundëson identifikimin e fushave ku krijohen vonesa, ku ka volum më të lartë çështjesh dhe ku kërkohet organizim më i specializuar i trupës gjyqësore. Për rrjedhojë, seksionet nuk shërbejnë vetëm për ndarjen tematike të çështjeve, por edhe si instrument për menaxhimin më efikas të fluksit të punës, për përshpejtimin e shqyrtimit gjyqësor dhe për uljen graduale të stokut të çështjeve të prapambetura.

Në të njëjtën kohë, ndarja në seksione ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e dhënies së drejtësisë. Gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm organizohen dhe funksionojnë në seksione, të cilat mund të përfshijnë, ndër të tjera, seksionin civil, penal, tregtar, familjar apo fusha të tjera të veçanta të së drejtës. Edhe Gjykata e Apelit e juridiksionit të përgjithshëm organizohet dhe funksionon në seksione, kryesisht civile dhe penale, por pa u kufizuar domosdoshmërisht vetëm në to. Ky model krijon mundësinë, që çështjet të trajtohen nga gjyqtarë me përvojë më të konsoliduar në fushën përkatëse, duke rritur cilësinë e arsyetimit, uniformitetin e praktikës gjyqësore dhe parashikueshmërinë e vendimmarrjes.

Megjithatë, zbatimi praktik i këtij modeli tregon se potenciali i parashikuar nga ligji nr. 98/2016 dhe nga rregullat e Këshillit të Lartë Gjyqësor për seksionimin ende nuk është realizuar plotësisht. Sipas informacionit të përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me e-mail të datës 18 mars 2026, në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm janë krijuar vetëm seksione për të miturit, seksione civile dhe seksione penale, ndërsa në gjykatat administrative nuk rezultojnë të jetë krijuar asnjë seksion. Po kështu, edhe në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar nuk rezultojnë të jenë krijuar seksione të veçanta.

Ky konstatim evidenton një hendek ndërmjet arkitekturës normative dhe zbatimit institucional të saj. Nga njëra anë, ligji nr. 98/2016 dhe Vendimi nr. 408/2025 krijojnë bazën për një organizim më të specializuar të gjykatave, duke e lidhur seksionimin me rritjen e efikasitetit, cilësinë e drejtësisë dhe menaxhimin më të mirë të ngarkesës. Nga ana tjetër, krijimi i kufizuar i seksioneve tregon se specializimi gjyqësor mbetet ende në një fazë të pjesshme dhe jo plotësisht të konsoliduar. Një nga arsyet që mund të ketë ndikuar në këtë situatë lidhet me mungesat në organikat efektive të gjykatave, si dhe me lëvizjet e vazhdueshme, që po përjeton sistemi gjyqësor, si në plan horizontal, përmes transferimeve, ashtu edhe në plan vertikal, përmes ngritjeve në detyrë.

Nga ana tjetër, të dhënat empirike të vitit 2024 tregojnë përmirësimin e normës së evadimit të çështjeve — *Clearance Rate* (CR) — mbi 100% në Gjykatën e Lartë dhe në gjykatat administrative të shkallës së parë; ulja e stokut të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë me 19.8%; ulja e kohës së pritshme të përfundimit të çështjeve — *Disposition Time* (DT) — me 38.5% në Gjykatën Administrative të Apelit përbëjnë tregues të rëndësishëm empirikë, që mbështesin argumentin se reforma ka prodhuar efekte pozitive në funksionimin e sistemit gjyqësor dhe në aksesin substancial në drejtësi.

Megjithatë, është e nevojshme të theksohet se harta gjyqësore nuk mund të konceptohet si një mekanizëm i drejtpërdrejtë dhe autonom për uljen e stokut të çështjeve të prapambetura. *Backlog*-u përbën një fenomen kompleks institucional, i cili nuk lidhet

vetëm me organizimin territorial të gjykatave, por edhe me faktorë të tjerë strukturorë, administrativë, proceduralë dhe normativë. Kjo qasje është pranuar edhe nga vetë Këshilli i Lartë Gjyqësor në strategjinë për uljen e çështjeve të prapambetura, ku trajtimi i *backlog*-ut është konceptuar si një proces shumëdimensional, që kërkon ndërhyrje të koordinuara në disa nivele të funksionimit të sistemit gjyqësor. Në këtë kuptim, efekti i hartës gjyqësore duhet të vlerësohet jo në mënyrë të ngushtë, vetëm përmes uljes numerike të çështjeve të mbartura, por në një kuadër më të gjerë analitik, që lidhet me racionalizimin e organizimit gjyqësor, rishpërndarjen më të drejtë të ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve specializimin e trupave gjykyes, si dhe përdorimin më eficient të burimeve njerëzore e administrative. Pra, kontributi kryesor i reformës së hartës qëndron në krijimin e kushteve institucionale më të favorshme për menaxhimin efektiv të gjykatave, për balancimin e ngarkesës së punës dhe për rritjen e kapacitetit të sistemit për të përballuar fluksin e çështjeve në mënyrë më të qëndrueshme dhe më të barabartë, dhe në rritjen e cilësisë në dhënien e drejtësisë.

Për këtë arsye, vlerësimi i plotë i impaktit të hartës gjyqësore duhet të kryhet pas plotësimit të organikave të gjykatave, e cila lejon matjen reale të efekteve të reformës mbi aksesin, efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit gjyqësor. Ndërkohë, mbetet e rëndësishme të rikonsiderohet përdorimi i instrumenteve plotësuese të parashikuara nga legjislacioni, veçanërisht krijimi i degëve gjyqësore në qytetet e prekura nga riorganizimi territorial, në përputhje me nenin 13 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Këto degë mund të shërbejnë si mekanizëm korrigjues dhe balancues për të garantuar se racionalizimi territorial i gjykatave të mos shoqërohet me kufizim praktik të aksesit të qytetarëve në drejtësi.

Operacionalizimi i fazave të reformës krijoi probleme komplekse të menaxhimit të çështjeve në procesin tranzitor. Çështjet e regjistruara në gjykatat e suprimuara para datave të mbylljes (1 shkurt, 1 maj, 1 korrik 2023) duhet të ndaheshin me short të ri midis trupës së re gjyqësore. Kjo procedurë u realizua kryesisht përmes sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve (ICMIS), por ngadalësimi operacional ishte i pashmangshëm. Po ashtu, shumë çështje, që ishin në fazë të avancuar të gjykimit, u rikthyen në hap zero pas ndryshimit të trupës gjykyese, duke prodhuar humbje shtesë të kohës. Kjo problematikë u zbut në vitin 2024 me krijimin e ekipeve NUNÇP në gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe të Apelit Administrativ që, ndonëse nuk gjykojnë, përgatisin çështjet paraprakisht.

Më gjerësisht, viti 2024 dëshmoi konsolidim të vetë institucionit të KLGJ-së. Ripërtëritja e anëtarësisë me tre anëtarë të rinj jogjyqtarë, ndryshimi i strukturës drejtuese dhe maturimi i procedurave institucionale të Këshillit dëshmojnë se KLGJ-ja vetë po konsolidohet si organ i vetëqeverisjes gjyqësore. Pavarësisht ndryshimeve, funksionaliteti dhe ritmi i veprimtarisë së Këshillit nuk janë cenuar, që është dëshmia e mbarëvajtjes së parashikimeve kushtetuese të nenit 147/a për stabilitetin institucional të KLGJ-së. Ky konsolidim institucional është element i nënvlerësuar i reformës, por ai përbën themelin për qëndrueshmërinë afatgjatë të vetë reformës së hartës.

Së pari, pas reformës kushtetuese, roli i ekzekutivit në hartën gjyqësore nuk është më dominues në kuptimin politik të mëparshëm, por mbetet pjesë e domosdoshme e procedurës ligjore, përmes Ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave. Roli i KLGJ-së është përcaktues në vlerësimin profesional dhe institucional të nevojës për riorganizim, ndërsa miratimi përfundimtar realizohet nga Këshilli i Ministrave, sipas procedurës së parashikuar në ligj. Reforma kushtetuese e vitit 2016, nëpërmjet Ligjit nr. 98/2016, neni

13,14,15 e shndërroi pikësynimin nga “harta si akt politik” në “harta si akt teknik”. VKM-ja nr. 495/2022 është reflektim besnik i propozimit të KLGJ-së, ndërsa Vendimi i KLGJ-së nr. 585/2024 për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve nga 408 në 417 është dëshmia e dytë normative e këtij rikualifikimi: KLGJ-ja ushtron tashmë në praktikë kompetencën e modifikimit të strukturës mbi bazën e të dhënave empirike, sipas detyrimit të nenit 14 të Ligjit nr. 98/2016 për rishikim periodik.

Së dyti, procesi shtatë-vjeçar 2018–2024 është rast paradigmatic i ndërtimit gradual të reformës strukturore. Shtatë fazat e identifikuar — identifikimi (2018), ndërtimi institucional (2019), konsolidimi metodologjik (2020), konsultimi (2021–fillimi 2022), miratimi (qershor–korrik 2022), operacionalizimi (2023) dhe konsolidimi institucional (2024) — dëshmojnë se reformat e suksesshme strukturore kërkojnë kohë, durim institucional dhe ndërtim sistematik. Çdo fazë i shtoi një dimension të ri: nga diagnoza tek baza teknike, nga propozimi te legjitimimi shumë-aktorial, nga operacionalizimi në matjen e parë empirike të rezultateve. Viti 2024 dëshmon se procesi nuk është një ngjarje, që mbyllet me VKM-në, por një cikël, që vazhdon të prodhojë dinamikë institucionale.

Së treti, të dhënat empirike të dy-vjeçarit 2023–2024 dëshmojnë se zbatimi fazor i reformës po fillon të prodhojë përmirësime substanciale, ndërsa sfidat strukturore mbeten. Treguesit pozitivë: rritja e organikës efektive nga 247 në 272 gjyqtarë (+10,1%); ulja e backlog-ut në Gjykatën e Lartë me 19,8%; arritja e CR-së mbi 100% në Gjykatën e Lartë dhe gjykatat administrative të shkallës së parë (për herë të parë në historinë post-reformë); ulja e DT-së me 38,5% në Gjykatën Administrative të Apelit. Treguesit problematikë: vakanca, që mbetet 33%; *backlog* total i sistemit, që rritet në afërsisht 131.000 çështje në fund të 2024-it; ngarkesa për gjyqtar (700–800 çështje), që mbetet 4–5 herë mbi normën e miratuar me vendimin e KLD. Reforma është e nevojshme dhe ka dëshmuar potencialin e saj, por nuk është e mjaftueshme: pa investime adekuate infrastrukturore dhe në burime njerëzore, pa dyfishimin e ndihmësve ligjorë dhe pa implementimin e ICMIS-it të ri, harta e re nuk mund të prodhojë efektet e plota të premtuara.

Së katërti, reforma ka prodhuar ndarje të dukshme midis aksesit gjeografik dhe aksesit substancial. Të dhënat empirike të vitit 2024 ofrojnë argumente substanciale në favor të reformës (CR mbi 100% në gjykatat administrative; ulja e *backlog*-ut në Gjykatën e Lartë).

Së pesti, reforma e hartës nuk është një reformë “më vete”, por një moment kulminues i reformës më të gjerë të vitit 2016 dhe kornizë e zbatimit të Strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2024–2030. Ajo nuk mund të analizohet pa marrë parasysh tre procese paralele: (i) procesin e rivlerësimit kalimtar (vetting), që në fund të 2024-ës ka prodhuar 144 shkarkime nga KPK dhe 113 vendimmarrje shkarkim nga KPA, me efekt financiar kumulativ prej 965.768.125 lekë; (ii) reformën e organeve të qeverisjes së drejtësisë (KLGJ, KLP, ILD, KED, IKLD), e cila ka konsoliduar arkitekturën institucionale që zbaton reformën, e dëshmuar nga ripërtëritja e suksesshme e KLGJ-së në 2024 dhe nga ndryshimi i strukturës drejtuese; dhe (iii) procesin e integritimit evropian, që në 2024 dëshmoi hapjen e grup-kapitullit të parë “Themeloret”, ku reforma e hartës u prezantua si dëshmi e progresit institucional. Pa këto tre kontekste, reforma e hartës do të kishte qenë jashtë çdo lexueshmërie analitike.

Tabela 7. Sintezë krahasuese e treguesve kryesorë (2018–2024)

Treguesi	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Numri i gjykatave	38	38	38	38	38	22 (-42%)	22
Organika gjyq. (nominale)	408	408	408	408	408	408	417 (+9)
Gjyqtarë efektivë	361	306	270	256	251	247	272 (+10,1%)
% e organikës nominale	88,5%	75,0%	66,2%	62,7%	61,5%	60,5%	66,6%
Backlog total (përafr.)	75.803	92.602	~98.000	~108.000	~110.000	~114.000	~131.000
Vendime KLGJ	~250	~480	654	~580	~600	743	763 (+3%)
Mbledhje plenare KLGJ	~50	65	87	75	78	80	65 (-18,8%)
Akte nënligjore (rregullore)	~5	~10	~15	~12	~18	27	60 (+122%)
Caktime në çështje të veçanta	0	0	Të pakta	Mesatare	Mesatare	208	66 (-68%)
Buxheti gjyqësor (mln lekë)	~3.100	~3.200	3.409	3.444	3.760	4.363 (+16%)	4.967 (+13,9%)

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e Raporteve Vjetore të KLGJ-së për vitet 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024 (kapitujt mbi gjendjen e sistemit gjyqësor); raporti i KShH-së për vitin 2023 (mars 2025); Raporti Vjetor 2024 i KLGJ-së.

Tabela 7 ofron një pasqyrë të përmbledhur të dinamikës shtatëvjeçare të sistemit gjyqësor. Prej saj dalin pesë konstatime kryesore. Së pari, struktura territoriale e gjykatave ndryshoi rrënjësisht në vitin 2023, me një ulje prej rreth 42% të numrit të gjykatave, ulje e cila nuk duhet interpretuar si reduktim i funksioneve gjyqësore, por si pasojë e krijimit të gjykatave më të mëdha përmes bashkimit të juridiksioneve të mëparshme dhe përqendrimit të kompetencave territoriale në struktura më të gjera institucionale. Ky riorganizim u stabilizua në vitin 2024, kur sistemi filloi të funksiononte mbi bazën e konfigurimit të ri territorial. Së dyti, trupa gjyqësore efektive, e cila kishte pësuar rënie të vazhdueshme nga 361 gjyqtarë në vitin 2018 në 247 gjyqtarë në vitin 2023, shënoi në vitin 2024 një kthesë pozitive, duke arritur në 272 gjyqtarë efektivë, me një rritje prej 10.1%. Së treti, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të parashikuar në organikë u rrit në 417 në vitin 2024, pas miratimit të vendimit nr. 585, duke përbërë modifikimin e parë organik post-reformë dhe një përpjekje për ta përshtatur strukturën e burimeve njerëzore me gjykatat e reja të konsoliduara. Së katërti, aktiviteti vendimmarrës i KLGJ-së u intensifikua ndjeshëm në

vitin 2023, me 743 vendime, si dhe vijoi në vitin 2024 me 763 vendime, ndërsa rënia e caktimeve *ad hoc* me 68% tregon një kalim gradual nga administrimi emergjent i krizës së vakancave drejt një forme më të qëndrueshme të menaxhimit institucional. Së pesti, rritja e akteve nënligjore në vitin 2024 dëshmon investimin institucional në konsolidimin rregullator të sistemit të ri, duke krijuar bazën normative për funksionimin afatgjatë të hartës së re gjyqësore.

Vendimi nr. 70/2023 i Gjykatës Kushtetuese, gjithashtu, konfirmoi se riorganizimi territorial i gjykatave nuk duhet të vlerësohet vetëm në mënyrë formale, përmes numrit të gjykatave të mbyllura, të bashkuara ose të riorganizuara, por në mënyrë substanciale, përmes efekteve reale që prodhon mbi aksesin në drejtësi, eficiencën institucionale, shpërndarjen e ngarkesës gjyqësore dhe cilësinë e administrimit të gjykatave. Nga ana tjetër, miratimi i hartës nga Këshilli i Ministrave (VKM 495/2022), që ndoqi besnikërisht propozimin e KLGJ-së është argument i fortë në favor të kushtetutshmërisë formale. Po ashtu, cikli i konsultimeve publike 2021–2022, që dokumentoi pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesit, plotëson kërkesat ligjore për legjitimim procedural. Po ashtu, vendimi i KLGJ-së nr. 585/2024, që rriti organikën nga 408 në 417, përpara konsultimit publik, është dëshmi e mbarëvajtjes së procedurës konsultuese të reformës. Megjithatë, shqetësimet substanciale për aksesin e qytetarëve në territoret e prekura kanë legjitimitet të vetin, që duhet adresohet, posaçërisht përmes krijimit të degëve të përhershme dhe të përkohshme, që ende nuk është realizuar.

Konteksti i integritetit evropian shton një dimension të ri legjitimitimi në vitin 2024. Hapja e grup-kapitullit të parë “Themeloret”, që përfshin Kapitullin 23 (“Gjyqësori dhe të drejtat themelore”) dhe Kapitullin 24 (“Drejtësia, liria dhe siguria”), e bëri reformën e hartës gjyqësore kontribut të drejtpërdrejtë në procesin e anëtarësimit. Komisioni Evropian, përmes raporteve të tij vjetore, ka vlerësuar pozitivisht progresin institucional të KLGJ-së dhe të reformës. Po ashtu, finalizimi i Strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2024–2030 vendos reformën e hartës brenda një kornize më të gjerë të reformimit të drejtësisë. Të gjitha këto elemente janë legjitimues të jashtëm të reformës, që plotësojnë legjitimimin e brendshëm institucional.

Analiza e ndërmarrë në këtë kapitull, mbi bazën e raporteve vjetore të KLGJ-së për periudhën 2018–2024, prodhon një sintezë me karakter institucional të reformës më të rëndësishme strukturore të sistemit gjyqësor shqiptar pas vitit 1990. Reforma e hartës gjyqësore përfaqëson shprehjen më kryesore të transformimit kushtetues 2016: zhvendosjen e administrimit të drejtësisë nga sfera e ekzekutivit në sferën e vetëqeverisjes gjyqësore profesionale. Procesi shtatë-vjeçar 2018–2024 dëshmon se ky transformim është i mundur dhe i qëndrueshëm, ndonëse i kushtueshëm dhe i komplikuar. Procesi pesë-vjeçar i ndërtimit (2018–2022), viti i parë i operacionalizimit (2023) dhe viti i parë i konsolidimit institucional (2024) dëshmojnë tre nivele realizimi: nivel formal-institucional, ku reforma rezulton e konsoliduar nga pikëpamja normative dhe organizative dhe që në vitin 2024 u plotësua me modifikimin e parë organik (Vendimi nr. 585/2024); nivel strukturor-territorial, ku reforma ka prodhuar ndryshime themelore dhe nivel funksional-operacional, ku rezultatet e fazës së parë të konsolidimit (2024) janë inkurajuese (CR mbi 100% në Gjykatën e Lartë dhe gjykatat administrative të shkallës së parë; ulja e DT me 38,5% në Gjykatën Administrative të Apelit; ulja e *backlog*-ut me 19,8% në Gjykatën e Lartë) por jo të mjaftueshme për të zgjidhur sfidat e mbartura të organikës së pamjaftueshme dhe *backlog*-ut të lartë.

Reforma e hartës gjyqësore nuk është një akt i përfunduar. Reforma e hartës gjyqësore nuk duhet parë si një akt i mbyllur, por si një proces, që vijon të prodhojë efekte institucionale dhe funksionale gjatë periudhës së zbatimit të strategjive për uljen e çështjeve të prapambetura dhe konsolidimin e kapaciteteve gjyqësore. Megjithatë, pavarësisht nga zhvillimet e ardhshme, ky kapitull dëshmon se cikli gjatë periudhës 2023–2024 është një moment historik institucional. Kjo është dëshmia se reformat strukturore mund të prodhohen jo si akte të vullnetit politik momental, por si rezultate të punës metodologjike institucionale të organeve të vetëqeverisjes profesionale, të mbështetura në bazë empirike dhe të legjitimuara përmes konsultimit shumë-aktorial dhe verifikimit ciklik. Konsolidimi institucional i KLGJ-së në vitin 2024 — dëshmuar nga ripërtëritja e suksesshme e anëtarësisë, ndryshimi i strukturës drejtuese pa cenim të funksionalitetit, dhe miratimi i Strategjisë së *Backlog*-ut 2024–2027 — është kontributi më i thellë juridik dhe institucional i reformës. Reforma e hartës ka prodhuar jo vetëm një strukturë të re gjyqësore, por edhe një organizëm institucional, të aftë të menaxhojë në mënyrë të vazhdueshme reformën. Përfundimisht, harta gjyqësore aktuale e Republikës së Shqipërisë, e konsoliduar nga VKM 495/2022, e operacionalizuar përgjatë vitit 2023 dhe e modifikuar fillimisht nga Vendimi i KLGJ-së nr. 585/2024, është pjesë integrale e arkitekturës së re kushtetuese të post-reformës 2016. Ajo do të rishikohet detyrueshëm në vitin 2027 sipas mandatit të nenit 14 të Ligjit nr. 98/2016 — moment në të cilin do të jenë në dispozicion të dhënat e fazës së dytë të zbatimit (2025–2026) dhe do të mund të bëhet vlerësim më i plotë i performancës. Deri atëherë, KLGJ-ja, si organi i ngarkuar me mandatin kushtetues të propozimit, do të vazhdojë monitorimin metodologjik të strukturës dhe do të prodhojë rekomandime të bazuara në praktikë. Të dhënat empirike të vitit 2024 — që shfaqen si pikë kthese pozitive pas viteve të rënies — janë dëshmia e parë substanciale se procesi i ndërtimit shtatë-vjeçar në periudhën 2018–2024 ka filluar të prodhojë rezultatet e premtuara, ndërsa konsolidimi i tyre kërkon vazhdimin e investimit institucional, financiar dhe njerëzor në vitet që pasojnë.

KAPITULLI III

REFORMA NË ORGANIZIMIN DHE ADMINISTRIMIN E GJYKATAVE

3.1 Kuadri konceptual dhe normativ i administrimit gjyqësor pas reformës në drejtësi në vështrim krahasues

Ndryshe nga kapitujt pararendës, të cilët trajtojnë reformën kushtetuese dhe riorganizimin territorial të gjykatave, ky kapitull fokusohet në dimensionin e administrimit të brendshëm të gjykatave dhe në rolin e KLGJ-së si organ përgjegjës për standardizimin, mbikëqyrjen dhe mbështetjen institucionale të këtij administrimi. Administrimi gjyqësor dhe administrimi i gjykatës janë dy gjëra të ndryshme. Administrimi gjyqësor përkufizohet si një grup aktivitete, që priten t'u mundësojë gjykatave të zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë të drejtë, ekonomike, të shpejtë dhe të pavarur, pra janë në thelb detyrat, që u mundësojnë gjykatave të bëjnë drejtësi. Dhënia e drejtësisë përfshin marrjen parasysh të kohës, kostos, drejtësisë, paanshmërisë dhe aksesit. Ndërkohë që rolet dhe përgjegjësitë e gjykatave duket se janë zgjeruar me kalimin e kohës për të përqafuar zgjidhjen e problemeve, ndërmjetësimin dhe arbitrazhin, misioni themelor i gjykatave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve vazhdon të njihet si qëllimi parësor i sistemeve gjyqësore²⁹³.

Çështja e administrimit të gjykatave ka një rëndësi të madhe, jo vetëm për ata që janë të përfshirë në administrimin e drejtësisë²⁹⁴, por edhe për komunitetin në tërësi. Sipas Alexander Hamilton *“Administrimi i drejtësisë kontribuon, më shumë se çdo rrethanë tjetër, në ngulitjen në mendjet e njerëzve të ndjenjës së përkushtimit, respektit dhe nderimit ndaj qeverisjes së tyre.”*²⁹⁵ [përkthim nga autori] Pra, është e vështirë të mendohet një shoqëri apo komunitet që nuk mbështetet në idenë e shtetit ligjor për mirëqenien dhe suksesin e saj. Në mungesë të një kuadri ligjor, shoqëria lihet e pambrojtur ndaj kaosit ose sundimit autoritar. Prandaj, natyrshëm, themeli i një shoqërie të drejtë mbështetet në funksionimin efikas të gjykatave, të cilat janë krijuar për dhënien e drejtësisë.

Është e pranuar gjerësisht se funksionimi i qetë i sistemit të drejtësisë mbështetet shumë në një bashkëpunim të fortë midis gjyqësorit dhe administratorëve të gjykatave²⁹⁶.

Roli i administratës gjyqësore është një pjesë thelbësore e procesit gjyqësor, duke mbuluar përgjegjësi, detyra dhe strukturë të ndryshme të personelit²⁹⁷. Sipas Kondrych²⁹⁸, standardet ndërkombëtare theksojnë rëndësinë e të pasurit organe gjyqësore të përkushtuara kundër korrupsionit dhe garancinë që drejtësia të administrohet përmes këtyre gjykatave. Kjo qasje mund të luajë një rol vendimtar në rivendosjen e besimit të publikut në gjyqësor.

Sipas Zaffarano²⁹⁹, rekomandohet një përqasje e menaxhimit dhe ekipit, ku kryetari

²⁹³ R. Heeler, *Judicial Administration: Its relation to judicial independence* (Administrimi gjyqësor: lidhja e tij me pavarësinë gjyqësore) 24 (1998).

²⁹⁴ Kjo çështje është trajtuar edhe nga artikulli lidërshtepi ne gjyqësor.

²⁹⁵ Alexander Hamilton, “The Federalist No. 17” (1787), cituar në Russell Wheeler, *Judicial Administration: Its Relation to Judicial Independence* (Williamsburg, VA: National Center for State Courts, 1988),

²⁹⁶ Administratorët e gjykatave dhe gjyqësori - Partnerë në dhënien e drejtësisë Nga i nderuari Wayne Martin AC, Kryetar i Gjykatës së Australisë Perëndimore, vëll. 6 Nr. 2, dhjetor 2014 ISSN 2156-7964 URL: <http://www.iacaijournal.org>. fq.3.

²⁹⁷ Teremetskyi, V., & Kutsenko, K.D. (2021). *Statusi Ligjor i Administratës së Gjykatës*. Buletini i Universitetit Kombëtar të Punëve të Brendshme të Kharkiv.

²⁹⁸ Kondrych, V. (2021). *Gjykata e lartë kundër korrupsionit në kuadër të standardeve ndërkombëtare të procedurës gjyqësore dhe administrimit të drejtësisë*. Revista Amazonia Investiga.

²⁹⁹ Zaffarano, M.A. (2016). Kuptimi i udhëheqjes në gjykatat shtetërore: një ese analizuese.

dhe administratori i gjykatës ndajnë përgjegjësitë dhe marrin trajnimin e duhur për drejtimin. Këto studime theksojnë rëndësinë e drejtimit në sistemin gjyqësor dhe theksojnë nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse për zhvillimin dhe zbatimin e tij.

Sa më sipër, miratimi i paketës së reformës në drejtësi (2016) përfaqëson një ndër ndërhyrjet më të rëndësishme normative dhe institucionale në administrimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri, jo vetëm për shkak të krijimit të organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, por edhe për shkak të rikonceptimit të mënyrës së qeverisjes dhe administrimit brenda vetë gjykatave. Në këtë kuptim, reforma shënon kalimin nga një model i fragmentuar rregullator, drejt një arkitekture më të konsoliduar, ku administrimi gjyqësor trajtohet si komponent i domosdoshëm i pavarësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit.

Ky ristrukturim u materializua kryesisht përmes tri akteve bazë: ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në bashkëveprim, këto ligje krijojnë një kuadër më të qartë kompetencash, procedurash dhe mekanizmash mbikëqyrjeje, duke synuar unifikimin e standardeve të administrimit të gjykatave në rang sistemi.

Në aspektin e teknikës legislative, reforma solli një konsolidim të rregullimeve, që më parë ishin të shpërndara në akte të ndryshme. Për herë të parë, një pjesë e konsiderueshme e normave, që i përkasin organizimit dhe funksionimit të sistemit gjyqësor, u përmbledhën në një ligj të vetëm, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, e cila më parë rregullohej nga një ligj i posaçëm. Paralelisht, çështjet që lidhen me statusin e magjistratit, karrierën (përfshirë ngritjen në detyrë) dhe përgjegjësinë disiplinore u sistemuan në mënyrë shteruese në ligjin për statusin, duke u distancuar nga qasja më e përgjithshme dhe e kufizuar e ligjit të vitit 2008, ku statusi i gjyqtarëve dhe organizimi i brendshëm i gjykatës rregulloheshin në mënyrë të përmbledhur.

Ligji nr. 98/2016 ka një rol themelor në këtë kuadër, pasi synon të rregullojë jo vetëm organizimin e gjykatave, por edhe çështjet e administrimit gjyqësor në kuptimin e gjerë të fjalës. Ai parashikon rregulla të plota dhe më të standardizuara lidhur me: (i) kompetencën tokësore të gjykatave; (ii) krijimin dhe funksionimin e seksioneve; (iii) përbërjen e trupave gjyqësore; (iv) hartën e gjykatave dhe procesin e rishikimit të saj; (v) organizimin e brendshëm të gjykatave; (vi) funksionimin e administratës gjyqësore; si dhe (vii) statusin e punonjësve në gjykata. Në këtë mënyrë, administrimi i gjykatës nuk trajtohet si aspekt dytësor, por si element strukturor, që garanton funksionimin e qëndrueshëm të shërbimit publik të drejtësisë. Për herë të parë, në këtë ligji (neni 2) është dhënë kuptimi “Administrimi gjyqësor”, që është tërësia e veprimtarive që synojnë organizimin dhe sigurimin e funksionimit të shërbimeve në mbështetje të sistemit gjyqësor.

Një ndryshim i rëndësishëm institucional konsiston në forcimin e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në rregullimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e organizimit dhe funksionimit të gjykatave në praktikë. Rregullimet e reja synojnë të sigurojnë një sistem më të konsoliduar të administrimit gjyqësor, nën një autoritet, që përfaqëson vetëqeverisjen e gjyqësorit, pa cenuar pavarësinë e gjykatës në ushtrimin e funksionit gjyqësor. Krahas kësaj, vihet re edhe reduktimi i rolit të Ministrisë së Drejtësisë në funksione kryesisht konsultative dhe koordinuese, si një shprehje e mëtejshme e parimit të ndarjes së pushteteve dhe e autonomisë institucionale të gjyqësorit në aspektin e administrimit.

Reforma kushtetuese dhe ligjore në fushën e drejtësisë, e ndërmarrë në Republikën e Shqipërisë gjatë viteve 2016–2017 përbën, në thelb, një ribërje paradigmatiske të arkitekturës institucionale që administron pushtetin gjyqësor. Në qendër të kësaj reforme qëndron zëvendësimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) — strukturë e ngritur me Kushtetutën e vitit 1998 dhe e organizuar në bazë të Ligjit nr. 8811/2001 — me Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), si organ kushtetues i ri me përbërje, status, kompetenca dhe organizim të brendshëm thelbësisht të rishikuar.³⁰⁰

Korniza e re ligjore e organizimit të KLGJ-së përbëhet nga dy shtylla normative kryesore: *Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, që rregullon përbërjen, statusin, organizimin dhe kompetencat e KLGJ-së si organ qeverisjeje,³⁰¹ dhe *Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, që përcakton strukturën dhe funksionimin e gjykatave dhe shtrirjen e kompetencave të KLGJ-së në administrimin e tyre.³⁰² Të dy këto ligje, së bashku me Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe Ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, formojnë trupin organik të paketës ligjore të reformës. Ato shfuqizojnë në mënyrë të shprehur Ligjin nr. 8811/2001³⁰³ dhe Ligjin nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”,³⁰⁴ duke shënuar mbylljen e një ere institucionale dhe hapjen e një tjetre.

Në kornizën institucionale të mëparshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë cilësohej në vetë Ligjin nr. 8811/2001 si “autoriteti shtetëror përgjegjës” për një gamë funksionesh kryesisht të administrimit të karrierës së gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, duke përjashtuar shprehimisht gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.³⁰⁵ Kompetenca e tij ushtrohej brenda një logjike administrative të ngushtë: emërim, transferim, shkarkim, vlerësim profesional, edukim dhe kontroll mbi veprimtarinë e gjyqtarëve. Ligji nr. 115/2016, përkundrazi, e vendos KLGJ-në brenda një kornize të re parimore. Neni 2 i tij shpall se sistemi i drejtësisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe efijencës³⁰⁶ — parime, që funksionojnë si filtra interpretues për të gjitha dispozitat pasuese dhe që orientojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë organizimin e brendshëm, vendimmarrjen dhe llogaridhënien publike të KLGJ-së. Vetë identifikimi i KLGJ-së jepet shprehimisht në nenin 3, pika 1, të të njëjtit ligj, ku përcaktohet se ai është “organ kolegjal i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët shërbejnë në detyrë me kohë të plotë”.³⁰⁷

³⁰⁰Shih amendamentet kushtetuese të miratuara me Ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, neni 17, përmes të cilit u zëvendësua tërësisht Pjesa IX e Kushtetutës dhe u riformulua organi përgjegjës për qeverisjen e gjyqësorit, duke kaluar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) në Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ).

³⁰¹Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Fletorja Zyrtare nr. 224/2016, neni 1.

³⁰²Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Fletorja Zyrtare nr. 209/2016, neni 1.

³⁰³Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, sot i shfuqizuar. Ky ligj formëonte arkitekturën institucionale të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) deri në hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 115/2016.

³⁰⁴Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sot i shfuqizuar. Shfuqizimi është parashikuar shprehimisht në nenin 92, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016.

³⁰⁵Ligji nr. 8811/2001, neni 1: “Këshilli i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën, dhe për kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.”

³⁰⁶Ligji nr. 115/2016, neni 2: “Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë qeveriset bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efijencës.”

³⁰⁷Ligji nr. 115/2016, neni 3, pika 1: “Këshilli i Lartë Gjyqësor është organ kolegjal i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët shërbejnë në detyrë me kohë të plotë.”

Përkufizimi i tij funksional plotësohet edhe nga Ligji nr. 96/2016, sipas të cilit KLGJ-ja është organi, që merret me çështjet që lidhen me gjyqtarët, të emëruarit, të diplomuarit dhe kandidatët për magistratë.³⁰⁸

Ndryshimi nuk është thjesht emëror. Ai shenjon: **së pari**, kalimin nga një organ ku shumica e funksioneve realizoheshin në mënyrë periodike përmes mbledhjeve plenare të një trupi me anëtarë jo me kohë të plotë (me përjashtim të Zëvendëskryetarit), te një organ ku të gjithë njëmbëdhjetë anëtarët shërbejnë me kohë të plotë; **së dyti**, heqjen e elementit të integritetit politik të drejtpërdrejtë në kompozimin e Këshillit (figura të tilla si Presidenti i Republikës, Ministri i Drejtësisë dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë nuk janë më pjesë *ex officio* e tij); dhe së treti, shtrirjen e kompetencave të KLGJ-së drejt fushave, që më parë i përkisnin Presidentit të Republikës, Ministrin të Drejtësisë ose Konferencës Gjyqësore Kombëtare, siç do të shtjelohet në vijim.

Sipas nenit 3 të Ligjit nr. 8811/2001, KLD-ja përbëhej nga pesëmbëdhjetë anëtarë, të grupuar në tri kategori: (i) anëtarë *ex officio* — Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Ministri i Drejtësisë; (ii) tre anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë; dhe (iii) nëntë gjyqtarë të të gjitha niveleve, të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.³⁰⁹

Karakteristikat thelbësore të kësaj përbërjeje ishin: (a) prezenca e drejtpërdrejtë e tre titullarëve me funksione politike-ekzekutive ose drejtuese gjyqësore (Presidenti, Ministri dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë), me Presidentin si Kryetar të KLD-së *ex officio*;³¹⁰ (b) ushtrimi i veprimtarisë me kohë të pjesshme nga shumica e anëtarëve, me përjashtim vetëm të Zëvendëskryetarit, i cili sipas nenit 13, pika 1, ishte “funksionar me kohë të plotë”;³¹¹ (c) kërkesa profesionale të diferencuara për anëtarët gjyqtarë (10 vjet përvojë gjyqësore) dhe ata jogjyqtarë (15 vjet përvojë juridike);³¹² dhe (d) mandat 5-vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme.³¹³

Ligji nr. 115/2016, në nenin 3 të tij, ridimensionon plotësisht arkitekturën e brendshme të organit. KLGJ-ja, sipas pikës 1 të kësaj dispozite, “është organ kolegjal i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët shërbejnë në detyrë me kohë të plotë”. Gjashtë prej tyre janë gjyqtarë nga të gjitha nivelet e pushtetit gjyqësor; pesë të tjerët janë juristë të përzgjedhur nga radhët e avokatëve, të pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë, të Shkollës së Magistraturës dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile.³¹⁴

Tipari kryesor i përbërjes së re mund të sintetizohet si më poshtë: **(a) Numri i anëtarëve zvogëlohet nga 15 në 11**, duke favorizuar funksionimin më të rrjedhshëm dhe

³⁰⁸Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 2, shkronja “ë”, nënparagrafi (i): “Këshilli i Lartë Gjyqësor [...] është organi që merret me çështje që lidhen me gjyqtarët, të emëruarit, të diplomuarit dhe kandidatët për magistratë që ndjekin Shkollën e Magistraturës, me qëllim që të bëhen gjyqtarë.”

³⁰⁹Ligji nr. 8811/2001, neni 3: “Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe 9 gjyqtarë, të të gjitha niveleve, të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.”

³¹⁰Ligji nr. 8811/2001, neni 11, pika 1: “Presidenti i Republikës është Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”

³¹¹Ligji nr. 8811/2001, neni 12, pika 2: “Zëvendëskryetari organizon veprimtarinë e përditshme të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.” Sipas nenit 13, pika 1, të të njëjtit ligj, “Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është funksionar me kohë të plotë.”

³¹²Ligji nr. 8811/2001, neni 4: anëtarët e zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare duhej të ishin gjyqtarë me jo më pak se 10 vjet përvojë; ata të zgjedhur nga Kuvendi duhej të ishin juristë me jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale.

³¹³Ligji nr. 8811/2001, neni 6, pika 1: “Anëtarët e zgjedhur qëndrojnë në detyrë për një periudhë 5-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme.”

³¹⁴Ligji nr. 115/2016, neni 3, pika 1: “Gjashtë prej anëtarëve të Këshillit janë gjyqtarë nga të gjitha nivelet e pushtetit gjyqësor. Pesë anëtarët e tjerë të Këshillit janë juristë të përzgjedhur nga radhët e avokatëve, të pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë, të Shkollës së Magistraturës dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile.”

efektiv. **(b) Eliminohet anëtarësimi ex officio i politikës dhe ekzekutivit:** Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Ministri i Drejtësisë nuk janë më anëtarë të Këshillit. **(c) Të gjithë anëtarët shërbejnë me kohë të plotë,** duke kapërcyer kufizimin e modelit të mëparshëm ku vetëm Zëvendëskryetari ushtronte detyrë me kohë të plotë. **(d) Mbahet shumica e gjyqtarëve** (gjashtë gjyqtarë kundrejt pesë jogjyqtarëve), por ndryshohet rrënjësisht trupi zgjedhës: anëtarët gjyqtarë tani zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve e jo nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare;³¹⁵ anëtarët jogjyqtarë zgjidhen nga Kuvendi mbi bazën e një procesi vlerësimi paraprak të kushteve dhe kriterëve ligjorë.³¹⁶ **(e) Mandati 5-vjeçar ruhet,** por shpërndarja e tij ndalon shprehimisht “rizgjedhjen e njëpasnjëshme”.³¹⁷ Përpjesëtimi i brendshëm i kuotës gjyqësore parashikohet me një saktësi që mungonte në kornizën e mëparshme. Sipas nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, gjashtë anëtarët gjyqtarë shpërndahen sipas raportit: tre nga shkalla e parë (të paktën një prej tyre nga gjykatat jashtë Tiranës); dy nga apeli (të paktën një jashtë Tiranës); dhe një nga Gjykata e Lartë.³¹⁸ Ky kuotim normativ siguron, përveç përfaqësimit hierarkik, edhe një ekuilibër gjeografik, që synon të kapërcejë mbi-përfaqësimin tradicional të gjykatave të kryeqytetit.

Një ndryshim i rëndësishëm dogmatik është kthimi i anëtarit të KLGJ-së në një figurë juridike me status të mirëpërcaktuar. Neni 4 i Ligjit nr. 115/2016 përcakton se anëtari i Këshillit ka statusin e magjistratit, sipas rregullave të parashikuara në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.³¹⁹ Anëtari gëzon pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë,³²⁰ nuk i nënshtrohet vlerësimit etik dhe profesional gjatë mandatit, por performanca e tij merret parasysh në rast transferimi ose promovimi të mëvonshëm; dhe parashikohen rregulla për kthimin në vendin e mëparshëm të punës pas përfundimit të mandatit, si edhe ndalim transferimi, ngritjeje në detyrë ose delegimi për tre vjet pas mandatit.³²¹ Nga ana tjetër, anëtarët e KLGJ-së i nënshtrohen një regjimi specifik përgjegjësie disiplinore. Neni 5 i Ligjit nr. 115/2016 (siç është ndryshuar me Ligjin nr. 47/2019) përcakton tipologjinë e shkeljeve disiplinore, ndërsa neni 6 cakton se procedura disiplinore zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, mbi bazën e hetimit të kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.³²² Ky model ndryshon plotësisht nga ai i mëparshmi, ku anëtari i KLD-së nuk gëzonte një status të mirëpërcaktuar magjistrati dhe ku procedimi disiplinor i anëtarëve nuk ishte i rregulluar me një nivel të krahasueshëm hollësie.

³¹⁵Ligji nr. 115/2016, neni 3, pika 2: “Anëtarët gjyqtarë zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të të gjitha niveleve.” Krahaso me Ligjin nr. 8811/2001, neni 3, ku anëtarët gjyqtarë zgjidheshin nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.

³¹⁶Ligji nr. 115/2016, neni 3, pika 3.

³¹⁷Ligji nr. 115/2016, neni 3, pika 4: “Përveç rasteve kur vërtetohen kushtet për ndërprerjen e parakohshme të mandatit, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor qëndron në detyrë për 5 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme.”

³¹⁸Ligji nr. 115/2016, neni 7, pika 1: “Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të të gjitha niveleve zgjedh 6 anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas raportit të mëposhtëm: a) tre prej të zgjedhurve janë gjyqtarë të shkallës së parë. Së paku 1 prej tyre është gjyqtar në një gjykatë të shkallës së parë jashtë Tiranës; b) dy prej të zgjedhurve janë gjyqtarë të apelit. Së paku 1 prej tyre është gjyqtar në një gjykatë të apelit jashtë Tiranës; c) një prej të zgjedhurve është gjyqtar në Gjykatën e Lartë.”

³¹⁹Ligji nr. 115/2016, neni 4, pika 1: “Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor ka statusin e magjistratit, sipas rregullave të parashikuara nga ligji ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.”

³²⁰Ligji nr. 115/2016, neni 4, pika 2: “Anëtari i Këshillit gëzon pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.”

³²¹Ligji nr. 115/2016, neni 4, pikat 3 dhe 4. Pika 4 parashikon shprehimisht: “Anëtari gjyqtar i Këshillit nuk mund të transferohet, të ngrihet në detyrë ose të delegohet gjatë 3 viteve pas përfundimit të mandatit.”

³²²Ligji nr. 115/2016, neni 5 (i ndryshuar me Ligjin nr. 47/2019), për përkufizimin e shkeljeve disiplinore të anëtarit të KLGJ-së, dhe neni 6 për procedurën disiplinore, sipas të cilit shkeljet hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të KLGJ-së përbën një nga zonat ku ndryshimi është më substancial dhe më i strukturuar. Sipas Ligjit nr. 8811/2001, anëtarët gjyqtarë zgjidheshin nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, ndërsa anëtarët jogjyqtarë (vetëm tre) emëroheshin nga Kuvendi pa parashikim hollësish për kritere objektive vlerësuese ose për procedurë vlerësimi paraprak. Hyrja e Presidentit, Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe Ministrit ishte automatike, *ex officio*. Ligji nr. 115/2016 ngre një arkitekturë procedurale të hollësishme dhe të diferencuar për secilën nga kategoritë e anëtarëve. Për anëtarët gjyqtarë (gjashtë), nenet 9 deri 18 të këtij ligji përshkruajnë në mënyrë të hollësishme: (i) thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, (ii) verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga një Komision Kualifikimi i kryesuar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë me dy gjyqtarë të zgjedhur me short, (iii) thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve, dhe (iv) votimin e fshehtë dhe individual, me prani të vëzhguesve³²³ nga Ministri i Drejtësisë dhe Kuvendi.³²⁴ Për anëtarët jogjyqtarë (pesë), zgjedhja kryhet nga Kuvendi mbi bazën e procedurave të diferencuara: dy anëtarë nga radhët e avokatëve sipas neneve 19 e vijues,³²⁵ dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës sipas neneve 36 e vijues,³²⁶ dhe një anëtar nga shoqëria civile sipas neneve 47 e vijues.³²⁷ Në çdo rast, është parashikuar një proces vlerësimi paraprak nga organe të specializuara — Avokati i Popullit me Komisionin e Pavarur *Ad Hoc* për anëtarët nga avokatia, ose dekanati/Këshilli Pedagogjik për pedagogët — me kritere të mirëpërcaktuara profesionale, morale, organizative dhe drejtuese (neni 34, Ligji nr. 115/2016).

Një ndryshim i rëndësishëm është gjithashtu shumica e cilësuar prej dy të tretash në Kuvend për miratimin e listës së kandidatëve jogjyqtarë (neni 35, pika 16, e Ligjit nr. 115/2016). Mosarritja e kësaj shumice në votimin e parë, të dytë ose të tretë çon në një mekanizëm të hollësishëm (anti-bllokues): pas tri raundeve të dështuara, kandidatët e listës së tretë konsiderohen të zgjedhur *ex lege*.³²⁸ Ky model është krijuar për të ruajtur konsensusin politik si parim, duke garantuar njëkohësisht funksionalitetin e procesit të krijimit të Këshillit.

Sipas Ligjit nr. 8811/2001, KLD-ja vepronte në mënyrë “kolegjiale në mbledhjet e tij”,³²⁹ me një model të vetëm pune të bazuar në mbledhje plenare të rregullta (jo më rrallë se një herë në dy muaj, sipas nenit 19, pika 1) ose të jashtëzakonshme. Procedura e mbledhjes ishte e rregulluar nga nenet 19 deri 27.³³⁰ Veprimtaria përgatitore — verifikimi i ankesave, vlerësimi profesional, hetimi paraprak — kryhej nga Inspektorati pranë KLD-

³²³Ligji nr. 115/2016, nenet 9–11. Neni 9 parashikon thirrjen e shprehjes së interesit nga Kryetari i Gjykatës së Lartë jo më vonë se 4 muaj nga data e mbarimit të mandatit; neni 10 rregullon paraqitjen dhe shqyrtimin e shprehjes së interesit; neni 11 parashikon Komisionin e Kualifikimit, të kryesuar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë me dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë të zgjedhur me short.

³²⁴Ligji nr. 115/2016, nenet 13–17. Neni 13 parashikon thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme nga Kryetari i Gjykatës së Lartë; neni 14, kuorumin (më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve); neni 16, procesin e votimit (i fshehtë dhe individual); neni 17, numërimin e votave dhe shpalljen e rezultatit.

³²⁵Ligji nr. 115/2016, neni 19, dhe vijues, për procedurën e zgjedhjes së dy anëtarëve të KLGJ-së nga radhët e avokatëve.

³²⁶Ligji nr. 115/2016, neni 36, dhe vijues, për procedurën e zgjedhjes së dy anëtarëve të KLGJ-së nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

³²⁷Ligji nr. 115/2016, nenet 47 dhe vijues, për procedurën e zgjedhjes së anëtarit nga radhët e shoqërisë civile.

³²⁸Ligji nr. 115/2016, neni 35, pika 16: “Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve me dy të tretat e të gjithë anëtarëve.” Dispozita parashikon edhe procedurën e raundeve të votimit në rast mosarritjeje të shumicës së kërkuar.

³²⁹Ligji nr. 8811/2001, neni 18: “Këshilli i Lartë i Drejtësisë i kryen funksionet që i janë ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji, në mënyrë kolegjiale në mbledhjet e tij.”

³³⁰Ligji nr. 8811/2001, neni 19 (thirrja e mbledhjeve), neni 22 (rendi i ditës), neni 23 (kuorumi: jo më pak se 8 anëtarë).

së, i cili ishte një strukturë e brendshme, e drejtuar nga Zëvendëskryetari, dhe e përbërë nga Kryeinspektori dhe inspektorët, sipas neneve 14–16 të Ligjit nr. 8811/2001.³³¹ Ky organizim, megjithëse i thjeshtë, ka mangësi të dukshme nga këndvështrimi i ndarjes funksionale të vendimmarrjes: i njëjti organ kolegjial vendoste për të gjitha çështjet — emërimet, transferimet, vlerësimet, masa disiplinore — pa diferencim të punës paraprake nga vendimmarrja përfundimtare; Inspektorati ishte një strukturë e ngushtë administrative dhe *de facto*, e në varësisë e Zëvendëskryetarit dhe jo një organ vlerësues kolegjial autonom.

Modeli i organizimit të KLGJ-së sipas Ligjit nr. 115/2016 është konceptualisht i ndryshëm. Neni 61, pika 1, përcakton se “Këshilli i Lartë Gjyqësor organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhje plenare ose në komisione”.³³² Kjo dispozitë ngre një model të diferencuar të vendimmarrjes, ku puna paraprake-vendimore, përgjithësisht, është e ndarë sipas fushave specifike, ndërsa vendimet me karakter të përgjithshëm normativ ose ato që prekin tërësinë e sistemit i takojnë mbledhjes plenare. Sipas nenit 62, pika 3, të Ligjit nr. 115/2016, Këshilli ka në përbërjen e tij katër komisione të përhershme: (a) Komisioni i planifikimit strategjik, administrimit dhe buxhetit — me dy anëtarë jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar; (b) Komisioni disiplinor — me dy anëtarë gjyqtarë dhe një jogjyqtar; (c) Komisioni i vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale — me dy anëtarë gjyqtarë dhe një jogjyqtar; dhe (ç) Komisioni i zhvillimit të karrierës — me dy anëtarë gjyqtarë dhe një jogjyqtar.³³³ Çdo komision përbëhet nga tre anëtarë dhe dy anëtarë zëvendësues. Një anëtar i Këshillit mund të jetë anëtar në jo më shumë se dy komisione të përhershme dhe kryetar në jo më shumë se një. Anëtarët e Komisionit të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale nuk mund të jenë në të njëjtën kohë anëtarë të Komisionit të zhvillimit të karrierës — një ndalim, që mbron paanshmërinë e procesit të vlerësimit në lidhje me vendimet pasuese për karrierë. Mandati pranë komisionit zgjat dy vjet e gjysmë, duke siguruar rotacion brenda mandatit pesë-vjeçar të anëtarit.³³⁴ Modeli plotësohet nga figura e relatorit, që caktohet me short për çdo akt administrativ individual, në lidhje me statusin profesional të një gjyqtari ose nëpunësi të administratës gjyqësore. Relatori përgatit dosjen, projekt-aktin dhe koordinohet me Kryetarin e komisionit ose me Kryetarin e Këshillit për mbledhjen plenare. Kryetari i Këshillit nuk mund të jetë relator.³³⁵

Kryetari dhe Zëvendëskryetari i KLGJ-së zgjidhen, sipas nenit 59 të Ligjit nr. 115/2016, nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë me shumicë të thjeshtë në mbledhjen e parë të Këshillit. Ata mbeten në detyrë deri në përfundim të mandatit. Ky është një ndryshim themelor në krahasim me Ligjin nr. 8811/2001, ku Kryetari ishte *ex officio* Presidenti i Republikës, dhe Zëvendëskryetari zgjidhej me propozim të Presidentit nga radhët e

³³¹Ligji nr. 8811/2001, neni 14 (Inspektorati pranë KLD-së: Kryeinspektori dhe inspektorët, drejtuar nga Zëvendëskryetari); neni 16 (detyrat e Inspektoratit, përfshirë verifikimin e ankesave, kontrollin profesional, gjetjet për procedim disiplinor).

³³²Ligji nr. 115/2016, neni 61, pika 1: “Këshilli i Lartë Gjyqësor organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhje plenare ose në komisione.”

³³³Ligji nr. 115/2016, neni 62, pika 3: “Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në përbërje komisionet e përhershme si më poshtë: a) Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit; b) Komisioni Disiplinor; c) Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale; ç) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.”

³³⁴Ligji nr. 115/2016, neni 62, pikat 4 (përbërja: tre anëtarë + dy zëvendësues), 5 (anëtari mund të jetë në jo më shumë se 2 komisione dhe kryetar në jo më shumë se 1), 8–11 (përbërja e secilit komision sipas raportit gjyqtar/jogjyqtar), 12 (mandati 2.5 vjet pranë komisionit), 13 (komisioni i përkohshëm për ankime kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë), 14 (komisione të përkohshme), 15 (vendosja me shumicë votash në prani të të gjithë anëtarëve), 16 (raporti vjetor).

³³⁵Ligji nr. 115/2016, neni 63: relatori, i caktuar me short, që drejton procedimin administrativ individual për gjyqtarë dhe nëpunësit e administratës gjyqësore.

anëtarëve të Këshillit.³³⁶ Mbledhja plenare ushtron, sipas nenit 61, pika 2, të Ligjit nr. 115/2016, kompetencat thelbësore me karakter të përgjithshëm: emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë dhe transferimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve; vendosjen e masave disiplinore ndaj tyre; propozimin të Presidenti i Republikës të kandidatëve për Gjykatën e Lartë; miratimin e rregullave të etikës; drejtimin e veprimtarisë administrative të gjykatave; propozimin dhe administrimin e buxhetit të vet dhe të gjykatave; informimin e publikut dhe Kuvendit; miratimin e akteve nënligjore normative; dhe miratimin e rregulloreve të brendshme. Procedura e mbledhjes plenare — kuorumi (jo më pak se 7 anëtarë), votimi i hapur, dokumentimi me regjistrim audio dhe procesverbal — rregullohet nga nenet 66 deri 70 të të njëjtë ligj.³³⁷ Veprimtaria e Këshillit mbështetet edhe nga një administratë e organizuar në njësi të specializuara, sipas neneve 77–79 të Ligjit nr. 115/2016, e cila ndahet të paktën në njësi mbështetëse për çështjet juridike të përgjithshme, për secilin komision të përhershëm, për buxhetin, për etikën (Zyra e Këshilltarit të Etikës), për marrëdhëniet me publikun, për teknologjinë e informacionit, dhe për trajnimin. Drejtuesi më i lartë administrativ i KLGJ-së është Sekretari i Përgjithshëm.³³⁸

Ndoshta zona ku reforma është më pak e dukshme në strukturë, por më e thellë në substancë, është ajo e shtrirjes së kompetencave. Sipas nenit 2 të Ligjit nr. 8811/2001, kompetencat e KLD-së ishin tetë në numër — të lidhura kryesisht me karrierën e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, vlerësimin e tyre, masat disiplinore, dhe emërimin/shkarkimin e kryetarëve të këtyre gjykatave dhe të inspektorëve.³³⁹ Ligji nr. 115/2016, në kontrast, e ngre KLGJ-në në një organ qeverisjeje sistemike të gjyqësorit. Krahas kompetencave klasike të karrierës, ai ka tani edhe kompetenca për planifikim strategjik, administrim, buxhetim, marrëdhënie me publikun dhe propozim legjislativ.

Sipas nenit 61, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016, mbledhja plenare e KLGJ-së “emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve”.³⁴⁰ Ky formulim, dhe veçanërisht fjalët “të të gjitha niveleve”, përmbysin një kufizim historik: KLD-ja sipas Ligjit nr. 8811/2001 kishte kompetencë vetëm mbi gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit, jo mbi anëtarët e Gjykatës së Lartë. Tani, KLGJ-ja propozon edhe kandidatët për Gjykatën e Lartë, sipas neneve 85 dhe 86 të Ligjit nr. 115/2016, që e plotësojnë rregullimin e karrierës dhe disiplinës.³⁴¹

Procedura e emërimit, gjithashtu, është thjeshtuar dhe çpolitizuar pjesërisht. Sipas Ligjit nr. 9877/2008, neni 12, gjyqtari emërohej “nga Presidenti i Republikës, me

³³⁶Ligji nr. 115/2016, neni 59, pika 1: “Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhen në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve. Ata qëndrojnë në detyrë deri në përfundim të mandatit si anëtarë të Këshillit.”

³³⁷Ligji nr. 115/2016, nenet 66–70: thirrja e mbledhjes plenare, rendi i ditës, kuorumi (jo më pak se 7 anëtarë), votimi, dokumentimi i mbledhjes (regjistrim audio, procesverbal me përmbledhje).

³³⁸Ligji nr. 115/2016, nenet 77–79: administrata e Këshillit, e drejtuar nga Kryetari, me Sekretar të Përgjithshëm dhe ndarje në njësi (mbështetëse për çështje juridike, për secilin komision, buxhetit, etikës, marrëdhënieve me publikun, IT-së, trajnimit).

³³⁹Ligji nr. 8811/2001, neni 2, përcaktonte kompetencat e KLD-së si më poshtë: a) propozonte Presidentit emërimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit; b) vendoste për shkarkimin e këtyre gjyqtarëve; c) vendoste për transferimin e gjyqtarëve; ç) vendoste për marrjen e masave disiplinore; d) kujdesej për kualifikimin; dh) vendoste kriteret për vlerësim; e) emëronte dhe shkarkonte kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe apelit; ë) emëronte dhe shkarkonte inspektorët; f) kryente detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

³⁴⁰Ligji nr. 115/2016, neni 61, pika 2, shkronja “a”: “emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve”.

³⁴¹Ligji nr. 115/2016, neni 85 (rekrutimi, emërimi i gjyqtarëve dhe propozimi i kandidatëve për Gjykatën e Lartë) dhe neni 86 (zhvillimi i karrierës dhe disiplina): emërim, caktim në pozicion, transferim, ngritje në detyrë, komandim dhe riemërim, vlerësim i veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosje e masave disiplinore dhe pezullim.

propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, dhe Presidentit i jepej një rol formal-decizional 30-ditor.³⁴² Sipas regjimit të ri, KLGJ-ja kryen drejtpërdrejt emërimin e magistratëve pas diplomimit në Shkollën e Magistraturës, ndërsa propozimi për Gjykatën e Lartë ruhet si kompetencë e veçantë drejtuar Presidentit.³⁴³ Në fushën e etikës, KLGJ-ja ka tani një kompetencë të mirëformuar dhe me shtrirje të gjerë. Neni 83 i Ligjit nr. 115/2016 e bën Këshillin përgjegjës për miratimin dhe rishikimin periodik të standardeve të etikës gjyqësore dhe rregullave të sjelljes së gjyqtarëve, për mbikëqyrjen e respektimit të tyre dhe për raportimin publik mbi shkallën e zbatimit. Po kjo dispozitë krijon figurën e Këshilltarit për Etikën, që zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve, që plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të Gjykatës së Lartë, me mandat 5-vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.³⁴⁴

Disiplina, nga ana tjetër, ka pësuar një ndarje vertikale të funksioneve. Hetimi disiplinor është nxjerrë jashtë KLGJ-së dhe është bartur tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë (institucion i ri me bazë kushtetuese), ndërsa vendimmarrja disiplinore mbetet brenda KLGJ-së — më saktë, brenda Komisionit Disiplinor (neni 62, pika 9, e Ligjit nr. 115/2016) dhe përfundimisht, brenda mbledhjes plenare. Edhe shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë për arkivim ose pushim të hetimit i takon një komisioni të përkohshëm me përbërje të veçantë (dy jogjyqtarë dhe një gjyqtar), sipas nenit 62, pika 13.³⁴⁵ ³⁴⁶ Ky riorganizim dallon thellësisht nga modeli i Ligjit nr. 8811/2001, ku procedimi disiplinor fillohej nga Ministri i Drejtësisë mbi bazën e inspektimeve të kryera prej tij ose nga Inspektorati i KLD-së (neni 31). Bartja e nismës hetimore te një organ kushtetues i pavarur dhe heqja e plotë e Ministrisë të Drejtësisë nga ndonjë rol formal vendimor në procedimin disiplinor, është një nga ndryshimet më të rëndësishme të reformës nga pikëpamja e ndarjes së pushteteve.

Neni 81 i Ligjit nr. 115/2016 ngre një kompetencë të re, që nuk kishte ekzistuar në kornizën e mëparshme: planifikimi strategjik. KLGJ-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, harton, miraton dhe zbaton një plan strategjik për sistemin gjyqësor, që përcakton misionin, vlerat, profilin e gjyqësorit, çështjet strategjike, prioritetet dhe kornizën e monitorimit dhe vlerësimit. Plani shoqërohet detyrimisht me një plan veprimi, përfshirë objektivat operacionale, veprimtaritë, ndikimin financiar dhe treguesit e arritjeve.³⁴⁷ Në vijim, nenet 89–94 të Ligjit nr. 115/2016 saktësojnë funksionet konkrete të Këshillit në fushën e administrimit gjyqësor: (a) hartim dhe ndjekje e politikave për administrimin gjyqësor; (b) monitorim i ngarkesës së gjyqtarëve dhe gjykatave dhe i

³⁴²Ligji nr. 9877/2008, neni 12, pika 1: “Gjyqtari në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.” Pika 5 e të njëjtit nen parashikonte një afat 30-ditor për Presidentin për nxjerrjen e dekretit, përtej të cilit propozimi vlerësohej i rrëzuar.

³⁴³Ligji nr. 115/2016, neni 61, pika 2, shkronja “c”: “i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

³⁴⁴Ligji nr. 115/2016, neni 83: KLGJ-ja është përgjegjës për miratimin e standardeve të etikës gjyqësore dhe rregullave të sjelljes, mbikëqyrjen e respektimit të tyre, dhe caktimin e Këshilltarit për Etikën nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Gjykatës së Lartë.

³⁴⁵Ligji nr. 115/2016, neni 6, pika 1: “Shkeljet disiplinore të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”.

³⁴⁶Ligji nr. 115/2016, neni 62, pika 13: “Për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, krijohet një komision i përkohshëm i përbërë nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar”.

³⁴⁷Ligji nr. 115/2016, neni 81: planifikimi strategjik, që duhet të përcaktojë misionin dhe vlerat kryesore të gjyqësorit, profilin e gjyqësorit, çështjet strategjike, prioritetet dhe kuadrin e monitorimit/vlerësimit. Plani strategjik shoqërohet me planin e veprimit, përfshirë objektivat operacionale, veprimtaritë, ndikimin financiar dhe treguesit e arritjeve.

kohëzgjatjes së çështjeve mbi bazën e të dhënave të mbledhura përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve; (c) miratim i rregullave standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave; (d) qasje në drejtësi dhe marrëdhënie me publikun, përfshirë krijimin e portalit elektronik të gjyqësorit; dhe (e) zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit për gjykatat.³⁴⁸

Një ndryshim themelor i kompetencave kushtetuese dhe ligjore ndodh në fushën e hartës gjyqësore. Neni 84 i Ligjit nr. 115/2016 njih shprehimisht se KLGJ-ja kryen funksione në lidhje me përcaktimin e kompetencave territoriale dhe të madhësisë së gjykatave.³⁴⁹ Përmbajtja e këtyre funksioneve gjendet në Ligjin nr. 98/2016, neni 13, që parashikon vlerësimin e KLGJ-së për organizimin e rretheve gjyqësore të paktën çdo pesë vjet, propozimin e përbashkët me Ministrin e Drejtësisë për riorganizimin dhe përcjelljen e propozimit të Këshilli i Ministrave. Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve, sipas nenit 21 dhe ai i gjyqtarëve për çdo gjykatë, sipas nenit 22, propozohen tani nga KLGJ-ja.³⁵⁰ Krahaso këtë me regjimin e mëparshëm, ku të dyja këto kompetenca i takonin Presidentit të Republikës, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, që merrte vetëm mendimin e KLD-së.³⁵¹

Neni 95 i Ligjit nr. 115/2016 e bën KLGJ-në përgjegjës për hartimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm të Këshillit dhe të sistemit gjyqësor në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave. Më e rëndësishme, KLGJ-ja merr pjesë në mbledhjen e Kuvendit, ku diskutohet projekt-buxheti i sistemit gjyqësor — një ndryshim i thelluar nga modeli i mëparshëm, ku roli i KLD-së në procesin buxhetor ishte minimal. Neni 96 e plotëson rregullimin me krijimin e njësisë së administrimit të buxhetit gjyqësor pranë Këshillit, e cila studion dhe përcakton nevojat buxhetore për të gjitha hallkat e gjyqësorit, përpunon treguesit financiarë dhe kontrollon përdorimin e fondeve të akorduara.³⁵² Reforma e ka pajisur KLGJ-në me një kompetencë të re: llogaridhënien publike strukturore. Sipas nenit 82 të Ligjit nr. 115/2016, Këshilli raporton para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, jo më pak se një herë në vit, brenda datës 1 maj. Raporti përshkruan veprimtarinë e Këshillit dhe të komisioneve të tij dhe përmban rekomandimet e nevojshme për përmirësim. Rekomandimet e përcjella në rezolutën e Kuvendit për këtë raport janë të detyrueshme për KLGJ-në “për aq sa nuk cenojnë pavarësinë e këtij institucioni” — një kompromis, që ruan tensionin e drejtpeshuar midis llogaridhënies dhe pavarësisë.³⁵³ Roli këshillimor në procesin legjislativ ngrihet

³⁴⁸Ligji nr. 115/2016, nenet 89 (administrimi i gjykatave), 90 (burimet njerëzore në gjykata), 91 (qasja në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun), 92 (sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit), 94 (rregullat e brendshme standarde të gjykatave, përfshirë organigramën standarde, përshkrimet e detyrave, afatet kohore, statistikat gjyqësore dhe modelet për vendime).

³⁴⁹Ligji nr. 115/2016, neni 84: KLGJ-ja kryen funksionet në lidhje me përcaktimin e kompetencave territoriale dhe madhësisë së gjykatave, sipas Ligjit nr. 98/2016.

³⁵⁰Ligji nr. 98/2016, neni 13, pikat 1–5 (vlerësimi i organizimit të rretheve gjyqësore çdo pesë vjet, propozimi i përbashkët KLGJ–Ministër i Drejtësisë për Këshillin e Ministrave); neni 21 (numri i përgjithshëm i gjyqtarëve, propozuar nga KLGJ-ja); neni 22 (numri i gjyqtarëve për çdo gjykatë, vlerësimi rishikues çdo pesë vjet nga KLGJ-ja).

³⁵¹Krahaso me Ligjin nr. 9877/2008, neni 6 (kompetencat tokësore caktohen me dekret të Presidentit të Republikës me propozim të Ministrit të Drejtësisë, që merrte më parë mendimin e KLD-së) dhe neni 8 (numri i gjyqtarëve për çdo gjykatë caktohet me dekret të Presidentit, me propozim të Ministrit të Drejtësisë). Reforma e ka transferuar iniciimin nga Presidenti dhe Ministri të KLGJ-ja.

³⁵²Ligji nr. 115/2016, neni 95 (buxheti vjetor i KLGJ-së dhe i sistemit gjyqësor është pjesë e Buxhetit të Shtetit, hartohet nga KLGJ-ja në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave) dhe neni 96 (zbatimi i buxhetit gjyqësor, me krijimin e njësisë së administrimit të buxhetit gjyqësor pranë KLGJ-së).

³⁵³Ligji nr. 115/2016, neni 82, pika 1: “Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, jo më pak se një herë në vit”. Pika 2 cakton afatin: jo më vonë se data 1 maj. Pika 4:

gjithashtu në një kompetencë formale. Neni 93 i Ligjit nr. 115/2016 i jep KLGJ-së përgjegjësinë për të shprehur mendime dhe për të bërë propozime për ndryshimin e legjislacionit që mund të ndikojë në punën e gjyqësorit, përfshirë shqyrtimin e funksionimit të rregullave procedurale civile, penale dhe administrative. Këshilli mund t'i propozojë Ministrin të Drejtësisë ushtrimin e nismës ligjore për çdo çështje që është nën përgjegjësinë e tij.³⁵⁴

3.2 Modeli i ri i qeverisjes gjyqësore pas reformës kushtetuese të vitit 2016

3.2.1 Baza kushtetuese dhe ligjore e funksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Administrimi i gjyqësorit përbën një kategori juridiko-institucionale të dallueshme nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në kuptimin substancial. Ndërsa funksioni gjyqësor përfshin vendimmarrjen mbi mosmarrëveshjet konkrete dhe interpretimin e ligjit në rastin individual, administrimi i gjyqësorit përfshin tërësinë e veprimtarive që sigurojnë kushtet institucionale, organizative, financiare dhe njerëzore për ushtrimin e atij funksioni³⁵⁵. Kjo ndarje konceptuale, e konsoliduar nga praktika kushtetuese ndërkombëtare dhe nga rekomandimet e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) si dhe e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (CCJE), përbën themelin e shtetit modern të së drejtës: pavarësia e gjyqtarit në vendimmarrje nuk mund të garantohet pa pavarësinë institucionale të organit që administron sistemin gjyqësor.

Reforma kushtetuese e vitit 2016 në Republikën e Shqipërisë, e miratuar përmes Ligjit nr. 76/2016, përfaqëson pikën më të rëndësishme të kalimit nga modeli i administrimit të gjyqësorit nga ekzekutivi në modelin e vetëqeverisjes profesionale. Ajo e zëvendësoi këtë model me dy organe të reja kushtetuese — Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) — duke krijuar një ndarje të qartë midis qeverisjes së gjyqësorit dhe qeverisjes së prokurorisë, dhe duke konsoliduar pavarësinë institucionale të të dy degëve të magjistraturës. Ky kapitull synon të analizojë në mënyrë sistematike rolin, kompetencat, strukturat administrative dhe ndikimin operacional të Këshillit të Lartë Gjyqësor në administrimin e sistemit gjyqësor shqiptar gjatë periudhës 2018–2024. Periudha e analizës fillon me vitin e parë të funksionimit efektiv të KLGJ-së dhe shtrihet deri në vitin 2024, vit i cili shënon konsolidimin institucional të Këshillit përmes ripërtëritjes së anëtarësisë dhe ndryshimit të strukturës drejtuese³⁵⁶. Burimi kryesor empirik i analizës janë Raportet vjetore mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2024, dokumente të miratuara me vendime përkatëse të KLGJ-së dhe të dorëzuara në Kuvendin e Republikës së

rekomandimet e rezolutës së Kuvendit janë të detyrueshme për t'u marrë parasysh nga Këshilli, për aq sa nuk cenojnë pavarësinë e tij.

³⁵⁴Ligji nr. 115/2016, neni 93: KLGJ-ja shqyrton funksionimin e rregullave procedurale civile, penale ose administrative; bën rekomandime; jep mendim mbi projektligje dhe çështje të tjera që mund të prekin sistemin gjyqësor; propozon Ministrin të Drejtësisë ushtrimin e nismës legjislative.

³⁵⁵Mbi ndarjen konceptuale midis administrimit gjyqësor dhe ushtrimit të funksionit gjyqësor, shih: Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), "Revised Saturn Guidelines for Judicial Time Management" (2014); Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (CCJE), Opinion nr. 10 (2007) "On the Council for the Judiciary at the service of society"; si dhe Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës "On judges: independence, efficiency and responsibilities".

³⁵⁶Burimet kryesore empirike të analizës janë: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për Vitin 2020 (Tiranë, 2021); Raport për Vitin 2021 (Tiranë, 2022); Raport për Vitin 2022 (Tiranë, 2023, miratuar me Vendim nr. 196, datë 26.04.2023); Raport për Vitin 2024 (Tiranë, 2025).

Shqipërisë sipas detyrimit kushtetues të raportimit. Metodologjia analitike kombinon tre qasje: (i) qasjen normative-kushtetuese, që ndjek evoluimin e kompetencave të KLGJ-së sipas Kushtetutës dhe legjislacionit organik; (ii) qasjen institucionale-organizative, që analizon strukturat e brendshme — komisionet e përhershme dhe të përkohshme, ndarjen e kompetencave dhe ndërveprimin me organe të tjera kushtetuese; dhe (iii) qasjen empirike-statistikore, që analizon të dhënat sasiore mbi veprimtarinë e KLGJ-së përgjatë gjashtë viteve të para të funksionimit. Kombinimi i këtyre tre qasjeve mundëson një vlerësim të plotë të rolit të KLGJ-së si organ i vetëqeverisjes gjyqësore.

Themelet kushtetuese të KLGJ-së gjenden në nenet 147, 147/a dhe 147/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të rishikuara plotësisht me Ligjin nr. 76/2016. Sipas nenit 147, paragrafi 1, KLGJ-ja siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë³⁵⁷. Kjo formulim kushtetues është mjaft i rëndësishëm për tre arsye: (i) ai konfirmon karakterin e KLGJ-së si organ kushtetues i ngarkuar me një mision të caktuar — pavarësinë e gjyqësorit; (ii) ai përcakton një trinitet detyrimesh — pavarësia, përgjegjshmëria dhe mbarëvajtja — që nuk mund të ndahen; dhe (iii) ai e vendos KLGJ-në jashtë sferës së pushteteve të tjera klasike (legjislativ, ekzekutiv), duke krijuar një organ *sui generis*, me natyrë të vetëqeverisjes. Neni 147/a, paragrafi 1 i Kushtetutës përcakton kompetencat themelore të KLGJ-së në shtatë shkronja, që mbulojnë tërësinë e ciklit të jetës profesionale të gjyqtarit dhe të organizimit të strukturës gjyqësore. Konkretisht, KLGJ-ja: (a) emëron, vlerëson, ngrit në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve; (b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve; (c) propozon te Presidenti i Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë; (ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre; (d) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave; (dh) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor; dhe (e) kryen funksione të tjera të caktuara me ligj³⁵⁸.

Operacionalizimi i kornizës kushtetuese është realizuar përmes Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, që përcakton në mënyrë të detajuar kompetencat, strukturat e brendshme, procedurat e vendimmarrjes dhe rregullat e funksionimit të KLGJ-së dhe organeve të tjera të qeverisjes së drejtësisë³⁵⁹. Ky ligj është plotësuar dhe konkretizuar nga Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që përcakton statusin profesional, të drejtat dhe detyrimet e magistratëve dhe nga Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, që përcakton strukturën institucionale të gjykatave.

Trekëndëshi normativ i përbërë nga Ligji nr. 115/2016, Ligji nr. 96/2016 dhe Ligji nr. 98/2016 përbën themelin ligjor të administrimit modern të gjyqësorit shqiptar. Ndërveprimi midis këtyre tre ligjeve garanton një sistem të integruar ku KLGJ-ja, si organ kushtetues, ushtron kompetenca që mbulojnë statusin e magistratit (Ligji 96/2016), strukturën institucionale të gjykatave (Ligji 98/2016) dhe vetë organizimin e brendshëm të organeve të qeverisjes (Ligji 115/2016). Akte nënligjore të miratuara nga vetë KLGJ-ja, në

³⁵⁷Neni 147 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar me Ligjin nr. 76/2016): “Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.”

³⁵⁸Neni 147/a i Kushtetutës parashikon kompetencat e KLGJ-së: emërim, vlerësim, ngritje në detyrë dhe transferim, masa disiplinore, propozim i buxhetit gjyqësor, administrim i sistemit gjyqësor.

³⁵⁹Korniza ligjore përbëhet nga: Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” — të gjitha të miratuara si pjesë e paketës ligjore të reformës në drejtësi.

bazë të autorizimeve ligjore, plotësojnë këtë kornizë me rregullimin e detajuar të procedurave të brendshme dhe ndarjen e kompetencave midis komisioneve.

Sipas tipologjisë së pranuar nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), modelet e qeverisjes së gjyqësorit në Evropë mund të grupohen në katër kategori kryesore: (i) modeli i Këshillit të Lartë Gjyqësor me kompetenca të gjera (modeli italian, francez, portugez); (ii) modeli i administrimit nga ministria me organ konsultativ profesional (modeli gjerman tradicional); (iii) modeli britanik me ndarje të mprehtë midis administrimit dhe vendimmarrjes; dhe (iv) modeli skandinav me autoritet të pavarur administrativ. KLGJ-ja shqiptare i përket qartë kategorisë së parë, modelit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me kompetenca të gjera, që përbën edhe modelin më të miratuar nga vendet kandidate të BE-së dhe nga Komisioni i Venecias³⁶⁰.

Veçoria specifike e modelit shqiptar, që e dallon nga homologët klasikë italianë apo francezë, është ndarja e plotë midis qeverisjes së gjyqësorit (KLGJ) dhe qeverisjes së prokurorisë (KLP). Modeli shqiptar paraqet një konfigurim të veçantë në rajon, për shkak të ndarjes institucionale ndërmjet qeverisjes së gjyqësorit dhe qeverisjes së prokurorisë.

Po ashtu, modeli shqiptar parashikon një organ tjetër kushtetues — Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) — që ushtron funksionin e inspektimit dhe të nismës së procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo strukturë trefishe (KLGJ + KLP + ILD), përbën një arkitekturë institucionale unike në Evropë, e shpjegueshme përmes nevojës specifike shqiptare të vetëpastrimit të sistemit përmes procesit të rivlerësimit kalimtar (vettingut).

Boshti më i fortë konceptual i reformës, që përshkon të gjitha ndryshimet e analizuara më lart, është eliminimi i ndikimit institucional të drejtpërdrejtë të pushtetit politik-ekzekutiv mbi qeverisjen e gjyqësorit. Ky bosht shfaqet në tre boshte konkrete normative. Së pari, heqja e Presidentit të Republikës, Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe Ministrit të Drejtësisë si anëtarë *ex officio* të organit kolegjal të qeverisjes së gjyqësorit. Sipas Ligjit nr. 8811/2001, neni 3, të tre këto figura ishin pjesë e KLD-së dhe Presidenti vepronte madje si Kryetar *ex officio*.³⁶¹ Ligji nr. 115/2016, përkundrazi, ndërton një organ ku të gjithë anëtarët janë profesionistë (gjyqtarë ose juristë) të zgjedhur sipas procedurave specifike të vlerësimi, dhe ku Kryetari zgjidhet jo nga jashtë e jo nga gjyqtarët, por nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë me shumicë votash. Së dyti, heqja e tërësishme e funksionit të Ministrit të Drejtësisë në inicimin e procedimit disiplinor të gjyqtarëve. Sipas nenit 31 të Ligjit nr. 8811/2001, Ministri i Drejtësisë inspektonte gjykatat dhe propozonte procedimin disiplinor të gjyqtarëve para KLD-së.³⁶² Sipas regjimit të ri, Ministri i Drejtësisë mund vetëm të paraqesë ankesë tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë ose të kërkojë inspektime institucionale e tematike, por nuk ka asnjë rol vendimor formal në procesin disiplinor.³⁶³ Marrëdhënia e tij me KLGJ-në është bashkëpunuese, jo hierarkike: ai mund

³⁶⁰Sipas tipologjisë së CEPEJ, modelet e qeverisjes gjyqësore klasifikohen si: (i) këshilla gjyqësore të mirëfilltë (genuine judicial councils); (ii) modelet e administrimit nga Ministria e Drejtësisë; (iii) modele hibride. Shih CEPEJ, “European judicial systems — Efficiency and quality of justice”, Studim nr. 26 (2018, 2020, 2022).

³⁶¹Ligji nr. 8811/2001, neni 11, pika 1: “Presidenti i Republikës është Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Krahaso me Ligjin nr. 115/2016, neni 59, sipas të cilit Kryetari i KLGJ-së zgjidhet nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë.

³⁶²Ligji nr. 8811/2001, neni 31, pika 1: “Ministri i Drejtësisë kryen inspektimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit për organizimin dhe punën e shërbimeve gjyqësore, administrimin gjyqësor, si dhe realizon e vendos për procedimin disiplinor të gjyqtarëve të tyre”. Pika 3: “Në përfundim të inspektimit dhe në bazë të rezultateve të këtij inspektimi, Ministri i Drejtësisë propozon procedimin disiplinor të gjyqtarëve para Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

³⁶³Ligji nr. 115/2016, neni 71, pikat 1, 2 dhe 5: “Ministri i Drejtësisë koordinon zhvillimin dhe zbatimin e politikave shtetërore dhe të strategjisë sektoriale të sektorit të drejtësisë [...]. Ministri i Drejtësisë mund të paraqesë ankesë tek

të bëjë vërejtje, të kërkojë mendim, të marrë pjesë në mbledhje të përbashkëta të KLGJ-së dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë ose të dërgojë vëzhgues — por jo të vendosë. Së treti, heqja e Inspektoratit nga brendia e KLGJ-së dhe transferimi i funksioneve të tij hetimore-disiplinore në një organ kushtetues të pavarur — Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Inspektorati pranë KLD-së, sipas neneve 14–16 të Ligjit nr. 8811/2001, ishte një strukturë e brendshme administrative; Inspektori i Lartë i Drejtësisë sipas regjimit të ri është një organ kushtetues i veçantë, që i raporton një organi tjetër. Kjo ndarje e funksioneve hetimore nga ato vendimore brenda po të njëjtit institucion është një nga garancitë më substanciale të paanshmërisë procedurale.

Vitet e para të KLGJ-së u karakterizuan nga sfida të jashtëzakonshme institucionale. Së pari, ngarkesa e kalimit nga regjimi i KLD-së në regjimin e ri kërkoj miratimin e një numri të madh aktesh nënligjore për të vënë në funksion strukturat e brendshme. Së dyti, paralelisht me konstituimin e KLGJ-së, vazhdonte procesi i rivlerësimit kalimtar (vetting), që po shkaktonte vakanca masive në trupën gjyqësore dhe që kërkonte angazhim institucional të Këshillit në mbështetjen e organeve të rivlerësimit. Së treti, viti 2020 solli sfidën e jashtëzakonshme të pandemisë globale Covid-19, që detyroi KLGJ-në të kalonte në metodologji virtuale të vendimmarrjes³⁶⁴. Sipas Raportit Vjetor 2020 të KLGJ-së, përkundër këtyre sfidave, gjatë vitit 2020 KLGJ-ja realizoi 87 mbledhje plenare (35% më shumë se viti 2019) dhe miratoi 654 vendime, duke dëshmuar qëndrueshmërinë institucionale të organit në kushte krize.

Periudha 2019–2020 mund të cilësohet si fazë e “instalimit” dhe e procesit të mësimit institucional. Gjatë kësaj periudhe, KLGJ-ja miratoi paketën themelore të akteve nënligjore për funksionimin e brendshëm: rregulloret e komisioneve të përhershme, rregullat e procedimit disiplinor, kriteret e vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve dhe procedurat për ngritjen në detyrë. Po ashtu, u finalizua propozimi i parë i Hartës së re gjyqësore (29 shtator 2020) që iu dërgua Ministrisë së Drejtësisë, duke shënuar ushtrimin e parë të kompetencës ligjore të KLGJ-së për propozimin e ndryshimeve në strukturën territoriale të gjyqësorit.

Vitet 2021 dhe 2022 shënuan kalimin e KLGJ-së nga faza e instalimit në fazën e konsolidimit operacional. Gjatë vitit 2021, KLGJ-ja realizoi 100 mbledhje plenare dhe miratoi 607 vendime, duke ruajtur ritmin e vendimmarrjes së lartë³⁶⁵. Në fund të vitit 2021 dhe gjatë vitit 2022, ndodhi ripërtëritja e parë e pjesshme e Këshillit, me mbarimin e mandateve të disa anëtarëve të zgjedhur³⁶⁶. Kjo ripërtëritje konfirmoi mekanizmin e rotacionit institucional, që siguron rigjenerim të vazhdueshëm të organit pa cenuar vazhdimësinë.

Viti 2022 shënoi kulmin e veprimtarisë vendimmarrëse të KLGJ-së në kuadrin e reformës së hartës gjyqësore, me realizimin e 114 mbledhjeve plenare (arritja më e madhe që prej krijimit) dhe miratimin e 562 vendimeve, ndër të cilat akti më i rëndësishëm ishte

Inspektori i Lartë i Drejtësisë për shkelje disiplinore të pretenduara të gjyqtarëve, si dhe mund të kërkojë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike në gjykata”.

³⁶⁴Raporti Vjetor i KLGJ-së për Vitin 2020, fq. 9–11, dokumenton 87 mbledhje plenare të zhvilluara në kontekstin e pandemisë Covid-19, ku Këshilli operoi në një kombinim format fizik dhe online për të garantuar vazhdimësinë e veprimtarisë.

³⁶⁵Raporti Vjetor i KLGJ-së për Vitin 2021, që dokumenton 100 mbledhje plenare dhe 607 vendime të miratuara, përfshirë konsolidimin e procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe gjykatat e posaçme.

³⁶⁶Ripërtëritja e parë u realizua përmes Vendimeve të KLGJ-së nr. 581, 582, 583 të datës 13.12.2021 (për mbarimin e mandatit të anëtarëve Bici, Toska, Kadi) dhe nr. 77, 78 të datës 02.03.2022 (për mbarimin e mandatit të anëtarëve Qoku dhe Muharremaj).

propozimi për Hartën e re gjyqësore me Vendimin nr. 211, datë 10.06.2022, që u përvetësua besnikërisht nga Këshilli i Ministrave përmes VKM-së nr. 495, datë 21.07.2022³⁶⁷. Po ashtu, vitin 2022 e karakterizoi konsolidimi i bashkëpunimit ndërinstytucional me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (që kishte filluar veprimtarinë në vitin 2020) dhe konsolidimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve.

Viti 2024 përfaqëson një moment të dytë të rëndësishëm institucional. Gjatë këtij viti ndodhi ripërtëritja e dytë e pjesshme e KLGJ-së, me mbarimin e mandateve të anëtarëve jogjyqtarë të zgjedhur në vitin 2018³⁶⁸. Tre anëtarë të rinj jogjyqtarë u instaluan: z. Albens Tabaku dhe z. Bledar Bajri (avokatë), si dhe znj. Violanda Theodori (shoqëria civile), me mandat 2024–2029. Si pasojë, për herë të parë që nga themelimi i KLGJ-së, ndryshoi struktura drejtuese.

Pavarësisht këtyre ndryshimeve të rëndësishme në përbërje dhe drejtim, funksionaliteti dhe ritmi i veprimtarisë së Këshillit nuk u cenuan, duke dëshmuar mekanizmin e “vazhdimësisë institucionale”, të parashikuar nga Kushtetuta. Gjatë vitit 2024, KLGJ-ja realizoi 65 mbledhje plenare dhe miratoi 763 vendime, duke përfshirë 9 akte nënligjore, 513 akte individuale, 190 akte kolektive, 51 akte rregulla të brendshme dhe 1 udhëzim. Ky vit shënoi gjithashtu përfundimin me sukses të 6-vjetorit të parë të KLGJ-së, periudhë gjatë të cilës organi u shndërrua nga një institucion i sapokrijuar në një organ të konsoliduar të vetëqeverisjes gjyqësore.

3.2.2 Përbërja, statusi dhe struktura vendimmarrëse e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Sic është përmendur edhe më lartë, KLGJ-ja përbëhet nga 11 anëtarë, sipas formulës kushtetuese 6+5: 6 anëtarë gjyqtarë të zgjedhur nga vetë trupa gjyqësore, dhe 5 anëtarë jogjyqtarë juristë të spikatur, të zgjedhur nga Kuvendi me shumicë të cilësuar prej 3/5 të votave³⁶⁹. Përbërja e gjyqtarëve përfshin përfaqësues të të gjitha niveleve gjyqësore: 1 nga Gjykata e Lartë, 2 nga gjykatat e apelit dhe 3 nga gjykatat e shkallës së parë (përfshirë gjykatat administrative). Kjo shpërndarje siguron pjesëmarrjen e të gjitha shkallëve gjyqësore në vendimmarrjen e organit dhe shmang dominimin e ndonjë niveli të caktuar.

Përbërja jogjyqtare përfshin 5 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi nga lista kandidatësh të paraqitur nga: (a) shoqëria civile (1 anëtar); (b) trupa e pedagogëve të fakulteteve juridike (2 anëtarë); dhe (c) trupa e avokatëve (2 anëtarë). Kjo shpërndarje siguron përfaqësim të disa profesioneve juridike dhe perspektivave të ndryshme mbi sistemin gjyqësor. Kërkesa e shumicës 3/5 në Kuvend është një garanci e rëndësishme kundër politizimit të Këshillit sepse detyron blloqet e mëdha politike të arrijnë konsensus mbi kandidatët.

Mandati 5-vjeçar, jo i ripërtëritshëm, përfaqëson një mekanizëm tjetër kyç për pavarësinë institucionale. Pamundësia e ripërtëritjes parandalon situata, ku anëtarët e Këshillit do të mund të orientonin sjelljen e tyre për të ruajtur pozicionin, duke prishur kështu pavarësinë e vendimmarrjes. Po ashtu, sistemi parashikon ripërtëritjen e pjesshme — disa anëtarë

³⁶⁷Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” dhe Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 211, datë 10.06.2022 “Për miratimin e raportit vlerësues mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore”.

³⁶⁸Ripërtëritja e dytë u realizua në vitin 2024.

³⁶⁹Përbërja 6+5 (gjashtë anëtarë gjyqtarë dhe pesë jogjyqtarë) është e parashikuar shprehimisht në nenin 147/1 të Kushtetutës dhe ka për qëllim të garantojë balancën midis ekspertizës profesionale gjyqësore dhe pikëpamjes së ndërsjellë jashtë trupës gjyqësore, duke parandaluar njëkohësisht rrezikun e korporatizmit.

largohen në kohë të ndryshme — për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë institucionale dhe transferimin e njohurive midis brezave të anëtarëve.

Mbledhja Plenare e KLGJ-së përfaqëson organin maksimal vendimmarrës, ku marrin pjesë të 11 anëtarët. Sipas Ligjit nr. 115/2016, neni 60, mbledhjet plenare miratojnë: (i) aktet nënligjore me karakter të përgjithshëm; (ii) vendimet individuale për ngritjen në detyrë, transferimin dhe lirimin nga detyra të gjyqtarëve; (iii) vendimet disiplinore (në bazë të propozimit të Komisionit Disiplinor); (iv) raportet vjetore institucionale; (v) propozimet për reformat strukturore; dhe (vi) buxhetin vjetor të sistemit gjyqësor³⁷⁰. Numri i mbledhjeve plenare të zhvilluara çdo vit përbën një tregues kryesor të intensitetit të veprimtarisë institucionale të Këshillit.

Tabela 1. Veprimtaria vendimmarrëse e KLGJ-së në mbledhje plenare (2019–2024)

Treguesi	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Mbledhje plenare	65	87	100	114	80	65
Vendime totale	~480	654	607	562	743	763
Akte nënligjore	~10	11	12	10	27	9
Akte individuale	~280	377	340	354	506	513
Akte kolektive	~150	215	203	152	162	190
Akte rregulla të brendshme	~30	49	48	45	47	51

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e Raporteve Vjetore të KLGJ-së për vitet 2019, 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024.

Tabela 1 ofron një pamje të qartë të dinamikës së veprimtarisë vendimmarrëse të KLGJ-së gjatë gjashtë viteve të para të funksionimit. Tre observime kryesore: (i) Numri i mbledhjeve plenare ka pasur kulmin në vitin 2022 (114 mbledhje), që përkon me intensifikimin e punës për reformën e hartës gjyqësore; (ii) Numri total i vendimeve është rritur me ritëm të vazhdueshëm, duke arritur kulmin në vitin 2024 (763 vendime), që dëshmon konsolidimin e funksioneve administrative; (iii) Aktet nënligjore me karakter të përgjithshëm — që kanë ndikim sistematik në të gjithë gjyqësorin — kanë vlerën më të lartë në vitin 2023 (27 akte), dëshmi i investimit institucional në kornizën rregullatore për zbatimin e reformës së hartës.

Sipas neneve 61–62 të Ligjit nr. 115/2016, KLGJ-ja organizon veprimtarinë e tij themelore përmes katër komisioneve të përhershme, të cilët përgatitin propozimet që miratohen më pas në mbledhjet plenare. Çdo komision përbëhet nga 3 anëtarë titullarë dhe 2 anëtarë zëvendësues, dhe ka kompetenca të specializuara në një fushë specifike të administrimit gjyqësor³⁷¹. Kjo strukturë funksionale siguron jo vetëm specializim profesional, por edhe ekuilibër midis efikasitetit (komisione më të vogla mund të punojnë më shpejt) dhe legjitimitetit demokratik (vendimet finale merren nga mbledhja plenare e plotë).

Komisioni i planifikimit strategjik, administrimit dhe buxhetit (KPSAB) KPSAB-ja është struktura përgjegjëse për hartimin, miratimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit

³⁷⁰Neni 60 i Ligjit nr. 115/2016 përcakton se Këshilli vepron përmes mbledhjes plenare dhe komisioneve të përhershme, duke ndarë kështu kompetencat midis vendimmarrjes kolektive (mbledhja plenare) dhe punës paraprake teknike (komisionet).

³⁷¹Nenet 61 dhe 62 të Ligjit nr. 115/2016 rregullojnë organizimin dhe funksionimin e komisioneve të përhershme, duke përcaktuar përbërjen, kompetencat dhe procedurat e tyre.

Strategjik, politikave administrative, financiare dhe buxhetore në funksion të menaxhimit të mirë e efikas të sistemit gjyqësor në vend. Sipas Raportit Vjetor 2022 të KLGJ-së, gjatë vitit 2022 KPSAB-ja realizoi 40 mbledhje, në të cilat u morën 100 vendime, ndërsa gjatë vitit 2021 ky komision pati 107 vendime³⁷². Vendimmarrjet e Komisionit shpërmdaheshin tipikisht në katër fusha: (i) planifikim strategjik (rreth 22% të vendimeve); (ii) administrim dhe efikasitet (rreth 46% të vendimeve); (iii) planifikim dhe menaxhim financiar e buxhetor (rreth 18%); dhe (iv) miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare (rreth 12%).

Roli i KPSAB-së është thelbësor për qëndrueshmërinë afatgjatë të vetë institucionit dhe të sistemit gjyqësor. Përmes këtij komisioni, KLGJ-ja ushtron kompetencën kushtetuese të nenit 147/a, shkronja “d”, për propozimin dhe administrimin e buxhetit të sistemit gjyqësor. Po ashtu, KPSAB-ja ka udhëhequr hartimin e dy Planeve Strategjike të KLGJ-së: Planin e parë 2019–2020 dhe Planin e dytë 2022–2024, që përfaqësojnë dokumentet kryesore të orientimit strategjik për të gjithë sistemin gjyqësor.

Komisioni i zhvillimit të karrierës (KZHK) është komisioni më voluminoz në aspektin e numrit të vendimeve të propozuara, për shkak të nevojës për menaxhimin e karrierës profesionale të rreth 250–270 gjyqtarëve aktivë. Gjatë vitit 2020, KZHK-ja propozoi 508 vendime, gjatë vitit 2022 propozoi 377 vendime, dhe e ka mbajtur trendin e lartë në vitet pasuese³⁷³. Vendimmarrjet e këtij komisioni mbulojnë tërësinë e ciklit të jetës profesionale të gjyqtarit: emërimet, ngritjet në detyrë, transferimet, komandimet, skemat e delegimit, dhe mbarimet e statusit. Specifikisht për vitin 2022, KZHK-ja propozoi 3 akte për procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë (anëtarët nga radhët e juristëve të spikatur); 97 akte për procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e tjera; 73 akte në kuadër të procedurave të emërimit të magistratëve; 52 akte për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të kandidimit në Shkollën e Magistraturës; dhe 74 akte për caktimin e gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçanta. Kjo paletë e gjerë vendimmarrjeje dëshmon kompleksitetin e administrimit modern të një trupe gjyqësore profesionale.

Komisioni i vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale (KVEVP) ushtron një nga kompetencat më të ndjeshme të KLGJ-së: vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të të gjitha niveleve, sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Vlerësimi etik dhe profesional është parakusht ligjor për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e trupës gjyqësore³⁷⁴. Gjatë vitit 2022, KVEVP-ja zhvilloi 25 mbledhje, që u materializuan në 60 vendimmarrje, prej të cilave 38 ishin projektraporte vlerësimi (27 të miratuara nga KLGJ-ja në mbledhje plenare). Në tre vite veprimtari (deri në fund të vitit 2022), u hartuan dhe miratuan 107 raporte vlerësimi për 60 gjyqtarë, duke vlerësuar rreth 1/3 e gjyqtarëve, që ndodheshin efektivisht në detyrë.

Niveli kumulativ i vlerësimeve etiko-profesionale arriti një vlerë mjaft të lartë në vitin 2024: gjatë periudhës 2020–2024, sipas Raportit vjetor 2024 të KLGJ-së, u miratuan në total 190 raporte vlerësimi për 119 gjyqtarë, duke vlerësuar rreth 63% të gjyqtarëve për

³⁷²Raporti Vjetor i KLGJ-së për Vitin 2022, fq. 11–12, dokumenton 40 mbledhje dhe 100 vendime të KPSAB-së gjatë vitit 2022, ndarë ndërmjet planifikimit strategjik (22 vendime), administrimit (46 vendime), planifikimit financiar dhe buxhetor (18 vendime) dhe akteve individuale (2 vendime).

³⁷³KZHK gjatë vitit 2020 propozoi 508 vendime, ndërsa në vitin 2022 numri ka qenë 377 vendime. Krahësimi tregon se vllimi në vitin 2020 reflektoi koncentrimin e procedurave të transferimit të përkohshëm dhe skemave të delegimit në kontekstin e Covid-19.

³⁷⁴Vlerësimi etik dhe profesional rregullohet nga nenet 78–93 të Ligjit nr. 96/2016, me kriteret kryesore: aftësitë profesionale, etika në ushtrimin e detyrës dhe angazhimi profesional. Programe të rregullta vjetore zhvillohen duke prioritetuar gjyqtarët në procedura ngritjeje në detyrë.

303 procedura vlerësimi të filluara. Kjo dëshmon konsolidimin gradual të procesit dhe shtrirjen e tij në mënyrë sistematike në të gjithë trupën gjyqësore. Vlen të theksohet se KVEVP-ja ndihmohet nga Njësia e vlerësimit etik dhe profesional (NVEP) — strukturë administrative-teknike, që përgatit dokumentacionin paraprak dhe analizat e dosjeve gjyqësore për vlerësim.

Komisioni Disiplinor është organi, i cili trajton shkeljet disiplinore të gjyqtarëve, mbi propozimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) ose me iniciativën e tij. Sipas nenit 147/a, paragrafi 1, shkronja “b” të Kushtetutës, kompetenca për dhënien e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve është ekskluzive e KLGJ-së, ndërsa hetimi disiplinor është kompetencë e ILD-së³⁷⁵. Kjo ndarje e qartë midis hetimit dhe vendimmarrjes përfaqëson një garanci kryesore të procesit të rregullt ligjor në çështjet disiplinore.

Veprimtaria disiplinore e KLGJ-së ka njohur evolucion gradual. Gjatë vitit 2020 — viti i parë i ushtrimit faktik të kompetencave disiplinore — Këshilli zhvilloi vetëm 3 procedime disiplinore. Gjatë vitit 2022, Komisioni Disiplinor trajtoi 5 procedura disiplinore (4 të reja dhe 1 të mbartur), që rezultuan në: 1 marrëveshje pranimit me masën “pezullim 6-mujor”; 2 masa “pezullim nga detyra” (3-mujor dhe pa afat); dhe 2 vendime jopërfundimtare. Gjatë vitit 2024, Komisioni Disiplinor trajtoi 7 procedime disiplinore të reja dhe 5 të mbartura, prej të cilave për 7 procedimet e iniciuara rishtazi u dhanë 2 shkarkime nga detyra, që dëshmojnë konsolidimin e ushtrimit të kompetencave disiplinore.

Krahas komisioneve të përhershme, KLGJ-ja krijon edhe komisione të përkohshme për të adresuar problematika të veçanta të sistemit gjyqësor që nuk mbulohen nga veprimtaria e komisioneve të përhershme. Sipas Raporteve Vjetore për vitet 2020–2022, KLGJ-ja ka krijuar dhe ka mbajtur në funksion disa komisione të përkohshme: (i) Komisioni i përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional (KPVEP) në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve; (ii) Komisioni i Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë në Shkollën e Magjistraturës; (iii) Komisioni i Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari; dhe (iv) Komisioni i përkohshëm për mbrojtjen e gjyqtarëve, të familjes dhe të pasurisë së tyre³⁷⁶.

Komisioni i përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar (KPVEP), është më i rëndësishmi nga ana operacionale. Ky komision kontrollon dhe miraton raportet e analizimit të aftësive profesionale të gjyqtarëve, që paraqesin formularin e rivlerësimit dhe i depoziton ato pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK). Gjatë vitit 2020, KPVEP zhvilloi 101 mbledhje dhe organizoi 148 shorte për përzgjedhjen e dosjeve të 5 gjyqtarëve për rivlerësim. Deri në fund të vitit 2022, KPVEP kishte depozituar pranë KPK-së në total 379 raporte të hollësishme dhe të arsyetuara — ekuivalente me 79% të të gjithë subjekteve që kishin paraqitur formularin e rivlerësimit. Ky kontribut sasior dhe cilësor dëshmon ndërvarësinë e thellë midis KLGJ-së dhe procesit të vetting-ut.

³⁷⁵Ndarja midis Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (që zhvillon hetimin disiplinor) dhe Komisionit Disiplinor të KLGJ-së (që merr vendimin përfundimtar) është një model i veçantë i “kontrollit dyfish”, që siguron pavarësi më të madhe se modelet ku i njëjti organ heton dhe vendos. Shih nenin 147/b të Kushtetutës dhe nenin 64 të Ligjit nr. 115/2016.

³⁷⁶Komisionet e Përkohshme janë rregulluar nga neni 65 i Ligjit nr. 115/2016, që parashikon mundësinë e krijimit të tyre për trajtimin e çështjeve specifike që nuk mbulohen nga komisionet e përhershme.

3.2.3 Kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor në administrimin, buxhetimin dhe disiplinën gjyqësore

Kompetencat administrative të KLGJ-së në lidhje me menaxhimin e karrierës gjyqësore përfshijnë: (i) emërimin e magistratëve të rinj, që dalin nga Shkolla e Magistraturës; (ii) ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në gjykata të nivelit më të lartë; (iii) transferimin e gjyqtarëve në mënyrë të përkohshme ose të përhershme; (iv) komandimin e gjyqtarëve në institucione të tjera; (v) caktimin e gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin; (vi) skemën e delegimit; dhe (vii) propozimin pranë Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë³⁷⁷. Tërësia e këtyre kompetencave bën që KLGJ-ja të jetë organi qendror i menaxhimit të kapitalit njerëzor në sistemin gjyqësor.

Numri i magistratëve të emëruar për herë të parë në sistem nga viti 2019 në vitin 2022 ishte 71, prej të cilëve 4 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur dhe 67 magistratë të diplomuar nga Shkolla e Magistraturës³⁷⁸. Deri në fund të vitit 2024, ky numër kumulativ kishte arritur 144 magistratë nga viti 2019 në vitin 2024 — 4 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur dhe 140 magistratë të diplomuar nga Shkolla e Magistraturës. Megjithatë, ky numër mbetet i pamjaftueshëm për të kompensuar largimet nga vetting-u dhe vakancat e tjera, që kanë shkaktuar zvogëlim të vazhdueshëm të trupës gjyqësore efektive nga 361 gjyqtarë në vitin 2018 në 247 gjyqtarë në vitin 2023, dhe pjesërisht rikuperim në 272 gjyqtarë në vitin 2024.

Mekanizmat alternativë të caktimit — skema e delegimit, transferimi i përkohshëm dhe caktimi në çështje gjyqësore të veçanta — kanë qenë mjete kryesore të KLGJ-së për të kompensuar mungesën e gjyqtarëve dhe për të siguruar funksionimin e gjykatave, që kanë pësuar vakancat më të mëdha. Gjatë vitit 2022, KLGJ-ja trajtoi 566 kërkesa, duke caktuar 742 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme. Gjatë vitit 2023, ky numër arriti 208 caktime — vit i caktuar nga zbatimi fillestar i hartës së re — ndërsa gjatë vitit 2024 ranë në 66 caktime, që dëshmon kalimin gradual nga “menaxhimi i krizës” në “menaxhim normal” pas konsolidimit të reformës.

Sipas nenit 147/a, paragrafi 1, shkronja “d” të Kushtetutës, KLGJ-ja “propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave”. Kjo kompetencë përfaqëson një nga zhvendosjet më të rëndësishme nga ekzekutivi tek vetëqeverisja e gjyqësorit, sepse para reformës 2016, buxheti i sistemit gjyqësor administrohej kryesisht nga Ministria e Drejtësisë³⁷⁹. Buxheti i KLGJ-së ndahet në tre programe buxhetore: Programi 01110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” (për funksionimin e vetë KLGJ-së); Programi 01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë” (për Qendrën e teknologjisë së informacionit); dhe Programi 03310 “Buxheti gjyqësor” (për funksionimin e gjykatave).

Tabela 2. Buxheti vjetor i sistemit gjyqësor 2019–2024 (në ALL)

³⁷⁷Kompetencat e KLGJ-së për karrierën e magistratëve, përfshirë ngritjen në detyrë, transferimin dhe komandimin, janë të rregulluara nga Pjesa II e Ligjit nr. 96/2016, që përcakton në mënyrë sistematike statusin e gjyqtarit dhe prokurorit.

³⁷⁸Sipas të dhënave të Raportit Vjetor 2022, gjatë periudhës 2019–2022 në sistem janë emëruar 71 magistratë, nga të cilët 4 në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur dhe 67 nga Shkolla e Magistraturës. Numri kumulativ i magistratëve të emëruar nga viti 2019 deri në fund të vitit 2024 arriti në 144.

³⁷⁹Neni 147/a, pika “d” e Kushtetutës dhe nenet 80–95 të Ligjit nr. 115/2016 përcaktojnë kompetencën e KLGJ-së për propozimin e buxhetit të sistemit gjyqësor dhe administrimin e tij.

Treguesi (mln lekë)	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Buxheti i miratuar	3.005,9	3.409,1	3.444,2	3.759,8	4.362,6	4.967,5
Rritja vjetore (%)	—	+13,4%	+1,0%	+9,2%	+16,0%	+13,9%
% e PBB-së	0,33%	0,34%	0,33%	0,35%	~0,36%	~0,38%
Buxhet/banor (euro)	~9,0	~10,0	~10,5	11,2	~13,5	17,5
Mesatarja CEPEJ (euro/banor)	—	—	—	45,8	—	28,3

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e Raporteve Vjetore të KLGJ-së për vitet 2020 (faqe 46), 2021 (faqe 94), 2022 (faqe 32-33), 2024 (faqe 38-47); ligjet vjetore të buxhetit të shtetit. Mesatarja CEPEJ për vitin 2022 sipas Raportit CEPEJ 2022 me të dhënat e vitit 2020; për vitin 2024 sipas raportit më të fundit CEPEJ.

Tabela 2 ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të dinamikës buxhetore të sistemit gjyqësor gjatë gjashtë viteve të para të KLGJ-së. Tre observime kryesore: (i) Buxheti është rritur në mënyrë të vazhdueshme nga rreth 3 miliardë lekë në vitin 2019 në pothuajse 5 miliardë lekë në vitin 2024, që përbën një rritje kumulative prej 65,3% në gjashtë vjet; (ii) Pesha specifike e buxhetit ndaj PBB-së ka pasur tendencë të lehtë rritëse, duke shkuar nga 0,33% në vitin 2019 në rreth 0,38% në vitin 2024; (iii) Megjithatë, krahasuar me mesataren evropiane, buxheti gjyqësor shqiptar mbetet i pamjaftueshëm. Buxheti për banor në vitin 2022 ishte 11,2 euro/banor, përkundrejt mesatares evropiane prej 45,8 euro/banor (sipas të dhënave CEPEJ 2020); në vitin 2024 ky raport ishte 17,5 euro/banor përkundrejt mesatares evropiane për vendet me PBB nën 10,000 euro/banor prej 28,3 euro/banor³⁸⁰. Pavarësisht rritjes së dukshme, ky deficit krahasimor dëshmon nevojën për investim më të madh shtetëror në sistemin gjyqësor.

Realizimi i buxhetit nga KLGJ-ja ka qenë në vlera të larta, që dëshmojnë menaxhim efikas: realizimi total ka variuar nga 91% në vitin 2021 në 95% në vitin 2020 dhe 93% në vitin 2022. Këto vlera vërtetojnë se KLGJ-ja, përmes KPSAB-së, ushtron kompetencën buxhetore me përgjegjshmëri financiare. Kjo është e rëndësishme për pavarësinë institucionale, sepse aftësia për të menaxhuar fondet me efikasitet rrit besueshmërinë e KLGJ-së përpara Kuvendit dhe Ministrisë së Financave, dhe konsoliton pozicionin e KLGJ-së në negociatat buxhetore vjetore.

Kompetenca disiplinore e KLGJ-së përfaqëson njërin nga elementet më delikate të arkitekturës institucionale. Sipas nenit 147/a, paragrafi 1, shkronja “b” të Kushtetutës, KLGJ-ja “vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve”. Modeli shqiptar ndan qartë funksionin e hetimit (kompetencë e ILD-së) nga funksioni i vendimmarrjes (kompetencë e KLGJ-së), që përbën një garanci të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor³⁸¹. Inspektorit i Lartë i Drejtësisë, që filloi veprimtarinë në vitin 2020, është autoriteti që verifikon ankesat, heton me nismë shkeljet e dyshuara dhe propozon

³⁸⁰CEPEJ, “European Judicial Systems — Efficiency and Quality of Justice”, Studim nr. 28 (2022). Buxheti për sistemin gjyqësor në Shqipëri për vitin 2022 ishte 11,2 euro/banor, kundrejt mesatares evropiane prej 45,8 euro/banor — pra pothuajse katër herë më i ulët. Edhe pse buxheti u rrit në 17,5 euro/banor në vitin 2024, hendeu strukturor mbetet i theksuar krahasuar me 28,3 euro/banor mesatarja CEPEJ për vitin 2024.

³⁸¹Reforma kushtetuese e vitit 2016 vendosi modelin e “disiplinës dyfish”: Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) si organ hetimor i pavarur (sipas nenit 147/c të Kushtetutës) dhe Komisioni Disiplinor i KLGJ-së si organ vendimmarrës. Ky model është konsideruar nga Komisioni i Venecias si më pak i ekspozuar ndaj rrezikut të “vetëmbrojtjes korporative” të trupës gjyqësore.

fillimin e procedimit disiplinor. KLGJ-ja, përmes Komisionit Disiplinor, gjykon mbi propozimin dhe vendos masën përkatëse.

Sipas Ligjit nr. 96/2016, masat disiplinore përfshijnë gradime nga më të lehta (vërejtje, qortim) deri në më të rënda (pezullim nga detyra, shkarkim nga detyra). Procedurat disiplinore mbartin garanci të procesit të rregullt: e drejta e mbrojtjes, e drejta e ankesës, dhe ndarja midis hetimit dhe gjykimit. Po ashtu, për t'iu shmangur konflikti e kompetencave midis KLGJ-së dhe organeve të rivlerësimit kalimtar (KPK dhe KPA), Ligji parashikon mekanizmat e bashkërendimit: kur një gjyqtar është nën hetim disiplinor nga ILD-ja dhe njëkohësisht nën rivlerësim kalimtar nga KPK-ja, KLGJ-ja mund të pezullojë procedimin disiplinor deri në marrjen e formës së prerë të vendimit të rivlerësimit (siç ndodhi në vendimin nr. 436, datë 25.10.2022).

Veprimtaria disiplinore e KLGJ-së ka qenë gradualisht në rritje. Sipas Raporteve Vjetore: gjatë vitit 2020 u zhvilluan 3 procedime disiplinore (3 prej të cilëve me vendim shkarkimi nga detyra ose pezullimi); gjatë vitit 2022 u zhvilluan 5 procedime disiplinore me 2 masa pezullimi nga detyra; gjatë vitit 2024 u trajtuan 7 procedime të reja dhe 5 të mbartura, me 2 vendime shkarkimi nga detyra³⁸². Krahasuar me numrin total të gjyqtarëve aktivë (rreth 250–270), ky volum vendimmarrjeje disiplinore është i moderuar, që mund të interpretohet në dy mënyra: ose sistemi gjyqësor ka nivele të ulëta të shkeljeve disiplinore (interpretim pozitiv), ose ka nën-përdorim të mekanizmave disiplinorë (interpretim më kritik).

Bashkëpunimi midis KLGJ-së dhe ILD-së është dëshmuar të jetë funksional, megjithëse jo pa tensione. Sipas raporteve vjetore, gjatë vitit 2022, përveç procedimeve disiplinore, KLGJ-ja shqyrtoi gjithashtu 147 ankime (22 të mbartura nga 2021 dhe 125 të regjistruara në 2022) kundër vendimeve të ILD-së për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. Kjo dëshmon ekzistencën e një mekanizmi kontrolli të dyfishtë: ILD-ja ushtron kontrollin parësor mbi nismën disiplinore, ndërsa KLGJ-ja, përmes Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve, ushtron kontrollin dytësor mbi vendimet e ILD-së.

3.3 Konsolidimi institucional dhe funksional i KLGJ-së gjatë periudhës 2018–2024

Koncepti i vetëqeverisjes gjyqësore, i konsoliduar në praktikën ndërkombëtare përmes dokumenteve të Komisionit të Venecias, Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (CCJE) dhe Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), nënkupton një sistem ku trupa gjyqësore, përmes përfaqësuesve të zgjedhur prej saj dhe me pjesëmarrjen e jogjyqtarëve të zgjedhur demokratikisht, administrojnë çështjet e brendshme të gjyqësorit pa ndërhyrje nga ekzekutivi³⁸³. Tre parimet themelore të vetëqeverisjes gjyqësore janë: (i) pavarësia institucionale (organi nuk duhet t'i nënshtrohet ekzekutivit); (ii) përbërja e ekuilibruar (shumicë gjyqtarësh por jo monopolizim profesional); dhe (iii) llogaridhënia demokratike (transparenca, raportimi përpara Kuvendit, mbikëqyrja gjyqësore mbi vendimet).

Modeli shqiptar i KLGJ-së përmbush të tre këto parime në mënyrë të kënaqshme. Pavarësia institucionale garantohet nga karakteri kushtetues i organit, mandati 5-vjeçar i

³⁸²Procedimet disiplinore janë: 3 në vitin 2020, 3 në vitin 2021, 5 në vitin 2022 (nga të cilat 2 me masë “Pezullim nga detyra”), si dhe 12 procedime gjatë vitit 2024 (përfshirë 2 shkarkime nga detyra). Burim: Raportet Vjetore 2020, 2021, 2022 dhe 2024.

³⁸³Mbi konceptin e vetëqeverisjes gjyqësore, shih Komisioni i Venecias, “Report on the Independence of the Judicial System — Part I: The Independence of Judges”, CDL-AD(2010)004; dhe CCJE, Opinion nr. 10 (2007).

pa-ripërtëritshëm, autonomia buxhetore dhe pavarësia procedurale. Përbërja e ekuilibruar realizohet me formulën 6+5 (gjyqtarë + jogjyqtarë). Llogaridhënia demokratike sigurohet nga: (a) raportimi vjetor i detyrueshëm përpara Kuvendit; (b) publikimi i raporteve vjetore dhe i të gjitha vendimeve; (c) mundësia e ankesës kundër vendimeve të KLGJ-së përpara Gjykatës Administrative; dhe (d) mbikëqyrja kushtetuese e Gjykatës Kushtetuese mbi aktet me karakter të përgjithshëm.

Sipas Raportit Vjetor 2022 të KLGJ-së, gjatë periudhës 2019–2022, Këshilli ka kryer 7 deklaratat zyrtare në mbrojtje dhe mbështetje të figurës së gjyqtarëve, si dhe 3 deklaratat për shtyp me objekt “Reagim dhe informim mbi veprimtarinë e Këshillit”. Këto deklaratat janë instrumente me peshë të rëndësishme, sepse mbrojnë gjyqtarë nga sulme publike të papërligjura ndaj profesionalitetit ose integritetit të tyre³⁸⁴. Roli i KLGJ-së si “mbrojtës i pavarësisë institucionale” përfaqëson një funksion sa simbolik aq dhe substancial: kur një anëtar i ekzekutivit, i Kuvendit ose i medias kritikon në mënyrë të papërligjur trupën gjyqësore, KLGJ-ja ka legjitimitetin e nevojshëm për të reaguar publikisht, duke mbrojtur kështu pavarësinë e gjyqësorit.

Po ashtu, KLGJ-ja merr vendime për mbrojtjen e veçantë të magjistratëve gjatë ushtrimit të funksionit përmes Komisionit të përkohshëm për mbrojtjen e gjyqtarëve, të familjes dhe të pasurisë së tyre, që funksionon në bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore. Pavarësisht se ky komision ka pasur veprimtari të kufizuar (1 vendim për mbrojtje gjatë 2022, 3 vendime gjatë 2020), prania e tij është e rëndësishme: ai siguron që gjyqtarët të cilët gjykojnë çështje të ndjeshme (terrorizëm, krim i organizuar, korrupsion i lartë) të kenë mbrojtje fizike dhe institucionale, që është parakusht i ushtrimit të lirshëm të funksionit gjyqësor.

Si organ i vetëqeverisjes, KLGJ-ja nuk vepron në izolim institucional, por në një rrjet të dendur bashkëpunimesh me institucione të tjera kushtetuese dhe ligjore. Sipas raporteve vjetore, bashkëpunimi më intensiv realizohet me: (i) Kuvendin e Republikës, përmes raportimit vjetor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit, si dhe propozimeve për ndryshime ligjore; (ii) Ministrinë e Drejtësisë, për reformat strukturore (përfshirë hartën gjyqësore) dhe nismat ligjore; (iii) Shkollën e Magjistraturës, për përcaktimin e kuotave të kandidatëve për magjistratë dhe trajnimin e vazhdueshëm; (iv) organet e rivlerësimit kalimtar (KPK, KPA, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit), për mbështetjen me raporte profesionale; dhe (v) Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, për procedurat disiplinore³⁸⁵.

Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë përfaqëson një dimension tjetër të rëndësishëm. Që nga krijimi, KLGJ-ja është mbështetur nga programe të jashtme: “Drejtësi për të Gjithë” (USAID), Misioni EURALIUS V, Projekti i Cilësisë dhe etë drejtësisë i Këshillit të Evropës, Akademia e Transparencës SHBA-Shqipëri (USATA), si dhe organizata si OSBE-ja, OPDAT, Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (IRZ). Po ashtu, KLGJ-ja është anëtare e Rrjetit të Këshillave Gjyqësorë Evropian (ENCJ) dhe ka marrë pjesë në krijimin e Rrjetit Rajonal të Këshillave Gjyqësorë (Ballkani Perëndimor). Këto angazhime ndërkombëtare jo vetëm sigurojnë mbështetje

³⁸⁴Raportet Vjetore të KLGJ-së dokumentojnë: 7 deklaratat zyrtare në mbrojtje të figurës së gjyqtarëve gjatë periudhës 2019–2022, dhe 3 deklaratat për shtyp “Reagim dhe informim mbi veprimtarinë e Këshillit”.

³⁸⁵Bashkëpunimi ndërinstitucional i KLGJ-së përfshin: Kuvendin (raportim vjetor), Ministrinë e Drejtësisë (reformat strukturore), Shkollën e Magjistraturës (formimi fillestar dhe vazhdueshëm), organet e rivlerësimit kalimtar (KPK, KPA, ONM), dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

teknike dhe financiare, por edhe vlerësim të jashtëm të performancës institucionale dhe legjitimitimi i KLGJ-së si organ modern i vetëqeverisjes.

Një organ i vetëqeverisjes, sado i pajisur me kompetenca kushtetuese dhe ligjore, mbetet i paaftë të prodhojë rezultate substanciale pa një strukturë administrative të konsoliduar dhe pa politika koherente për menaxhimin e burimeve njerëzore. Në këtë drejtim, Këshilli i Lartë Gjyqësor është konfiguruar që në fillim si një institucion me dy nivele të menaxhimit të burimeve njerëzore: (i) administrimi i burimeve të vetë institucionit, përfshirë anëtarët e Këshillit dhe stafin mbështetës; dhe (ii) menaxhimi i burimeve njerëzore në tërësinë e sistemit gjyqësor, përfshirë gjyqtarët dhe nëpunësit civilë gjyqësorë në të gjitha gjykatat e vendit³⁸⁶. Ky dualitet i ekzistencës — si organ administrativ i vetë-administruar dhe si organ administrues i një sistemi më të gjerë — përcakton kompleksitetin e sfidave me të cilat Këshilli është përballur që nga viti 2018.

Sipas strukturës organizative të Këshillit, miratuar në bazë të nenit 95 të Ligjit nr. 115/2016, KLGJ-ja përbëhet nga 11 anëtarë (Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 9 anëtarë të tjerë) dhe një administratë mbështetëse që në vitin 2022 numëronte 117 nëpunës civilë e punonjës administrativë, duke arritur në një strukturë të përgjithshme prej 128 punonjësish³⁸⁷. Organika faktike, megjithatë, ka qenë gjithmonë më e ulët se ajo e parashikuar: në vitin 2022, KLGJ-ja ka funksionuar me 106 punonjës efektivisht në detyrë (83% e organikës së plotë), kurse gjatë vitit 2024 numri i strukturës është rritur në linjë me kërkesat e shtuara të punës.

Administrata e Këshillit organizohet në departamente dhe drejtori, ku ndër strukturat më të rëndësishme përmenden Sekretari i Përgjithshëm (i nivelit të lartë drejtues), Departamenti i administrimit të gjykatave dhe teknologjisë së informacionit, Drejtoria e burimeve njerëzore, Drejtoria e marrëdhënieve me publikun, si dhe njësitë specializuara si Njësia e vlerësimit etik dhe profesional. Çdo Komision i Përhershëm ka në mbështetje këshilltarë profesionistë, të cilët kryejnë analiza paraprake, përgatisin projekt-vendime dhe sigurojnë kujtesën institucionale të Komisionit. Sipas raportimeve për vitin 2022, në KLGJ ushtrojnë funksionin 2 nëpunës të nivelit të lartë drejtues dhe 14 nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (5 drejtorë drejtorie dhe 9 këshilltarë komisionesh).

Përbërja gjinore e administratës së Këshillit pasqyron një ekuilibër në favor të grave: 59,4% e stafit të KLGJ-së në vitin 2022 ishte e gjinisë femërore, kurse në nivelin e lartë dhe të mesëm drejtues kjo përqindje arriti në 75%. Ky tregues, ndonëse jashtë fokusit kryesor të analizës mbi administrimin e gjyqësorit, ka rëndësi institucionale: ai dëshmon zbatimin e parimit të barazisë gjinore në strukturat e qeverisjes së gjyqësorit, parim i parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në standardet evropiane për qeverisjen demokratike³⁸⁸.

Menaxhimi i burimeve njerëzore në sistemin gjyqësor ka qenë sfida më e madhe operacionale e Këshillit gjatë gjithë periudhës 2018–2024. Sipas dekretit të Presidentit të Republikës, struktura organizative e gjyqësorit parashikon 408 gjyqtarë në të gjitha nivelet, të shoqëruar nga 1.187 nëpunës të administratës gjyqësore. Megjithatë, organika faktike ka mbetur konstantesisht nën këtë shifër, kryesisht si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar

³⁸⁶Mbi dualitetin e funksioneve të menaxhimit të burimeve njerëzore — administrimi i brendshëm i KLGJ-së dhe menaxhimi i sistemit në tërësi — shih CCJE, Opinion nr. 10 (2007), pika 19, që rekomandon “një administratë profesionale me autonomi të mjaftueshme financiare dhe operacionale” për këshillat gjyqësore.

³⁸⁷Sipas Raportit Vjetor 2022, fq. 27, organika e KLGJ-së është: 11 anëtarë + 117 nëpunës civilë e punonjës administrativë = 128 punonjës. Organika faktike në fund të vitit 2022 ishte 106 punonjës (83% e organikës së plotë).

³⁸⁸Raporti Vjetor 2022, fq. 28: 59,4% e stafit të KLGJ-së ishte e gjinisë femërore (63 punonjës nga 106 totalit), kurse në nivelin e lartë dhe të mesëm drejtues përqindja arriti në 75% (12 nga 16 punonjës).

(vetting), i cili ka çuar në shkarkimin e dhjetëra gjyqtarëve dhe në krijimin e vakancave të vështira për t'u plotësuar³⁸⁹.

Të dhënat e raportuara në Raportet Vjetore të KLGJ-së vizatojnë një tablo shqetësuese për pjesën më të madhe të periudhës. Në fund të vitit 2022, numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë ishte vetëm 228 — 8,2 gjyqtarë për 100.000 banorë, krahasuar me mesataren evropiane prej 22,2 gjyqtarësh për 100.000 banorë sipas raportit CEPEJ 2022. Kjo do të thoshte se sistemi gjyqësor shqiptar gjatë vitit 2022 funksionoi me afërsisht 56% të kapacitetit të dekretuar, ku gjyqtarët efektivisht në detyrë përbënin më pak se 40% të mesatares evropiane për 100.000 banorë.

Tabloja u përmirësua progresivisht në vitet 2023 dhe sidomos në 2024. Sipas të dhënave të Raportit Vjetor 2024, në fund të atij viti rezultojnë 272 gjyqtarë efektivisht në detyrë, duke arritur 66,6% të kapacitetit të dekretuar — një rritje prej rreth 6,6% krahasuar me 2023, kur numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë ishte 247. Rritja u mundësua kryesisht nga emërimi i 32 magjistratëve të rinj, që përfunduan Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2023–2024, si dhe nga rikthimi në detyrë i disa gjyqtarëve, që kishin kaluar me sukses procesin e rivlerësimit³⁹⁰. Në një vështrim tërësor, gjatë periudhës 2019–2024, në sistem janë emëruar gjithsej 144 magjistratë: 4 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë nga radhët e juristëve të spikatur dhe 140 magjistratë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Pavarësisht këtyre rritjeve, treguesi i numrit të gjyqtarëve për 100.000 banorë në fund të vitit 2024 ishte vetëm 9,85 — pra ende më pak se gjysma e mesatares evropiane prej 21,9 gjyqtarësh për 100.000 banorë sipas raportit CEPEJ. Ky hendek strukturor mes Shqipërisë dhe vendeve të BE-së në lidhje me kapacitetin njerëzor të gjyqësorit përbën, sipas vetë Këshillit, faktorin kryesor, që kushtëzon performancën cilësore të sistemit gjyqësor dhe ngarkesën e lartë mbi gjyqtarët efektivisht në detyrë.

Tabela 3. Evolucioni i burimeve njerëzore në sistemin gjyqësor, 2019–2024

Treguesi	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Gjyqtarë sipas dekretit	408	408	408	408	408	408
Gjyqtarë efektivisht në detyrë	≈245	≈230	≈220	228	247	272
Plotësim i organikës (%)	≈60%	≈56%	≈54%	55,8%	60,5%	66,6%
Gjyqtarë / 100.000 banorë	—	≈8,2	7,91	8,16	8,9	9,85
Mesatarja CEPEJ (gjyqtarë/100k)	—	22,2	22,2	22,2	21,9	21,9
Magjistratë të emëruar gjatë vitit	—	13	18	23	≈30	32
Gjyqtarë të shkarkuar (kumulativ KPK)	—	≈90	≈110	126	≈137	144
Vakanca totale gjyqtarësh	—	—	≈170	180	≈155	136

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e Raporteve Vjetore të KLGJ-së për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2024, krahasuar me të dhënat CEPEJ. Vlerat e shënuara me shenjën “≈” përfaqësojnë vlerësime të bazuara në burime sekondare ose interpolime nga vlerat zyrtare të raportuara në vitet ngjitur.

³⁸⁹Procesi i rivlerësimit kalimtar (vetting), i parashikuar në Aneksin e Kushtetutës dhe në Ligjin nr. 84/2016, është realizuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA). Procesi ka qenë mekanizmi qendror i pastrimit të gjyqësorit nga elemente të kompromentuara, por ka çuar në mungesë të theksuar të burimeve njerëzore.

³⁹⁰Raporti Vjetor 2024, fq. 33, dokumenton se gjatë vitit 2024 në sistem janë emëruar 32 magjistratë të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2023–2024.

3.3.1 Mekanizmat e planifikimit, transparencës dhe llogaridhënies institucionale

Planifikimi strategjik institucional përbën një instrument relativisht të ri për qeverisjen gjyqësore në Shqipëri, i futur në praktikë vetëm pas reformës kushtetuese të vitit 2016 dhe instalimit të KLGJ-së. Me Vendimin nr. 98, datë 18.06.2019, Këshilli miratoi Planin e tij të parë strategjik për sistemin gjyqësor, që mbulonte periudhën 2019–2020, i shoqëruar me një Plan veprimi të detajuar dhe me indikatorë të matshëm³⁹¹. Ky plan, i hartuar në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë (USAID, Misioni EURALIUS, Këshilli i Evropës), shërbeu si udhërrëfyes për 12 muajt e parë të funksionimit operativ të Këshillit, duke përcaktuar prioritetet kryesore: konsolidimin institucional, plotësimin e vakancave, fillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional, si dhe themelimin e infrastrukturës digjitale.

Plani i dytë strategjik, që mbulonte periudhën 2022–2024, u miratua me Vendimin nr. 184, datë 11.05.2022. Ky plan i ri u rikonceptua në bazë të analizës së zbatueshmërisë së Planit të parë, që identifikoi mangësitë dhe arritjet e periudhës 2019–2020, si dhe iu përshtat kontekstit të ri operativ, sidomos zbatimit të Hartës së re gjyqësore, sfidave të vazhdueshme të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe nevojës për intensifikim të komunikimit me publikun. Plani Strategjik 2022–2024 u shoqërua nga Plani i komunikimit për gjykatat, miratuar me Vendimin nr. 454, datë 02.11.2022, që përcaktonte një kornizë dyvjeçare për ndëreveprimin e gjykatave me publikun dhe median. Në vijimësi të këtij cikli planifikimi, KLGJ miratoi edhe Planin Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë 2025–2027, me Vendimin nr. 771, datë 29.10.2025, duke e shtrirë qasjen strategjike të institucionit në fazën pas konsolidimit fillestar të hartës së re gjyqësore dhe duke e orientuar atë drejt forcimit të integritetit, transparencës, efikasitetit dhe luftës kundër korrupsionit³⁹².

Më tej, gjatë vitit 2024, Këshilli ka filluar punën për përgatitjen e Planit Strategjik 2025–2027, si dhe për Strategjinë Kombëtare të Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata 2024–2027 (miratuar me Vendimin nr. 223, datë 25.04.2024)³⁹³. Hartimi i një strategjie të dedikuar për reduktimin e backlog-ut përfaqëson një moment të rëndësishëm institucional: për herë të parë, KLGJ-ja ndërmerr një politikë të dedikuar afatshkurtër-afatmesme për një nga problematikat më të mprehta strukturore të sistemit gjyqësor shqiptar.

Sipas detyrimeve të nenit 18 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, KLGJ-ja është autoritet publik i nënshtuar në regjimin e transparencës proaktive dhe ka publikuar në faqen e tij zyrtare Programin e Transparencës, që përditësohet rregullisht. Numri i kërkesave për informacion drejtuar Këshillit ka qenë i vogël por i qëndrueshëm: 24 kërkesa në 2022 dhe një numër i ngjashëm në vitet 2023–2024³⁹⁴, të cilat janë trajtuar

³⁹¹Vendimi i KLGJ-së nr. 98, datë 18.06.2019 “Për miratimin e Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, viti 2019–20”.

³⁹² Këshilli i Lartë Gjyqësor, *Plani Strategjik i Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë 2025–2027*, 2025.

³⁹³Vendimi i KLGJ-së nr. 184, datë 11.05.2022 “Për miratimin e Planit Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, viti 2022–24”; Vendimi nr. 454, datë 02.11.2022 “Mbi Planin e Komunikimit për Gjykatat”; Vendimi nr. 223, datë 25.04.2024 “Mbi miratimin e Planit Strategjik 2024–2025 për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura”.

³⁹⁴Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikon detyrimin e autoriteteve publike për transparencë proaktive përmes Programit të Transparencës. Sipas Raportit Vjetor 2022, KLGJ-ja trajtoi 24 kërkesa për informacion gjatë vitit 2022, të gjitha brenda afateve ligjore.

brenda afateve të arsyeshme ligjore. Asnjë nga rastet e trajtuara gjatë periudhës 2020–2024 nuk ka rezultuar në ankim pranë Komisionerit për të Drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale për refuzim të padrejtë të informacionit, që përbën një tregues të rëndësishëm të cilësisë së përgjegjshmërisë institucionale.

Vlerësimi i transparencës proaktive të KLGJ-së, kryer nga Komisioneri për të Drejtën e informimit përmes indeksit të transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë (publikuar në dhjetor 2022), klasifikoi Këshillin me 6 nga 8 pikë maksimale, duke e kategorizuar institucionin si “transparent proaktiv mesatar”. Ky vlerësim, ndonëse jo i shkëlqyer, përfaqëson përmirësim të dukshëm krahasuar me vitet e mëparshme dhe vendos KLGJ-në në nivel të krahasueshëm me institucionet e tjera kushtetuese.

Llogaridhënia parlamentare e KLGJ-së realizohet përmes raportit vjetor të detyrueshëm mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit, dorëzuar Kuvendit në bazë të nenit 95, pika 2 të Ligjit nr. 115/2016. Pas shqyrtimit, Kuvendi miraton një rezolutë vlerësuese, që përmban rekomandime konkrete për Këshillin për vitin pasardhës³⁹⁵. Ky cikël i raportim-rezolutë-zbatim përfaqëson mekanizmin kryesor formal të llogaridhënies dhe ka funksionuar përgjithësisht në mënyrë të rregullt gjatë gjithë periudhës 2019–2024. Rekomandimet e Kuvendit kanë trajtuar tema të vazhdueshme: plotësimin e vakancave, përsheptimin e procedurave të vlerësimit, mbështetjen për Gjykatën e Lartë, dhe ndjekjen e zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore.

Krahas raportit vjetor, Kryetari i KLGJ-së merr pjesë rregullisht në seancat e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit, ku paraqet pozicione zyrtare mbi nismat ligjore që prekin sistemin gjyqësor. Gjatë vitit 2022, KLGJ-ja propozoi në Kuvend një paketë ndryshimesh për paketën ligjore të sistemit të drejtësisë (në tetor të atij viti), duke ushtruar kështu rolin e tij aktiv të iniciativës legjislative në fushën e qeverisjes gjyqësore.

3.3.2 Rikonceptimi i organizimit të brendshëm të gjykatave pas reformës në drejtësi: nga modeli i fragmentuar drejt qeverisjes së brendshme institucionale

Administrimi i gjykatave ka qenë një nga aspektet më problematike të kuadrit ligjor para reformës në drejtësi, duke u konsideruar shpesh si një nga dobësitë kryesore të ligjit nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Kuadri i mëparshëm ligjor fokusohej kryesisht në statusin, të drejtat dhe detyrimet e magjistratit, ndërsa dimensionin administrativ i funksionimit të gjykatës trajtohej në mënyrë të kufizuar dhe jo të sistematizuar. Rregullimi normativ përqendrohej kryesisht te roli i kryetarit të gjykatës dhe i kancelarit, ndërkohë që struktura e gjerë e administratës gjyqësore parashikohej në mënyrë minimaliste.

Në këtë kontekst, neni 39 i ligjit nr. 9877/2008 parashikonte se shërbimet ndihmëse në gjykatë kryheshin nga sekretaria gjyqësore dhe nga sektorët e administratës, ekonomisë, financës, informatizimit, regjistrimit dhe arkivimit të dokumenteve. Megjithatë ky formulim identifikonte disa funksione bazë mbështetëse, ai nuk arrinte të pasqyronte kompleksitetin real të veprimtarive administrative që mbështesin procesin gjyqësor. Administrata gjyqësore trajtohej më tepër si një strukturë teknike ndihmëse dhe jo si një

³⁹⁵Detyrimi i raportimit vjetor është i parashikuar në nenin 95, pika 2 të Ligjit nr. 115/2016, që specifikon edhe afatet dhe formën e raportimit. Rezolutat parlamentare miratohen pas shqyrtimit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

komponent funksional i drejtësidhënies, i lidhur drejtpërdrejt me aksesin në drejtësi, cilësinë e shërbimit, menaxhimin e çështjeve dhe besimin publik te gjykatat.

Pikërisht kjo paqartësi normative u reflektua edhe në kontrollin kushtetues të disa dispozitave të ligjit nr. 9877/2008. Vendimi nr. 20, datë 9.7.2009 i Gjykatës Kushtetuese përbën një moment të rëndësishëm në zhvillimin e jurisprudencës shqiptare mbi pavarësinë gjyqësore dhe raportin ndërmjet administrimit gjyqësor dhe pushtetit ekzekutiv. Çështja u iniciua nga Shoqata kombëtare e gjyqtarëve, e cila kundërshtoi, ndër të tjera, nenin 37, pika 2, që parashikonte emërimin dhe shkarkimin e kancelarit nga Ministri i Drejtësisë, si dhe nenin 38, shkronjat “a” dhe “b”, që i njihnin kancelarit kompetenca për emërimin dhe shkarkimin e personelit të sekretarisë gjyqësore dhe të administratës teknike, si edhe për mbikëqyrjen e procesit të ndarjes së çështjeve me short.

Gjykata Kushtetuese e shqyrtoi çështjen në dritën e parimeve të shtetit të së drejtës, ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe pavarësisë së gjyqësorit. Ajo theksoi se pavarësia gjyqësore nuk mund të kuptohet vetëm si pavarësi individuale e gjyqtarit në dhënien e vendimit, por përfshin edhe dimensionin institucional, organizativ dhe administrativ të funksionimit të gjykatave. Në këtë kuptim, administrata gjyqësore nuk mund të ndahet artificialisht nga funksioni i dhënies së drejtësisë, pasi sekretaria gjyqësore, regjistrimi, dokumentimi, njoftimet, arkivimi dhe administrimi i dosjeve janë elemente që ndikojnë drejtpërdrejt në procesin e rregullt ligjor dhe në funksionimin efektiv të gjykatës.

Mbi këtë bazë, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se vendosja e administratës gjyqësore në një skemë varësie hierarkike nga Ministri i Drejtësisë, përmes kancelarit, mund të krijonte rrezik për ndikim të papërshtatshëm mbi funksionin gjyqësor dhe të cenonte pavarësinë organizative të gjykatave. Për këtë arsye, ajo shfuqizoi si të papajtueshme me Kushtetutën dispozitën, që i jepte kancelarit kompetencën për të emëruar dhe shkarkuar personelin e sekretarisë gjyqësore dhe personelin administrativo-teknik të gjykatës. Në të njëjtën kohë, Gjykata nuk e konsideroi antikushtetuese kompetencën e kancelarit për mbikëqyrjen e organizimit dhe dokumentimit të shortit, për sa kohë procedurat e shortit përcaktoheshin nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe nuk lejonin ndërhyrje në shpërndarjen konkrete të çështjeve. Ndërsa për dispozitën, që parashikonte emërimin dhe shkarkimin e kancelarit nga Ministri i Drejtësisë, Gjykata nuk arriti shumicën e nevojshme për një vendim themeli, duke e rrëzuar kërkesën për këtë pjesë për arsye procedurale.

Rëndësia doktrinare e këtij vendimi qëndron në faktin se ai e zhvendosi kuptimin e pavarësisë gjyqësore nga një koncept i ngushtë, i lidhur vetëm me gjyqtarin individual, drejt një koncepti më të gjerë institucional. Në këtë kuadër, administrimi i gjykatave, menaxhimi i personelit dhe autonomia organizative u identifikuan si kushte të domosdoshme për ushtrimin real dhe efektiv të funksionit të drejtësidhënies.

Reforma e vitit 2016 synoi pikërisht të adresonte këto mangësi. Miratimi i ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, solli një rikonceptim të thellë të administratës gjyqësore, duke e zhvendosur atë nga një model i fragmentuar, minimalist dhe heterogjen, drejt një modeli institucional më të standardizuar, të bazuar në parime të shërbimit civil, meritokracisë, profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë. Sipas këtij ligji, administrata gjyqësore përkufizohet si struktura dhe tërësia e veprimtarive që synojnë organizimin dhe sigurimin e funksionimit të gjykatave, duke përfshirë nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjës të tjerë gjyqësorë.

Reforma në drejtësi nuk u kufizua tek riformimi i organit qendror të qeverisjes. Por, përmes Ligjit nr. 98/2016, ajo solli edhe një ribërje thelbësore të arkitekturës menaxheriale

brenda secilës gjykatë. Neni 7 i këtij ligji shpall parimin e bashkëpunimit midis pesë organeve të administrimit gjyqësor: KLGJ-ja, Këshilli i Gjykatës, Kryetari i gjykatës, Kancelari, dhe kategoritë e ndryshme të nëpunësve civilë gjyqësorë. Të pesta këto organe “bashkëpunojnë për të garantuar që pushteti gjyqësor të jetë i pavarur, efikas, i besueshëm dhe transparent”.³⁹⁶ Tre nga këta — Këshilli i Gjykatës, Kancelari dhe kategoria e nëpunësve civilë gjyqësorë — janë institucione plotësisht të reja, të paparashikuara në Ligjin nr. 9877/2008.

Risia më e rëndësishme e ligjit nr. 98/2016 është krijimi i shërbimit civil gjyqësor si një regjim juridik i posaçëm për personelin administrativ të gjykatave. Ky status synon të garantojë qëndrueshmëri, profesionalizëm, integritet dhe performancë të matshme në funksionimin e shërbimeve gjyqësore. Në këtë mënyrë, administrata gjyqësore nuk perceptohet më si një strukturë dytësore ose thjesht teknike, por si pjesë funksionale e drejtësisë, e cila ndikon drejtpërdrejt në aksesin në gjykatë, në cilësinë e shërbimit, në ritmin e shqyrtimit të çështjeve dhe në besimin e publikut ndaj sistemit gjyqësor.

Nga pikëpamja normative, shërbimi civil gjyqësor prodhon tri pasoja kryesore. Së pari, ai garanton një status juridik më të qëndrueshëm për nëpunësit civilë gjyqësorë, duke i dalluar ata nga punonjësit e tjerë të gjykatës, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës. Së dyti, ai synon të sigurojë stabilitet institucional, duke shmangur lëvizjet e shpeshta të personelit dhe humbjen e kapaciteteve profesionale të krijuara brenda gjykatave. Së treti, ai vendos një logjikë karriere të bazuar në meritë, përmes rekrutimit, trajnimit, vlerësimit, mobilitetit dhe ngritjes në detyrë, duke e trajtuar personelin administrativ si kapital institucional të sistemit gjyqësor.

Në këtë arkitekturë të re, roli i Këshillit të Lartë Gjyqësor është përcaktues. Sipas nenit 90 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, KLGJ ushtron kompetenca të rëndësishme në mbikëqyrjen e burimeve njerëzore të gjykatave. Ai vepron si organ emërues dhe disiplinor për kategori të caktuara të nëpunësve civilë gjyqësorë, veçanërisht për kancelarët, ndihmësit ligjorë dhe këshilltarët ligjorë në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu, KLGJ miraton kurrikulat e formimit fillestar dhe programet e trajnimit të vazhdueshëm për administratën gjyqësore, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe institucionet e tjera përkatëse. Ky rol tregon se reforma nuk synoi vetëm ndryshimin formal të statusit të administratës gjyqësore, por krijimin e një sistemi të ri të menaxhimit të burimeve njerëzore në gjykata.

Një tjetër element thelbësor i reformës është rikonceptimi i drejtimit të brendshëm të gjykatës. Ligji nr. 98/2016 vendos një model të ri udhëheqjeje institucionale, të ndërtuar mbi tri subjekte kryesore: Këshillin e Gjykatës, kryetarin e gjykatës dhe kancelarin. Ky model synon të zëvendësojë administrimin e mëparshëm të personalizuar dhe të fragmentuar me një sistem më kolegjal, më të standardizuar dhe më të përgjegjshëm.

Në aspektin funksional, Këshilli i Gjykatës përfaqëson mekanizmin ku ndërthuren dimensionin gjyqësor dhe ai administrativ i funksionimit të gjykatës. Ai merr vendime për organizimin e brendshëm, strukturën, ndarjen në seksione, projektbuxhetin, sigurinë, infrastrukturën, shërbimet ndihmëse, marrëdhëniet me publikun dhe çështje të statusit të nëpunësve civilë gjyqësorë. Përmes këtij organi, ligji krijon një mekanizëm të brendshëm

³⁹⁶Ligji nr. 98/2016, neni 7, pika 1: “Administrimi gjyqësor është detyrë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Gjykatës, kryetarit të gjykatës, kancelarit, kategorive të ndryshme të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe çdo institucioni tjetër të përcaktuar me ligj”.

vetëqeverisjeje, ku vendimmarrja administrative nuk përqendrohet te një individ i vetëm, por shpërndahet ndërmjet aktorëve kryesorë të drejtimit të gjykatës.

Sipas nenit 27 të Ligjit nr. 98/2016, “në çdo gjykatë ngrihet dhe funksionon Këshilli i gjykatës”. Përbërja e tij përfshin tre anëtarë: Kryetarin e gjykatës (i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës), Zëvendëskryetarin, dhe Kancelarin. Në raste të veçanta — kur Këshilli vendos për çështje në lidhje me kancelarin — ky i fundit zëvendësohet nga gjyqtari i renditur më pas; kur Këshilli vepron si komision disiplinor për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë, kancelari zëvendësohet nga një nëpunës i lartë civil gjyqësor i KLGJ-së, i caktuar nga ky i fundit.³⁹⁷ Funksionimi i Këshillit të Gjykatës — me njoftim paraprak, kuorum të plotë, vendosje me shumicë votash, publikim i procesverbalit në faqen zyrtare — rregullohet nga neni 28 i Ligjit nr. 98/2016.³⁹⁸

Kompetencat e Këshillit të Gjykatës, sipas nenit 38 të Ligjit nr. 98/2016, janë gjithëpërfshirëse për administrimin e brendshëm të gjykatës: (a) miraton përshkrimet e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor; (b) merr vendime në lidhje me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë; (c) miraton strukturën dhe organikën e administratës së gjykatës (sipas modelit të miratuar nga KLGJ-ja); (ç) miraton strukturën e gjykatës dhe cakton gjyqtarët në seksione dhe trupa gjykues, pas marrjes së mendimit të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve; (d) shqyrton ankesat për çështje infrastrukturore dhe të shërbimeve ndihmëse; (dh) vlerëson dhe shqyrton projektbuxhetin përpara paraqitjes në KLGJ; dhe (e–gj) jep informacion ose mendime për institucionet shtetërore, bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës, organizon takime me përdoruesit e gjykatës, miraton rregulla të veçanta për ruajtjen dhe sigurinë.³⁹⁹ Në këtë kuptim, Këshilli i Gjykatës përfaqëson një nga risitë më të rëndësishme të arkitekturës së re të administrimit të brendshëm, pasi vendimmarrja administrative zhvendoset nga modeli i personalizuar drejt një modeli kolegjal, më transparent dhe më të përgjegjshëm. Në raste të caktuara, për shkak të konfliktit të interesit ose kur Këshilli vepron si komision disiplinor për kategori të caktuara të nëpunësve civilë gjyqësorë, përbërja e tij ndryshon sipas parashikimeve ligjore. Ky rregullim synon të garantojë paanshmëri, transparencë dhe përgjegjshmëri në vendimmarrjen administrative të gjykatës.

Pikërisht këtu shfaqet zhvendosja më e rëndësishme e kompetencave brenda gjykatës: caktimi i gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues, që sipas Ligjit nr. 9877/2008 ishte kompetencë vetiake e Kryetarit të gjykatës (neni 18, pika 1), tani është kompetencë e Këshillit të Gjykatës si organ kolegjal. Ky është një ndryshim me efekt të drejtpërdrejtë mbi pavarësinë e brendshme të gjyqtarit, pasi heq një instrument të mundshëm presioni nga duart e një titullari të vetëm hierarkik.

Sipas Ligjit nr. 9877/2008, neni 16, Kryetari i gjykatës emërohej drejtpërdrejt nga KLD-ja mbi bazën e konkurrimit dhe ushtronte i vetëm një gamë të gjerë kompetencash

³⁹⁷Ligji nr. 98/2016, neni 27, pikat 1 dhe 2: “Në çdo gjykatë ngrihet dhe funksionon Këshilli i Gjykatës. Këshilli i Gjykatës përbëhet nga tre anëtarë: kryetari, zëvendëskryetari dhe kancelari. Kryetari i Gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës; b) zëvendëskryetari i gjykatës; c) kancelari i gjykatës”.

³⁹⁸Ligji nr. 98/2016, neni 28: funksionimi i Këshillit të Gjykatës — drejtimi nga kryetari, thirrja sa herë kërkohet, njoftimi paraprak të paktën tri ditë para mbledhjes me materialet dhe projektvendimet, regjistrimi i mbledhjes, vendosja me shumicë votash në prani të të gjithë anëtarëve, publikimi i përmbledhjes së procesverbalit në faqen zyrtare të gjykatës.

³⁹⁹Ligji nr. 98/2016, neni 38, që parashikon ndër të tjera: miratimin e përshkrimeve të punës për nëpunësit civilë gjyqësorë; vendimet për statusin e tyre; miratimin e strukturës dhe organikës së administratës së gjykatës (sipas modelit të KLGJ-së); miratimin e strukturës së gjykatës dhe caktimin e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues; shqyrtimin e ankesave për infrastrukturën dhe shërbimet ndihmëse; vlerësimin e projektbuxhetit; bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës dhe KLGJ-në për formimin profesional.

drejtuese (përfshirë caktimin e gjyqtarëve në seksione, planifikimin e gjyqtarëve për çështje të ngutshme, mbikëqyrjen disiplinore). Reforma e ka rikonceptuar këtë figurë në një drejtues, që ushtron kompetenca jo më i vetëm, por në bashkëpunim të strukturuar me Këshillin e Gjykatës. Sipas nenit 26 të Ligjit nr. 98/2016, Kryetari zgjidhet sipas procedurave të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, ndërsa Zëvendëskryetari zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të gjykatës — risi e dukshme.⁴⁰⁰

Kryetari i gjykatës ruan funksionin klasik të drejtimit gjyqësor, por roli i tij reformohet për shkak të ndërveprimit me Këshillin e Gjykatës dhe kancelarin. Ai përfaqëson gjykatën në marrëdhënie me të tretët, kryeson mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve dhe Këshillin e Gjykatës, mbikëqyr etikën dhe solemnitetin gjyqësor, koordinon me KLGJ-në për çështje të vlerësimit profesional dhe etik, si dhe garanton zbatimin e vendimeve dhe politikave të KLGJ-së.

Kompetencat e Kryetarit, të listuara në nenin 37 të Ligjit nr. 98/2016, janë qartësisht ato të një drejtuesi të “menaxhimit të përgjithshëm gjyqësor”, përfaqësim i gjykatës, miratim i listës së gjyqtarëve për çështje urgjente, mbikëqyrje e etikës dhe disiplinës, kërkesë për fillim të hetimit kur dyshohet shkelje disiplinore, kujdes për administrimin gjyqësor përmes kancelarit, thirrje dhe drejtim të mbledhjeve të përgjithshme të gjyqtarëve dhe të Këshillit të Gjykatës, udhëzim dhe mbikëqyrje e kancelarit. Në këtë mënyrë, kryetari nuk është më vetëm drejtues administrativ i gjykatës, por një figurë institucionale, që lidh pavarësinë gjyqësore me përgjegjshmërinë organizative.

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve, e parashikuar në nenin 29 të Ligjit nr. 98/2016, është një organ tjetër i ri brenda arkitekturës së gjykatës. Ajo thirret rregullisht (të paktën një herë në muaj, sipas nenit 40), kryesohet nga Kryetari, është e vlefshme kur marrin pjesë shumica e gjyqtarëve, dhe regjistrohet me audio dhe procesverbal të ruajtur për dhjetë vjet.⁴⁰¹ Sipas nenit 40, kompetencat e saj përfshijnë: zgjedhjen e Zëvendëskryetarit; diskutimin dhe dhënien e mendimit për raportin vjetor të gjykatës; diskutimin e çështjeve të natyrës juridike, vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimeve të KLGJ-së dhe akteve të kontrollit dhe inspektimit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.⁴⁰² Krijimi i kësaj mbledhjeje si organ formal me kompetenca i jep secilës gjykatë një hapësirë të institucionalizuar bisedimi ku gjyqtarët mund të diskutojnë çështjet themelore juridike, profesionale dhe administrative të gjykatës — element ky që mungonte në kornizën e Ligjit nr. 9877/2008.

Nga ana tjetër, pozicioni i kancelarit, i krijuar me Ligjin nr. 98/2016, është një nga risitë më të dukshme në arkitekturën e re. Neni 39 e përcakton si “përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor” dhe e pajis me një grup kompetencash që e bëjnë *de facto* menaxherin e përgjithshëm administrativ të gjykatës: është anëtar me të drejtë vote

⁴⁰⁰Ligji nr. 98/2016, neni 26: “Kryetari i një gjykate zgjidhet sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve’ dhe ka kompetencat e përcaktuara sipas këtij ligji.” Pikat 3 dhe 4 parashikojnë se Zëvendëskryetari zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, për një mandat trevjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje.

⁴⁰¹Ligji nr. 98/2016, neni 29: “Mbledhja e përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të gjykatës thirret rregullisht dhe kryesohet nga kryetari i gjykatës [...]. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë shumica e gjyqtarëve.” Pika 2 parashikon regjistrim audio dhe procesverbal për diskutimet, që ruhen për të paktën dhjetë vjet dhe i vihen në dispozicion gjyqtarëve të gjykatës, anëtarëve të KLGJ-së dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

⁴⁰²Ligji nr. 98/2016, neni 40: kompetencat e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve përfshijnë zgjedhjen e Zëvendëskryetarit, diskutimin dhe dhënien e mendimit për raportin vjetor të gjykatës, diskutimin e çështjeve të natyrës juridike, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e KLGJ-së dhe akte të kontrollit dhe inspektimit të ushtruara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

në Këshillin e Gjykatës; kryen veprime dhe merr vendime për statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë; mbikëqyr procesin e ndarjes së çështjeve me short; emëron, drejton dhe shkarkon punonjësit e gjykatës; mbikëqyr mirëmbajtjen e godinës.⁴⁰³ Përgjegjësitë e tij plotësohen, sipas pikës 2 të të njëjtit nen, me funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, raportimin periodik te KLGJ-ja, dhe sigurimin e qasjes në të dhënat statistikore.⁴⁰⁴

Në vijim të këtij rikonceptimi, neni 50 i Ligjit nr. 98/2016 e ndan këtë trupë në shtatë kategori: kancelari, këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë, ndihmësi ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, kryesekretari, sekretari gjyqësor, nëpunësi i financës dhe buxhetit, si dhe nëpunës të tjerë (në kërkim ligjor, burime njerëzore, IT, arkiv, marrëdhënie me publikun). Pranimi në shërbimin civil gjyqësor kalon përmes formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (për kancelarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë) ose përmes konkurrimit të hapur (për nëpunësit e tjerë), me kritere të veçanta të diferencuara sipas pozicionit.⁴⁰⁵ Statusi kalimtar i kancelarëve, që ishin në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të reformës rregullohet me kujdes në nenin 83 të Ligjit nr. 98/2016, që parashikon verifikim të pasurisë, figurës dhe kushteve ligjore nga KLGJ-ja, si dhe një provim profesional me kërkesën minimale prej 70 për qind të pikëve, përtej të cilit kancelari konsiderohet i papërshtatshëm dhe ndërpriten marrëdhëniet e punës.⁴⁰⁶

Në këtë kuptim, modeli i ri i administrimit gjyqësor pas reformës paraqitet si një model i institucionalizuar dhe kolegjal i drejtimit të gjykatës. Kolegjaliteti i Këshillit të Gjykatës, drejtimi gjyqësor i kryetarit dhe menaxhimi profesional administrativ i kancelarit ndërthuren në një sistem funksional, që synon të balancojë pavarësinë gjyqësore, autonominë institucionale, përgjegjshmërinë dhe efikasitetin administrativ. Ky model përputhet me idenë se një gjykatë e mirëadministruar nuk mund të ekzistojë pa një formë të mirëqeverisjes së brendshme, ku vendimmarrja është transparente, e kontrollueshme dhe e orientuar drejt së mirës së përbashkët.

Nga pikëpamja praktike, që nga viti 2019, kur numri i nëpunësve civilë gjyqësorë ishte 655, ai është rritur progresivisht në 744 në fund të vitit 2022 (89 punonjës më shumë në katër vjet) dhe ka vijuar të rritet edhe në vitet 2023–2024. Vetëm gjatë vitit 2022, numri i punonjësve të administratës gjyqësore u rrit me 50 pozicione shtesë, prej të cilëve 47 iu akorduan gjykatave dhe 3 KLGJ-së.

Gjatë vitit 2022, raporti gjyqtar/staf administrativ në sistemin gjyqësor ishte 1:3,3 (sipas organikës së miratuar) dhe 1:4,6 në fakt — një tregues, që afrohet me mesataren evropiane prej 1:3,9 sipas raportit CEPEJ. Megjithatë, ky raport është rritur artificialisht në bazë faktike për shkak të numrit të ulët të gjyqtarëve efektivisht në detyrë: kur ka pak

⁴⁰³Ligji nr. 98/2016, neni 39: “Kancelari është përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor dhe në veçanti ka kompetencat e mëposhtme: a) është anëtar me të drejtë vote në Këshillin e Gjykatës [...]; b) kryen veprime dhe merr vendime që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë [...]; c) mbikëqyr procesin e organizimit dhe dokumentimit të ndarjes së çështjeve me short; d) emëron, drejton, mbikëqyr dhe shkarkon punonjësit e gjykatës; e) mbikëqyr mirëmbajtjen e godinës së gjykatës.”

⁴⁰⁴Ligji nr. 98/2016, neni 39, pika 2: pas këshillimit me Kryetarin, Kancelari është përgjegjës për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, raportimin periodik te KLGJ-ja, raportimin e nevojave të sistemit, drejtimin dhe mbikëqyrjen e nëpunësve civilë gjyqësorë, dhe sigurimin e qasjes në të dhëna statistikore për KLGJ-në dhe Ministrinë e Drejtësisë.

⁴⁰⁵Ligji nr. 98/2016, neni 50 (kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë), neni 53 (vlerësimi kualifikues për kancelar, këshilltar dhe ndihmës ligjor, përfshirë formimin fillestar nga Shkolla e Magjistraturës çdo tri vjet për kancelarët), nenet 54–56 (vlerësimi i nëpunësve të tjerë dhe kriteret e veçanta për pranim).

⁴⁰⁶Ligji nr. 98/2016, neni 83: regjim kalimtar për kancelarët në detyrë, që duhet t’i nënshtrohen verifikimit të pasurisë, figurës dhe kushteve ligjore nga KLGJ-ja brenda gjashtë muajve nga krijimi i tij, dhe pastaj të kalojnë provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës me të paktën 70 për qind të pikëve.

gjyqtarë por sasi normale e administratës, raporti shfaqet i favorshëm pa qenë domosdoshmërisht treguesi i një shërbimi cilësor.

Zhvillimi profesional i gjyqtarëve dhe nëpunësve civilë gjyqësorë përbën një kompetencë të bashkëndarë midis KLGJ-së dhe Shkollës së Magjistraturës. Këshilli, si organi që menaxhon karrierën e gjyqtarëve, ka rolin e identifikimit të nevojave për trajnim dhe propozimit të temave specifike, kurse Shkolla është institucioni që kryen trajnimin fillestar dhe vazhdues⁴⁰⁷. Sipas raportimeve, numri i gjyqtarëve të trajnuar gjatë programit vazhdues ka qenë mbresëlënës: 220 gjyqtarë në vitin 2022 (96,5% e gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën), niveli i njëjtë i mbulimit të vazhdueshëm ka mbetur edhe gjatë viteve 2023 dhe 2024.

Trajnimi i nëpunësve civilë gjyqësorë ka qenë gjithashtu i shtuar në fokus, duke u realizuar përmes bashkëpunimit me Shkollën shqiptare të administratës publike (ASP), Shkollën e Magjistraturës dhe partnerët ndërkombëtarë. Vetëm në vitin 2022, 103 nëpunës civilë gjyqësorë morën trajnim përmes këtyre kanaleve, ndërsa në vitin 2024 numri arriti në 117 nëpunës civilë gjyqësorë të trajnuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe 23 nga partnerët ndërkombëtarë. Gjithashtu, KLGJ-ja ka miratuar rregulla të reja për përgjegjshmërinë disiplinore të nëpunësve civilë gjyqësorë (kancelarë, këshilltarë, ndihmës ligjorë), përmes rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor”, miratuar gjatë vitit 2022.

Nga analiza e mësipërme rezulton se administrimi gjyqësor përbën një nga dimensionet më të ndjeshme të organizimit të pushtetit gjyqësor në Shqipëri, veçanërisht në periudhën para reformës në drejtësi. Kuadri ligjor i vitit 2008 nuk arrinte të ndërtonte një model të plotë, të qartë dhe të standardizuar të administrimit të brendshëm të gjykatave, duke e trajtuar administratën gjyqësore kryesisht si strukturë ndihmëse teknike dhe jo si komponent funksional të drejtësidhënies. Kjo qasje krijonte boshllëqe normative, praktika të fragmentuara organizative dhe një varësi të tepruar të administrimit të gjykatës nga roli individual i kryetarit dhe kancelarit.

Një rol të rëndësishëm në zgjerimin e kuptimit të administrimit gjyqësor pati jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, veçanërisht Vendimi nr. 20, datë 9.7.2009. Ky vendim afirmoi se pavarësia e gjyqësorit nuk mund të reduktohet vetëm në pavarësinë individuale të gjyqtarit në dhënien e vendimit, por përfshin edhe autonominë organizative, administrative dhe funksionale të gjykatave. Në këtë kuptim, administrimi i gjykatave, menaxhimi i personelit, organizimi i shërbimeve ndihmëse dhe garancitë për ndarjen e çështjeve me short u identifikuan si elemente, që ndikojnë drejtpërdrejt në procesin e rregullt ligjor dhe në funksionimin efektiv të drejtësisë.

Reforma e vitit 2016 shënoi një ndryshim strukturor në këtë drejtim. Ligji nr. 98/2016 dhe ligji nr. 115/2016 e zhvendosën administrimin gjyqësor nga një model i fragmentuar dhe i personalizuar drejt një modeli më të institucionalizuar, kolegjal dhe të standardizuar. Krijimi i shërbimit civil gjyqësor, përcaktimi i rolit të KLGJ-së në menaxhimin e burimeve njerëzore, ngritja e Këshillit të Gjykatës si organ kolegjal i administrimit të brendshëm, si dhe rikonceptimi i rolit të kryetarit dhe kancelarit, përfaqësojnë elemente thelbësore të këtij transformimi institucional.

⁴⁰⁷Bashkëpunimi midis KLGJ-së dhe Shkollës së Magjistraturës rregullohet nga nenet 256–263 të Ligjit nr. 96/2016 dhe akteve të saj nënligjore, që përcaktojnë procedurat për përcaktimin e kuotave të kandidatëve për magjistratë dhe procedurat e formimit fillestar dhe vazhdues.

Në këtë arkitekturë të re, shërbimi civil gjyqësor paraqitet si një nga shtyllat kryesore të reformës së administrimit gjyqësor. Ai synon të garantojë stabilitet, profesionalizëm, meritokraci, integritet dhe performancë të matshme në funksionimin e gjykatave. Në këtë mënyrë, administrata gjyqësore nuk trajtohet më si një funksion periferik apo thjesht teknik, por si një faktor me ndikim të drejtpërdrejtë në aksesin në drejtësi, cilësinë e shërbimit, ritmin e shqyrtimit të çështjeve dhe besimin publik ndaj sistemit gjyqësor.

Po kështu, ngritja e Këshillit të Gjykatës dhe rishpërndarja e kompetencave të brendshme kanë rëndësi të veçantë për forcimin e pavarësisë së brendshme të gjyqtarit. Transferimi i kompetencave strukturore, përfshirë caktimin e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues, nga kryetari i gjykatës te një organ kolegjal, zvogëlon rrezikun e përqendrimit të pushtetit administrativ në duart e një titullari të vetëm dhe krijon garanci më të mëdha për transparencë, përgjegjshmëri dhe paanshmëri në drejtimin e gjykatës.

Nga pikëpamja praktike, forcimi i administratës gjyqësore, rritja e numrit të nëpunësve civilë gjyqësorë, përmirësimi i raportit gjyqtar/staf mbështetës dhe zgjerimi i programeve të trajnimit tregojnë se reforma nuk ka pasur vetëm karakter formal ose normativ, por ka synuar edhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale të gjykatave. Megjithatë, këto tregues duhet të lexohen me kujdes, pasi raportet numerike mund të reflektojnë jo vetëm rritje reale të kapaciteteve administrative, por edhe efektin e numrit të ulët të gjyqtarëve efektivisht në detyrë.

Në përfundim, reforma e administrimit gjyqësor dëshmon se pavarësia gjyqësore dhe mirëadministrimi nuk janë kategori të ndara, por dimensione të ndërvarura të funksionimit të shtetit të së drejtës. Një gjyqësor i pavarur kërkon jo vetëm garanci kushtetuese për statusin e gjyqtarit, por edhe gjykata të mirëorganizuara, administratë profesionale, mekanizma të qartë përgjegjshmërie dhe një model drejtimi që ndërthur kolegjalitetin, profesionalizmin dhe eficiencën institucionale. Për këtë arsye, administrimi gjyqësor duhet të konsiderohet jo si funksion ndihmës, por si kusht thelbësor për efektivitetin, legjitimitetin dhe besueshmërinë e sistemit të drejtësisë.

3.3.3 Teknologjia e informacionit si instrument i administrimit të mirë dhe qeverisjes digjitale të drejtësisë

Administrimi i mirë i gjykatës nuk mund të reduktohet në organizimin e brendshëm të sekretarisë gjyqësore, në ndarjen formale të detyrave administrative ose në sigurimin e kushteve materiale minimale për zhvillimin e seancave. Në kuptimin bashkëkohor, ai përfaqëson një funksion të mirëfilltë qeverisës, përmes të cilit gjykata organizon burimet njerëzore, teknologjike, financiare dhe procedurale për të garantuar ushtrimin efektiv të funksionit gjyqësor. Për këtë arsye, administrimi i gjykatës duhet të kuptohet si ura lidhëse ndërmjet pavarësisë gjyqësore, e cila mbron gjyqtarin nga ndërhyrjet e jashtme dhe llogaridhënies institucionale, e cila kërkon që sistemi gjyqësor të prodhojë rezultate të matshme, të parashikueshme dhe të aksesueshme për qytetarin. Në këtë kuadër, teknologjia e informacionit nuk është më thjesht një instrument ndihmës, por një komponent strukturor i administrimit gjyqësor sepse ndikon drejtpërdrejt në regjistrimin e çështjeve, shpërndarjen e tyre, menaxhimin e kalendarit, gjenerimin e statistikave, publikimin e vendimeve dhe komunikimin ndërmjet gjykatës, palëve dhe institucioneve të tjera publike.

Në sistemin gjyqësor shqiptar, përpjekjet për digjitalizimin e administrimit gjyqësor kanë nisur relativisht herët, që në fillim të viteve 2000, duke reflektuar nevojën

për modernizimin e menaxhimit të çështjeve, rritjen e eficiencës procedurale dhe forcimin e transparencës institucionale. Këto iniciativa përbëjnë fazën fillestare të transformimit digjital të gjyqësorit shqiptar dhe janë mbështetur kryesisht nga partnerë ndërkombëtarë zhvillimorë. Në këndvështrimin e administrimit të mirë të gjykatës, këto përpjekje nuk duhen parë thjesht si zhvillime teknike, por si hapa të parë drejt ndërtimit të një modeli më të strukturuar, më të matshëm dhe më të përgjegjshëm të funksionimit të gjykatave. Administrimi i mirë kërkon që veprimtaria gjyqësore të mbështetet jo vetëm në rregulla procedurale, por edhe në kapacitete institucionale për të mbledhur, përpunuar dhe përdorur të dhëna të sakta mbi funksionimin real të gjykatës.

Në këtë kuadër, në gjykatat shqiptare u vendosën dy sisteme paralele të menaxhimit elektronik të çështjeve: ICMS/CCMIS dhe ARK-IT. Sistemi ICMS/CCMIS u zhvillua me mbështetjen e Bankës Botërore për Qeverinë Shqiptare, me kontribut financiar dhe teknik shtesë nga Bashkimi Evropian, ndërsa sistemi ARK-IT u financua nga Fondacioni Soros dhe DANIDA. Vlerësimi krahasimor i realizuar nga Projekti EURALIUS në vitin 2006, në dokumentin *“Rekomandim për kompjuterizimin e gjykatave: Krahasimi ndërmjet sistemit CCMIS të Bankës Botërore dhe sistemit ARK-IT të USAID-it”*, evidentoi se sistemi CCMIS paraqiste avantazhe më të mëdha në aspektin e arkitekturës teknologjike, integritimit institucional dhe mundësisë për zhvillim afatgjatë të një sistemi të unifikuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore⁴⁰⁸.

Nga pikëpamja e administrimit të gjykatës, rëndësia e këtyre sistemeve qëndron në faktin se ato kontribuan në formalizimin e proceseve të regjistrimit dhe ndjekjes së çështjeve, në rritjen graduale të kapaciteteve të administratës gjyqësore dhe në krijimin e një kulture të re institucionale mbi rëndësinë e të dhënave, statistikave dhe monitorimit. Përmes tyre, teknologjia filloi të shfaqej si instrument i domosdoshëm për administrimin e mirë të gjykatës, pasi administrimi efektiv nuk mund të mbështetet vetëm në organizim formal, por kërkon informacion të saktë, të përditësuar dhe të përdorshëm për vendimmarrje institucionale.

Pas reformës në drejtësi të vitit 2016, administrimi institucional i sistemeve të teknologjisë së informacionit pësoi ndryshime thelbësore. Nëse më parë sistemi ICMS administrohej nga Ministria e Drejtësisë, pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kompetencat për administrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në gjykata u transferuan te ky institucion, në përputhje me arkitekturën e re të vetëqeverisjes gjyqësore të parashikuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Ky ndryshim duhet kuptuar jo thjesht si transferim teknik i përgjegjësisë, por si zhvendosje konceptuale e administrimit të teknologjisë nga ekzekutivi drejt organeve të vetëqeverisjes gjyqësore, në funksion të pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mirëfunksionimit të pushtetit gjyqësor. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 147/a, i ngarkon Këshillit të Lartë Gjyqësor përgjegjësinë për sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mirëfunksionimit të pushtetit gjyqësor, ndërsa ligji nr. 115/2016, në nenin 92/c, parashikon krijimin e një sistemi të integruar të teknologjisë së informacionit për institucionet e drejtësisë.

Kjo lidhje ndërmjet administrimit të mirë dhe teknologjisë merr rëndësi të veçantë në kontekstin shqiptar, ku reforma kushtetuese dhe ligjore e vitit 2016 synoi jo vetëm

⁴⁰⁸ Dokumentacion arkivor i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, administruar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Rekomandim për kompjuterizimin e gjykatave: Krahasimi ndërmjet sistemit CCMIS të Bankës Botërore dhe sistemit ARK-IT të USAID-it”, dokument i konsultuar pranë arkivit institucional të KLGJ-së nga autori.

riorganizimin e organeve të qeverisjes së drejtësisë, por edhe ndërtimin e një modeli të ri administrimi të gjykatave, më të standardizuar, më të matshëm dhe më të orientuar drejt performancës. Ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, krijuan bazën normative për një administrim gjyqësor të mbështetur në standarde të unifikuara, në planifikim strategjik, në menaxhim buxhetor dhe në përdorim sistematik të të dhënave. Në këtë kuptim, teknologjia e informacionit duhet të shihet si pjesë e arkitekturës së re të qeverisjes gjyqësore dhe jo si një projekt i veçantë teknik⁴⁰⁹.

Në praktikë, funksionimi paralel i sistemeve ARK-IT dhe ICMS ka evidentuar kufizime të rëndësishme teknike dhe funksionale. Një sistem elektronik i menaxhimit të çështjeve duhet të mbulojë të gjithë ciklin procedural, nga regjistrimi i padisë, hedhja e shortit dhe mbajtja e procesverbalit, deri te publikimi i vendimeve dhe gjenerimi i statistikave. Gjithashtu, ai duhet të garantojë siguri të të dhënave, gjurmueshmëri të proceseve dhe akses ndërgjyqësor në dosje edhe pas kalimit të tyre në nivele më të larta gjykimi. Megjithatë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Raportin Vjetor 2019, ka evidentuar se sistemi ICMS paraqiste problematika të tilla si pamundësia për të gjeneruar statistika të sakta automatike, mungesa e ndërveprueshmërisë me sisteme të tjera shtetërore, mospërshtatja me ndryshimet procedurale, kufizimet në konfigurimin e trupave gjyqësore, publikimi i vendimeve pa anonimizim dhe mospërputhja ndërmjet të dhënave të regjistrave fizikë dhe atyre elektronikë.

Këto problematika ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e administrimit të gjykatës, sepse kufizojnë aftësinë e drejtuesve të gjykatave dhe të organeve të qeverisjes gjyqësore për të monitoruar ngarkesën, për të analizuar vonesat, për të identifikuar shkaqet e stokut të çështjeve të prapambetura dhe për të planifikuar burimet njerëzore mbi bazën e të dhënave të besueshme. Për këtë arsye, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vlerësuar se modernizimi dhe zëvendësimi i sistemit ekzistues të menaxhimit të çështjeve me një platformë të re, të integruar dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare të e-Justice, përbën domosdoshmëri për garantimin e funksionimit eficient, transparent dhe të qëndrueshëm të administrimit gjyqësor.

Në këtë kontekst, krijimi i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të qeverisjes së TIK-ut në gjyqësor. QTI u ngrit me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 972/2020 “Për organizimin, funksionimin dhe përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë”, mbi bazën e kuadrit kushtetues dhe ligjor që rregullon qeverisjen e sistemit të drejtësisë, përfshirë nenet 147/a dhe 148/b të Kushtetutës dhe nenin 92/c të ligjit nr. 115/2016. Vendorsja e saj pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe pajisja me buxhet të dedikuar synojnë të garantojnë funksionim të qëndrueshëm institucional, koordinim ndërinstitutional dhe autonomi në administrimin e infrastrukturës digjitale të drejtësisë.

Në plan funksional, sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve gjyqësore, CMIS, i cili tashmë është në fazën e implementimit, pritet të rrisë eficiencën dhe cilësinë e proceseve gjyqësore, si dhe transparencën e veprimtarisë institucionale, duke garantuar njëkohësisht respektimin e plotë të garancive të gjyqimit të drejtë në mjediset e digjitalizuara. Sistemi

⁴⁰⁹ Ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

do të mbulojë të gjithë ciklin e administrimit të çështjeve, duke përfshirë gjenerimin automatik të statistikave, menaxhimin e ngarkesës dhe kalendarëve gjyqësorë, hartimin, anonimizimin dhe publikimin elektronik të vendimeve, krijimin e dosjeve të plota digjitale, si dhe aksesin e sigurt për përdoruesit e autorizuar. Në këtë drejtim, standardet e CEPEJ-it mbi drejtësinë digjitale theksojnë se teknologjia duhet të shërbejë për një drejtësi më efikase, më transparente dhe më të aksesueshme, por gjithmonë në përputhje me garancitë e procesit të rregullt ligjor dhe me parimin e gjykimit të drejtë. Kjo qasje reflektohet në dokumentet e CEPEJ-it, veçanërisht në “Guidelines on how to drive change towards Cyberjustice”, CEPEJ(2016)13, dhe në “Digitalisation for a better justice: CEPEJ Action Plan 2022–2025”, CEPEJ(2021)12.

Nga pikëpamja e administrimit të gjykatës, vlera e CMIS-it qëndron në aftësinë për të krijuar një sistem unik informacioni mbi ecurinë e çështjes, veprimet procedurale, kohëzgjatjen, ngarkesën e gjyqtarëve dhe performancën administrative. Një sistem i tillë mundëson që drejtuesit e gjykatave të identifikojnë më shpejt pengesat procedurale, vonesat strukturore, mbingarkesën e seksioneve të caktuara dhe nevojën për masa organizative. Për rrjedhojë, CMIS-i nuk duhet kuptuar thjesht si platformë teknologjike, por si instrument i administrimit të mirë, sepse shndërron të dhënat gjyqësore në burim vendimmarrjeje.

Transformimi digjital i gjyqësorit, megjithatë, nuk është një proces thjesht teknik. Ai prek mënyrën se si konceptohet autoriteti gjyqësor, marrëdhënia gjykatë–palë, organizimi i punës administrative dhe vetë natyra e dhënies së drejtësisë. Për këtë arsye, teknologjia në gjyqësor nuk mund të trajtohet si një mjet neutral. Ajo riartikullon raportin ndërmjet gjykimit njerëzor dhe automatizimit, ndërmjet transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave, si dhe ndërmjet eficiencës procedurale dhe garancive të procesit të rregullt. Karta Evropiane Etike e CEPEJ-it për përdorimin e inteligjencës artificiale në sistemet gjyqësore, e miratuar në vitin 2018, vendos si parime themelore respektimin e të drejtave themelore, mosdiskriminimin, cilësinë dhe sigurinë e të dhënave, transparencën, kontrollueshmërinë dhe nënshtrimin e mjeteve të inteligjencës artificiale ndaj kontrollit njerëzor.

Po në këtë linjë, Opinioni nr. 26 i Këshillit konsultativ të gjyqtarëve evropianë, “Moving forward: the use of assistive technology in the judiciary”, i vitit 2023, e koncepton teknologjinë si “assistive technology”, pra si mjet ndihmës dhe jo zëvendësues të funksionit gjyqësor. Ky Opinion thekson se përgjegjësia përfundimtare për vendimin gjyqësor duhet të mbetet gjithmonë njerëzore dhe se teknologjia nuk duhet të diktojë përmbajtjen e vendimit, por vetëm të mbështesë gjyqtarin në ushtrimin e funksionit të tij. Ky standard është veçanërisht i rëndësishëm për administrimin e gjykatës, sepse vendos një kufi të qartë ndërmjet përdorimit të teknologjisë për menaxhim, organizim dhe mbështetje administrative, nga njëra anë dhe ruajtjes së pavarësisë dhe përgjegjësisë së gjyqtarit në vendimmarrje, nga ana tjetër.

Në përfundim, teknologjia e informacionit duhet të konceptohet si instrument në shërbim të administrimit të mirë të gjykatës dhe jo si qëllim në vetvete. Ajo mund të përmirësojë ndjeshëm menaxhimin e çështjeve, shpërndarjen e ngarkesës, gjurmueshmërinë e veprimeve procedurale, transparencën institucionale dhe aksesin në drejtësi. Megjithatë, efektiviteti i saj varet nga cilësia e administrimit të të dhënave, nga siguria e sistemeve, nga ndërveprueshmëria institucionale, nga trajnimi i përdoruesve dhe nga ruajtja e kontrollit njerëzor mbi vendimmarrjen gjyqësore. Prandaj, një gjykatë teknologjikisht e avancuar mund të konsiderohet realisht e mirëadministruar vetëm kur

teknologjia shërben për të forcuar dhe jo për të zëvendësuar, pavarësinë gjyqësore, përgjegjshmërinë institucionale, transparencën dhe orientimin e sistemit gjyqësor drejt qytetarit.

3.3.4 Sfidat strukturore të administrimit gjyqësor dhe kufijtë e pavarësisë institucionale

Pavarësisht arritjeve të dukshme në konsolidimin institucional dhe progresit në disa fusha specifike, periudha 2018–2024 ka qenë e karakterizuar nga sfida strukturore, që kanë ndikuar dukshëm në efektshmërinë e administrimit gjyqësor. Identifikimi sistematik i këtyre sfidave përbën një parakusht për të kuptuar kufijtë e modelit shqiptar të vetëqeverisjes gjyqësore dhe drejtimit e mundshme të reformave të mëtejshme.

Vakancat strukturore përbëjnë sfidën më të mprehtë të periudhës. Ndonëse procesi i rivlerësimit kalimtar (veting) ka qenë domosdoshmëri institucionale për pastrimin e gjyqësorit nga elemente të kompromentuara nga pikëpamja etike dhe pasurore, kostot e tij operacionale për sistemin kanë qenë domethënëse. Sipas Raportit Vjetor 2024, që nga fillimi i procesit deri më 31 dhjetor 2024 janë shkarkuar nga detyra në total 144 gjyqtarë me vendim të KPK-së, me një efekt financiar kumulativ në shumën 965.768.125 lekë⁴¹⁰. Vetëm gjatë vitit 2024 janë shkarkuar 7 gjyqtarë me vendimmarrje të KPK-së. Përveç këtij grupi, gjatë vitit 2024 rezultojnë 60 gjyqtarë me vendimmarrje shkarkimi nga KPK-ja që presin zhvillimin e procesit në KPA, duke mbajtur statusin e gjyqtarit për shkak të pezullimit dhe duke përfituar 75% të pagës bruto fillestare sipas ligjit, me një efekt financiar prej 140.992.975 lekë.

⁴⁶⁴ Këshilli i Evropës. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 5(3): “Çdo person i arrestuar ose i ndaluar në përputhje me dispozitat e paragrafit 1(c) të këtij Neni duhet të sillet menjëherë para një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar pushtet gjyqësor dhe ka të drejtë të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit. Lirimi mund të kushtëzohet nga garancitë për t'u paraqitur në gjyq”. Në të vërtetë, edhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë në vendimet e saj të hershme C-185/95, vendim i 17 dhjetorit 1998, nënvizoi rëndësinë e vendimit përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm.

⁴⁶⁵ Këshilli i Evropës. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 13.: “Kushdo, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, duhet të ketë një mjet efektiv juridik para një autoriteti kombëtar, pavarësisht nëse shkelja është kryer nga persona që veprojnë në një cilësi zyrtare”.

⁴⁶⁶ Calvez, F., cit note 46.

⁴⁶⁷ Kombet e Bashkuara. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Neni. 14(3): “Në përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij, kushdo ka të drejtë për garancitë minimale të mëposhtme, në barazi të plotë: (a) Të informohet menjëherë dhe në detaje në një gjuhë që e kupton për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij; (b) Të ketë kohë dhe lehtësira të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe për të komunikuar me avokatin e zgjedhur prej tij; (c) Të gjykohe pa vonesa të panevojshme; (d) Të gjykohe në prani të tij dhe të mbrohet vetë personalisht ose nëpërmjet ndihmës ligjore të zgjedhur prej tij; të informohet, nëse nuk ka ndihmë ligjore, për këtë të drejtë; dhe t'i caktohet ndihmë ligjore, në çdo rast kur interesat e drejtësisë e kërkojnë këtë dhe pa pagesë nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar atë; (e) Të marrë në pyetje, ose të ketë marrë në pyetje, dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij sipas të njëjtave kushte si dëshmitarët kundër tij; (f) Të ketë ndihmën falas të një përkthyesi nëse nuk mund ta kuptojë ose të flasë gjuhën e përdorur në gjykatë; (g) Të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetes ose të pranojë fajësinë”.

⁴⁶⁸ Bashkimi Evropian. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Neni 47(2): “Çdokush ka të drejtë për një seancë të drejtë dhe publike brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar më parë me ligj. Çdokush ka mundësinë të këshillohet, të mbrohet dhe të përfaqësohet”.

⁴⁶⁹ *Intiba kundër Turqisë*, vendim i 24 majit 2005.

“arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit të veçantë dhe duke iu referuar kriterëve të mëposhtme: kompleksiteti i çështjes, sjellja e aplikantit dhe autoriteteve përkatëse dhe çfarë ishte në diskutim për aplikantin gjatë mosmarrëveshjes”⁴⁷⁰ [përthim nga autori]. Të kuptuarit kur një çështje konsiderohet si komplekse është thelbësore për vlerësimin e efikasitetit gjyqësor dhe përcaktimin e afateve kohore të arsyeshme në procedurat gjyqësore. Kompleksiteti mund të lindë si nga rregullat ligjore ashtu edhe nga rrethanat faktike që rrethojnë çështjen. Për shembull, një procedurë ligjore mund të konsiderohet komplekse nëse përfshin një ndryshim të dukshëm në legjislacion, siç është kalimi nga rregullat komuniste në rregullat demokratike. Për më tepër, rastet në të cilat zgjidhja e një çështjeje civile varet nga përfundimi paraprak i një procedure penale, ose nga përfundimi më parë i procedurave të tjera civile të lidhura me të, dëshmojnë më tej kompleksitetin që buron nga rregullat ligjore.⁴⁷¹

Megjithatë, një çështje mund të jetë komplekse edhe për shkak të fakteve të çështjes. Shembuj, që mund të përfshijnë nevojën për të intervistuar një numër të madh dëshmitarësh,⁴⁷² ekspertizë të veçantë ose vështirësi në rindërtimin e fakteve dhe mbledhjen e provave,⁴⁷³ veçanërisht në rastin e mungesës së dëshmitarëve në një çështje penale,⁴⁷⁴ nevojën për përthim ose një përthyes⁴⁷⁵ ose një rast kompleks mashtrimi.⁴⁷⁶ Kështu, ndonjëherë, megjithëse procedura ligjore është jashtë parametrave të “kohës së arsyeshme”, GJEDNJ-ja mund të vërtetojë se një shtet nuk ka shkelur nenin 6(1) të KEDNJ-së.⁴⁷⁷

Sipas GJEDNJ-së, aplikantët në procedurat civile duhet të kenë “kujdesin e duhur”. Kështu, vetëm “vonesat, që i atribuohen shtetit, mund të justifikojnë një konstatim të mosrespektimit të kërkesës së ‘kohës së arsyeshme’⁴⁷⁸ [përthim nga autori]. Megjithatë, në rastin e mosmarrëveshjeve penale, “...neni 6 nuk kërkonte që aplikantët të bashkëpunonin në mënyrë aktive me autoritetet gjyqësore”⁴⁷⁹ [përthim nga autori]. Kështu, “personi i interesuar kërkohet vetëm të tregojë zell në kryerjen e hapave proceduralë që kanë të bëjnë me të, të përmbahet nga përdorimi i taktikave vonuese dhe të përfitojë nga veprimi i dhënë nga ligji i brendshëm për shkurtimin e procedurave. Ai nuk ka asnjë detyrë të ndërmarrë veprime, që nuk janë të përshtatshme për këtë qëllim”⁴⁸⁰ [përthim nga autori]. Shtetet nuk do të konsiderohen përgjegjës për shkelje të nenit 6 (1) të KEDNJ-së nëse aplikantët bëjnë disa ankesa kushtetuese, që janë jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese,⁴⁸¹ kërkojnë disa shtyrje të procedurave,⁴⁸² ose përpiqen të sigurojnë

⁴⁷⁰ Frydlander kundër Francës, vendim i 27 qershorit 2000, § 43.

⁴⁷¹ Jangozov kundër Bullgarisë, vendim i 8 korrikut 2004.

⁴⁷² Mitev kundër Bullgarisë, vendim i 22 dhjetorit 2004.

⁴⁷³ Akçakale kundër Turqisë, vendim i 25 majit 2004.

⁴⁷⁴ Jean-Claude Boddaert kundër Belgjikë, vendim i 17 prillit 1991; El Khoury kundër Gjermanisë, vendim i 9 korrikut 2015.

⁴⁷⁵ Sari kundër Turqisë dhe Danimarkës, vendim i 8 nëntorit 2001.

⁴⁷⁶ Wejrup kundër Danimarkës, vendim i 7 marsit 2002.

⁴⁷⁷ Habran and Dalem kundër Belgjikë, vendim i 17 janarit 2017. Sipas GJEDNJ-së, çështja ishte shumë komplekse, me një numër të madh faktesh dhe informacionesh brenda një krimi të organizuar.

⁴⁷⁸ Hervouet kundër France, vendim i 2 korrikut 1997.

⁴⁷⁹ Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë, vendim i 15 korrikut 1982, § 82.

⁴⁸⁰ Union Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës, vendim i 7 korrikut 1989, § 35.

⁴⁸¹ Pereira da Silva kundër Portugalisë, vendim i 22 marsit 2016; Liga Portuguesa de Futebol Profissional kundër Portugal, vendim i 17 majit 2016.

⁴⁸² Bor kundër Hungarisë, vendim i 18 qershorit 2013; JGK Statyba Ltd dhe Guselnikovas kundër Lituaniës, vendim i 5 nëntorit 2013.

një zgjidhje miqësore,⁴⁸³ ose shmangien e drejtësisë me vullnetin e tyre të lirë.⁴⁸⁴ Nga ana tjetër aplikantët nuk mund të konsiderohen përgjegjës për vonesat, që lidhen me shëndetin e tyre.⁴⁸⁵

Për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, shtetet mund të mos jenë përgjegjës për shkeljen e nenit 6(1) të KEDNJ-së. Për shembull, situata të veçanta socio-ekonomike mund të konsiderohen si një justifikim. Konkretisht “shtrirja e problemeve që ndodhën në Reggio Calabria nga viti 1970 deri në vitin 1973 [të cilat] ... kishte dy implikime të rëndësishme për rastin konkret. Së pari, ato krijuan një klimë të pazakontë politike dhe sociale dhe një klimë, në të cilën gjykatat mund të frikësoheshin, në rast të dënimeve të precipituara ose dënimeve të rënda, një përsëritje të tensionit dhe madje edhe një përsëritje të çrregullimeve. Së dyti, problemet nuk ishin pa efekte në funksionimin e drejtësisë penale. Efekte të tilla u ndjenë kryesisht në Gjykatën Rajonale të Reggio, por edhe gjykatat në Potenza, në të cilat çështjet ishin transferuar, u përballën gjithashtu me një numër të jashtëzakonshëm çështjesh të prapambetura”.⁴⁸⁶ Prandaj, “këto rrethana duhet të mbahen parasysht dhe, në veçanti, kalimet normale të kohës që rrjedhin nga transferimi i çështjeve nuk duhet të konsiderohen të pajustificuara”⁴⁸⁷ [përkthim nga autori].

Edhe recesioni ekonomik mund të sjellë një rritje të mosmarrëveshjeve të punës.⁴⁸⁸ Kështu, shtetet nuk mund të jenë përgjegjës për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave ligjore. Për më tepër, një shtet nuk është përgjegjës kur ka nevojë për dokumente të shumta rogative në vende të tjera.⁴⁸⁹ Për më tepër, megjithëse shtetet mund të zvogëlojnë ndikimin e grevave të avokatëve, në përgjithësi, shtetet nuk do të ishin përgjegjës në rast vonesave që lidhen me të.⁴⁹⁰ Për më tepër, “një numër i përkohshëm i çështjeve të prapambetura nuk përfshin përgjegjësi nga ana e shteteve kontraktuese me kusht që ato të ndërmarrin, me shpejtësinë e nevojshme, veprime korrigjuese për t’u marrë me një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji”⁴⁹¹ [përkthim nga autori]. Kjo qasje duket disi shpërblyese për parlamentet kombëtare, që zgjidhin numrin e tyre të përkohshëm të çështjeve të prapambetura.

Argumentet tipike, të refuzuara për vonesat, lidhen me buxhetin, përpjekjen për t’ua lënë fajin aplikantëve dhe reformimin e sistemit gjyqësor. Lëvizja e kufizuar e shteteve nuk mund të konsiderohet si një argument për të justifikuar shkeljen e nenit 6(1).⁴⁹² Me fjalë të tjera, “u takon shteteve kontraktuese të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre t’i garantojnë gjithsecilit të drejtën për një vendim përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile”⁴⁹³ [përkthim nga autori].

Përveç kësaj, një shtet shkel nenin 6(1) të KEDNJ-së edhe kur vonesa shkaktohet për shkak të transferimit të juridiksionit nga gjykatat ushtarake në ato civile, pasi “neni 6(1) u imponon shteteve kontraktuese detyrën për të organizuar sistemin e tyre gjyqësor në

⁴⁸³ *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerë kundër Rumanisë*, vendim i 29 nëntorit 2016.

⁴⁸⁴ *Sari kundër Turqisë dhe Danimarkës*, vendim i 8 nëntorit 2001.

⁴⁸⁵ *Lavents kundër Latvia*, vendim i 28 shkurtit 2002; *Rashid kundër Bulgaria*, vendim i 5 qershorit 2008.

⁴⁸⁶ *Foti dhe të tjerët kundër Italisë*, vendim i 10 dhjetorit 1982.

⁴⁸⁷ *Ibid.*

⁴⁸⁸ *Buchholz kundër Gjermanisë*, vendim i 6 majit 1981.

⁴⁸⁹ *Neumeister kundër Austrisë*, vendim i 27 qershorit 1968.

⁴⁹⁰ *Savvidou kundër Greqisë*, vendim i 1 gushtit 2000.

⁴⁹¹ *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, vendim i 13 korrikut 1983.

⁴⁹² *Burdov kundër Rusisë*, vendim i 15 janarit 2009.

⁴⁹³ *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerë kundër Rumanisë*, vendim i 29 nëntorit 2016.

mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të plotësojnë secilën nga kërkesat e tij, duke përfshirë detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një afati të arsyeshëm”⁴⁹⁴ [përkthim nga autori].

Në zbatimin e nenit 6(1) të KEDNJ-së, gjyqtarët marrin parasysh edhe rrethanat e një çështjeje. Për shembull, një procedurë shtatëvjeçare me tre shkallë është shkelje e nenit 6(1) të KEDNJ-së kur kërkuesi/ja privohet nga pasuritë e tij/saj për shkak të autoriteteve tatimore.⁴⁹⁵

Në përgjithësi, mund të thuhet se “për të përcaktuar nëse shkelja e një të drejte arrin nivelin minimal të ashpërsisë, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm: natyra e të drejtës së pretenduar të shkelur, serioziteti i ndikimit të shkeljes së pretenduar në ushtrimin e një të drejte dhe/ose efektet e mundshme të shkeljes në situatën personale të aplikantit. Në vlerësimin e këtyre pasojave, Gjykata do të marrë në konsideratë, në veçanti, çështjen në lojë në procedurat kombëtare ose rezultatin e tyre”⁴⁹⁶ [përkthim nga autori]. Natyrisht, një procedurë që zgjat më shumë se 27 vjet është një shkelje e qartë e nenit 6(1) të KEDNJ-së.⁴⁹⁷

Për të ndihmuar shtetet, që të mos shkelin nenin 6(1) të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja ka përcaktuar se disa raste duhet të kenë “përparësi”. Megjithatë, ndërsa për këto raste gjykatat duhet të jenë të rrepta,⁴⁹⁸ megjithatë standardet e “kohës së arsyeshme” mbeten edhe në rastet e tjera, që nuk gjenden të çështjet ligjore me përparësi.⁴⁹⁹ Për më tepër, në raste të tjera, GJEDNJ ka konstatuar shkeljen e nenit 6(1) të KEDNJ-së, megjithëse procedura zgjati më pak se dy vjet për nivel juridiksioni.⁵⁰⁰

GJEDNJ-ja ka përcaktuar shtatë çështje prioritare. Duhet theksuar se edhe në të drejtën kanonike, gjatë shekullit të 14-të, disa kategori kontestesh kishin përparësi në procedurën ligjore më shumë se të tjerat.⁵⁰¹ Kështu, një listë prioritare e rasteve nuk është një risi.

Kategoria e parë e rasteve prioritare janë mosmarrëveshjet e punës, pasi ato mbulojnë rëndësi kritike për jetën e individëve.⁵⁰² Kështu, gjykatat duhet të aplikojnë një kujdes të jashtëzakonshëm.⁵⁰³ Duhet theksuar se “mosmarrëveshjet e punës në praktikën e saj gjyqësore nuk kufizohet vetëm në mosmarrëveshjet në lidhje me ligjshmërinë e një pezullimi ose një pushimi nga puna ose përcaktimin e të drejtës për pension, por përfshin edhe çështje të tjera të lidhura me punësimin, siç është njohja e të drejtës për kualifikim profesional”⁵⁰⁴ [përkthim nga autori]. Përsëri, edhe në rastin e punës së vetëpunësuar, d.m.th. një arkitekt, kontrata me një firmë, që është klienti kryesor, mund të konsiderohet si pjesë e kontratës së punës.⁵⁰⁵

⁴⁹⁴ *Şahiner kundër Turqisë*, vendim i 25 shtatorit 2001.

⁴⁹⁵ *Hentrich kundër Francës*, vendim i 22 shtatorit 1994.

⁴⁹⁶ *Giusti kundër Italisë*, vendim i 18 janarit 2012.

⁴⁹⁷ *Fasan dhe të tjerë kundër Italy*, vendim i 13 prillit 2017.

⁴⁹⁸ *Krastanov kundër Bullgarisë*, vendim i 30 shtatorit 2004.

⁴⁹⁹ *Johansen kundër Norvegjisë*, vendim i 7 gushtit 1996.

⁵⁰⁰ Ndër të tjerë, *Styranowski kundër Polonisë* vendim i 30 tetorit 1998; *Nikolov and Others kundër Bullgarisë*, vendim i 21 shkurtit 2012; *Syngayevskiy kundër Rusisë*, vendim i 27 marsit 2012; *Sizov kundër Rusisë (No. 2)*, vendim i 24 korrikut 2012; *D.M.T. and D.K.I. kundër Bullgarisë*, vendim i 24 korrikut 2012.

⁵⁰¹ Van Rhee, C. H. *The Law's Delay: Essays in Undue Delay in Civil Litigation*. Intersentia, 2004.

⁵⁰² *Lechelle kundër Francës*, vendim i 8 qershorit 2004.

⁵⁰³ Ndër të tjerë, *Obermeier kundër Austrisë*, vendim i 28 qershorit 1990; *Buchholz kundër Gjermanisë*, vendim i 6 majit 1981; *X kundër Francës*, vendim i 31 marsit 1992; *Mianowicz kundër Gjermanisë (No. 2)*, vendim i 11 qershorit 2009; *Petko Ivanov kundër Bullgarisë*, vendim i 26 marsit 2009.

⁵⁰⁴ *Hajrudinović kundër Sllovenisë*, vendim i 21 majit 2015, § 44.

⁵⁰⁵ *Doustaly kundër Francës*, vendim i 23 prillit 1998.

Kategoria e dytë e rasteve prioritare është kompensimi për viktimat e aksidenteve. Kjo përfshin edhe vdekjen, nëse trashëgimtarët privohen nga mjetet e tyre kryesore të mbështetjes financiare.⁵⁰⁶ Përveç kësaj, kujdesi i veçantë është gjithashtu kur paafësia ka sjellë humbjen e kapacitetit të punës.⁵⁰⁷ Në rastin e neglizhencës mjekësore, gjykatat duhet të kenë kujdes të veçantë në rast se aksidenti ka sjellë një efekt të dëmshëm në jetë⁵⁰⁸ dhe dëmshpërblimi i dëmit është i lidhur me këtë.⁵⁰⁹

Kategoria e tretë e rasteve prioritare janë pjesë e zbatimit të nenit 5(3) të KEDNJ-së, nëse aplikanti është ndaluar gjatë procedurës. Siç dihet, në të drejtën penale, një person i akuzuar nuk duhet të qëndrojë shumë gjatë në një gjendje pasigurie.⁵¹⁰ Ky parim theksohet në rastin kur gjykatat më të larta rrisin sanksionimin⁵¹¹ ose kur i dyshuari është informuar me akuzat penale pas një kohe të gjatë nga kryerja e një vepre penale të dyshuar.⁵¹²

Kategoria e katërt e rasteve prioritare janë kur shëndeti ose jeta e aplikantit është në rrezik dhe në këto lloj kategorish ka nevojë për përsheptim të jashtëzakonshëm. Ky mund të jetë rasti i një pacienti hemofilik, që i ishte nënshtruar transfuzioneve të gjakut dhe vdiq për shkak të SIDA-s.⁵¹³ Përsheptim i jashtëzakonshëm pritet edhe në rastin e një pacienti që ka qenë HIV-pozitiv që nga lindja.⁵¹⁴ Duhet të theksohet se ekziston një ndarje midis rasteve, që fokusohen në pacientët e prekur nga HIV dhe rasteve kur aplikantët janë në varësi ose prindër të viktimave të SIDA-s, ku nuk ka nevojë për përsheptim të jashtëzakonshëm. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, mosha e avancuar e aplikantit është gjithashtu një arsye e përsheptimit të jashtëzakonshëm: ky ishte rasti i një palë ndërgjyqëse tetëdhjetë-vjeçare, që kërkonte pensionin e tij të luftës.⁵¹⁵

Kategoria e pestë e rasteve prioritare ka të bëjë me të drejtën familjare, veçanërisht në lidhje me shkeljet e jetës familjare, detyrimeve të mirëmbajtjes dhe gjendjes civile. Për shembull, çështje të tilla si pagesat e detyrimit ushqimor, duke përfshirë ato të varura nga vendimet e huaja, duhet të gjykohen brenda një afati kohor të arsyeshëm.⁵¹⁶ Përveç kësaj, nuk ka shkelje të nenit 6(1) të KEDNJ-së kur gjatë ndarjes fëmija dhe prindërit kanë vazhduar marrëdhënien e tyre për shkak të një mase të përkohshme.⁵¹⁷

Kategoria e gjashtë e rasteve prioritare janë mosmarrëveshjet ligjore që lidhen me shkeljen e së drejtës absolute. Ky mund të jetë një rast kur punonjësit e policisë çenojnë të drejtat e një qytetar⁵¹⁸ ose për dëmet civile që policia ka bërë ndaj tyre.⁵¹⁹ Në të gjitha këto raste, shtetet kanë një detyrim pozitiv për të kryer një hetim efektiv.⁵²⁰ GJEDNJ-ja ka

⁵⁰⁶ Ndër të tjerë, *Mehmet Özel dhe të tjerë kundër Turqisë* vendim i 26 prillit 2005; *Meryem Güven hde të tjerë kundër Turqisë*, vendim i 22 shkurtit 2005; *Hatun Güven dhe të tjerë kundër Turqisë*, vendim i 8 shkurtit 2005; *Karakaya kundër Francës*, vendim i 26 gushtit 1994; *Obermeier kundër Austrisë*, vendim i 28 qershorit 1990.

⁵⁰⁷ *Kurt Nielsen kundër Danimarkës*, vendim i 15 shkurtit 2000.

⁵⁰⁸ *Jurica kundër Koracisë*, vendim i 2 majit 2017.

⁵⁰⁹ *Țăvîrlău kundër Rumanisë*, vendim i 2 shkurtit 2016.

⁵¹⁰ *Stögmüller kundër Austrisë*, vendim i 10 nëntorit 1969.

⁵¹¹ *Soto Sánchez kundër Spanjës*, vendim i 25 nëntorit 2003.

⁵¹² *O'Neill dhe Lauchlan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 28 qershorit 2016.

⁵¹³ *X kundër Francës*, vendim i 31 marsit 1992.

⁵¹⁴ *Henra kundër Francës*, vendim i 29 prillit 1998.

⁵¹⁵ *Pantaleon kundër Greqisë*, vendim i 10 majit 2007.

⁵¹⁶ *Dinu kundër Romania and Francë*, vendim i 4 nëntorit 2008.

⁵¹⁷ *Matusik kundër Polonisë*, vendim i 1 tetorit 2013 or *Eriksson kundër Sweden*, vendim i 12 prillit 2012.

⁵¹⁸ *Caloc kundër Francës*, vendim i 20 korrikut 2000.

⁵¹⁹ *Krastanov kundër Bullgarisë*, vendim i 30 shtatorit 2004.

⁵²⁰ *Kirins kundër Letonisë*, vendim i 12 janarit 2017.

nënvizuar se vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet rasteve kur ka shkelje të nenit 2, 3 dhe 4 të KEDNJ-së.⁵²¹

Kategoria e fundit e rasteve prioritare janë rastet e tjera që marrin parasysh rrethana të veçanta. Ky mund të jetë një rast që lidhet drejtpërdrejt me karrierën politike të aplikacionit⁵²² ose kur ka një cënim të privatësisë⁵²³ ose diskriminimit.⁵²⁴ Sipas GJEDNJ-së, kur çështja nuk është komplekse, edhe një periudhë prej 28 muajsh është e paarsyeshme.⁵²⁵

Për të siguruar efikasitetin e sistemit gjyqësor, keqpërdorimi i të drejtës për të filluar procedurat gjyqësore mund t'i nënshtrohet sanksioneve. Gjykatat janë të autorizuar të penalizojnë aplikantët që veprojnë në keqbesim që shfrytëzojnë mekanizmat procedural vetëm për të vonuar proceset gjyqësore. Në raste të tilla, zgjatja e panevojshme e procedurave nuk mund t'i atribuohet domosdoshmërisht autoriteteve gjyqësore. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), për shembull, ka përcaktuar se neni 6 (1) nuk shkelet kur një aplikant abuzon vazhdimisht me mjetet juridike procedurale. Në një rast, aplikanti paraqiti katër ankesa, paraqiti shtatë kërkesa për sqarime, kundërshtoi vendime përmes gjashtë veprimeve për t'i anuluar ato, paraqiti katër aplikime për shqyrtim dhe paraqiti tre aplikime të tjera - njëra duke dyfishuar një kërkesë të refuzuar më parë. Gjykata arriti në përfundimin se ky model i sjelljes procedurale kishte për qëllim kryesisht të vononte procedurat. Kështu, kohëzgjatja e çështjes nuk mund t'i atribuohet autoriteteve, veçanërisht pasi të gjitha ankesat kushtetuese ishin jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.

Me qëllim zbatimin e nenit 6 KEDNJ-së dhe në veçanti, reduktimin e çështjeve të prapambetura, në qershor 2023, CEPEJ publikoi *Backlog Reduction Tool*.⁵²⁶ Me fjalë të tjera, akumulimi i çështjeve të pazgjidhura me kalimin e kohës sjell vonesa dhe përbën shkelje të konceptit të “afatit të arsyeshëm”. Siç është treguar më parë nga doktrina dhe studime të ndryshme, rritja e vonesave në gjykata dhe shkelja e nenit 6 të KEDNJ-së ndikojnë negativisht në sigurinë juridike, perceptimin publik dhe besimin në sistemin gjyqësor.

Në vitin 2023, CEPEJ publikoi këtë instrument për reduktimin e *backlog*-ut përmes një metodologjie hap pas hapi. Dokumenti përmban tabela të shumta, duke ofruar udhëzime konkrete për interpretimin e tyre dhe mënyrën e plotësimit.

Megjithëse CEPEJ miratoi këtë mjet, ai lë ende një shkallë diskrecioni për shtetet në përcaktimin e disa elementeve specifike, si p.sh. afatet kohore brenda të cilave duhet të zgjidhet një çështje,⁵²⁷ organi publik përgjegjës (Këshillat Gjyqësor, Gjykata e Lartë, Ministria e Drejtësisë apo një organ i posaçëm si një grup pune *ad hoc* për reduktimin e *backlog*-ut),⁵²⁸ si dhe lloji i dokumentit (në nivel strategjik apo operativ).⁵²⁹që do të

⁵²¹ L.E. kundër Greqisë, vendim i 21 janarit 2016.

⁵²² Siffre, Ecoffet dhe Bernardini kundër Francës, vendim i 12 dhjetorit 2006.

⁵²³ Gunes kundër Francës, vendim i 20 nëntorit 2008.

⁵²⁴ Oršuš dhe të tjerë kundër Kroacisë, vendim i 16 marsit 2010.

⁵²⁵ Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë, vendim i 1 prillit 2014.

⁵²⁶ European Commission for the Efficiency of Justice. *Backlog Reduction Tool*, miratuar në mbledhjen plenare të 40-të (Strasbourg, 15–16 qershor 2023). I disponueshëm në internet: <https://rm.coe.int/backlog-reduction-tool-en/1680b2ca1e>

⁵²⁷ arsyeshëm.

⁵²⁸ Në rastin e Shqipërisë, kjo bëhet përmes Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu, janë krijuar Ekipet për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura (NUNÇP).

⁵²⁹ Në rastin e Shqipërisë, kjo është një dokument strategjik (shif Seksionin 4.4).

vendosë rregullat kombëtare. CEPEJ thekson se ulja ose eliminimi i *backlog*-ut nuk duhet të vijë në dëm të cilësisë së vendimeve gjyqësore.⁵³⁰

Kjo strategji përbëhet nga katër hapa: analiza, masat, monitorimi dhe qëndrueshmëria. Çdo hap ka objektivat dhe metodat e veta. Ndërsa hapi i parë synon identifikimin e *backlog*-ut dhe analizimin e shkaqeve të tij, hapi i dytë përfshin zhvillimin e një strategjie për ta adresuar në mënyrë efektive. Ndërkohë, hapi i tretë dhe i katërt synojnë monitorimin dhe sigurimin e qëndrueshmërisë.

Në hapin e parë, mbledhja e të dhënave dhe analiza e tyre gjithëpërfshirëse realizohen edhe përmes një qasjeje statistikore.⁵³¹ Të dhënat janë thelbësore për të diagnostikuar situatën. Metodatat e aplikuara mund të përfshijnë përdorimin e *Data Driven Methodology* (e bazuar kryesisht në analizën e të dhënave statistikore) së bashku me *Delphi Method* (e njohur edhe si metoda e “panelit të ekspertëve”). Shqyrtimi i të dhënave mund të kryhet në mënyra të ndryshme, si në nivel kombëtar, sipas llojit të gjykatave, shkallës së gjykimit apo llojit të çështjeve. Matja mund të bëhet në baza vjetore ose gjashtëmujore.

Brenda këtij hapi përfshihet gjithashtu studimi i legjislacionit ekzistues dhe i zgjidhjeve të propozuara, si dhe analiza e burimeve në dispozicion (burime njerëzore, financiare dhe materiale). Për më tepër, është thelbësore siguri i trajnimeve të vazhdueshme dhe të detyrueshme.

Hapi i dytë duket të jetë më i rëndësishmi, pasi synon zhvillimin e një strategjie për të adresuar *backlog*-un. Pas identifikimit të *backlog*-ut dhe të shkaqeve të tij (që është objektivi i hapi të parë), ky dokument përfshin gjithashtu planin e veprimit, i cili shërben si një udhëzues praktik. Natyrisht, plani i veprimit duhet të përfshijë objektivat e tij, të cilat duhet të jenë realiste për periudha afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata. Për më tepër, strategjia për përcaktimin e objektivave është po aq e rëndësishme sa vetë objektivat.⁵³² Strategjia mund të ketë natyrë legjislative, të lidhet me burimet ose trajnimet, ndërsa zbatimi i periudhave mund të ndryshojë sipas nevojës.

Faza e tretë synon monitorimin e zbatimit të strategjisë së vendosur në fazën e dytë. Në këtë fazë, duhet të merren parasysh disa aspekte, si: organi përgjegjës për monitorimin, çfarë duhet të monitorohet, bazuar në cilat të dhëna, periudha dhe mënyra monitorimit.⁵³³ Gjatë shqyrtimit, objektivat mund të rezultojnë jo realistë, dhe për këtë arsye duhet të përcaktohen objektiva të rinj. Në këtë hap, gjithashtu, është thelbësore të zbatohet *risk mitigation* (zbutja e rreziqeve), e cila shërben si masë korrigjuese: për shembull, në një rreth gjyqësor numri i gjyqtarëve dhe personelit jo-gjyqtar është më i lartë dhe ata duhet të transferohen në rrethe të tjera.

Hapi i fundit është krijimi i qëndrueshmërisë. Qëllimi i tij është parandalimi i krijimit të *backlog*-ut në të ardhmen. Ky është hapi final që zbatohet pasi të jenë realizuar

⁵³⁰ Consultative Council of European Judges. *Opinion No. 11 (2008) on “the quality of judicial decisions”*. I disponueshëm në internet: <https://www.coe.int/en/web/ccje/ccje-opinions-and-magna-carta>

⁵³¹ Një shembull i mirë mund të shihet gjithashtu në dokumentin e European Commission for the Efficiency of Justice. *Compendium of “best practices” on time management of judicial proceedings*, miratuar në mbledhjen plenare të 8-të (Strasbourg, 6–8 dhjetor 2006). I disponueshëm në internet: <https://rm.coe.int/16807473ab>

⁵³² European Commission for the Efficiency of Justice. *Implementation Guide “Towards European Timeframes for Judicial Proceedings”*, miratuar në Strasbourg, 7 dhjetor 2016. I disponueshëm në internet: <https://rm.coe.int/16807481f2>

⁵³³ Një mjet i rëndësishëm për këtë hap është gjithashtu European Commission for the Efficiency of Justice. *Guide on communication with the media and the public for courts and prosecution authorities*, miratuar në Strasbourg, 7 dhjetor 2018. I disponueshëm në internet: <https://rm.coe.int/cepej-2018-15-en-communication-manual-with-media/16809025fe>

me sukses tre hapat e mëparshëm. Në fakt, hapat paraprakë ndihmojnë në identifikimin e strategjive dhe zgjidhjeve më të mira.

Si përfundim, ndërsa e drejta për një gjykim të drejtë njihet si një standard ndërkombëtar, mbikombëtar ose kushtetues, kohëzgjatja e procedurave vazhdon të paraqesë sfida të rëndësishme. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përcaktuar rrethanat në të cilat shtetet mund të justifikohen për të shkaktuar vonesa të tepërta dhe gjithashtu ka formuluar udhëzime për priorizimin e rasteve të caktuara dhe nga CEPEJ janë krijuar mekanizma si të reduktohet backlogu.

4.1.3 Procesi i rivlerësimit kalimtar dhe standardet e nenit 6 të KEDNJ-së

Procesi i vetingut është një vlerësim i magistratëve shqiptarë (gjyqtarë dhe prokurorë), që synon verifikimin e integritetit, pasurisë dhe kompetencës profesionale të tyre. Qëllimi i tij është të sigurojë llogaridhënie dhe të forcojë besimin e publikut në gjyqësor.⁵³⁴ Ky seksion studion procesin e vetingut në funksion të GJEDNJ-së. Ai fokusohet vetëm në vendimet e vitit 2025. Ky seksion synon t'u përgjigjet dy pyetjeve të mëposhtme në lidhje me nenin 6(1) të KEDNJ-së. Së pari, cili është standardi i provës që aplikohet në rastin e procesit të vetingut? Së dyti, dhe më e rëndësishmja për efikasitetin gjyqësor, a mund të përdorë procesi i vetingut një justifikim për kohëzgjatjen e procedurës ligjore?

Seksioni 4.1.3 tregon se megjithëse procesi i vetingut është pjesë e procedurave civile dhe jo e mosmarrëveshjeve penale, neni 6(1) i KEDNJ-së ende e detyron Shqipërinë të mos bëjë supozime të përgjithshme, supozime të paqarta ose arsyetime të paqarta.

Seksioni 4.1.2 sqaron se procesi i vetingut nuk mund të konsiderohet si një justifikim për kohëzgjatjen e procedurave ligjore. Së dyti, nënvizon përsëri se një vendim gjyqësor duhet të rishikohet brenda një “kohe të arsyeshme” edhe në rastet që nuk kanë përparësi. Së treti, versioni aktual i kompensimit në rast të shkeljes së konceptit të “kohës së arsyeshme”, i shtuar me ligjin nr.38/2017 të 30 marsit 2017, duhet të rishqyrtohet. Së treti, siç thuhet në seksionin 4.1.2., në disa raste të jashtëzakonshme,⁵³⁵ shtetet nuk do të konsideroheshin përgjegjëse për shkeljen e nenit 6(1) të KEDNJ-së. Megjithatë, vetingu nuk konsiderohet një rast i jashtëzakonshëm. Në fakt, kjo është në përputhje me praktikën e mëparshme gjyqësore pasi vetingu nuk po sjell vetëm një numër të përkohshëm të çështjeve të prapambetura,⁵³⁶ megjithëse shteti shqiptar ka marrë masa për të ulur numrin e vendimeve duke e ulur atë në fakt midis viteve 2022-2023 (shih Seksionin 4.4.)

Çështja Selimi kundër Shqipërisë e 25 nëntorit 2025 (Kërkesa nr. 37896/19)

Z. Selimi, gjyqtar shqiptar, nuk e përfundoi me sukses procesin e vetingut për shkak të gjetjeve të shoqatave me anëtarë të organizatave kriminale. Sipas vendimeve të Komisioni i Pavaruar i Kualifikimit (KPK) dhe Kolegjit të Posacëm të Apelimit (KPA), si dhe vëzhgimeve paraprake nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM), ai ishte i lidhur me dy individë të lidhur me organizata të tilla.

⁵³⁴ Dimitrova, Denitsa. cit note 27.

⁵³⁵ Ndër të tjerë, *Foti dhe të tjerë kundër Italisë*, vendim i 10 dhjetorit 1982; *Buchholz kundër Gjermanisë*, vendim i 6 majit 1981; *Pereira da Silva kundër Portugalisë*, vendim i 22 marsit 2016.

⁵³⁶ Pikërisht, sipas *Zimmermannand Steiner kundër Zvicrës*, § 29, vendim i 13 korrikut 1983. “një numër i përkohshëm i çështjeve të prapambetura nuk përfshin përgjegjësi nga ana e shteteve kontraktuese me kusht që ato të ndërmarrin, me shpejtësinë e nevojshme, veprime korrigjuese për t'u marrë me një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji” [përkthim nga autori].

Gjetja e parë kryesore tregoi se zoti Selimi dhe bashkëshortja e tij ishin të listuar në policën e sigurimit të makinës për dy vjet rresht që i përkisnin A.S., një individ i identifikuar si pjesë e një organizate kriminale. Pika e dytë domethënëse theksoi përfshirjen e zotit Selimi në pengimin e ekstradimit të A.S., i cili konsiderohet gjithashtu kriminel. Për më tepër, Z. Selimi mori vetëm një version të redaktuar të raportit të DSIK, pa qasje në dokumentacionin shoqërues dhe u përball me akuza nga ONM-ja në lidhje me kontakte të papërshtatshme me personat e lidhur me A.I.

Ai pretendoi se kishte një shkelje të nenit 6(1) të KEDNJ-së pasi “ai as nuk ishte informuar për faktet thelbësore të mbajtura kundër tij dhe as nuk i ishte dhënë akses në provat, mbi të cilat ishte bazuar shkarkimi i tij nga detyra” (paragrafi 54) [përkthim nga autori].

Para se të analizohet ky rast, nevojiten disa sqarime. Së pari, KPK dhe KPA konsiderohen si “tribunale”. Kështu, do të zbatohet neni 6(1) i KEDNJ-së.⁵³⁷ Së dyti, GJEDNJ-ja nuk synon të përcaktojë nëse shkarkimi ishte i ligjshëm apo i justifikuar; ai synon vetëm të identifikojë nëse gjatë këtij procesi ka pasur shkelje të nenit 6(1) të KEDNJ-së.

Së treti, në rastin e procedurës civile, e cila përfshin edhe sanksionet disiplinore në kuadër të procesit të vettingut,⁵³⁸ aplikimi i një “gjykimi të drejtë” nuk zbatohet aq i rreptë sa në rastin e kontesteve penale. Në të vërtetë, në rastin e procedurave penale, e drejta për t’u informuar është e lidhur fort me të drejtën e mbrojtjes.⁵³⁹ Megjithatë, edhe në rastin e procedurës civile, aplikantët duhet të kenë mundësi të përshtatshme për të kundërshtuar gjetjet,⁵⁴⁰ si dhe mundësinë për të komentuar përmbajtjen dhe vërtetësinë e tij.⁵⁴¹

Së katërti, në rastin e procesit të vettingut, siguria kombëtare vlerësohet si interes i kundërt kundërt të drejtës së palëve në procedurë. Megjithatë, kufizimi i nenit 6(1) të KEDNJ-së mund të jetë koherent me KEDNJ-në vetëm kur thelbi i saj nuk sulmohet.⁵⁴²

Duke pasur parasysh se Z. Selimi nuk kishte akses në të gjitha dokumentet nga DSIK dhe iu ofruan vetëm akuza të përgjithshme, aftësia e tij për të ngritur një mbrojtje të duhur ishte shumë e kufizuar. Për më tepër, megjithëse KPK pohoi besueshmërinë e provave të vlerësuara, ajo nuk dha justifikim të mjaftueshëm për të vërtetuar këtë pretendim.

Kështu, sipas GJEDNJ-së, nuk u zbuluan asnjë element faktik apo provë. Kështu, “duke qenë se i mungon ndonjë informacion në lidhje me elementët thelbësorë faktikë dhe në lidhje me provat e pazbuluara, Gjykata nuk mund të përcaktojë se çfarë shkalle aktuale shqyrtimi aplikoi KPA në verifikimin e vërtetësisë, besueshmërisë dhe bazës së pretendimeve të paraqitura në organet e vettingut nga ONM-ja dhe autoritetet e huaja/kombëtare (krahaso *Kurkut dhe të tjerët kundër Türkiye*, nr. 58901/19 dhe 6 të tjera, §§ 106-07, 25 qershor 2024 dhe *Corneschi*, cituar më lart, § 112), ose nëse ato prova u vlerësuan në një bazë të barabartë me provat e zbuluara. Vlerësimi i të gjitha provave nuk tregon bindshëm se përbën një faktor kundërbalancues të mjaftueshëm për refuzimin për

⁵³⁷ *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, vendim i 9 shkurtit 2021.

⁵³⁸ *Thanza kundër Shqipërisë*, vendim i 4 korrikut 2023.

⁵³⁹ *Leka kundër Shqipërisë*, vendim i 5 marsit 2024.

⁵⁴⁰ *Thanza kundër Shqipërisë dhe Xhoxhaj kundër Shqipërisë*.

⁵⁴¹ *Vorotnikov kundër Letonisë*, vendim i 4 shkurt 2021; *Colloredo Mannsfeld kundër Republikës Çeke*, vendim i 15 dhjetorit 2016; *Krčmář dhe të tjerë kundër Republikës Çeke*, vendim i 3 marsit 2000.

⁵⁴² *Regner kundër Republikës Çeke*, vendim i 19 shtatorit 2017; *Thanza kundër Shqipërisë*, vendim i 4 korrikut 2023.

të informuar kërkuesin për elementët thelbësorë faktikë të pretendimeve në rastin konkret” (paragrafi 85) [përkthim nga autori].

Si rezultat i kësaj, Z. Selimi nuk u vu në gjendje të përgënjeshtrohe një pohim të paqartë⁵⁴³ ose të citonte rrethana lehtësuese. Mjaft interesante, është se GJEDNJ-ja, gjithashtu, e shqyrtoi vendimin e KPA duke e konsideruar atë “evazive” (paragrafi 92). Në të vërtetë, nga raportet e dorëzuara në GJEDNJ, nuk rezulton se A.S. (pronari i makinës) të jetë konsideruar si një “person i përfshirë në krimin e organizuar” ose se ndërveprimet e aplikantit me të, në vetvete, përbënin “kontakt të papërshtatshëm”.

Sipas vendimit të gjykatave shqiptare, prezumimi i njohurive me A.S. dhe A.I. konsiderohej si “fakt i njohur botërisht”, që nuk kërkon prova të mëtejshme” (paragrafi 95) [përkthim nga autori]. GJEDNJ nënvizoi se megjithëse në procedurat civile shkaku është më pak i rreptë se mosmarrëveshjet penale,⁵⁴⁴ është detyrë që të drejta për një gjykim të drejtë të mos të shkelen. Me fjalë të tjera, edhe në rastin e mosmarrëveshjeve civile, “shtetet mbeten brenda kufijve të arsyeshëm, duke marrë parasysh rëndësinë e asaj që është në rrezik dhe duke ruajtur të drejtat e mbrojtjes. Mjetet e përdorura duhet të jenë në mënyrë të arsyeshme proporcionale me qëllimin legjitim që kërkohet të arrihet” (paragrafi 96) [përkthim nga autori].

Kjo do të thotë se ekziston shkelje e parimit të gjykimit të drejtë, i kodifikuar në nenin 6(1) të KEDNJ-së. Për më tepër, duke marrë parasysh përfshirjen e bashkëshortes së tij dhe rolin e gjyqtarit në shoqërinë shqiptare, të njëjtat argumente sjellin se ka edhe shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së.⁵⁴⁵ Në përfundim nuk ka shkelje të nenit 46 të KEDNJ-së.⁵⁴⁶ Ndërsa parashtruesi i kërkesës vlerësoi dëmin e tij jomonetar në 150.000 EUR, përveç 12,896 EUR për shpenzimet e avokatëve të tij, të bëra para Gjykatës dhe 2,600 EUR për përkthimin nga shqipja në anglisht, sipas nenit 41 të KEDNJ-së,⁵⁴⁷ Gjykata vendosi t’i paguajë Z. Selimi vetëm 6.500 EUR.

Çështja e Arb Shpk e të tjerëve kundër Shqipërisë e datës 8 gusht 2025 (Aplikimet Nr. 39860/19 dhe 3 të tjerë)

Më tej, ofrohet një analizë të vendimit të GJEDNJ-së të datës 8 gusht 2025. Rishikimi mbulon katër vendime të veçanta, që trajtojnë çështje, që lidhen me kohëzgjatjen e procedurave ligjore. Dy vendimet e para kanë të bëjnë me personat juridikë të përfshirë në mosmarrëveshjet e kontratave të biznesit, ndërsa i tretë ka të bëjë me zgjidhjen e kontratës së punës dhe i katërti ka të bëjë me një kërkesë për pension pleqërie nga një minator. Siç përsëritet në seksionin 4.1.2, GJEDNJ theksoi se megjithëse dy rastet fillestare nuk u konsideruan çështje prioritare, si çështja e tretë ashtu edhe ajo e katërt, u klasifikuan si prioritare.

⁵⁴³ *Thanza kundër Shqipërisë*, vendim i 4 korrikut 2023. § 115.

⁵⁴⁴ *Busuttil kundër Maltës*, vendim i 3 qershorit 2021.

⁵⁴⁵ Këshilli i Evropës. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 8.: “Çdokush ka të drejtë të respektohet jeta e tij private dhe familjare, shtëpia dhe korespondenca e tij. Nuk do të ketë ndërhyrje nga një autoritet publik në ushtrimin e kësaj të drejte, përveç rasteve kur është në përputhje me ligjin dhe është e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e çrregullimeve ose krimin, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

⁵⁴⁶ Këshilli i Evropës. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 46.: “Palët e Larta Kontraktuese zotohen të respektojnë vendimin përfundimtar të Gjykatës në çdo çështje në të cilën ato janë palë. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij”.

⁵⁴⁷ Këshilli i Evropës. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 41.: “Nëse Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës ose të Protokolleve të saj, dhe nëse ligji i brendshëm i Palës së Lartë Kontraktuese në fjalë lejon vetëm dëmshpërblim të pjesshëm, Gjykata, nëse është e nevojshme, i jep shpërblim të drejtë palës së dëmtuar”.

Theksohet se GJEDNJ-ja ka vlerësuar rëndësinë e procesit të vetingut si dhe strategjinë e re për strategjinë e reduktimit të prapambetjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të miratuar më 9 maj 2024. Megjithatë, GJEDNJ-ja, gjithashtu, nënvizoi se në vitin 2023, numri i prapambetur i vetëm të Gjykatës Administrative të Apelit ishte më i lartë se 23.000 çështje gjyqësore ndërsa më 20 dhjetor 2024, Gjykata e Lartë ishte më e lartë se 18.665 vendime gjyqësore.⁵⁴⁸ Për një vend me më pak se 2.4 milionë banorë,⁵⁴⁹ ky numër i prapambetur është jashtëzakonisht i lartë.

Pas vendimit në *çështjen Luli e të tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 64480/09 dhe pesë të tjerë, 1 prill 2014), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, përmes Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, tërhoqi vëmendjen urgjente për çështjet e prapambetura në Shqipëri. Në mbledhjen e 1514-të të mbajtur nga 3-5 dhjetor 2024, u vu në dukje se procedurat para Gjykatës Kushtetuese tani përfundojnë përgjithësisht brenda një afati kohor të arsyeshëm dhe se numri i prapambetur në Gjykatën e Lartë është ulur me 18% nga viti 2023 në vitin 2022. Gjithashtu, u theksua rëndësia e nismës bashkëpunuese të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës "Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri" (SEJ IV).

Përgjigja e shtetit shqiptar ishte e menjëhershme:⁵⁵⁰ nënvizoi reformën e re territoriale të gjykatave (neni 13 ligji nr. 96/2016 dhe akti nënligjor (VKM) nr. 495 i 21 korrikut 2022). Kjo reformë uli numrin e gjykatave të shkallës së parë nga 22 në 13; Gjykatat e Shkallës së Parë Administrative nga 6 në 2; dhe e vetmja 1 Gjykata e Apelit. Së dyti, është miratuar një strategji e re gjyqësore ndërdisiplinore 2024-2030. Së treti, është krijuar një sistem i ri i menaxhimit dixhital të rasteve. Së katërti, punësimi i 28 konsulentëve të rinj ligjorë që synojnë të zvogëlojnë numrin e prapambetur (shi seksionin 2.3.1). Së pesti, publikimi i Urdhrit Nr. 1 të Këshillit të Ministrave të 26 majit 2022 për të tërhequr të gjitha ankesat joefektive.

Është e rëndësishme të pranohet krijimi i një ekipi të ri brenda Gjykatës së Apelit, i njohur si Ekipet për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura. Në vitin 2024, ky ekip shqyrtoi 1,146 çështje në Gjykatën e Apelit të Përgjithshëm, duke zgjidhur 257 dhe shqyrtoi 941 çështje në Gjykatën Administrative të Apelit, duke zgjidhur me sukses 303.⁵⁵¹

Mjaft interesante, GJEDNJ-ja jo vetëm që iu referua legjislacionit shqiptar, praktikës gjyqësore të mëparshme të GJEDNJ-së dhe dokumenteve të Këshillit të Evropës, por kujtoi edhe Raportin shqiptar të vitit 2024. Në të vërtetë, u nënvizua "efikasiteti i sistemit të drejtësisë duhet të përmirësohet. Efikasiteti vazhdoi të ndikohej negativisht nga sfidat duke përfshirë kohëzgjatjen e procedurave dhe numrin e lartë të çështjeve të prapambetura, veçanërisht në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Apelit Administrativ. Pranimi vjetor i magjistratëve nga Shkolla e Magjistraturës është ende i pamjaftueshëm. Kodet e procedurës pengohen nga formalitetet dhe nuk ofrojnë mjete adekuate për të

⁵⁴⁸ Të dhëna të ngjashme janë konfirmuar edhe në raportin e fundit të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit. *Raport mbi Gjendjen e Sistemit Gjyqësor dhe Veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Gjyqësorit, Viti 2024*. I disponueshëm në internet: <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>. Më shumë informacion, shihni Seksionin 5.4.

⁵⁴⁹ Instat. Popullsia e Shqipërisë më 1 janar 2025. I disponueshëm në internet: <https://www.instat.gov.al/media/v2jls5y3/population-on-1-january-2025-dt-12062025-anglisht.pdf>.

⁵⁵⁰ Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë – Mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimit (përkthim jozyrtar në shqip)*. I disponueshëm në: <https://rm.coe.int/1514cmnotes-01-luli-2750-7631-6426-51-albanian-non-official-translation/1680b3b700>.

⁵⁵¹ Këshilli i Lartë të Gjyqësorit, cit note 7.

adresuar numrin e lartë të prapambetur. Vonesa serioze përjetohen me afatet ligjore për publikimin e vendimeve të arsyetuara nga gjykatat. Në periudhën raportuese, [KLGJ] themeloi një grup punues për efikasitetin, i cili ka paraqitur një draft dokument strategjik dhe propozime legislative. Këto propozime synojnë të përmirësojnë efikasitetin dhe po shqyrtohen gjithashtu nga Parlamenti. Megjithatë, përputhja e këtyre nismave ligjore me parimet e përgjithshme të reformës në drejtësi dhe standardet evropiane ende nuk është siguruar plotësisht”⁵⁵² [përkthim nga autori] (shih seksionin 2.4.3).

Në vendimin e 8 gushtit 2025, GJEDNJ-ja sqaroi se viktimë është kur gjyqtarët kombëtarë kanë pretenduar në mënyrë eksplicite ose implicite shkelje të KEDNJ-së dhe kanë dhënë zgjidhjet e duhura.⁵⁵³ Përveç kësaj, siç thuhet në seksionin 4.1.2., “arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kriterëve të përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, në veçanti kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit dhe autoriteteve përkatëse, dhe atë që ishte në lojë për kërkuesin në mosmarrëveshje” (paragrafi 109) [përkthim nga autori].

Përsëri, siç thuhet në seksionin 4.1.2., në dy rastet e para që nuk klasifikohen si çështje prioritare, “Gjykata përsërit se palët në mosmarrëveshjet civile që nuk kërkojnë ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë të drejtë, sipas nenit 6 § 1 të Konventës, për një seancë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm” (paragrafi 118) [përkthim nga autori]. Megjithatë, në këto raste palëve “nuk u kërkohet të tregojnë, për këtë qëllim, se ndonjë dëm i veçantë ose shtesë është shkaktuar nga vonesat procedurale” (paragrafi 118) [përkthim nga autori].

Në katër çështjet e ngritura kundër Shqipërisë nën kërkesat nr. 39860/19 dhe tre të tjera, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) u ngarkua të vlerësonte nëse vendimet e Gjykatës Kushtetuese shqiptare, të nxjerra si mjet përfundimtar për shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese (nenet 131(1)(f) dhe 134(1)(i) të Kushtetutës së Shqipërisë), përputheshin me praktikën gjyqësore të vendosur të GJEDNJ-së.

GJEDNJ-ja përcaktoi se qeveria shqiptare nuk mund të justifikonte në mënyrë adekuate vonesat në procedurë, duke i atribuar ato procesit të vetingut ose duke përmendur prioritizimin e rasteve të caktuara dhe duke përjashtuar të tjerat. Konkretisht, një vonesë shtatë-vjeçare para Gjykatës së Lartë përbën një shkelje të nenit 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Megjithëse Gjykata nënvizon rëndësinë e legjislacionit të fundit, ku palët mund të kërkojnë dëmshpërblim civil për qeverinë shqiptare përpara se të plotësojnë një padi në GJEDNJ,⁵⁵⁴ GJEDNJ-ja nënvizon “se kujdes i veçantë kërkohet nga shteti kur merret me rastet, në të cilat palët kërkojnë dëmshpërblim për dëmet e pësura për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procedurave” (paragrafi 139) [përkthim nga autori]. Në fakt, kjo nuk është hera e parë që GJEDNJ e nxjerr në pah këtë koncept.⁵⁵⁵ GJEDNJ-ja, gjithashtu, ka vendosur një kufizim kohor për dëmet civile të llogaritura për kohëzgjatjen

⁵⁵² Komisioni Evropian, *Commission Staff Working Document: Albania Report 2024*, SWD (2024) 690 final, 30 tetorit 2024, f. 25.

⁵⁵³ *Cocchiarella kundër Italisë*, vendim i 29 marsit 2006; *Cataldo kundër Italisë*, vendim i 3 qershorit 2004; *Vidaković kundër Serbisë*, vendim i 24 majit 2011.

⁵⁵⁴ Kodi i Procedurës Civile së Shqipërisë, Kreu X, “Gjykimi i Kërkesave për Konstatimin e Shkeljes së Afatit të Arsyeshëm, Përshpejtimi i Procedurave dhe Shpërblimin e Dëmit”, shtuar me Ligjin nr. 38/2017, 30 marsit 2017.

⁵⁵⁵ *Shiko Hajrudinović kundër Sllovenisë*, vendim i 21 majit 2015; *Belperio and Ciarmoli kundër Italisë*, vendim i 21 dhjetorit 2010.

e paarsyeshme ose procedurat, të cilat nuk duhet të kalojnë 2.5 vjet, duke përfshirë jo vetëm procedimin, por edhe ekzekutimin e tij.⁵⁵⁶

GJEDNJ gjithashtu shqyrtoi shkurtimisht KREU X të Kodit të Procedurës Civile të titulluar Gjykimi i Kërkesave për Konstatimin e Shkeljes së Afatit të Arsyeshem, Përsheptimin e Procedurave dhe Shpërblimin e Dëmit duke deklaruar se “kjo marrëveshje ka potencialin jo vetëm për të zgjatur kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave në raste individuale, por edhe për të shtuar barrën e përpunimit të çështjeve të një sistemi drejtësie tashmë të mbingarkuar. Numri i rasteve në të cilat është dhënë kompensim në këtë kontekst duket se mbetet shumë i kufizuar. Gjykata u bën thirrje autoriteteve kombëtare të marrin në konsideratë efektivitetin praktik të mjetit kompensues sipas neneve 399/1 e në vijim të KPP” (paragrafi 192) [përkthim nga autori].

Procedura të ngjashme janë zbatuar edhe në vende të tjera. Në Itali, Ligji Nr. 89/2001, i miratuar në vitin 2001, vendosi një mjet të brendshëm për shkeljet e nenit 6(1) të KEDNJ-së nga gjykatat italiane. Kërkesat dorëzohen në Gjykatën e Apelit me qëllim zvogëlimin e numrit të aplikantëve para GJEDNJ-së. Gjyqtarët italianë zbatojnë udhëzime të krahasueshme me ato të formuluar nga GJEDNJ për të vlerësuar dëmet civile, që rezultojnë nga vonesat gjyqësore.

Në mënyrë të përmbledhur, në të katër rastet, GJEDNJ identifikoi një shkelje të nenit 6(1) dhe në çështjen e pensioneve, gjeti gjithashtu një shkelje të nenit 13 të KEDNJ-së. Për më tepër, GJEDNJ u dha dëmshpërblim civil viktimave, megjithëse shumat e dhëna ishin më të ulëta se ato të pretenduara.

4.1.4 Reflektimi i standardeve të CEPEJ-it në legjislacionin shqiptar

Ky seksion tregon statistikat e Shqipërisë në lidhje me administrimin gjyqësor. Përveç kësaj, ai tregon përafrimin e legjislacionit shqiptar me udhëzimet e CEPEJ.

Të dhënat e fundit të CEPEJ janë të vitit 2024 pasi publikimi i tyre është dyvjeçar. Megjithatë, CEPEJ iu referua të dhënave të vitit 2022. Kështu, ky seksion do të shqyrtojë publikimin e fundit nga Këshilli i Lartë i Gjyqësorë në Shqipëri⁵⁵⁷ të miratuar më 23 prill 2025. Raportimi i bërë nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor në Shqipëri bazohet tek dokumenti i CEPEJ “Mjet për Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura (Backlog)” publikuar gjatë mbledhjes plenare së 40-të, mbajtur në Strasburg, me 15 dhe 16 qershor 2023.

Në fillim të vitit 2024, Gjykata e Lartë po menaxhonte 26,058 çështje, që përfaqëson një rënie prej 18% nga viti i kaluar. Gjatë vitit 2024, Gjykata mori 2,469 çështje të reja, që shënoi një rritje prej 15% krahasuar me vitin 2023. Deri në fund të vitit, ngarkesa e rasteve ishte reduktuar në 20,888, duke reflektuar menaxhimin efektiv të rasteve.

Prandaj, që prej vitit 2020, EUJS publikon raportin vjetor të shtetit të të drejtës.⁶²⁸ Në vitin 2025, EUJS “është bërë një mjet thelbësor brenda kutisë së mjeteve të BE-së për shtetin e të drejtës” (p.4)⁶²⁹ [përkthim nga autori]. Kështu, EUCJ kontribuon jo vetëm në Semestrin European, por edhe në Raportin vjetor të shtetit të të drejtës dhe instrumentin e rimëkëmbjes dhe qëndrueshmërisë.

Shteti i të drejtës është vlerësuar nga disa indekse të dalluara,⁶³⁰ duke përfshirë Freedom House (“Liria në botë”), Bertelsmann Stiftung (“Indeksi i transformimit Bertelsmann”), Banka Botërore (“Treguesit e qeverisjes botërore”) dhe Projekti botëror i drejtësisë (“Indeksi i shtetit të të drejtës”).⁶³¹ Megjithatë, Liria në botë nuk përditësohet, Indeksi i transformimit Bertelsmann nuk mbulon të gjitha vendet anëtare të BE-së, Projekti botëror i drejtësisë ndryshon me kalimin e kohës dhe Treguesit e qeverisjes botërore janë kritikuar pasi nuk kanë një renditje të mirë përqindjeje.

Edhe pse EUJS përfshin disa avantazhe, disa kritika mund të nënvizohen. Së pari, EUJS është i kufizuar në vlerësimin e të dhënave të forta dhe jo në analizën e tyre të thelluar. Me fjalë të tjera, EUJS shikon të dhënat statike si kohëzgjatja e procedurave, ngarkesa e çështjeve ose sanksionet disiplinore, ai nuk fokusohet në aspektet joformale të “ligjit në veprim”. Në të vërtetë, EUCJ e thekson këtë problem: “shifrat e paraqitura në tabelën e rezultateve nuk ofrojnë një vlerësim ose paraqesin të dhëna sasiore mbi

internet: <https://www.imf.org/~media/Files/Publications/REO/EUR/2017/November/eur-booked-print.ashx?la=en>; Banka Botërore, *World Development Report 2017: Governance and the Law*, Kapitulli 3: *The Role of Law*, 2017, f. 83, 140. I disponueshëm në: <http://www.worldbank.org/en/publication/wdr2017>; Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), *The Global Economics of Civil Justice: New Cross-Country Data and Empirics*, OECD Economics Department Working Papers nr. 1060, August 2013; Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), *What Makes Civil Justice Effective?*, OECD Economics Department Policy Notes nr. 18, June 2013.

⁶²⁵ Komisioni Evropian. *Speech: Safeguarding the Rule of Law and Solving the “Copenhagen Dilemma”: Towards a New EU-Mechanism*. I disponueshëm në internet: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/SPEECH_13_348

⁶²⁶ Dinan, Desmond. “Governance and Institutions: The Insidious Effect of Chronic Crisis”. *Journal of Common Market Studies*, vol. 55, 2017, p. 73.

⁶²⁷ Dimitrov, Georgi, Kaloyan Haralampiev, and Stoycho Stoychekundër “The Adventures of the CVM in Bulgaria and Romania”. In *Has the EU’s Eastern Enlargement Brought Europe Together?* 2016, p. 213.

⁶²⁸ Komisioni Evropian, *The 2024 EU Justice Scoreboard*, p. 3. I disponueshëm në internet: <https://network-presidents.eu/sites/default/files/2024%20EU%20Justice%20Scoreboard.pdf>.

⁶²⁹ Komisioni Evropian. *EU Justice Scoreboard 2015*. I disponueshëm në internet: https://commission.europa.eu/system/files/2017-06/justice_scoreboard_2015_en.pdf

⁶³⁰ Jakab, András. cit note 3.

⁶³¹ Për një studim më të mirë të këtyre metodave, shihni: Për tre të parat, një pasqyrë e mirë jepet nga Thiery, Shering, and Muno. *Wie misst man Recht? Möglichkeiten und Grenzen der Messung von Rechtsstaatlichkeit*. In *Interdisziplinäre Rechtsforschung: Kongressbeiträge – Wie wirkt Recht*, edited by Estermann, 2009. Lidhur me Freedom House, për një përmbledhje mbi kushtet historike të treguesit Liria në Botë, shih Bradley, Christopher. “International Organizations and the Production of Indicators: The Case of Freedom House”. In *The Quiet Power of Indicators: Measuring Governance, Corruption, and the Rule of Law*, edited by Merry, Davis, and Kingsbury, 2015, pp. 27–74.

efektivitetin e masave mbrojtëse” (f. 44)⁶³² [përkthim nga autori]. Megjithëse janë bërë disa hapa pozitivë duke marrë parasysh sondazhet e ndryshme duke përfshirë administrimin gjyqësor të perceptuar nga publiku,⁶³³ por kjo nuk mund të japë një pamje cilësore të realitetit.

Së dyti, emrat e anëtarëve, që përbëjnë grupin joformal prej dy anëtarësh brenda rishikimit kombëtar, nuk janë zbuluar. Për më tepër, një individ është i lidhur me Ministrinë e Drejtësisë, duke reflektuar kështu perspektivën e degës ekzekutive. Duhet theksuar, gjithashtu, se Komisioni Evropian funksionon si degë ekzekutive e Bashkimit Evropian.

Duke pasur parasysh këto shqetësime, Komisioni mund të përballlet me presion politik dhe kritika nëse të dhënat pasqyrojnë me saktësi situatën brenda shteteve anëtare.⁶³⁴ Shtetet individuale mund të interpretojnë gjetjet e EUJS për t’iu përshtatur interesave të tyre. Për shembull, në Poloni, kur EUCJ theksoi aspektet pozitive të gjyqësorit, qeveria promovoi zbatimin dhe domosdoshmërinë e rekomandimeve të EUCJ. Në të kundërt, nëse të dhënat kritikojnë gjyqësorin polak, zyrtarët argumentuan se informacioni nuk ishte i besueshëm.⁶³⁵

Një qasje e mundshme për të trajtuar kritikën e lartpërmendura është përfshirja ose zëvendësimi i dy anëtarëve të grupit joformal me ekspertë specifikë të fushës, që përfaqësojnë secilin vend. Këta ekspertë do të zgjidhen sipas kriterëve të përcaktuara qartë në lidhje me kualifikimet dhe përshtatshmërinë e tyre. Si të tilla, “pikat e kontaktit” të caktuara do të mbeten të pavarura si nga autoritetet ekzekutive ashtu edhe nga ato gjyqësore. Procesi i emërimit do të ishte transparent, duke lejuar ekspertët ndërkombëtarë ose kombëtarë të aplikojnë, megjithëse BE-ja mund të zgjedhë të mos zbulojë identitetin e tyre.

Si përmbledhje, dekadat e fundit kanë parë miratimin e strategjive të reja, që përdorin mjete të buta për të ndikuar në sjelljen kombëtare – të tilla si Korniza e shtetit të të drejtës dhe raporti i shtetit të të drejtës. EUJS kërkon të bashkëpunojë me shtetet anëtare për të koordinuar politikën kombëtare përmes monitorimit dhe vlerësimit dhe jo harmonizimit. Është e rëndësishme të theksohet se EUJS nuk është një iniciativë pioniere, pasi elementët e metodologjisë së saj rrjedhin nga treguesit e CEPEJ, të cilët u krijuan në vitin 2004 – një dekadë më parë. Vitet e fundit, BE-ja është angazhuar, gjithashtu, në përpjekje bashkëpunimi me CEPEJ.

4.2.1 Treguesit evropianë të performancës gjyqësore dhe rëndësia e tyre për Shqipërinë.

Projektreforma kushtetuese e vitit 2016, theksoi rëndësinë e vlerave të BE-së edhe në preambulën e tij.⁶³⁶ Në të vërtetë, ajo deklaroi “me një bindje të thellë se vlerat evropiane, drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi midis kombeve janë ndër vlerat

⁶³² Komisioni Evropian. *EU Justice Scoreboard 2020*. I disponueshëm në internet: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52020DC0306>.

⁶³³ Bashkimi Evropian. cit note 39.

⁶³⁴ Jakab, András. cit note 3.

⁶³⁵ Pech, L. “The Rule of Law”. In *The Evolution of EU Law*, 3rd ed., edited by P. Craig and G. De Búrca, Oxford University Press, 2021, pp. 322–324.

⁶³⁶ Euralius. *Consolidated Version of the Constitution of the Republic of Albania Integrating the Draft Constitutional Amendments Dated 04 Majit 2016*. I disponueshëm në internet: <https://euralius.eu/images/Justice-Reform/Constitution-04-05-2016-ENG-clean-copy.pdf>.

më të larta të njerëzimit” [përkthim nga autori]. Edhe pse ky version nuk u miratua, përparësia e ligjit të BE-së mbi legjislacionin shqiptar është argumentuar nga doktrina.⁶³⁷

Për më tepër, doktrina ka treguar në raste konkrete zbatimin e ligjit të BE-së nga Gjykata Kushtetuese apo Gjykata e Lartë.⁶³⁸ Sipas këtij hulumtimi të fundit, gjyqtarët shqiptarë kanë zbatuar ligjin e BE-së – si burime ligjore parësore dhe dytësore – si dhe ligjin e butë (soft laws) të BE-së.

Në disa raste, doktrina ka treguar rëndësinë e ligjit të BE-së edhe në legjislacionin kombëtar: të tilla si ligji i konsumatorit,⁶³⁹ kontratat e ndarjes së kohës,⁶⁴⁰ përgjegjësia civile mjekësore,⁶⁴¹ si dhe ligji i trashëgimisë.⁶⁴² Duke u fokusuar në rastin e administrimit gjyqësor, me tej, do të tregojë se në një rast ku gjyqtarët nënvizuan edhe rëndësinë e administrimit gjyqësor, Gjykata e Lartë iu referua edhe ligjit të BE-së.

Ndërsa normat e tjera kushtetuese që lidhen me ligjin e BE-së – pra neni 2 (4),⁶⁴³ 39 (2),⁶⁴⁴ 64 (4),⁶⁴⁵ 80/a,⁶⁴⁶ 109 (4),⁶⁴⁷ 122 (3),⁶⁴⁸ 161 (3)⁶⁴⁹ dhe 179 (10)⁶⁵⁰ – nuk u miratuan, roli i BE-së në rivlerësimin e magjistratëve shqiptarë u miratua. Në të vërtetë, neni 179/B (1) i Kushtetutës thotë se “operacioni ndërkombëtar i monitorimit do të mbështesë procesin e rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes së gjithë procesit. Ky operacion përfshin partnerët në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe

⁶³⁷ Veshi, Denard, et al. “The EU’s Impact on the Albanian Succession Private International Law”. *Studi sull’Integrazione Europea*, no. 1, 2023, pp. 139–162.

⁶³⁸ Veshi, Denard. “The European Union’s Impact on the Albanian Time-Share Contracts on Immovable Properties”. *Journal of Civil Law Studies*, vol. 17, 2025, p. 367.

⁶³⁹ Veshi, Denard. cit note 10.

⁶⁴⁰ Veshi, Denard. “Time-Sharing of Immovable Property between EU and Albanian Law: Jurisdiction, Applicable Law, and Consumer Protection in Case-Law.” *European Property Law Journal*, no. 3, 2025, pp. 239–262.

⁶⁴¹ Koka, Enkelejda, Denard Veshi, and Aisha Morina. “EU Impact on Albanian Medical Civil Liability: A Case Law Approach”. *Freedom, Security & Justice: European Legal Studies*, no. 2, 2025, pp. 146–1616.

⁶⁴² Koka, Enkelejda, et al. “Implementation of the Commission Recommendation of 7 December 1994 on the Transfer of Small- and Medium-Sized Enterprises in Albania: A German or Italian Model?” *European Review of Private Law*, vol. 32, no. 5, 2024; Cekaj, Fiorela, et al. “Succession Contracts for Family Firms in Italy and Albania: A European Private International Law Approach”. *Osservatorio del Diritto Civile e Commerciale*, vol. 11, no. 2, 2022, pp. 621–638; Veshi, Denard, et al. “Albanian (International) Succession Law and the EU Legislation.” *European Review of Private Law*, vol. 32, no. 1, 2024; Veshi, Denard, et al. “The EU’s Impact on the Albanian Succession Private International Law”. *Studi sull’Integrazione Europea*, no. 1, 2023, pp. 139–162.

⁶⁴³ Propozimi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 4 Maj 2016. Në dispozicion në: <https://euralius.eu/images/Justice-Reform/Constitution-04-05-2016-ENG-clean-copy.pdf>, Neni 2(4): “Me anëtarësimin, Republika e Shqipërisë u delegon institucioneve të Bashkimit Evropian kompetencat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi, bazuar në një ligj të miratuar me shumicën prej tre të pestash të të gjithë anëtarëve të Kuvendit”.

⁶⁴⁴ Neni 39(2): “Ekstradimi lejohet kur parashikohet shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, vetëm me vendim gjyqësor, si dhe në rast se parashikohet nga legjislacioni i Bashkimit Evropian”.

⁶⁴⁵ Neni 64(4): “Me hyrjen e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, qytetarët shqiptarë zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Asamblenë Evropiane me votim të drejtpërdrejtë në një mënyrë të rregulluar me ligj”.

⁶⁴⁶ Neni 80a: *i Ministrave do t’i raportojë Kuvendit mbi aktet që po përgatiten në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë në institucionet e Bashkimit Evropian. Kuvendi Magjistrat nxjerr një rezolutë e cila do të shërbejë si bazë për veprimet e Këshillit të Ministrave në institucionet e Bashkimit Evropian.*

⁶⁴⁷ Neni 109/4: “Këshilli i Ministrave i raporton Kuvendit mbi aktet që po përgatiten në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë në institucionet e Bashkimit Evropian. Kuvendi nxjerr një rezolutë e cila shërben si bazë për veprimet e Këshillit të Ministrave në institucionet e Bashkimit Evropian”.

⁶⁴⁸ Neni 122(3): “E drejta e Bashkimit Evropian që zbatohet drejtpërdrejtë mbizotëron mbi të drejtën e brendshme të Republikës së Shqipërisë”.

⁶⁴⁹ Neni 161(3): “Nëse Shqipëria lidh një marrëveshje me Bashkimin Evropian për të futur Monedhën Evropiane, Banka e Shqipërisë do të transferojë kompetencat në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje”.

⁶⁵⁰ Neni 179 (10): “Ndryshimet në nenet 39 paragrafi 2, 64 paragrafi 4, 80/a, 122 paragrafi 3, 161 paragrafi 3, hyjnë në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë që ratifikon traktatin e pranimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian”.

bashkëpunimit euro-atlantik dhe udhëhiqet nga Komisioni Evropian” [përkthim nga autori]. Ky është i vetmi rast kur në nivel Kushtetues roli i BE-së është miratuar, siç sugjeroi Opinioni i Venecias nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2016. Kjo tregon interesin e të dyja palëve ligjvënësve kushtetues: BE-ja dhe Shqipëria – për reformën gjyqësore shqiptare dhe procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve shqiptarë. Përfundimisht, mbase edhe për shkak të procesit të vettingut, 47% e publikut besojnë në sistemin gjyqësor.⁶⁵¹ Edhe pse ky numër është më i ulët se mesatarja e BE-së (54%), besimi i publikut shqiptar në sistemin gjyqësor është më i larti për vendet e BE-së që kanë hapur kapitujt e negociatave (30% në Serbi, 28% në Maqedoninë e Veriut dhe 26% në Mal të Zi).

Kapitulli 23 i Raportit për Shqipërinë 2025⁶⁵² titullohet Gjyqësori dhe të drejtat themelore. Në të vërtetë, ai fillon duke nënkuptuar rëndësinë e sistemit gjyqësor. Raporti thekson rëndësinë e Kapitullit 23, i cili trajton gjyqësorin dhe të drejtat themelore. Megjithatë, ai tërheq vëmendjen në disa aspekte negative. Për shëmbull cilësia e përgjithshme e drejtësisë mbetet e kufizuar, veçanërisht për shkak të standardeve të pamjaftueshme në trajnimin profesional. Ka probleme me qëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore, vendet vakante gjyqësore dhe anëtarët e pamjaftueshëm të stafit, si dhe mungesën e menaxhimit elektronik të çështjeve,⁶⁵³ ose ndalimin e magjistratëve të mëparshëm që nuk e kanë kaluar procesin e vettingut për të dhënë mësim në Shkollën e Magjistraturës.⁶⁵⁴

Duke u ndalur në efikasitetin gjyqësor, Raporti Shqiptar i vitit 2025 thotë “efikasiteti i sistemit të drejtësisë është i kufizuar. Efikasiteti pengohet ende nga kohëzgjatja e shtuar e procedurave dhe një numër i madh i çështjeve të prapambetura, veçanërisht në nivelin e apelit. Publikimi i vendimeve përfundimtare vazhdon të tejkalojë afatin ligjor dhe vonesat serioze shkaktohen nga menaxhimi i pamjaftueshëm i seancave gjyqësore dhe mungesa e avokatëve mbrojtës” (f. 30) [përkthim nga autori].

Megjithatë, niveli i pavarësisë dhe paanshmërisë mbetet i kënaqshëm brenda Gjykatës së Lartë dhe gjykatave të shkallës së parë. Përveç kësaj, një rezultat i ngjashëm i kënaqshëm vihet re edhe në lidhje me llogaridhënien e gjyqësorit. Në të vërtetë, nga tetori i vitit 2025, më pak se 40% e magjistratëve ishin konfirmuar në detyrë. Për më tepër, Inspektorati i lartë i deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe konflikteve të interesit duhet të vendosë rregulla të reja, që janë në përputhje me situatën aktuale. Për më tepër, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar një udhërrëfyes efikas për të adresuar numrin e prapambetur, megjithëse mbeten të nevojshme masa shtesë.

⁶⁵¹ Bashkimi Evropian, cit note 39.

⁶⁵² Komisioni Evropian. *Albania 2025 Report*. 2025. I disponueshëm në internet: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

⁶⁵³ Këshilli i Evropës, Committee of Ministers. *Luli and Others kundër Albania – Supervision of the Execution of the Judgment (Non-Official Albanian Translation)*. I disponueshëm në internet: <https://rm.coe.int/1514cmnotes-01-luli-2750-7631-6426-51-albanian-non-official-translation/1680b3b700>.

⁶⁵⁴ Megjithatë, duhet përmendur se Ligj Nr. 10/2026 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 115/2016, “Për Organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka shtuar në nenin 19(3) shkronja ç/1 ku thuhet: “të mos kenë masë disiplinore në fuqi, të mos jenë shkarkuar më parë nga detyra si rezultat i një mase disiplinore, në rastin e ish-magjistratëve të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ose të mos kenë dhënë dorëheqjen pa iu nënshtruar këtij procesi, ndërkohë që kanë qenë subjekt rivlerësimit në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të mos jenë skualifikuar më parë nga pozicione të ndryshme për shkak të verifikimit të pasurisë dhe figurës, sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi”. Me fjalë të tjera, rekomandimi i Raportit të BE-së 2025 në faqen 29 u zbatua menjëherë.

Financimi në reformën e sistemit gjyqësor është thelbësor. Ndërsa disa shtete anëtare të BE-së kanë prezantuar Fondet evropiane strukturore dhe të investimeve përmes aplikimit të Regj. Nr. 1303/2013 të BE-së,⁶⁵⁵ në Shqipëri janë aplikuar disa projekte; në veçanti, projektin e përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës “Forcimi i cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë në Shqipëri” (SEJ IV).

Për të përfunduar, ndërsa në vendet anëtare të BE-së reformat gjyqësore – të mbështetura edhe përmes Fondeve Strukturore dhe Evropiane të Investimeve – u zbatuan gjatë fillimit të viteve 2010, në Shqipëri u krye procesi i vettingut (rivlerësimi i magjistratëve) në vitin 2016. Përveç kësaj, megjithëse reforma kushtetuese e vitit 2016 nuk miratoi referenca eksplicite në ligjin e BE-së, neni B(1) i Kushtetutës nënvizoi në mënyrë eksplicite rolin e Komisionit Evropian në rivlerësimin e magjistratëve shqiptarë. Kjo mund të shpjegojë pse, krahasuar me vendet e tjera, që kanë hapur kapituj negociatash, Shqipëria demonstroi një nivel relativisht të lartë të besimit të publikut në sistemin e ri gjyqësor. Por ende, sipas Raportit më të fundit të BE-së, efikasiteti gjyqësor mbetet një nga sfidat kryesore në Kapitullin 23, i cili ka të bëjë me gjyqësorin dhe të drejtat themelore.

4.3 Administrimi i drejtësisë dhe zhvillimi i praktikës gjyqësore në Shqipëri

Ky seksion shqyrton rolin e administrimit gjyqësor në Shqipëri nga një këndvështrim i orientuar drejt praktikës gjyqësore. Siç theksohet në Kapitullin e 2, një reformë gjithëpërfshirëse kushtetuese u miratua në vitin 2016 me qëllim forcimin e besimit të publikut në gjyqësor. Neni 141(1) i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon se Gjykata e Lartë gjykon çështjet, që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, me qëllim të sigurimit të unifikimit dhe zhvillimit të praktikës gjyqësore, në përputhje me dispozitat ligjore.

Për hir të qartësisë, sistemi gjyqësor shqiptar përfshin juridiksionin e zakonshëm dhe mekanizmat alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, krahas gjykatave të specializuara të prezantuara nga reformat e viteve 2012 dhe 2016, përkatësisht Gjykatat Administrative dhe Gjykata e Posacme për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar. Sa i përket drejtësisë administrative, Gjykata e Lartë, nëpërmjet Kolegjit të saj Administrative, përbën autoritetin më të lartë gjyqësor për çështjet administrative sipas ligjit Nr. 49/2012 të 3 majit 2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e kontesteve administrative”. Kjo marrëveshje institucionale ndryshon nga sisteme të tilla si ato të Italisë dhe Francës, ku juridiksioni administrativ është strukturalisht i ndarë nga juridiksioni i zakonshëm dhe kulmon përkatësisht në *Consiglio di Stato*⁶⁵⁶ dhe *Conseil d'État*. Rrjedhimisht, ndërsa në Itali dhe Francë operojnë sisteme gjyqësore administrative me dy nivele, Shqipëria mban një strukturë me tre nivele, në të cilën Gjykata e Lartë mbetet autoriteti përfundimtar për mosmarrëveshjet administrative.

Një strukturë e ngjashme me tre nivele ekziston në ato çështje, që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe krimin e organizuar, e përbërë nga Gjykata e shkallës së parë për korrupsionin dhe krimin e organizuar, Gjykata e Apelit për korrupsionin dhe krimin e

⁶⁵⁵ Rregullorja (BE) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013, që përcakton dispozita të përbashkëta mbi Fondin evropian të zhvillimit rajonal, Fondin social evropian, Fondin e kohezionit, Fondin evropian bujqësor për zhvillim rural dhe Fondin evropian detar dhe të peshkimit, si dhe që përcakton dispozita të përgjithshme mbi Fondin evropian të zhvillimit rajonal, Fondin social evropian, Fondin e kohezionit dhe Fondin evropian detar dhe të peshkimit, si dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1083/2006.

⁶⁵⁶ Duhet theksuar se, përveç Siçilisë, e cila ka Gjykatën e vet të Apelit, Këshilli i Drejtësisë Administrative për Rajonin e Siçilisë. Giustizia Amministrativa, në dispozicion në internet: <https://www.giustizia-amministrativa.it/consiglio-cgars>

organizuar dhe, në fund të fundit, Gjykata e Lartë, që vepron përmes Kolegjit së saj Penale. Kështu, ashtu si në rastin e kontesteve administrative, edhe në çështjet penale, që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe krimin e organizuar, Gjykata e Lartë jep vendimin përfundimtar gjyqësor.

Duhet theksuar se sistemi gjyqësor me 3 nivele është në përputhje me Kushtetutën kombëtare, pasi neni 43 garanton të drejtën e ankimit të një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç nëse parashikon ndryshe Kushtetuta.

Bazuar në nenin 141(1) të Kushtetutës së Shqipërisë, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet reformave të fundit të Kodit të Procedurës Civile (KPP), Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe Ligjit Nr. 49/2012 të 3 majit 2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative". Së bashku, këto zhvillime legjislativë përforcojnë rolin institucional të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë duke forcuar funksionin autoritar të praktikës së saj gjyqësore në sigurimin e interpretimit uniform dhe zbatimit të qëndrueshëm të ligjit. Në lidhje specifike me procedurat administrative, neni 2 (2) i ligjit Nr. 49/2012 parashikon se dispozitat e tij plotësohen me ato të Kodit të Procedurës Civile, përveç rasteve kur rregullohet ndryshe shprehimisht. Prandaj, Ligji Nr. 49/2012 funksionon si *lex specialis*,⁶⁵⁷ duke vendosur rregulla procedurale të përshtatura për mosmarrëveshjet administrative, duke u mbështetur në mënyrë subsidiare në normat procedurale civile.

Konkretisht, një nga arsytet e shqyrtimit gjyqësor para Gjykatës së Lartë të Shqipërisë lind kur vendimi i ankimuar devijon nga praktika e vendosur e Kolegjit përkatës ose nga jurisprudenca e njohur e Kolegjeve të Bashkuara (neni 472 (1) (b) KPP, neni 58 (1) (b) Ligji Nr. 49/2012, neni 432 (1) (a) KPriP). Për më tepër, në procedurat që kanë të bëjnë me unifikimin ose modifikimin e praktikës gjyqësore, vendimet e miratuara nga Kolegji ose nga Kolegjet e Bashkuara janë të detyrueshme për gjykatat më të ulëta në gjykimin e çështjeve të ngjashme (neni 481 (8) KP, neni 62/a(8) Ligji Nr. 49/2012, neni 438(8) KPriP).

Reformat parashikojnë më tej se Gjykata e Lartë do të zhvillojë shqyrtimin e çështjes në seancë publike kur çështja është e rëndësishme për unifikimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore (neni 482/a(1)(a) KPP). Për të siguruar transparencë dhe shpërndarjen e jurisprudencës, vendimet për krijimin e praktikës së re gjyqësore duhet të publikohen në Fletoren Zyrtare (neni 485 (2) KPP, neni 63 (2) Ligji Nr. 49/2012, neni 441 (2) KPP, si dhe neni 35(4) të ligjit nr. 98/2016 " Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Së fundi, kur një çështje dërgohet për rishqyrtim në gjykatat më të ulta, udhëzimet e dhëna nga Gjykata e Lartë janë të detyrueshme për gjykatat më të ulëta (neni 493 (4) KCP, neni 63 (1) (c) Ligji Nr. 49/2012). Megjithëse ky mekanizëm mund të duket analog me doktrinën e *stare decisis*, parimet ligjore të vendosura nga një autoritet gjyqësor suprem janë përgjithësisht të detyrueshme në rastet e mëvonshme analoge. Prandaj, këto dispozita pasqyrojnë ushtrimin e funksionit nomofilaktik të Gjykatës së Lartë në Shqipëri, me qëllim sigurimin e interpretimit uniform dhe zbatimit të qëndrueshëm të ligjit.⁶⁵⁸

Megjithëse këto reforma synojnë t'i japin zbatim konkret Neni 6 i KEDNJ, jo të gjitha Kolegjet e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë i kanë zbatuar ato në përputhje me *ratio*

⁶⁵⁷ Veshi, Denard. cit note 10.

⁶⁵⁸ Veshi, Denard, cit note 17.

legis. Në veçanti, Neni 480 i Kodit të Procedurës Civile⁶⁵⁹ parashikon një mekanizëm filtrues, i cili në mënyrë ideale duhet të funksionojë brenda një afati prej 60 ditësh. Aktualisht, vetëm Kolegji Administrativ duket se e zbaton në mënyrë konsistente këtë mekanizëm.⁶⁶⁰ Megjithatë, pavarësisht rëndësisë së tij parësore për të shmangur që në fillim krijimin e një ngarkese të paarsyeshme të çështjeve në pritje të shqyrtimit në Gjykatën e Lartë, dispozita nuk parashikon rregulla të detajuara për zbatimin e saj.⁶⁶¹

Duhet theksuar, gjithashtu, se në procedurën seleksionuese (filtruese), që ndiqet sipas nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues nuk mund të japë vendime të tjera, nga ato të parashikuara më lart, ku i pari (mospranimi) është vendim jopërfundimtar, që i jep fund procesit, por pa u shprehur për themelin e çështjes, pikërisht sepse nuk ngrihen shkaqet e dhura në rekurs, ndërsa vendimmarrja e dytë është e ndërmjetme dhe nëpërmjet saj kalohet çështja për shqyrtim të mëtejshëm të shkaqeve të ngritura në rekurs, në mënyrë që gjykata t'u japë përgjigje atyre (par. 14).⁶⁶²

Megjithëse neni 480 i KPC është ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.05.2001 (neni 126), si dhe me ligjin nr. 122/2013, ka rezultuar e nevojshme informimi i publikut, të paktën për mosmarrëveshjet administrative, përmes një njoftimi të bërë në prill 2023.⁶⁶³ Në këtë kuadër, në vendimmarrjen e datës 24 prill 2023, gjyqtarët shqiptarë i janë referuar si jurisprudencës së GJEDNJ, ashtu edhe asaj të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë. Në mënyrë konkrete, është theksuar se nuk është e nevojshme të jepet një arsyetim i hollësishëm kur zbatohet një dispozitë ligjore për mospranimin e rekursit. Në këtë drejtim, janë marrë në konsideratë çështjet Gorou kundër Greqisë (nr. 2) (§41) dhe Burg e të tjerë kundër Francës, të referuara nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2023-1699, datë 24.04.2023. Në të vërtetë, mungesa e një arsyeimi të detajuar nuk përbën shkelje të standardit të arsyeimit të vendimit gjyqësor, sipas praktikës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë (shih vendimet nr. 12, datë 15.03.2023; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 8, datë 26.02.2015).

Ky seksion shqyrton rëndësinë e administrimit gjyqësor duke adoptuar një qasje të bazuar në praktikën gjyqësore të fokusuar në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë. Duke pasur parasysh pamundësinë e analizimit të tërësisë së praktikës gjyqësore dhe rëndësinë e veçantë të vendimeve, që unifikojnë ose modifikojnë praktikën gjyqësore kombëtare, ky seksion fokusohet ekskluzivisht në vendimet e miratuara nga trupat gjykues të Kolegjeve e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, si dhe të Kolegjeve të Bashkuara. Termat kyç të përdorur

⁶⁵⁹ Mospranimi i rekursit vendoset në dhomë këshillimi, në kolegji me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, në rastet kur:

a) bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji;

b) nuk plotësohen kërkesat procedurale të parashikuara në këtë kre; c) pala që ka paraqitur rekurs heq dorë prej tij.

Pala kundër së cilës është paraqitur rekursi, mund të paraqesë kundërshtimet e saj sipas rregullave të parashikuara në nenin 477 të këtij Kodi.

Shqyrtimi bëhet brenda 60 ditëve nga depozitimi i rekursit, pa praninë e palëve, por pasi janë shqyrtuar pretendimet me shkrim të tyre për çështjen e pranueshmërisë.

I njëjti trup gjykues vendos për çdo kërkesë procedurale të palëve, me përjashtim të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit.

⁶⁶⁰ Vokshi, Asim. "Funksionimi kushtetues i Gjykatës së Lartë dhe garantimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm". *Dialog Juridik: Revista Digjitale*, no. 2–4, 2026.

⁶⁶¹ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendim nr. 00-2023-1699, 24.04.2023.

⁶⁶² Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendim nr. 00-2023-1699, 24.04.2023, par. 14.

⁶⁶³ Për më shumë informacion, shih njoftimin zyrtar të publikuar nga Gjykata e Lartë e Shqipërisë http://www.gjykataelarte.gov.al/web/NJOFTIM_Kolegji_Administrativ_do_te_rinise_brenda_muajit_Prill_2023_me_shqyrtimin_ne_kolegjin_seleksionues_te_rekurseve_te_regjistruara_ne_m_22367_1.php. Megjithatë, ky link nuk është më funksional për shkak të ristrukturimit të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë.

për identifikimin e tyre janë “administrim”, “administrim gjyqësor”, “vetting” dhe “e drejta e qasjes (aksesit)”, në lidhje me administrimin e drejtësië.

Pas reformave, sistemi procedural miraton një tipologji të strukturuar të akteve gjyqësore, duke bërë dallimin midis vendimeve përfundimtare, të cilat zgjidhin mosmarrëveshjen në thelb dhe përfundojnë procedurat, dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat përbëjnë një rol funksional dhe instrumental duke trajtuar kërkesat procedurale dhe duke siguruar ecurinë e rregullt të procedurave (neni 127 KPP; Neni 62/a i ligjit Nr. 49/2012; Nenet 249 dhe 415 KPP).

Brenda kësaj arkitekture institucionale të reformuar, Gjykata e Lartë vepron përmes formacioneve të diferencuara gjyqësore, që korrespondojnë me funksione të veçanta sistemike. Ankesat shqyrtohen nga një trup gjykues me tre gjyqtarë brenda Kolegjit Civil, Penal ose Administrativ përkatësisht, duke ruajtur kështu funksionin e zakonshtëm të kasacionit. Detyra e sigurimit të interpretimit dhe zbatimit uniform të ligjit u ngarkohet kolegjeve prej pesë gjyqtarësh.

Në të kundërt, autoriteti për të modifikuar praktikën e vendosur gjyqësore i rezervohet Kolegjeve të Bashkuara, të përbëra nga nëntëmbëdhjetë gjyqtarë (neni 482 KPP; Neni 62/a i ligjit Nr. 49/2012; Neni 14/a KPriP).

Me fjalë të tjera, ndërsa para reformave funksioni i sigurimit të praktikës uniforme gjyqësore ushtrohej nga Kolegjet e Bashkuara, ky funksion tani kryhet nga kolegje të specializuara, që korrespondojnë me degët përkatëse të juridiksionit.⁶⁶⁴

Tabela 2: Vendimet e ndërmjetme për unifikimin ose modifikimin e praktikës gjyqësore 2021-2025

Viti	Numri i përgjithshëm i vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara	Numri i përgjithshëm i vendimeve të Kolegjit Civil në lidhje me të drejtën civile	Numri i përgjithshëm i vendimeve të Kolegjit Penal në lidhje me të drejtën penale	Numri i përgjithshëm i vendimeve të Kolegjit Administrativ në lidhje me të drejtën administrative
2021	7	1	4	2
2022	13	4	5	4
2023	13	2	4	7
2024	8	1	4	4
2025	4	1	2	1
Gjithsej 2021–2025	45	9	19	18

⁶⁶⁴ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Civil, vendimi nr. 00-2023-4411 (106), 2 Marsit 2023; Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Penal, vendimi unifikues Nr. 13, 4 Prillit 2018.

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e vendimeve të Gjykatës së Lartë për unifikimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, 2021–2025.

Të dhënat tregojnë se gjatë periudhës 2021–2025 janë marrë gjithsej 45 vendime për unifikimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, ku peshën më të madhe e zë fusha penale me 19 vendime, e ndjekur nga fusha administrative me 17 vendime dhe ajo civile me 9 vendime. Kjo shpërndarje dëshmon se funksioni unifikues i Gjykatës së Lartë është ushtruar në mënyrë të diferencuar sipas natyrës së çështjeve, duke reflektuar një qasje më të specializuar ndaj konsolidimit të jurisprudence.

Tabela 3: Vendimet për unifikimin ose modifikimin e praktikës gjyqësore 2018-2025

Viti	Numri i përgjithshëm i vendimeve të Kolegjet e Bashkuara	Numri i përgjithshëm i vendimeve të Kolegjit Civil në lidhje me të drejtën civile	Numri i përgjithshëm i vendimeve të Kolegjit Penal në lidhje me të drejtën penale	Numri i përgjithshëm i vendimeve të Kolegjit Administrativ në lidhje me të drejtën administrative
2018	2	1	1	0
2019	0	0	0	0
2020	0	0	0	0
2021	6	0	4	2
2022	7	2	5	0
2023	10	2	2	6
2024	9	2	2	5
2025	4	0	2	2
Totali 2021–2025	38	7	16	15

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e vendimeve të Gjykatës së Lartë për unifikimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, 2018–2025.

Të dhënat tregojnë se gjatë periudhës 2018–2025 Gjykata e Lartë ka miratuar gjithsej 38 vendime për unifikimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore. Peshën më të madhe e përket Kolegjit Penal, me 16 vendime, i ndjekur nga Kolegji Administrativ me 15 vendime dhe Kolegji Civil me 7 vendime. Mungesa e vendimeve në vitet 2019 dhe 2020 reflekton periudhën tranzitore të funksionimit të Gjykatës së Lartë, ndërsa rritja e tyre pas vitit 2021 dëshmon riaktivizimin gradual të funksionit unifikues të saj. Kjo shpërndarje tregon kalimin drejt një modeli më të zhdërvjellët të konsolidimit të jurisprudence, ku secili kolegji kontribuon në zhvillimin e praktikës gjyqësore brenda fushës përkatëse të juridiksionit.

Tabela 4: Vendimet për Gjykatën e Lartë, Kolegjet e Bashkuara 2022-2025

Viti	Numri i përgjithshëm i vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara	Numri i përgjithshëm i vendimeve të Kolegjit Civil në lidhje me të drejtën civile	Numri i përgjithshëm i vendimeve të Kolegjit Penal në lidhje me të drejtën penale	Numri i përgjithshëm i vendimeve të Kolegjit Administrativ në lidhje me të drejtën administrative
2022	2	1	1	0
2023	1	0	0	1
Totali 2022–2025	3	1	1	1

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, 2022–2025.

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 4 tregojnë se gjatë periudhës 2022–2025 roli i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në funksionin unifikues ka qenë i kufizuar, me vetëm 3 vendime gjithsej. Nga këto, 2 vendime i përkasin vitit 2022 dhe 1 vendim vitit 2023, ndërsa për vitet 2024 dhe 2025 nuk rezultojnë vendime të evidentuara në këtë kategori. Shpërndarja sipas fushave të së drejtës është e balancuar, pasi secila nga tri fushat — civile, penale dhe administrative — përfaqësohet me nga një vendim. Kjo tregon se Kolegjet e Bashkuara kanë ndërhyrë vetëm në raste të kufizuara, me rëndësi të veçantë për unifikimin ose orientimin e praktikës gjyqësore, ndërkohë që funksioni kryesor i konsolidimit të jurisprudence duket se është zhvendosur gradualisht drejt kolegjeve të specializuara. Në këtë kuptim, tabela dëshmon kalimin nga modeli tradicional i unifikimit përmes Kolegjeve të Bashkuara drejt një modeli më të diferencuar dhe sektorial, ku Kolegji Civil, Kolegji Penal dhe Kolegji Administrativ marrin një rol më aktiv në zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas fushës përkatëse të juridiksionit.

Tabela 5: Vendimet për Gjykatën e Lartë, Kolegjet e Bashkuara 2022-2025 që kanë përmendur administrimi gjyqësor

Kolegjet e Bashkuara	Vendimet e ndërmjetme	Vendimet Përfundimtare
Penale		
Vendim penal nr. akti 2, dt. 18.11.2022	Vendim penal nr. akti 71001-00493-00-2017, dt. 15.07.2022	Vendim penal nr. akti 00-2024-2161 (167), dt. 04.07.2024
		Vendim penal nr. akti 00-2018-148 (13), dt. 04.04.2018
Administrative		
		Vendim Administrativ nr. 00-2023-4279 (259), dt. 07.07.2023

Kolegjet e Bashkuara	Vendimet e ndërmjetme	Vendimet Përfundimtare
		Vendim Administrativ nr. akti 00–2023–5688 (409), dt. 23.11.2023
		Vendim Administrativ nr. 00-2025-1483, dt. 13.01.2025

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e vendimeve të Gjykatës së Lartë që përmendin administrimin gjyqësor.

Për ta përmbledhur, pas Vettingut deri në fund të vitit 2025, të dhënat e paraqitura në Tabelën 5 tregojnë se administrimi gjyqësor është përmendur në një numër të kufizuar vendimesh të Gjykatës së Lartë. Këto vendime i përkasin kryesisht fushës penale dhe asaj administrative, ndërsa nuk rezultojnë të ketë vendime të identifikuar në fushën civile që ta trajtojnë në mënyrë të shprehur këtë çështje. Në aspektin formal, vendimet janë të shpërndara ndërmjet Kolegjeve të Bashkuara, vendimeve të ndërmjetme dhe vendimeve përfundimtare, çka tregon se administrimi gjyqësor nuk është trajtuar vetëm si çështje procedurale, por edhe si element, që lidhet me funksionimin institucional të gjykatave, organizimin e procesit gjyqësor dhe efektivitetin e drejtësisë. Megjithatë, numri i kufizuar i vendimeve (vetëm 7 vendime), dëshmon se administrimi gjyqësor mbetet ende një temë e trajtuar në mënyrë sporadike në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, pavarësisht rëndësisë së tij për garantimin e një gjykimi efektiv, të organizuar dhe brenda një afati të arsyeshëm.

4.4 Praktika e Gjykatës së Lartë mbi administrimin gjyqësor dhe efikasitetin e gjykimit

Ndërsa seksioni 4.3 identifikoi rëndësinë e administrimit gjyqësor përmes analizës së jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, ky seksion synon të paraqesë konkretisht mënyrën se si kjo gjykatë e ka konceptuar administrimin e mirë të drejtësisë në praktikën e saj vendimmarrëse.

Gjykata e Lartë ka interpretuar edhe rregullat që lidhen me funksionimin institucional të sistemit të drejtësisë, veçanërisht në rastet kur dispozitat ligjore kanë paraqitur boshllëqe ose kanë kërkuar interpretim në funksion të mirëadministrimit të drejtësisë. Për shembull, neni 238 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” ndjek një qëllim legjitim dhe proporcional në kufizimin e të drejtës së rekursit, pasi dispozita përkatëse mishëron qëllimin e ligjvënësit për përfundimin në një kohë sa më shpejtë të procesit kushtetues të përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në funksion të zhblokimit të procesit të formimit të kësaj Gjykate dhe mirëadministrimit tërësor të sistemit të drejtësisë.⁶⁶⁵

Për më tepër, administrimi i mirë i drejtësisë lidhet ngushtë me garantimin e aksesit efektiv në gjykatë, me të drejtën për të ushtruar mjetet e ankimit, të parashikuara nga ligji

⁶⁶⁵ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00-2025-1483 (1), 13 janarit 2025, shumicë, paragrafi 11. Megjithatë, përkundrazi, gjyqtari Asim VOKSHI, në mendimin e tij mospajtues deklaroi se asnjë organ administrativ (KLGJ/KLP/KED etj) pavarësisht funksioneve që kryen në lidhje me administrimin e sistemit të drejtësisë, nuk mund të barazohet me gjykatën, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht vendimi i tyre në çdo lloj rasti nuk është “vendim gjyqësor” sipas kuptimit të kësaj dispozite kushtetuese (par. 12) [përkthim nga autori].

dhe me respektimin e garancive procedurale, që sigurojnë një proces të rregullt ligjor. Kjo do të jetë e kuptuar si në këndvështrimin formal ashtu edhe në atë procedural. Me fjalë të tjera, e drejta për të apeluar është pjesë e së drejtës për akses në drejtësi. Kështu, sipas Gjykatës, “administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë se një individ ka akses në gjykatë”, për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të të drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. Aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera.”⁶⁶⁶

Në rastin e të drejtës penale, administrimi i mirë gjyqësor, i lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë, përfshin gjithashtu, ndër të tjera, të drejtë e tij për t’u mbrojtur, për t’u dëgjuar, për të pasur akses në gjykatë, të drejta e çdo të pandehuri për të aksesuar në të gjitha rritualët e posaçme të gjykimit të parashikuar nga ligji procedural penal, që mund të jenë me efekt “premier”, si rasti i gjykimit të shkurtuar, të drejtën e të pandehurit për mbrojtje dhe kontradiktoritet, të drejtë e debatit gjyqësor për provat etj.⁶⁶⁷ Këtë e nënvizon edhe Gjykata Kushtetuese shqiptare,⁶⁶⁸ si dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së,⁶⁶⁹ apo rastet precedente të mëparshme.⁶⁷⁰

Një qëndrim të ngjashëm, ndonjëherë duke përdorur fjalë identike, është mbajtur jo vetëm nga Kolegji Penal, por edhe nga Kolegjet e Bashkuara, duke deklaruar se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë se një individ ka akses në gjykatë, për t’i siguruar atij/asaj të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës.⁶⁷¹

Edhe pse e drejta për të apeluar dhe e drejta për qasje (akses) në drejtësi janë të drejta kushtetuese, ligjvënësi mund të vendosë disa kufizime për të (d.m.th. afatet procedurale për ushtrimin e këtyre mjeteve të ankimit). Megjithatë, këto kufizime janë kushtetuese vetëm për sa kohë nuk cenojnë vetë thelbin e së drejtës për akses në drejtësi, pasi kjo e drejtë, sipas standardeve kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, nuk ka karakter absolut.⁶⁷² Gjykata e Lartë,⁶⁷³ duke cituar interpretimin e nenit 6 të KEDNJ-së nga GJEDNJ-ja,⁶⁷⁴ ka konfirmuar gjithashtu se këto kufizime janë në përputhje me të drejtën

⁶⁶⁶ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Penal, vendimi nr. 71001-00493-00-2017, 15 korrikut 2022, § 33.

⁶⁶⁷ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Penal, vendimi nr. 00-2024-2161 (167), 4 korrikut 2024.

⁶⁶⁸ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë. Vendimi nr. 24/2012, 10 shkurt 2012 dhe nr. 50, 30 korrikut 1999.

⁶⁶⁹ Konkretisht, Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Penal, vendimi nr. 00-2024-2161 (167), 4 korrikut 2024, ka cituar jurisprudencën të GJEDNJ-së disa herë.

⁶⁷⁰ Konkretisht, Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Penal, vendimi nr. 00-2024-2161 (167), 4 korrikut 2024, ka cituar jurisprudencën e Gjykatës së Lartë disa herë.

⁶⁷¹ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, vendimi nr. 2, 18 nëntorit 2022, § 41, mendimi i shumicës.

⁶⁷² Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00-2023-5688 (409), 23 nëntorit 2023, mendimet e shumicës dhe pakicës; Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00-2025-1483 (1), 13 janarit 2025, mendimi i shumicës.

⁶⁷³ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi Nr. 00-2023-5688 (409). 23 nëntorit 2023, mendimi i shumicës.

⁶⁷⁴ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00-2023-5688 (409), 23 nëntorit 2023, mendimet e shumicës dhe pakicës (duke cituar *Zubac kundër Kroacisë*; *Levages Prestations Services kundër Francës*, nr. 21920/93, 23 tetorit 1996); Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00-2025-1483 (1), 13 janarit 2025,

ndërkombëtare kur bëhen sipas qëllimit të normave ose për shkak të natyrës së saj dhe kompetencave rregullatore që ka shteti, që mund të variojnë në momente të ndryshme, sipas nevojave të publikut dhe individëve.⁶⁷⁵

Kështu, kufizimi nuk duhet të jetë i tillë që të reduktojë të drejtën deri sa të cenojë thelbin e saj.⁶⁷⁶ Me fjalë të tjera, aksesit në gjykatë mund t'i nënshtrohet kufizimeve për arsye të sigurisë juridike dhe mirëadministrimit të drejtësisë, me kusht që kufizimi të ndjekë një qëllim legjitim, të jetë proporcional dhe të mos prekë thelbin e së drejtës.⁶⁷⁷

Duhet theksuar se, kur nuk është ushtruar e drejta e ankimit, vendimi bëhet *res judicata*. Prandaj, për të pasur sigurinë juridike, një vendim i tillë nuk mund të rishikohet, përveç rasteve të përcaktuara shprehimisht dhe të parashikuara me ligj. Një shembull tipik i rishikimit për shkak të ndryshimit të rrethanave është vendimi që ka përcaktuar një detyrim ushqimor.⁶⁷⁸

Në disa raste specifike, ligjvënësi, gjithashtu, mund të përcaktojë se kur e drejta e ankimit ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe e drejta e rekursit ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk lejohet.⁶⁷⁹ Kjo qasje synon të shmangë çdo zvarritje të panevojshme të procesit, që do cenonte rëndë interesin publik dhe mirëadministrimin e sistemit të drejtësisë.⁶⁸⁰

Një rast tipik i kufizimit të së drejtës së ankimit parashikohet në nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012. Aty theksohet se kufizim është i vendosur me ligj në përputhje me nenet 17 dhe 43 të Kushtetutës dhe synon të balancojë të drejtën e aksesit në gjykatë dhe procesit të rregullt, me nevojën e interesit publik për mirëadministrimin e drejtësisë.⁶⁸¹ Ky ekuilibër vendos një raport proporcional mes këtyre interesave sepse pavarësisht se konflikti që shqyrtohet përfaqëson një vlerë të vogël monetare përsëri subjekteve u mundësohet që të kenë akses në të paktën një shkallë të sistemit gjyqësor, duke e bërë atë një mjet efektiv në kuptim edhe të nenit 13 të KEDNJ.⁶⁸² Ndonjëherë, e drejta e aksesit konsiderohet më e rëndësishme se administrimi i mirë gjyqësor: ky është rasti i sendeve, që kanë një vlerë disa herë më të lartë se kufiri i parashikuar në ligj.⁶⁸³

Siç pasqyrohet në Tabelën 5, në këto vendime Gjykata e Lartë i është referuar normave kushtetuese, jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, KEDNJ-së dhe praktikës së GJEDNJ-së synon të nënvizojë rëndësinë e administrimit të mirë gjyqësor. Për shembull, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, 00-2023- 4279 i Vendimit (259) i datës

mendimi i shumicës (duke cituar *Baka kundër Hungarisë*, § 120; *Zubac kundër Kroacisë*, § 98; *Famulli Katolike Greke Lupeni dhe të tjerë kundër Rumanisë*).

⁶⁷⁵ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2023–5688 (409), 23 nëntorit 2023, mendimi i shumicës, § 40.

⁶⁷⁶ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2025–1483 (1), 13 janarit 2025, mendimi i shumicës, § 22.

⁶⁷⁷ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2025–1483 (1), 13 janarit 2025, mendimi i shumicës, § 22.

⁶⁷⁸ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2023–4279 (259), 7 korrikut 2023.

⁶⁷⁹ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2023–5688 (409), 23 nëntorit 2023, mendimi i shumicës.

⁶⁸⁰ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2025–1483 (1), 13 janar 2025, mendimi i shumicës, § 31.

⁶⁸¹ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2023–5688 (409), 23 nëntorit 2023, mendimi i shumicës, §44.

⁶⁸² Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2023–5688 (409), 23 nëntorit 2023, mendimi i pakicës, § 12

⁶⁸³ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2023–5688 (409), 23 nëntorit 2023, mendimi i pakicës, § 28.

07.07.2023 iu referua praktikës gjyqësore Cañete de Goñi k. Spanjës, 2020, § 36 duke deklaruar se “rregullat që përcaktojnë hapat formalë që duhet të ndjekin palët si dhe afatet që duhen zbatuar prej tyre kur paraqesin një apel apo kërkesë për mbrojtje gjyqësore, synojnë sigurimin e administrimit të duhur të drejtësisë dhe veçanërisht, zbatimin e parimit të sigurisë juridike”.

Kjo e drejtë fillon “nga momenti kur pala vjen efektivisht në dijeni për një vendim të gjykatës që vendos një detyrim kundrejt saj apo që potencialisht dëmton të drejtat apo interesat e saj të ligjshme.”⁶⁸⁴ Ndërsa ky afat kohor nuk mund të rifillojë, Kodi parashikon mundësinë e rivendosjes së afatit kur pala demonstroi se ka humbur më parë afatin ligjor për paraqitjen e ankesës për arsye jashtë kontrollit të saj.⁶⁸⁵

Përveç kësaj, ndërsa gjykatat gëzojnë një shkallë diskrecioni në interpretimin e rregullave procedurale, ato duhet të vendosin një ekuilibër midis një interpretimi të rehtë, që do të minonte drejtësinë e procedurave dhe fleksibilitetit të tepruar, që do t'i bënte joefektive kërkesat procedurale të përcaktuara me ligj.⁶⁸⁶ Kur e bëjnë këtë, gjyqtarët duhet të marrin në konsideratë çështjet e sigurisë juridike dhe mirëadministrimit të drejtësisë duke marrë parasysh një balancë të drejtë midis legjitimitetit të masave procedurale për depozitimin e ankimit nga pikëpamja ligjore, nga njëra anë dhe të drejtës për akses në gjykatë, nga ana tjetër.⁶⁸⁷ Me fjalë të tjera, çështjet e sigurisë juridike dhe mirëadministrimit të drejtësisë janë dy elemente qendrorë për të bërë dallimin midis formalizimit të tepruar dhe formaliteteve procedurale të pranueshme për zbatim.⁶⁸⁸

Në të gjitha këto raste, shih tabelën 5, Gjykata e Lartë i është referuar praktikës së mëparshme gjyqësore. Për shembull, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vendimi 00–2023–5688 i Vendimit (409) i datës 23.11.2023, i referohet vendimit unifikues nr.3 të datës 06.12.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë duke u mbështetur se një administrimi sa më të mirë, efektiv dhe efikas të drejtësisë, që sjell zgjidhje sa më të shpejtë mosmarrëveshjeve dhe arritjen e paqes sociale me kosto sa më të ulët për shtetin dhe publikun është pjesë e interesit publik.

Ndonjëherë, Gjykata e Lartë i referohej asaj që kanë nënvizuar gjykatat e tjera të huaja. Për shembull, në rastin 00-2024-2161 i vendimit (167) të datës 04.07.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kanë cituar Gjykatën Kushtetuese italiane⁶⁸⁹ ose Gjykatat e Kasacionit⁶⁹⁰, si dhe legjislacionin e huaj – konkret (d.m.th. Kodi Penal i Francës (nenet 225-4-7) ose thjesht duke i përmendur pa identifikuar rregullin konkret (d.m.th. Kosova, Maqedonia e Veriut etj) – në disa raste. Në të vërtetë, edhe në kontekstin e administrimit të mirë gjyqësor, gjykatat kanë nënvizuar se, për veprat penale të këtij serioziteti të veçantë (“*Për vepra penale të një rëndësie të tillë të veçantë*”), Gjykata Kushtetuese shprehet se është i nevojshëm zhvillimi i një procesi publik me pjesëmarrjen e publikut për

⁶⁸⁴ Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës, 2000, § 37 (cituar në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë, Kolegji Administrativ, Vendimi nr. 00–2023–4279 (259), 7 korrikut 2023, § 32).

⁶⁸⁵ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2023–4279 (259), 7 korrikut 2023.

⁶⁸⁶ Hasan Tunç dhe të tjerët kundër Turqisë, 2017, paragrafi 32–33 (cituar në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2023–4279 (259), 7 korrikut 2023).

⁶⁸⁷ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2025–1483 (1), 13 janarit 2025, opinioni i shumicës, § 25 (duke cituar GJEDNJ, Ghrenassia kundër Luksemburgut, §§34–37).

⁶⁸⁸ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Administrativ, vendimi nr. 00–2025–1483 (1), 13 janar 2025, mendimi i shumicës, § 35.

⁶⁸⁹ Gjykata Kushtetuese Italiane, vendimet nr. 208/2021, 260/2020, 95/2015, 273/2014, 237/2012, 140/2010, 333/2009, 23/1992, 313/1990, 265/1994, 2019/2004 dhe 148/2004.

⁶⁹⁰ Gjykata Italiane e Kasacionit, vendimi nr. 44711, 27 tetor–18 nëntor 2004; Gjykata Italiane e Kasacionit, Seksionet e Bashkuara Penale. Vendimi nr. 2977, 6 marsit 1992; Gjykata Italiane e Kasacionit. Vendimi nr. 163, 1992.

administrimin e drejtësisë, me të gjitha garancitë si për të pandehurin, ashtu edhe për viktimat, për pjesëmarrje në zbardhjen e të vërtetës (vendim nr. 208/2021 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë).⁶⁹¹

Pra, të shtatë këto vendime i referohen Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) ose praktikës gjyqësore të saj, si dhe jurisprudencës kushtetuese. Siç theksohet në seksionin 4.1.2, kjo pasqyron orientimin kushtetues të gjyqtarëve shqiptarë. Përveç kësaj, në gjashtë nga shtatë rastet, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë iu referuan, gjithashtu, praktikës gjyqësore të mëparshme. Kjo nënvizon rëndësinë e praktikës gjyqësore, ose, më saktë, zbatimin e nenit 141 të Kushtetutës, si dhe ndikimin e reformave të fundit.

Ndërsa në një rast – vendimin penal nr. 00-2024-2161 (167), datë 4 korrik 2024 (përfundimtar) – gjyqtarët iu referuan edhe praktikës kushtetuese të Italisë, që përfaqëson një juridiksion të huaj, në dy raste – vendimin penal nr. 00-2024-2161 (167) të 4 korrikut 2024 (përfundimtar) dhe vendimin administrativ nr.00-2025-1483 (1) të 13 janarit 2025 (përfundimtar) – gjyqtarët përfshinë referenca eksplicite në ligjin e BE-së.

Tabela 6. Referimet normative dhe jurisprudenciale në vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që përmendin administrimin gjyqësor;

Vendimi	Referencë KEDNJ	Referencë GJEDNJ	Referencë GJK	Referencë Kolegjit Civil/Penal Ose Administrativ ose të Bashkuar	Referencë ligjit apo jurisprudencës së BE-së	Referencë ligjin e huaj apo jurisprudencë
Penale, 00-2018-148 i Vendimit (13) i 04.04.2018 (përfundimtar)	1 (shumica dhe pakica) ⁶⁹²	4 (pakicë) ⁶⁹³	12 (shumica) ⁶⁹⁴	6 (shumica) ⁶⁹⁵	-	-
Vendim Penal nr. akti 71001-00493-00-2017dt 15.07.2022 (I ndermjetem	-	3 (shumicë dhe pakicë) ⁶⁹⁶	6 (shumica dhe pakica) ⁶⁹⁷	2 (shumicë dhe pakicë) ⁶⁹⁸	-	-

⁶⁹¹ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Penal, vendimi nr. 00–2024–2161 (167), 4 korrikut 2024, mendimi i shumicës, § 28.

⁶⁹² Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) neni 6.

⁶⁹³ *Scoppola v Italy*; *Mione v Italy*, vendimi 12 shkurtit 2004; *Rasnik kundër Italisë*, vendimi 10 korrikut 2007); *Martelli kundër Italisë* (aplikimi nr. 20402/03), vendimi 12 prillit 2007.

⁶⁹⁴ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendimi nr. 29, 9 nëntorit 2005; vendimi nr. 31, 1 dhjetorit 2005; vendimi nr. 7, 9 marsit 2009; vendimi nr. 11, 23 prillit 2009; vendimi nr. 23, 23 korrikut 2009; vendimi nr. 12, 14 prillit 2010; vendimi nr. 30, 17 qershorit 2010; vendimi nr 31, 5 korrikut 2011; vendimi nr. 16, 27 marsit 2012; vendimi nr. 7, 27 shkurtit 2013; vendimi nr. 39, 30 qershorit 2014; Vendimi nr. 7, 16 shkurtit 2015.

⁶⁹⁵ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegji Penal, vendimi nr. 00-2018-140, 16 marsit 2018; vendimi nr. 00-2017-888, 5 tetorit 2017; vendimi nr. 00-2017-853 (130), 1 nëntorit 2017; Kolegje të Përbashkëta, vendimi unifikues nr. 1, 16 prillit 2004; vendimi nr. 3, 6 dhjetorit 2013; vendimi nr. 3, 28 prillit 2014.

⁶⁹⁶ Kolegji Penal vendosi se futja e Nenit 420/1 u diktua nga standardet kushtetuese dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me procesin e rregullt ligjor. Ai theksoi më tej se, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, mjetet juridike procedurale duhet të jenë efektive në praktikë dhe se e drejta e ankimit nuk është absolute.

⁶⁹⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 43; Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendimi nr. 5, 6 marsit 2009; vendimi nr. 14, 5 korrikut 2005; vendimi nr. 17, 19 qershorit 2009; vendimi nr. 26, 15 dhjetorit 2008; vendimi nr. 19, 23 dhjetorit 2004.

⁶⁹⁸ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegje të Bashkuara, vendimi unifikues nr. 1, 20 janarit 2011; vendimi unifikues nr. 2, 14 tetorit 2002.

Vendim penal nr. akti 2 dt 18.11.2022 (kolegjet bashkuara)	2 (shumicë) ⁶⁹⁹	10 (shumicë) ⁷⁰⁰	12 (shumicë dhe pakicë) ⁷⁰¹	5 (shumicë dhe pakicë) ⁷⁰²	-	-
Vendim Administrativ Nr.00-2023-4279 (259) dt 07.07.2023 (përfundimtar)	-	4 (shumicë) ⁷⁰³	2 (shumicë) ⁷⁰⁴	4 (shumicë dhe pakicë) ⁷⁰⁵	-	-
Vendim Administrativ nr akti Nr. 00-2023-5688 (409) dt 23.11.2023 (përfundimtar)	2 (shumicë dhe pakicë) ⁷⁰⁶	7 (Shumica dhe pakica) ⁷⁰⁷	5 (shumicë dhe pakicë) ⁷⁰⁸	6 (Shumica dhe pakica) ⁷⁰⁹	-	-
Vendim penal nr akti 00-2024-2161 (167) dt 04.07.2024	3	9	13	10 (shumicë dhe pakicë) ⁷¹³	1 (shumicë) ⁷¹⁴	6 (shumicë dhe pakicë) ⁷¹⁵

⁶⁹⁹ KEDNJ, neni 6(3)(c)–(e).

⁷⁰⁰ *Haxhia kundër Shqipërisë, vendim i 8 tetorit 2013; Ekbatani kundër Suedisë, vendim i 26 majit 1988; Poitrimol kundër Francës, vendim i 23 nëntorit 1993; Van Geyseghem kundër Belgjikës, vendim i 21 janarit 1999; T dhe V kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i 16 dhjetorit 1999; Sejdivic kundër Italisë, vendim i 1 marsit 2006; Ryabykh kundër Rusisë, vendim i 24 korrikut 2003; Bratyakin kundër Rusisë, vendim i 9 marsit 2006.*

⁷⁰¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 17 dhe 43; Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendimi nr. 109, 28 majit 2002; vendimi nr. 12, 6 qershorit 2005; vendimi nr. 5, 6 marsit 2009; vendimi nr. 17, 19 qershorit 2009; vendimi nr. 21, 29 prillit 2010; vendimi nr. 30, 17 qershorit 2010; vendimi nr. 12/2010; vendimi nr. 45, 10 tetorit 2011; vendimi nr. 26, 8 majit 2012; vendimi nr. 12, 15 shkurtit 2017.

⁷⁰² Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegje e Bashkuara, vendimi unifikues nr. 1, 20 janarit 2011; vendimi unifikues nr. 2, 14 tetorit 2002; Gjykata e Lartë e Shqipërisë, vendimi, 15 korrikut 2022; Kolegje e Bashkuara, vendimi unifikues nr. 1/2014; Gjykata e Lartë e Shqipërisë, vendimi nr. 02, 18 nëntorit 2022.

⁷⁰³ *Cañete de Goñi kundër Spain, vendim i 15 tetorit 2002; Zubac kundër Croatia, vendimi 5 prillit 2018; Hasan Tunç and Others kundër Türkiye, vendim i 31 janarit 2017; Miragall Escolano and Others kundër Spain, vendimi 25 janarit 2000.*

⁷⁰⁴ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendimi nr. 6, 16 shkurtit 2007; vendimi 13 prillit 2007.

⁷⁰⁵ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, vendimi nr. 00-2013-570 (73), 29 janarit 2013; vendimi nr. 431, 10 korrikut 2013; vendimi nr. 00-2015-3386, 9 korrikut 2015; vendimi nr. 00-2022-2780 (456), 9 nëntorit 2022.

⁷⁰⁶ KEDNJ, nenet 6, 13.

⁷⁰⁷ *Chapman kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], vendim i 18 Janarit 2001; Lupaş and Others kundër Rumanisë, vendim i 18 Dhjetorit 2001; Mariyka Popova and Asen Popov kundër Bullgarisë, vendim i 11 Prillit 2019, § 40; Stanev kundër Bullgarisë [GC], vendim i 17 janarit 2012; Zubac kundër Kroacisë [GC], vendim i 5 prillit 2018; Levages Prestations Services kundër Francës, vendim i 23 Tetor 1996; Platakou kundër Greqisë, vendim i 11 janarit 2001, § 38; Shkalla kundër Shqipërisë, vendim i 10 Majit 2011.*

⁷⁰⁸ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendimi nr. 31, 19 nëntorit 2003; vendimi nr. 34, 20 dhjetorit 2005; vendimi nr. 20, 11 korrikut 2006; vendimi nr. 20, 4 prillit 2014; vendimi nr. 25, 28 prillit 2014.

⁷⁰⁹ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegje të Përbashkëta, vendimi unifikues nr. 3, 6 dhjetorit 2013; vendimi unifikues nr. 392, 26 tetorit 2022; Gjykata e Lartë e Shqipërisë, vendimi nr. 462, 3 majit 2017; vendimi nr. 00-2021-1850, 7 tetorit 2021; vendimi nr. 00-2021-993, 24 qershorit 2022; vendimi nr. 00-2023-2448, 23 marsit 2023.

⁷¹³ Gjykata e Lartë e Shqipërisë, Kolegje të Përbashkëta, vendimi unifikues nr. 2, 29 janarit 2003; vendimi unifikues nr. 3, 2 nëntorit 2015; vendimi unifikues nr. 62, 1 nëntorit 2021; Gjykata e Lartë e Shqipërisë, vendimi nr. 04/2011; vendimi nr. 00-2022-1595, 6 dhjetorit 2022; vendimi nr. 00-2023-928 (169), 1 qershorit 2023; vendimi nr. 00-2024-427 (62), 7 marsit 2024; vendimi nr. 00-2024-1166 (150), 27 qershorit 2024; vendimi nr. 00-2024-1242 (176), 9 korrikut 2024.

⁷¹⁴ Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 25 tetorit 2012, që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit [2012] OJ L315/57.

⁷¹⁵ Gjykata Kushtetuese e Italisë, vendimi nr. 163/1992; vendimi nr. 2019/2004; vendimi nr. 148/2004; vendimi nr. 333/2009; vendimi nr. 140/2010; vendimi nr. 237/2012; vendimi nr. 273/2014; vendimi nr. 95/2015; vendimi nr. 260/2020.

(përfundimtar)	(shumicë dhe pakicë) ⁷¹⁰	(shumicë dhe pakicë) ⁷¹¹	(Shumica dhe pakica) ⁷¹²			
Nr. 00-2025-1483 i vendimit (1)dt 13.01.2025 (përfundimtar)	2 (shumicë) ⁷¹⁶	10 (shumicë dhe pakicë) ⁷¹⁷	3 (shumicë) ⁷¹⁸	-	1 (shumicë) ⁷¹⁹	-

Burimi: Përpunim i autorit mbi bazën e vendimeve të Gjykatës së Lartë, që përmendin administrimin gjyqësor.

Në përfundim, analiza e vendimeve të Gjykatës së Lartë tregon se administrimi gjyqësor është trajtuar si koncept i lidhur ngushtë me aksesin në gjykatë, të drejtën e ankimit, sigurinë juridike dhe efektivitetin e procesit gjyqësor. Në këto vendime, Gjykata e Lartë mbështetet kryesisht në Kushtetutë, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, KEDNJ-në dhe praktikën e GJEDNJ-së, duke konfirmuar orientimin kushtetues dhe konvencional të arsyetimit të saj. Njëkohësisht, referimet ndaj praktikës së mëparshme të Gjykatës së Lartë tregojnë rëndësinë e nenit 141 të Kushtetutës dhe të funksionit unifikues të saj pas reformës.

⁷¹⁰ KEDNJ, nenet 6, 7, dhe 14.

⁷¹¹ *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë* [GC], vendim i 20 Tetorit 2011; *Hermi kundër Italisë* [GC], vendim i 18 Tetorit 2006; *Hany kundër Italisë*, vendim i 6 Nëntorit 2007; *Kwiatkowska kundër Italisë*, vendim i 30 Nëntorit 2000; *Scoppola kundër Italisë* (No. 2) [GC], vendim i 17 Shtatorit 2009; *Pélissier dhe Sassi kundër Francës* [GC], vendim i 13 Mars 1999; *Drassich kundër Italisë*, vendim i 11 Dhjetorit 2007; *Kamasinski kundër Austrisë*, vendim i 19 Dhjetor 1989; *Sergey Zolotukhin kundër Rusisë* [GC], vendim i 10 Shkurt 2009; *Van Esbroeck kundër Belgjikës*, vendim i 9 marsit 2006.

⁷¹² Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendimi nr. 50, 30 korrikut 1999; vendimi nr. 5, 17 shkurtit 2003; vendimi nr. 33, 24 nëntorit 2003; vendimi nr. 1, 12 janarit 2011; vendimi nr. 25, 10 qershorit 2011; vendimi nr. 37, 19 shtatorit 2011; vendimi nr. 4, 10 shkurtit 2012; vendimi nr. 14, 26 marsit 2012; vendimi nr. 47, 26 korrikut 2012; vendimi nr. 12, 19 marsit 2015; vendimi nr. 207/2022; vendimi nr. 4, 31 janarit 2024.

⁷¹⁶ KEDNJ, nenet 6 dhe 13.

⁷¹⁷ *Chapman kundër Mbretërisë së Bashkua*, vendim i 18 Janarit 2001; *Lupaş dhe të tjerë kundër Rumanisë* vendim i 14 Dhjetor 2006; *Mariyka Popova and Asen Popov kundër Bullgarisë*, vendim i 11 prillit 2019, § 40; *Zubac kundër Kroacisë*, vendim i 5 prillit 2018; *Hasan Tunç dhe të tjerë kundër Turqisë*, vendim i 31 janarit 2017; *Levages Prestations Services kundër Francës*, vendim i 23 Tetor 1996; *Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës*, vendim i 19 Dhjetor 1997; *Ghrenassia kundër Luksemburgut*, vendim i 7 Dhjetorit 2021; *Xheraj kundër Shqipërisë*, vendim i 29 Korrikut 2008; *Legros dhe të tjerë kundër Francës*, vendim i 9 Nëntorit 2023.

⁷¹⁸ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendimi nr. 27, 9 majit 2012; vendimi nr. 62/2016; vendimi nr. 27/2022.

⁷¹⁹ Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian [2012] OJ C326/391, neni 47.

KAPITULLI V

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky kapitull mbyllës i punimit ka për qëllim të paraqesë gjetjet kryesore, që rrjedhin nga analiza e zhvilluar përgjatë kapitujve paraprirës dhe mbi këtë bazë, të formulojë rekomandimet konkrete, që mund të kontribuojnë në përmirësimin e administrimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Trajtimi është strukturuar në tri seksione kryesore: seksioni i parë rimerr në mënyrë të integruar gjetjet thelbësore të secilit kapitull; seksioni i dytë identifikon sfidat aktuale strukturore, që kushtëzojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të reformës; dhe seksioni i tretë formulon rekomandimet, të organizuara sipas dimensioneve të ndryshme funksionale të sistemit të drejtësisë.

5.1 Përmbledhje sintetizuese e gjetjeve të kapitujve

Ky seksion përmbledh gjetjet kryesore, që rrjedhin nga analiza e zhvilluar në kapitujt paraprirës dhe i vendos ato në lidhje të drejtpërdrejtë me sfidat strukturore, që kushtëzojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të reformës në drejtësi. Në këtë kuptim, ai nuk synon të përsërisë në mënyrë përsëritëse përfundimet e secilit kapitull, por të ndërtojë një lexim të integruar të tyre, duke nxjerrë në pah vijimësinë historiko-kushtetuese, rikonfigurimin institucional pas vitit 2016, efektet e reformës së hartës gjyqësore, rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në modelin e ri të vetëqeverisjes gjyqësore, si dhe problematikat që lidhen me efikasitetin e sistemit gjyqësor. Mbi këtë bazë, sfidat aktuale strukturore trajtohen jo si dukuri të shkëputura, por si pasoja dhe njëkohësisht, si prova të qëndrueshmërisë së transformimit institucional të sistemit gjyqësor shqiptar.

Analiza e zhvilluar në këtë disertacion ka shqyrtuar organizimin dhe administrimin e gjykatave në Shqipëri përmes një metode juridike diakronike, duke identifikuar elementet e vazhdimësisë dhe të ndërprerjes përgjatë periudhave të njëpasnjëshme historike. Ky lexim historiko-kushtetues tregon se administrimi gjyqësor shqiptar nuk është zhvilluar në mënyrë lineare, por përmes transformimeve të kushtëzuara nga regjimet politike, modelet juridike dominuese dhe raporti i ndryshueshëm ndërmjet pushtetit gjyqësor dhe pushteteve të tjera.

Në periudhën para regjimit komunist, ligji i parë themelor shqiptar, Statuti Organik i vitit 1914, shfaq një ndikim të fortë të trashëgimisë juridike osmane. Të gjitha ligjet themelore të miratuara gjatë periudhës midis viteve 1914 dhe 1946 u përcaktuan si Statute dhe jo si Kushtetuta. Nga pikëpamja strukturore, Statuti i vitit 1914 përbëhej kryesisht nga nene pa ndarje të brendshme në paragrafë, ndërsa Statuti i vitit 1922 ishte ligji i parë themelor shqiptar, që futi një ndarje sistematike të neneve në paragrafë. Për herë të parë në historinë kushtetuese shqiptare, Statuti i vitit 1925 përfshiu një preambulë. Në të gjitha këto Statute, organizimi gjyqësor drejtohej përmes një kombinimi të dispozitave kushtetuese, legjislacionit të zakonshëm dhe rolit të Kreut të Shtetit.

Sa i përket administrimit gjyqësor, Statuti i vitit 1914 strukturoi autoritetet gjyqësore në nivel kushtetues përmes Këshillit të Pleqve, gjyqtarëve të paqes, gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit. Megjithatë, ky model i organizimit të gjykatave të zakonshme nuk u kristalizua më në nivel kushtetues nga viti 1922 e tutje. Në mënyrë të ngjashme, ndërsa ligji i parë themelor shqiptar i kushtonte një rol të veçantë prokurorit, i cili ushtronte edhe funksione brenda procedurave civile, nga viti 1922 roli i prokurorit u kufizua në procedurat penale.

Që me Statutin e vitit 1922 u vendosën shprehimisht disa parime thelbësore të administrimit gjyqësor, ndër të cilat pavarësia e gjyqësorit dhe palëvizshmëria e gjyqtarëve. Për të forcuar pavarësinë e gjyqësorit, u krijua Gjykata e Aktakuzës si gjykatë *ad hoc* me juridiksion disiplinor mbi gjyqtarët, për sjellje të pahijshme në ushtrimin e funksioneve. Ky institucion u konfirmua më pas nga Statutet e vitit 1925 dhe 1928, por nuk u parashikua më në Statutin e vitit 1939.

Në aspektin e organizimit institucional, Statuti i vitit 1928 prezantoi organe shtesë gjyqësore krahas gjykatave të zakonshme dhe Gjykatës së Aktakuzës, përfshirë Gjykatën e Lartë të Shtetit, me juridiksion ndaj disa zyrtarëve të lartë publikë dhe politikë, si dhe gjykatat ushtarake. Në të kundërt, Statuti i vitit 1939 nuk rregullonte në nivel kushtetues gjykatat ushtarake, por i dha Gjykatës së Lartë të Drejtësisë kompetencën për të paditur ministrat e Mbretit për vepra penale të kryera në ushtrim të funksioneve të tyre. Megjithëse ky institucion ngjante me Gjykatën e Lartë të Shtetit, ai nuk ishte identik me të, pasi kuadri procedural dhe kategoritë e personave, që i nënshtroheshin juridiksionit të tij, ndryshonin.

Evoluimi i rregullimit të gjykatave të jashtëzakonshme tregon, po ashtu, zhvendosje të rëndësishme në konceptimin e garancive gjyqësore. Statuti i vitit 1914 i dha Princit dhe qeverisë së tij kompetencën për të krijuar gjykata speciale. Statuti i vitit 1922 solli një kufizim më të qartë, duke parashikuar se gjykatat e jashtëzakonshme nuk mund të krijoheshin në asnjë rast për të gjykuar mosmarrëveshje specifike; e njëjta qasje u ruajt edhe në Statutin e vitit 1925. Megjithatë, neni 126 i Statutit të vitit 1928 prezantoi një përjashtim të kufizuar kohor për shkeljet politike, ndërsa Statuti i vitit 1939 e zgjeroi këtë mundësi duke parashikuar krijimin e gjykatave të jashtëzakonshme në rastet e përcaktuara shprehimisht me ligj.

Parimet themelore të drejtësisë morën një formulim më të zhvilluar me Statutin e vitit 1922, i cili parashikonte vendimet gjyqësore të arsyetuara, publicitetin e seancave gjyqësore dhe përjashtime të justifikuara nga morali, ligji ose interesi publik. Kufizimi i lidhur me moralin u hoq më vonë nga Statuti i vitit 1925. Statuti i vitit 1922 rregullonte gjithashtu ushtrimin e funksioneve administrative nga gjyqtarët, edhe kur këto kryheshin pa shpërblim. Statuti i vitit 1928 i zgjeroi rregullat e papajtueshmërisë në veprimtaritë e sektorit privat, ndërsa ndalimet e angazhimit politik të gjyqtarëve u forcuan më tej. Në mënyrë të veçantë, Statuti i vitit 1925 parashikonte largimin e gjyqtarëve nga detyra në rastet e përfshirjes politike.

Gjatë regjimit komunist, Shqipëria ndryshoi tri herë ligjet e saj themelore: Statutin e vitit 1946, Kushtetutën e vitit 1950 dhe Kushtetutën e vitit 1976. Në të tre këto akte, rendi social dhe ekonomik vendosej përpara të drejtave themelore të njeriut dhe asnjëri prej tyre nuk përmbante preambulë. Sa i përket administrimit gjyqësor, Statuti i vitit 1946 themeloi gjykatat ushtarake dhe prokurorët ushtarakë; Kushtetuta e vitit 1950 njohu vetëm gjykatat ushtarake; ndërsa Kushtetuta e vitit 1976 nuk krijoi në nivel kushtetues një juridiksion të posaçëm për krimet ushtarake.

Në këtë periudhë, roli i sovranitetit popullor në procedurat gjyqësore u nënvizua në mënyrë të veçantë. Neni 79 i Statutit të vitit 1946 prezantoi jurinë popullore në gjykata, me të drejta të barabarta me gjyqtarët. Kjo qasje u përsërit edhe në nenin 83 të Kushtetutës së vitit 1950, ndërsa në Kushtetutën e vitit 1976 gjykatat u konceptuan shprehimisht si “gjykata popullore”. Të tre ligjet themelore konfirmuan, në nivel kushtetues, disa rregulla procedurale të rëndësishme, si shteti i të drejtës, publiciteti i seancave, kufizimi i rolit interpretues të Gjykatës së Lartë në aspektet e interpretimit ligjor dhe e drejta e të huajve për të kuptuar procedurën gjyqësore përmes përkthimit në gjuhën shqipe.

Megjithëse këto akte pranonin formalisht pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor, interpretimi sistematik i tyre tregon se gjyqësori gjatë regjimit komunist nuk ishte realisht i pavarur. Neni 76(3) i Statutit të vitit 1946 dhe neni 80(3) i Kushtetutës së vitit 1950 i njihnin Ministrin të Drejtësisë kompetencën për të drejtuar dhe kontrolluar punën e administratës gjyqësore dhe për t’u kujdesur për organizimin dhe funksionimin e mirë të gjykatave. Për më tepër, Kushtetuta e vitit 1976 parashikonte kompetenca të Kuvendit dhe të Presidiumit për emërimin, revokimin dhe kontrollin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Ky model ishte në përputhje me ideologjinë marksiste-leniniste, në të cilën pavarësia e pushtetit gjyqësor nuk konceptohej si garanci substanciale kundër ndërhyrjes politike.

Gjatë regjimit komunist, Prokuroria, e cila nuk ishte organ i pavarur dhe ishte pjesë e Kuvendit, luajti rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e ligjshmërisë. Ky rol u zgjerua me Kushtetutën e vitit 1976, e cila i ngarkonte Prokurorisë detyrën për të mbikëqyrur zbatimin e rreptë dhe uniform të ligjeve nga gjykatat dhe organet hetimore. Edhe kompetencat gjyqësore u përcaktuan në nivel kushtetues, por me një përmbajtje të kushtëzuar ideologjikisht: ndërsa Statuti i vitit 1946 dhe Kushtetuta e vitit 1950 e vendosnin theksin te shqyrtimi ligjor i çështjeve dhe mbrojtja e rendit juridik, Kushtetuta e vitit 1976 e zgjeroi funksionin e gjykatave drejt mbrojtjes së rendit juridik socialist, parandalimit të krimeve dhe edukimit të masave punonjëse me frymën e ligjshmërisë socialiste.

Pas rënies së regjimit komunist, pavarësia dhe paanshmëria e sistemit gjyqësor u shndërruan në objektiva themelore të kornizës tranzitore kushtetuese. Ligji nr. 7491, datë 29 prill 1991 dhe më pas Kushtetuta e vitit 1998, synuan të vendosnin bazat e një sistemi të ri të drejtësisë. Edhe pse Ministria e Drejtësisë vijoi të ushtronte kompetenca të gjera në organizimin gjyqësor, këto u kufizuan me krijimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si organ që synonte forcimin e rolit të magistratëve dhe të pavarësisë së gjyqësorit. Gjykata Kushtetuese u krijua vetëm pas përfundimit të regjimit komunist, si garant kryesor i

balancës së pushteteve, ndërsa Këshilli i Lartë i Drejtësisë mori njohje kushtetuese me Kushtetutën e vitit 1998. Megjithatë, dekadat e para të tranzicionit u shoqëruan me akuza për korrupsion dhe me nivel të ulët të besimit publik ndaj gjyqësorit. Në këtë kontekst, procesi i rivlerësimit kalimtar (vetting) dhe krijimi i institucioneve të reja kanë ndikuar në një tendencë drejt rikthimit gradual të besimit publik.

Në këtë kuptim, gjetja kryesore e analizës historiko-kushtetuese është se administrimi gjyqësor në Shqipëri nuk ka njohur një vazhdimësi normative në rregullimin e tij, por ka pasur ndërprerje të thella substanciale në përmbajtjen reale të pavarësisë gjyqësore. Kjo mungesë vazhdimësie dhe lidhja me politikën e kohës shpjegojnë pse reforma kushtetuese e vitit 2016 nuk mund të kuptohet si ndërhyrje e izoluar, por si përgjigje ndaj një historie të gjatë të tensionit ndërmjet formalizimit juridik të pavarësisë dhe kufizimit praktik të saj.

Ndërmarrja e reformës në drejtësi, me fokus të veçantë në vetëqeverisjen gjyqësore, nuk përbënte më një alternativë politike apo institucionale, por një domosdoshmëri sistematike të diktuar nga dinamika e tranzicionit demokratik dhe nga nevoja për rivendosjen e legjitimitetit funksional të pushtetit gjyqësor. Reforma kushtetuese e vitit 2016 paraqitet si një model hibrid transformimi, ku ndërthuren mekanizma të përkohshëm tranzitorë, si rivlerësimi kalimtar, me ristrukturime të përhershme institucionale, si këshillat e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe riformatimi i kompetencave kushtetuese. Legjitimiteti i saj u confirmua në dy plane: në planin ndërkombëtar, përmes mbështetjes së Komisionit të Venecias dhe jurisprudence të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; dhe në planin e brendshëm kushtetues, përmes jurisprudence të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu, reforma e vitit 2016 nuk mund të konceptohet si ndërhyrje e kufizuar administrative apo organizative, por si projekt transformues me natyrë kushtetuese, i orientuar drejt rikonfigurimit të marrëdhënieve ndërmjet pavarësisë, llogaridhënies dhe integritetit institucional të sistemit të drejtësisë. Thelbi i sfidës nuk lidhej thjesht me domosdoshmërinë e ndryshimit, por me thellësinë strukturore të tij, me shkallën e depërtimit në arkitekturën ekzistuese institucionale dhe me kapacitetin e sistemit për të absorbuar pasojat e një transformimi të tillë.

Përvoja shqiptare tregon se përpjekjet në rritje të reformimit gjatë dekadave të para të tranzicionit prodhuan rezultate të kufizuara, për shkak të mungesës së mekanizmave efektivë të zbatimit, rezistencës institucionale dhe persistencës së kulturave të varësisë ndërmjet pushteteve. Këto ndërhyrje graduale nuk arritën të prodhonin transformim strukturor, por kontribuan në riprodhimin e disfunksioneve ekzistuese dhe në konsolidimin e një ekuilibri formal, por jo funksional, të qeverisjes gjyqësore. Për këtë arsye, reforma u orientua drejt një rikonceptimi themelor të garancive kushtetuese dhe të mekanizmave institucionale, që mbështesin funksionimin e pavarur dhe të përgjegjshëm të gjyqësorit.

Një nga dimensionet më kritike të këtij transformimi lidhet me kostot strukturore të tij. Reformat e thella në sektorin e drejtësisë, veçanërisht ato që synojnë rivendosjen e integritetit institucional, prodhojnë në mënyrë të pashmangshme pasoja funksionale, të

cilat manifestohen përmes rezistencës së brendshme institucionale, pasigurisë profesionale dhe ndikimeve afatshkurtra në efikasitetin e sistemit. Në këtë kontekst, procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve përbën instrumentin më domethënës të ndërhyrjes transformuese në rastin shqiptar. I ndërtuar mbi verifikimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, ky mekanizëm synoi të adresonte në mënyrë strukturore problematikat e lidhura me korrupsionin, lidhjet me krimin e organizuar, deficitin profesional dhe erozionin e besimit publik ndaj drejtësisë.

Megjithatë, zbatimi i rivlerësimit kalimtar prodhoi pasoja të menjëhershme mbi kapacitetet funksionale të sistemit gjyqësor. Parashikimet fillestare të ekspertëve sugjerorin një dalje nga sistemi në raportin 1 në 4 ose 1 në 5 subjekte, ndërsa në praktikë vetëm 1 në 3 magjistratë të rivlerësuar u konfirmua në detyrë. Reduktimi i ndjeshëm i numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve aktivë krijoi boshllëqe të thella institucionale, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e ngarkesës gjyqësore, në zgjerimin e stokut të çështjeve dhe në zgjatjen e afateve të shqyrtimit. Kjo situatë evidentoi brishtësinë e kapitalit njerëzor si komponent themelor i qëndrueshmërisë së reformave dhe nevojën për politika komplementare në menaxhimin e burimeve njerëzore, përfshirë forcimin e Shkollës së Magjistraturës dhe përshpejtimin e mekanizmave të rekrutimit.

Paralelisht me ndërhyrjet në integritetin individual, reforma shqiptare adresoi edhe dimensionin institucional të qeverisjes gjyqësore përmes rikonceptimit të arkitekturës së vetëqeverisjes. Modeli i ri institucional synon të balancojë autonominë funksionale të gjyqësorit me kërkesat për llogaridhënie publike, duke integruar në organet qeverisëse përfaqësues të gjyqësorit, akademisë, shoqërisë civile dhe avokatisë. Ky konfigurim pluralist synon të shpërndajë përgjegjësinë qeverisëse, të reduktojë rreziqet e korporatizmit gjyqësor dhe të forcojë lidhjen ndërmjet sistemit të drejtësisë dhe shoqërisë, pa cenuar autonominë vendimmarrëse të gjyqtarëve në ushtrimin e funksionit të tyre kushtetues.

Në plan teorik, kjo përvojë përbën pjesë të një procesi më të gjerë të maturimit kushtetues, në të cilin vetëqeverisja gjyqësore nuk është thjesht mekanizëm administrativ për menaxhimin e karrierës dhe disiplinës, por shprehje e konsolidimit të demokracisë kushtetuese dhe e aftësisë së saj për të ndërtuar institucione, që garantojnë njëkohësisht pavarësinë dhe përgjegjshmërinë. Reforma shqiptare ilustron kompleksitetin e balancimit ndërmjet autonomisë institucionale dhe kontrollit demokratik, duke ofruar një rast studimor domethënës për analizën krahasuese të transformimeve të qeverisjes gjyqësore në sistemet juridike në tranzicion. Në të njëjtën kohë, përvoja shqiptare tregon se, ndonëse reformimi i sistemit gjyqësor mund të jetë domosdoshmëri politike dhe institucionale, procedurat e rivlerësimit kalimtar duhet të mbështeten në konsensus të gjerë politik e shoqëror dhe nuk mund të konsiderohen si zgjidhje universale për çdo sistem.

Reforma e Hartës së re gjyqësore përfaqëson një zhvendosje të qëllimshme nga një sistem territorialisht i fragmentuar dhe funksionalisht i pabarabartë drejt një organizimi më koherent të gjykatave, të bazuar mbi kapacitetin institucional. E mbështetur në një mandat të qartë ligjor dhe në një metodologji objektive vlerësimi, kjo reformë synon të

harmonizojë aksesin në drejtësi me kërkesat e efikasitetit, cilësisë dhe qëndrueshmërisë institucionale. Megjithatë riorganizimi ka gjeneruar shqetësime legjitime dhe sfida tranzitore, ai reflekton një kuptim të konsoliduar se gjeografia gjyqësore nuk është një zgjedhje neutrale administrative, por element themelor i efektivitetit dhe legjitimitetit të pushtetit gjyqësor.

Përvoja shqiptare demonstroi se aksesin në drejtësi nuk mund të kuptohet vetëm në terma hapësinorë, por duhet të vlerësohet në raport me aftësinë reale të institucioneve gjyqësore për të përmbushur funksionin e tyre kushtetues në mënyrë të qëndrueshme, brenda një kohe të arsyeshme dhe me besueshmëri. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 70, datë 27.12.2023, theksoi se aksesin nuk reduktohet vetëm në afërsinë gjeografike, por përfshin edhe elemente si: afati i arsyeshëm, cilësia e gjykimit dhe efikasiteti institucional; riorganizimi synon pikërisht përmirësimin e këtyre elementeve përmes balancimit të ngarkesës dhe rritjes së kapaciteteve.

Të dhënat e vitit 2024 tregojnë se harta e re gjyqësore nuk mund të trajtohet si instrument i drejtpërdrejtë dhe i vetë-mjaftueshëm për uljen e çështjeve të prapambetura. Harta krijon premisa për shpërndarje më racionale të kompetencave, administrim më të centralizuar të burimeve dhe standardizim më të mirë të funksionimit të gjykatave, por edhe reduktimi real i *backlog*-ut mbetet i lidhur me plotësimin e organikës gjyqësore, kapacitetin efektiv të gjyqtarëve në detyrë, mbështetjen administrative dhe funksionimin e mekanizmave të menaxhimit të çështjeve. Për këtë arsye, efekti i hartës mbi stokun e çështjeve nuk duhet vlerësuar si pasojë automatike e riorganizimit territorial, por si rezultat i ndërveprimit ndërmjet strukturës së re gjyqësore dhe investimit konkret në burime njerëzore, financiare dhe teknologjike. Në këtë kuptim, harta gjyqësore ka krijuar një kornizë më të përshtatshme organizative, por zgjidhja e *backlog*-ut kërkon masa të posaçme, të qëndrueshme dhe të mirëfinancuara.

Në plan krahasimor, reforma shqiptare e hartës gjyqësore reflekton tendenca më të gjera evropiane drejt konsolidimit të strukturave gjyqësore të udhëhequra nga funksionaliteti, efikasiteti dhe cilësia e drejtësisë. Ajo shpreh njohjen gjithnjë e më të qartë se mbrojtja gjyqësore efektive sipas nenit 6 KEDNJ kërkon jo vetëm prani territoriale, por edhe kapacitet institucional adekuat. Për rrjedhojë, harta gjyqësore përbën një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një gjyqësori më koherent, më rezilient dhe më të orientuar drejt performancës, ndërsa legjitimiteti i saj përfundimtar do të varet nga zbatimi i qëndrueshëm dhe nga aftësia e sistemit për ta përkthyer rikonfigurimin institucional në përmirësime të prekshme për përdoruesit e drejtësisë.

Krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor në vitin 2018, si pjesë organike e reformës kushtetuese të vitit 2016, përbën një pikë kthese institucionale në historinë e qeverisjes gjyqësore shqiptare. Këshilli i Lartë Gjyqësor u krijua për të zëvendësuar modelin e mëparshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili, ndonëse formalisht i pavarur, shfaqte në praktikë varësi të theksuar nga ekzekutivi dhe rezultoi i pamjaftueshëm për të garantuar

pavarësinë institucionale të kërkuar nga standardet e Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.

Periudha e parë e funksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dëshmon një trajektore të qartë konsolidimi: nga themelimi institucional dhe vendosja e bazës rregullatore dhe operative; te kalimi në fazën e operativitetit të plotë, i shënuar nga finalizimi i Hartës së re gjyqësore, miratimi i Planit të dytë strategjik dhe ripërtëritja e parë e anëtarësisë; e deri te arritja e konsolidimit institucional, e shënuar nga ripërtëritja e dytë, instalimi i strukturave të reja drejtuese dhe miratimi i Strategjisë kombëtare të uljes së numrit të çështjeve të prapambetura.

Krahasimi sistematik i dispozitave të Ligjit nr. 8811/2001 dhe Ligjit nr. 9877/2008, nga njëra anë, me Ligjin nr. 115/2016, Ligjin nr. 98/2016 dhe Ligjin nr. 96/2016, nga ana tjetër, lejon të nxirret përfundimi se ndryshimi i sjellë nga reforma në drejtësi e vitit 2016 është strukturalisht radikal dhe konceptualisht koherent. Ai nuk përbën një rishikim teknik, por një ribërje arkitekturore: zëvendësohet organi i mëparshëm me një organ të ri; rishikohet përbërja duke eliminuar anëtarët *ex officio* politikë; riformulohet procedura zgjedhore përmes zgjedhjes së drejtpërdrejtë profesionale, vlerësimit paraprak dhe shumicës së cilësuar parlamentare; ridimensionohet organizimi i brendshëm përmes ndërthurjes së mbledhjes plenare me komisionet e përhershme; dhe zgjerohen kompetencat në fushën e planifikimit strategjik, buxhetit të sistemit gjyqësor, hartës gjyqësore, propozimit të kandidatëve për Gjykatën e Lartë dhe raportimit publik para Kuvendit. Reforma nuk ndërhyr vetëm në qeverisjen qendrore të gjyqësorit, por edhe në arkitekturën drejtuese të gjykatës. Ajo krijon Këshillin e Gjykatës si organ kolegjal drejtues, ngre figurën e Kancelarit si drejtues administrativ profesional, krijon kategorinë e shërbimit civil gjyqësor, formalizon Mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve me kompetenca të mirëpërcaktuara dhe transferon caktimin e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues nga kryetari individual i gjykatës te Këshilli i Gjykatës.

Vektori dogmatik, që përshkon këto ndryshime, është tendosja e dyfishtë ndërmjet pavarësisë institucionale të gjyqësorit dhe llogaridhënies publike të tij. Pavarësia forcohet përmes heqjes së pranisë *ex officio* të organeve politiko-ekzekutive, transferimit të funksioneve hetimore disiplinore te një inspektor i pavarur kushtetues dhe bartjes së buxhetimit e planifikimit strategjik te vetë organi i qeverisjes së gjyqësorit. Llogaridhënia forcohet përmes detyrimit për raportim vjetor në Kuvend, publikimit të procesverbaleve dhe regjistrimeve audio të mbledhjeve, transparencës procedurale për zgjedhjen e anëtarëve dhe kuadrit të mbikëqyrjes etike përmes Këshilltarit për Etikën.

Në këtë kuptim, shumë prej ndryshimeve nuk janë thjesht riformulime normative, por zhvendosje të kompetencave nga Presidenti i Republikës, Ministri i Drejtësisë, Konferenca Gjyqësore Kombëtare dhe kryetari individual i gjykatës drejt organeve të reja kolegjiale, si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Gjykatës dhe Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve. Kjo zhvendosje është thelbësore për të kuptuar arkitekturën e re: Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk është thjesht “Këshilli i Lartë i Drejtësisë i ri”, por organ me përgjegjësi

të zgjeruar sistemike, i cili merr funksione që më parë nuk i takonin asnjë organi të vetëm, por shpërndaheshin në mënyrë të fragmentuar ndërmjet Presidentit, Ministrisë dhe vetë gjyqësorit.

Mbi këto baza, korniza ligjore e ndërtuar pas reformës së vitit 2016 paraqet një model të integruar, koherent dhe me ambicie të larta për sigurimin e një gjyqësori të pavarur, llogaridhënës, transparent dhe eficient. Roli i Këshillit të Lartë Gjyqësor si organ i vetëqeverisjes shfaqet i konsoliduar në planin formal-institucional, por ende i kushtëzuar në planin praktik nga sfida strukturore, të cilat lidhen sidomos me burimet njerëzore, pavarësinë financiare, menaxhimin e çështjeve dhe infrastrukturën teknologjike.

Në dimensionin e efikasitetit gjyqësor, disertacioni ka shqyrtuar standardet ndërkombëtare, mbikombëtare dhe kombëtare, duke u përqendruar në dokumentet e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, në Tabelën e Rezultateve të Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe në praktikën e Gjykatës së Lartë lidhur me administrimin gjyqësor. Edhe pse efikasiteti gjyqësor ka qenë prej kohësh objektiv i organizmave ndërkombëtarë, CEPEJ-i e ka institucionalizuar atë përmes raporteve dyvjeçare mbi sistemet e drejtësisë, ku kohëzgjatja e procedurave gjyqësore mbetet një ndër çështjet më të theksuara.

Koncepti i gjyqimit të drejtë është i vendosur në kornizat kushtetuese ndërkombëtare, mbikombëtare dhe kombëtare. Përmes analizës së praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, disertacioni ka evidentuar kuptimin e “kohës së arsyeshme”, duke dalluar çështjet prioritare nga ato joprioritare, por duke theksuar njëkohësisht se kërkesa për shqyrtim brenda një kohe të arsyeshme vlen për të gjitha çështjet. Tabela e rezultateve të drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe CEPEJ-i nuk synojnë të zëvendësojnë qeverisjen kombëtare të sistemeve gjyqësore, por ofrojnë të dhëna krahasuese dhe praktika të mira, të cilat ndihmojnë shtetet të reflektojnë mbi joefikasitetet e tyre. Të dy instrumentet janë të rëndësishme edhe sepse dëshmojnë lidhjen midis efikasitetit gjyqësor, rritjes ekonomike dhe sundimit të ligjit.

Në rastin shqiptar, raportet më të fundit të CEPEJ-it, Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2025 dhe raportet e Këshillit të Lartë Gjyqësor tregojnë se vendi vazhdon të përballë me sfida të rëndësishme në drejtim të efikasitetit gjyqësor. Në të njëjtën kohë, ky disertacion ka identifikuar se pas vetingut deri në dhjetor 2025, Gjykatës së Lartë vetëm në 7 vendime njohëse theksojnë në mënyrë eksplicite rëndësinë e administrimit gjyqësor: 3 nga kolegjet penale dhe 4 nga kolegjet administrative. Kjo tregon se administrimi i mirë gjyqësor po shfaqet gjithnjë e më shumë jo vetëm si çështje menaxheriale, por edhe si kategori relevante në arsyetimin jurisprudencial.

Disertacioni ka analizuar, gjithashtu, procesin e rivlerësimit kalimtar në raport me efikasitetin gjyqësor dhe me nenin 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky nen mbetet i zbatueshëm edhe për magjistratët shqiptarë, që i janë nënshtruar procesit të rivlerësimit. Edhe pse procesi i rivlerësimit kalimtar bie në kuadër të procedurave civile dhe në këto procedura neni 6(1) nuk zbatohet gjithmonë në mënyrë identike me procedurat

penale, thelbi i tij duhet të respektohet. Kjo nënkupton balancimin ndërmjet interesit publik për pastrimin institucional të sistemit të drejtësisë dhe të drejtës së magjistratëve për një gjykim të drejtë. Për rrjedhojë, rivlerësimi kalimtar nuk mund të shërbejë si justifikim për vonesa të tepërta në procedurat gjyqësore.

5.2 Sfidat strukturore aktuale

Pavarësisht arritjeve në konsolidimin institucional dhe progresit në fusha të caktuara, periudha e parë e funksionimit të arkitekturës së re të reformës është shoqëruar me sfida strukturore me natyrë sistematike. Këto sfida nuk e mohojnë rëndësinë e reformës, por tregojnë se qëndrueshmëria e saj afatgjatë varet nga aftësia e institucioneve për të kaluar nga rikonfigurimi formal i arkitekturës gjyqësore drejt funksionimit efektiv, të matshëm dhe të qëndrueshëm të saj.

Sfida e parë lidhet me vakancat e qëndrueshme në trupën gjyqësore, të cilat përbëjnë problematikën më të mprehtë të periudhës. Procesi i rivlerësimit kalimtar, ndonëse domosdoshmëri institucionale për pastrimin e gjyqësorit nga elemente të kompromentuara, ka pasur kosto të konsiderueshme operacionale për sistemin. Vakancat janë rezultat i ndërthurjes së disa faktorëve, si shkarkimet me vendime të organeve të rivlerësimit, daljet në pension, dorëheqjet vullnetare dhe transferimet e magjistratëve drejt institucioneve të tjera. Plotësimi i plotë i organikës së dekretuar mbetet një objektiv ende i largët, i cili, sipas projeksioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pritet të arrihet jo më herët se periudha 2027–2028.

Sfida e dytë lidhet me ngarkesën e shpërpjesëtuar gjyqësore ndërmjet gjykatave të të njëjtit nivel dhe juridiksion. Edhe pse Reforma e hartës së re gjyqësore ka zbutur ndjeshëm disa prej disekuilibrave të mëparshëm territorialë dhe funksionalë, ngarkesa mesatare për gjyqtar vijon të mbetet disa herë mbi normat zyrtare të vendosura që në vitin 2010 nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Kjo tregon se riorganizimi territorial, në mungesë të plotësimit të burimeve njerëzore dhe të mekanizmave të avancuar të menaxhimit të çështjeve, nuk mund të prodhojë i vetëm ulje të qëndrueshme të ngarkesës.

Sfida e tretë lidhet me stokun e çështjeve të prapambetura. Situata më shqetësuese paraqitet në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku akumulimi i çështjeve dëshmon një disbalancë strukturore ndërmjet ngarkesës, organikës efektive dhe kapaciteteve administrative mbështetëse. *Backlog*-u nuk është thjesht tregues statistikor, por shprehje e drejtpërdrejtë e kufizimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe e dobësimit të besimit të publikut tek aftësia funksionale e gjykatave.

Sfida e katërt lidhet me pavarësinë financiare të sistemit gjyqësor. Ndonëse buxheti i sistemit gjyqësor është rritur nominalisht në mënyrë progresive, pesha e tij specifike në raport me buxhetin e shtetit ka qëndruar e pandryshuar gjatë periudhës së analizuar. Në

terma për banor, buxheti për sistemin gjyqësor në Shqipëri mbetet ndjeshëm nën mesataren e vendeve të Këshillit të Evropës. Më e rëndësishmja, kërkesat buxhetore të Këshillit të Lartë Gjyqësor në kuadër të Projektbuxhetit afatmesëm janë miratuar vetëm pjesërisht, duke kufizuar *de facto* pavarësinë financiare të sistemit gjyqësor, edhe pse Këshilli gëzon pavarësi formale për hartimin e projektbuxhetit.

Sfida e pestë lidhet me specializimin e gjyqtarëve dhe me organizimin e brendshëm të gjykatave. Specializimi duhet të kuptohet si mekanizëm i lidhur ngushtë me administrimin e mirë të gjykatës, pasi krijon mundësi për organizim më racional të burimeve njerëzore, shpërndarje më të drejtë të ngarkesës, trajtim më të shpejtë të çështjeve dhe rritje të cilësisë së vendimmarrjes. Megjithatë, për të prodhuar efektet e synuara në uljen e *backlog*-ut dhe në përmirësimin e cilësisë së drejtësisë, nuk mjafton vetëm parashikimi normativ i seksioneve. Është e nevojshme që gjykatat të kenë kapacitete të mjaftueshme njerëzore, të plotësojnë standardin minimal prej së paku gjashtë gjyqtarësh për seksion dhe të ndërtojnë një praktikë të qëndrueshme të organizimit të brendshëm mbi bazën e të dhënave objektive të ngarkesës, llojit të çështjeve dhe nevojave reale të shërbimit gjyqësor. Vetëm në këtë mënyrë, kapaciteti më i madh i gjykatës mund të jetë funksional dhe specializimi të kthehet në instrument real për një drejtësi më të shpejtë, më cilësore dhe më të besueshme.

Sfida e gjashtë lidhet me konsolidimin praktik të efekteve të Hartës së re gjyqësore dhe me ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet aksesit në drejtësi dhe efikasitetit institucional. Riorganizimi territorial ka krijuar një kornizë më të përshtatshme organizative, por shqetësimet tranzitore, të krijuara nga përqendrimi i gjykatave, kërkojnë monitorim të vazhdueshëm, masa mbështetëse administrative dhe vlerësim periodik mbi bazën e të dhënave. Detyrimi ligjor për rishikimin periodik të hartës merr këtu rëndësi thelbësore, sepse hartëzimi gjyqësor duhet të mbetet një instrument dinamik qeverisjeje dhe jo një konfigurim administrativ statik. Legjitimiteti praktik i hartës do të varet nga aftësia e sistemit për ta përkthyer riorganizimin territorial në ulje të ngarkesës, përmirësim të afateve, cilësi më të lartë gjykimi dhe akses real për përdoruesit e drejtësisë.

Sfida e shtatë lidhet me kohëzgjatjen e tepruar të procedurave gjyqësore dhe me marrëdhënien ndërmjet kësaj kohëzgjatjeje dhe garancive të nenit 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në çështjen Arb Shpk dhe të tjerë kundër Shqipërisë, të datës 8 gusht 2025, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut theksoi se, pavarësisht masave të marra nga autoritetet shqiptare, qasja në këtë drejtim nuk është e kënaqshme. Ky konstatim e vendos efikasitetin gjyqësor në qendër të përgjegjësisë institucionale të shtetit dhe tregon se e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk mund të trajtohet si objektiv administrativ dytësor, por si detyrim konventor dhe kushtetues.

Sfida e tetë lidhet me infrastrukturën digjitale dhe me nevojën për finalizimin e Sistemit të Ri të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, i cili do të zëvendësojë sistemin ekzistues të vitit 2014 dhe pritet të prodhojë efektet më të mëdha gjatë periudhës 2026–2028. Digjitalizimi nuk duhet kuptuar thjesht si modernizim teknik, por si instrument i

domosdoshëm për standardizimin e praktikave të menaxhimit të çështjeve, gjenerimin e të dhënave të besueshme, monitorimin e ngarkesës, rritjen e transparencës dhe mbështetjen e vendimmarrjes institucionale. Pa një sistem funksional, të integruar dhe të besueshëm të menaxhimit elektronik të çështjeve, përpjekjet për uljen e *backlog*-ut, për shpërndarjen racionale të burimeve dhe për vlerësimin objektiv të performancës gjyqësore mbeten të kufizuara.

Në tërësi, këto sfida tregojnë se reforma në drejtësi ka hyrë në një fazë të dytë, në të cilën suksesi i saj nuk matet më vetëm me krijimin e institucioneve të reja dhe me miratimin e kornizës normative, por me aftësinë e sistemit për të prodhuar rezultate të qëndrueshme në funksionimin e përditshëm të gjykatave. Kjo fazë kërkon kalimin nga logjika e rindërtimit institucional drejt logjikës së konsolidimit funksional, ku pavarësia, llogaridhënia, efikasiteti, cilësia dhe aksesin në drejtësi trajtohen si dimensione të ndërvarura të të njëjtit proces kushtetues.

5.3 Rekomandime

Mbi bazën e analizës së zhvilluar në këtë disertacion dhe të sfidave strukturore të identifikuar në administrimin e sistemit gjyqësor shqiptar, rekomandimet e mëposhtme synojnë të kontribuojnë në konsolidimin e reformës në drejtësi, në forcimin e kapaciteteve institucionale të gjyqësorit, në rritjen e efikasitetit të gjykimit dhe në garantimin më të plotë të aksesit në drejtësi. Këto rekomandime nuk paraqiten si propozime të shkëputura nga analiza e zhvilluar në kapitujt paraprirës, por si rrjedhojë e vlerësimit historiko-kushtetues, normativ, institucional, empirik dhe krahasues të administrimit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Ato synojnë jo vetëm përmirësimin e funksionimit të gjykatave, por edhe forcimin e shtetit të së drejtës, të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të besimit publik në sistemin e drejtësisë.

Plotësimi i vakancave të qëndrueshme duhet të trajtohet si një ndër prioritetet kryesore të administrimit gjyqësor, pasi mungesa e gjyqtarëve ndikon drejtpërdrejt në rritjen e ngarkesës individuale, në zgjatjen e procedurave, në shtimin e çështjeve të prapambetura dhe në pamundësinë për të realizuar specializim efektiv brenda gjykatave. Për këtë arsye, rekomandohet që Këshilli i Lartë Gjyqësor të forcojë kapacitetet e komisioneve dhe strukturave përgjegjëse për emërimet, transferimet, ngritjet në detyrë dhe menaxhimin e karrierës gjyqësore. dhe përsheptimin e procedurave për plotësimin e vakancave, pa cenuar standardet e integritetit, meritës dhe profesionalizmit që qëndrojnë në themel të reformës kushtetuese të vitit 2016. Në këtë kuadër, duke qenë se Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton një numër të konsiderueshëm aktesh që lidhen me zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, përfshirë emërimet, transferimet, ngritjet në detyrë, caktimet dhe procedurat e vlerësimit profesional, rekomandohet të vlerësohet mundësia e rishikimit funksional të ndarjes së punës ndërmjet komisioneve të përhershme dhe mbledhjes plenare. Një pjesë e procedurave përgatitore, verifikuese dhe teknike mund të zhvillohet në nivel komisionesh,

duke rezervuar për mbledhjen plenare vendimmarrjen përfundimtare dhe çështjet me rëndësi thelbësore institucionale. Një qasje e tillë do të mund të kontribuonte në thjeshtimin e procedurave, lehtësimin e ngarkesës së mbledhjes plenare, rritjen e shpejtësisë së trajtimit të çështjeve të karrierës gjyqësore dhe forcimin e eficiencës së përgjithshme të KLGJ-së, pa cenuar garancitë e transparencës, kolegialitetit dhe kontrollit institucional.

Me plotësimin gradual të organikës së gjykatave, rekomandohet që gjykatat të nxiten të krijojnë seksione të posaçme për kategori të ndryshme çështjesh, mbi bazën e treguesve objektivë të ngarkesës, natyrës së çështjeve dhe stokut të krijuar. Krijimi i këtyre seksioneve do të mundësonte specializimin e gjyqtarëve, rritjen e cilësisë së vendimmarrjes, menaxhimin më të mirë të fluksit të çështjeve dhe uljen graduale të çështjeve të prapambetura. Specializimi duhet të kuptohet si mjet për rritjen e cilësisë së gjykimit dhe përmirësimin e administrimit të çështjeve gjyqësore.

Një rëndësi të veçantë merr edhe forcimi i Shkollës së Magjistraturës si porta kryesore hyrëse në sistemin gjyqësor. Roli i saj duhet të konsolidohet në trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të magjistratëve, por edhe në formimin profesional të administratës gjyqësore dhe sipas nevojës, të Avokaturës së Shtetit. Ky orientim është në përputhje me standardet e Opinionit nr. 17 të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë mbi trajnimin dhe vlerësimin profesional të gjyqtarëve. Në këtë kuadër, përsheptimi i procedurave të emërimit të magjistratëve të rinj duhet të realizohet përmes thjeshtimit të hapave administrativë, pa dobësuar garancitë që lidhen me kontrollin e integritetit, aftësive profesionale dhe përputhshmërisë me kërkesat kushtetuese të funksionit gjyqësor.

Për të reduktuar ngarkesën efektive mbi gjyqtarët në detyrë, rekomandohet rritja e ndjeshme e numrit të ndihmësve ligjorë, në përputhje me propozimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për shtimin e tyre deri në dy ndihmës për çdo gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Kjo masë do të mundësonte një ndarje më të mirë të punës, duke i lejuar gjyqtarët të përqendrohen në vendimmarrje, ndërsa përgatitja paraprake e dosjes, kërkimi ligjor dhe analiza ndihmëse të kryhen nga stafi profesional mbështetës. Në të njëjtën logjikë, rekomandohet konsolidimi i shërbimit civil gjyqësor si kategori e posaçme institucionale, përmes zbatimit të plotë të Planit Strategjik për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të nëpunësve civilë gjyqësorë, të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Administrata gjyqësore nuk duhet trajtuar si strukturë thjesht ndihmëse, por si pjesë e domosdoshme e cilësisë, efikasitetit, transparencës dhe aksesit në shërbimin gjyqësor.

Forcimi i pavarësisë financiare të sistemit gjyqësor duhet të konsiderohet si kusht i nevojshëm për qëndrueshmërinë e reformës dhe për funksionimin efektiv të gjykatave. Pavarësia institucionale nuk mund të garantohet plotësisht nëse gjyqësori nuk disponon burimet e nevojshme financiare, njerëzore dhe infrastrukturore për ushtrimin e funksionit të tij kushtetues. Për këtë arsye, rekomandohet rritja progresive e peshës së buxhetit të gjyqësorit në raport me buxhetin e shtetit dhe me Prodhimin e brendshëm bruto, me synimin e afrimit gradual me mesataret evropiane sipas treguesve të Komisionit evropian për efikasitetin e drejtësisë. Ky buxhet duhet të orientohet në mënyrë prioritare drejt

përmirësimin të kushteve të punës në gjykata, modernizimin të infrastrukturës gjyqësore, forcimin të kapaciteteve administrative dhe mbështetjes së gjykatave që paraqesin nevojë më të larta funksionale, të identifikuar mbi bazën e analizës së ngarkesës, gjendjes infrastrukturore dhe kërkesave reale për shërbim gjyqësor cilësor. Në këtë drejtim, rekomandohet intensifikimi i dialogut institucional ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor, Kuvendit dhe Ministrisë së Financave në kuadër të Projektbuxhetit Afatmesëm, në mënyrë që kërkesat buxhetore të Këshillit të Lartë Gjyqësor të reflektohen në një masë më të lartë në procesin buxhetor. Këto kërkesa duhet të mbështeten në analiza të detajuara të ngarkesës, stokut të çështjeve, gjendjes infrastrukturore dhe nevojave reale për shërbim gjyqësor cilësor. Pavarësia financiare nuk duhet kuptuar si privilegj institucional, por si garanci funksionale për ushtrimin efektiv të pushtetit gjyqësor dhe për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me gjykimin brenda afatit të arsyeshëm.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm lidhet me përdorimin më të strukturuar të fondeve evropiane për administrimin e drejtësisë. Përvoja e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, në kuadër të Rregullores nr. 1303/2013, tregon se fondet evropiane mund të shërbejnë si mjet i rëndësishëm për modernizimin e gjykatave, zhvillimin e drejtësisë elektronike dhe përmirësimin e menaxhimit institucional. Përvoja e Estonisë me mjetet e drejtësisë elektronike përbën një shembull pozitiv të përdorimit të Fondeve Strukturore dhe Evropiane të Investimeve për menaxhimin e drejtësisë. Në kontekstin shqiptar, projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri” — SEJ IV — dëshmon se kjo qasje është e zbatueshme dhe mund të shërbejë si bazë për nisma të mëtejshme në funksion të modernizimit të administrimit gjyqësor.

Reforma e hartës gjyqësore nuk duhet të konsiderohet si akt i përfunduar administrativ, por si proces institucional, që kërkon monitorim, vlerësim dhe përshtatje të vazhdueshme. Efektet e saj të plota mund të maten vetëm pas konsolidimit të gjykatave të reja, plotësimit të kapaciteteve njerëzore dhe finalizimit të infrastrukturës së nevojshme fizike dhe teknologjike. Për këtë arsye, rekomandohet zbatimi i plotë i fazave të mbetura të reformës, përfshirë konsolidimin operativ të gjykatave të riorganizuara dhe sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për përballimin e volumit të ri të çështjeve. Një reformë territoriale e gjykatave nuk mund të prodhojë efekte pozitive të qëndrueshme nëse nuk shoqërohet me investime të mjaftueshme në burime njerëzore, infrastrukturë dhe menaxhim institucional. Veçanërisht i rëndësishëm është vlerësimi i krijimit të degëve të gjykatave në qytetet e prekura nga riorganizimi, në përputhje me nenin 13 të Ligjit nr. 98/2016. Kjo masë do të mund të zbusë pasojat gjeografike të krijuara nga riorganizimi territorial dhe do të kontribuonte në balancimin e aksesit territorial në drejtësi me aksesin efektiv në shërbim gjyqësor. Ky i fundit lidhet jo vetëm me afërsinë fizike të gjykatës, por edhe me kohëzgjatjen e gjykimit, cilësinë e vendimmarrjes dhe mundësinë reale të qytetarëve për të marrë shërbim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

Në të njëjtën kohë, rekomandohet rishikimi periodik i hartës gjyqësore sipas mandatit të nenit 14 të Ligjit nr. 98/2016, mbi bazën e të dhënave empirike dhe treguesve të performancës gjyqësore. Ky rishikim duhet të funksionojë si mekanizëm vlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm, dhe jo si ushtrim formal administrativ. Në këtë mënyrë, harta gjyqësore duhet të trajtohet si çështje me rëndësi juridiko-kushtetuese, e lidhur me aksesin në drejtësi, efikasitetin gjyqësor dhe organizimin racional të gjykatave.

Reduktimi i stokut të çështjeve të prapambetura mbetet një nga prioritetet më urgjente të administrimit gjyqësor shqiptar. Në këtë drejtim, rekomandohet zbatimi i plotë dhe efektiv i Strategjisë Kombëtare të Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata 2024–2027, si dhe Udhërrëfyti për efikasitetin e pushtetit gjyqësor në shqipëri 2025–2027 (dokumnete që janë në qasje me metodologjinë së Backlog Reduction Tool të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë, të publikuar në qershor 2023) me fokus të veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe gjykatat e tjera me ngarkesë të lartë. Megjithatë, zbatimi i këtyre dokumnete strategjike duhet të shoqërohet me garanci të mjaftueshme për ruajtjen e cilësisë së vendimeve gjyqësore, pasi ulja numerike e çështjeve nuk mund të realizohet në dëm të standardeve të gjyqimit të drejtë.

Në funksion të këtij objekti, rekomandohet konsolidimi dhe zgjerimi i Ekipeve për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura pranë gjykatave të apelit. Këto ekipe përfaqësojnë një zgjidhje organizative të rëndësishme në kontekstin shqiptar, pasi, ndonëse nuk ushtrojnë funksion gjykues, kontribuojnë në përgatitjen paraprake të dosjeve dhe në lehtësimin e punës së trupave gjyqësore, duke i lejuar këto të fundit të përqendrohen në shqyrtimin dhe vendimmarrjen e çështjeve. Po kështu, rekomandohet monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të normave të reja procedurale dhe i afateve kohore të gjyqimit, mbi bazën e treguesve të matshëm, të krahasueshëm dhe periodikë. Ky monitorim do të mundësonte identifikimin në kohë të vonësive, shkaqeve të tyre dhe kategorive të çështjeve ose gjykatave ku ndërhyrja institucionale është më e nevojshme.

Digjitalizimi i procedurave gjyqësore duhet të mbetet një pjesë thelbësore e modernizimit të sistemit të drejtësisë. Ky orientim është në përputhje me dokumentet më të fundit të Komisionit Evropian, përfshirë dokumentin “Cilësia e Administratës Publike – Një kuti mjetesh për praktikuesit” të vitit 2025. Në këtë drejtim, rekomandohet finalizimi i përsheptuar i Sistemit të Ri të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, i cili pritet të zëvendësojë sistemin ekzistues të vitit 2014. Sistemi i ri duhet të mundësojë shkëmbimin elektronik të dokumenteve ndërmjet gjykatave, menaxhimin e diferencuar të çështjeve sipas natyrës dhe prioritetit, ndarjen automatike me short të çështjeve dhe integrimin me sistemet e tjera të drejtësisë, përfshirë Prokurorinë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Digjitalizimi nuk duhet parë vetëm si zhvillim teknik, por si mjet për rritjen e transparencës, efikasitetit, gjurmueshmërisë institucionale dhe aksesit të qytetarëve në drejtësi.

Në lidhje me mbrojtjen efektive të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, rekomandohet vlerësimi i mundësisë së përshtatjes së modelit italian të kompensimit për shkeljet e nenit 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si referencë e dobishme për sistemin shqiptar. Analiza juridike ka treguar se modeli italian mund të ofrojë një pikë krahasuese të vlefshme, veçanërisht duke pasur parasysh afërsitë strukturore ndërmjet legjislacionit shqiptar dhe atij italian, të evidentuara edhe në praktikën e Gjykatës së Lartë në vendimet nr. 00-2022-4596 (393), datë 26.10.2022; nr. 00-2022-4586 (392), datë 26.10.2022; nr. 106, datë 02.03.2023; dhe nr. 00-2023-5686 (724), datë 12.12.2023. Në këtë drejtim, rekomandohet rishqyrtimi i regjimit aktual të kompensimit për shkeljen e konceptit të “kohës së arsyeshme”, të shtuar me Ligjin nr. 38/2017, datë 30.03.2017, në dritën e jurisprudencës më të fundit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjet shqiptare, veçanërisht në çështjen Arb Shpk dhe të tjerë kundër Shqipërisë, të datës 8 gusht 2025.

Në këtë drejtim, duke marrë si pikë referimi modelin procedural italian, mund të shqyrtohet mundësia e një ndërhyrjeje në Kodin e Procedurës Civile shqiptar, të ngjashme me zgjidhjen e parashikuar nga neni 282 i Kodit Italian të Procedurës Civile, i ndryshuar me ligjin nr. 353, datë 26 nëntor 1990, sipas të cilit vendimi i gjykatës së shkallës së parë është përkohësisht i ekzekutueshëm ndërmjet palëve. Një mekanizëm i tillë nuk do të synonte kufizimin e së drejtës së ankimit, por racionalizimin e ushtrimit të saj, duke reduktuar interesin për ankime të pabazuara ose me karakter thjesht zvarritës. Nëse pala humbëse nuk ka një perspektivë reale për ndryshimin e vendimit, ekzekutimi i përkohshëm i vendimit të shkallës së parë mund të ulë nxitjen për përdorimin instrumental të ankimit si mjet vonese. Njëkohësisht, pala fituese do të mund të përfitonte më shpejt nga efektet juridike dhe praktike të vendimit gjyqësor, pa pritur përfundimin e plotë të të gjitha shkallëve të gjykimit.

Megjithatë, një ndërhyrje e tillë do të duhej të shoqërohej me garanci procedurale të mjaftueshme, përfshirë mundësinë e pezullimit të ekzekutimit në rastet kur ekzekutimi i menjëhershëm mund të shkaktojë dëm të rëndë ose të pariparueshëm. Në këtë mënyrë, reforma do të ruante ekuilibrin ndërmjet efikasitetit gjyqësor dhe së drejtës së palëve për ankim efektiv. E konceptuar në këtë formë, një zgjidhje e tillë mund të kontribuonte në reduktimin gradual të ngarkesës së gjykatave të apelit dhe, në mënyrë të tërthortë, edhe të Gjykatës së Lartë, duke kufizuar përdorimin abuziv të mjeteve të ankimit dhe duke forcuar efektivitetin praktik të vendimeve gjyqësore.

Në funksion të rritjes së eficiencës së sistemit gjyqësor dhe uljes së ngarkesës së gjykatave, rekomandohet ndërmarrja e ndryshimeve ligjore, që synojnë përdorimin më racional të burimeve gjyqësore dhe përqendrimin e gjykatave në çështjet që kërkojnë vlerësim të mirëfilltë juridik. Së pari rekomandohet zgjerimi i modelit të gjykimit nga **një gjyqtar i vetëm**, në gjykatat e shkallës së parë dhe sipas rastit, edhe në gjykatat e apelit administrativ, për kategori çështjesh të thjeshta, të përsëritura ose të standardizuara. Ky mekanizëm do të mundësonte trajtimin më të shpejtë të çështjeve me kompleksitet të ulët dhe rezervimin e trupave kolegjiale për çështje më të ndërlikuara ose me rëndësi më të madhe juridike. Së dyti, rekomandohet rishikimi i sistemit të ankimit dhe rekursit, përmes kufizimit proporcional të tyre për kategori të caktuara çështjesh civile dhe administrative,

mbi bazën e kriterëve objektive si vlera e padisë, objekti i kërimit, natyra dhe kompleksiteti i çështjes. Një kufizim i tillë duhet të realizohet pa cenuar të drejtën për akses në gjykatë, procesin e rregullt ligjor dhe standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Së treti, rekomandohet rishikimi i sistemit të lëshimit të urdhrave të ekzekutimit, duke duke shpërndarë kompetencën për lëshimin e tyre ndërmjet gjyqtarit, noterit dhe autoritetit publik që ka nxjerrë titullin. Kjo do të reduktonte ngarkesën formale dhe administrative të gjykatave, duke ruajtur njëkohësisht mundësinë e kontrollit gjyqësor në rast kundërshtimi nga palët.

Përfshirja e akademisë në qeverisjen gjyqësore duhet të vlerësohet si një nga arritjet e reformës kushtetuese të vitit 2016, përmes integritit të anëtarëve jogjyqtarë nga radhët e pedagogëve të drejtësisë në organet e vetëqeverisjes. Në këtë drejtim, rekomandohet forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit institucional ndërmjet sistemit gjyqësor dhe komunitetit akademik, në përputhje me prirjet e vërejtura në vendet me sisteme të konsoliduara drejtësie. Rekomandohet, gjithashtu, zhvillimi i projekteve ndëruniversitare dhe ndërdisiplinore mbi sistemin e drejtësisë, sipas praktikave ku kërkitimi i koordinuar ndërmjet universiteteve dhe institucioneve gjyqësore ka kontribuar në qartësimin e organizimit, menaxhimit dhe performancës së gjykatave. Kjo qasje është në përputhje edhe me orientimin e Komisionit evropian për efikasitetin e drejtësisë mbi rolin e akademisë në mbështetjen kërkimore dhe analitike të qeverisjes gjyqësore.

Pas hapjes së të gjithë kapitujve të negociatave në nëntor 2025, sistemi i drejtësisë ka fituar rëndësi të posaçme në procesin e integritit evropian. Për këtë arsye, rekomandohet vazhdimi i harmonizimit progresiv me standardet e Komisionit evropian për efikasitetin e drejtësisë, përfshirë treguesit kryesorë të performancës gjyqësore, si *Disposition Time*, *Clearance Rate*, *Workload Rate* dhe stoku i çështjeve të prapambetura. Po ashtu, rekomandohet harmonizimi me parametrat e Tabelës së rezultateve të drejtësisë së Bashkimit Evropian, e cila, sipas dokumenteve të vitit 2025, është shndërruar në një mjet thelbësor të BE-së për monitorimin e shtetit të të drejtës. Në të njëjtën linjë, duhet të zbatohen në mënyrë sistematike rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2025, i cili ka nënvizuar nevojën për përmirësime në cilësinë dhe efikasitetin e organizimit gjyqësor, kapacitetin e burimeve njerëzore, infrastrukturën gjyqësore dhe plotësimin e vendeve vakante. Më gjerë, rekomandohet që administrimi i mirë gjyqësor të përfshihet në mënyrë sistematike në kornizën e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030, si dokument bazë për koordinimin e politikave të reformës në sektorin e drejtësisë. Kjo do të mundësonte që masat për efikasitetin, cilësinë, pavarësinë dhe aksesin në drejtësi të trajtohen në mënyrë të bashkërenduar dhe jo si ndërhyrje të veçuara.

Në planin kushtetues dhe institucional, rekomandohet konsolidimi i mëtejshëm i ekuilibrit midis pavarësisë institucionale të gjyqësorit dhe llogaridhënies publike të tij. Ky ekuilibër përbën një nga çështjet kryesore të reformës së vitit 2016. Pavarësia duhet të mbrohet përmes ruajtjes së largimit të organeve politiko-ekzekutive nga organet e

vetëqeverisjes së drejtësisë, ndërsa llogaridhënia duhet të forcohet përmes mekanizmave ekzistues të raportimit vjetor në Kuvend, publikimit të procesverbaleve, transparencës procedurale dhe funksionimit efektiv të mekanizmave të etikës. Në këtë kuadër, rekomandohet forcimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në fushën disiplinore, përmes konsolidimit të procedurave të bashkërenduara dhe respektimit të qartë të ndarjes së kompetencave të përcaktuar nga reforma kushtetuese. Po ashtu, rekomandohet ushtrimi aktiv nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i rolit të tij si mbrojtës i pavarësisë gjyqësore, përfshirë përmes deklaratave publike në mbështetje të figurës së gjyqtarit në rastet kur gjyqtarët i nënshtrohen sulmeve publike të papërligjura, sikurse ka filluar të reflektohet në praktikën institucionale të viteve të fundit.

Rekomandimet e paraqitura në këtë kapitull synojnë jo vetëm përmirësimin e treguesve formalë të performancës gjyqësore, por edhe konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe forcimin e legjitimitetit të sistemit të drejtësisë në sytë e qytetarëve. Ato janë të lidhura ngushtësisht me detyrimet që rrjedhin nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me kërkesat e procesit të integritetit në Bashkimin Evropian. Për këtë arsye, këto rekomandime nuk pretendojnë të jenë të plota apo përfundimtare, por përbëjnë një kontribut analitik dhe normativ për debatin doktrinor, institucional dhe politik mbi të ardhmen e administrimit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Përvoja shqiptare nga miratimi i reformës kushtetuese të vitit 2016 deri më sot ofron mësim me vlerë për teorinë dhe praktikën e qeverisjes gjyqësore në vendet në tranzicion. Ajo dëshmon se reformat kushtetuese dhe institucionale, sado të plota në hartimin e tyre normativ, nuk prodhojnë rezultate automatike në praktikë. Përkundrazi, ato kërkojnë kohë konsolidimi, mbështetje të vazhdueshme politike dhe ndërkombëtare, si dhe ndërtim gradual të kapaciteteve institucionale. Po ashtu, përvoja shqiptare tregon se modeli i këshillit gjyqësor të mirëfilltë, ndonëse i përshtatshëm për një vend në tranzicion demokratik, përballë me sfida specifike që lidhen me pamjaftueshmërinë e burimeve, vakancat e krijuara nga procesi i rivlerësimit dhe trashëgiminë institucionale të sistemit të mëparshëm.

Konsolidimi i mëtejshëm i sistemit të ri institucional në vitet në vijim do të përbëjë një tregues të rëndësishëm si për përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, ashtu edhe për konsolidimin e shtetit të së drejtës në nivel kombëtar. Kuadri ligjor i ndërtuar nga reforma kushtetuese e vitit 2016 mbetet një sistem i lidhur, koherent dhe me objektiva të qarta për ndërtimin e një gjyqësori të pavarur, llogaridhënës, transparent dhe efikas. Megjithatë, vlera reale e këtij sistemi do të matet jo vetëm nga cilësia e parashikimeve normative, por nga aftësia e institucioneve për t'i zbatuar ato në mënyrë të qëndrueshme, të matshme dhe të prekshme për përdoruesit e drejtësisë dhe për qytetarët në përgjithësi.

Në përfundim, rekomandimet e paraqitura në këtë kapitull synojnë jo vetëm përmirësimin e treguesve formalë të performancës gjyqësore, por edhe konsolidimin e shtetit të së drejtës

dhe forcimin e legjitimitetit të sistemit të drejtësisë në sytë e qytetarëve. Ato janë të lidhura ngushtësisht me detyrimet që rrjedhin nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me kërkesat e procesit të integritetit në Bashkimin Evropian. Për këtë arsye, këto rekomandime nuk pretendojnë të jenë të plota apo përfundimtare, por përbëjnë një kontribut analitik dhe normativ për debatin doktrinor, institucional dhe politik mbi të ardhmen e administrimit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

BIBLIOGRAFI

I. LITERATURË

1. Libra dhe monografi

Amodio E (red), *I Giudici senza Toga: Esperienze e Prospettive della Partecipazione Popolare ai Giudizi Penali* (Giuffrè 1979).

Aoláin FN dhe Gross O (red), *Guantanamo and Beyond: Exceptional Courts and Military Commissions in Comparative Perspective* (Cambridge University Press 2013).

Berman HJ, *Justice in the U.S.S.R.: An Interpretation of Soviet Law* (Harvard University Press 1963).

Bickel AM, *The Least Dangerous Branch* (Yale University Press 1962).

Binoche B, *Introduction à De l'esprit des lois de Montesquieu* (FeniXX 1998).

Bobbio N dhe Morra N, *Il Positivismo Giuridico: Lezioni di Filosofia del Diritto* (G Giappichelli 1979).

Bonneau CW dhe Hall MG, *In Defense of Judicial Elections* (Routledge 2009).

Burbank SB dhe Friedman B (red), *Judicial Independence at the Crossroads: An Interdisciplinary Approach* (SAGE Publications 2002).

Calvez F (rifreskuar nga Régis N), *Length of Court Proceedings in the Member States of the Council of Europe Based on the Case Law of the European Court of Human Rights* (Studim CEPEJ nr. 3, Këshilli i Evropës 2012).

Carrera S dhe të tjerë, *The Triangular Relationship between Fundamental Rights, Democracy and the Rule of Law in the EU: Towards an EU Copenhagen Mechanism* (CEPS Paperbacks 2013).

Coman R, *The Politics of the Rule of Law in the EU Polity: Actors, Tools and Challenges* (Palgrave Macmillan 2022).

Czekalski T, *The Shining Beacon of Socialism in Europe: The Albanian State and Society in the Period of Communist Dictatorship 1944–1992* (2013).

Di Marzio M, *L'Appello Civile dopo la Riforma* (Giuffrè 2013).

Ferreira N dhe Kostakopoulou D (red), *The Human Face of the European Union: Are EU Law and Policy Humane Enough?* (Cambridge University Press 2016).

Finkel NJ, *Commonsense Justice: Jurors' Notions of the Law* (Harvard University Press 1995).

Fischer BJ, *Albania at War, 1939–1945* (Hurst & Co 1999).

Gastil J dhe Levine P (red), *The Deliberative Democracy Handbook: Strategies for Effective Civic Engagement in the Twenty-First Century* (Jossey-Bass 2005).

Gibson JL, *Electing Judges: The Surprising Effects of Campaigning on Judicial Legitimacy* (University of Chicago Press 2012).

Ginsburgs G, *The Soviet Procuracy and Forty Years of Socialist Legality* (Martinus Nijhoff 1988).

Ginsburgs G, *The Soviet Procuracy and the Supervision of Administration* (Martinus Nijhoff 1988).

Gokay B, *Eastern Europe Since 1970: Decline of Socialism to Post-Communist Transition* (Routledge 2015).

Haltom W dhe McCann M, *Distorting the Law: Politics, Media, and the Litigation Crisis* (University of Chicago Press 2004).

Hans VP, *Business on Trial: The Civil Jury and Corporate Responsibility* (Yale University Press 2000).

Hendler ES, *El Juicio por Jurados: Significados, Genealogías, Incógnitas* (Del Puerto 2006).

Hess B, *Europäisches Zivilprozessrecht* (bot. 2, De Gruyter 2021).

Kirchheimer O, *Political Justice: The Use of Legal Procedure for Political Ends* (Princeton University Press 2015).

Kosař D, *Perils of Judicial Self-Government in Transitional Societies* (Cambridge University Press 2016).

Kutnjak Ivković S, *Lay Participation in Criminal Trials: The Case of Croatia* (Austin & Winfield 1999).

Marder NS, *The Jury Process* (Foundation Press 2005).

Merkuri E, *Të Drejtat Kushtetuese dhe e Drejta Penale* (OSBE 2024).

Pacilli M, *L'Abuso dell'Appello* (Bononia University Press 2015).

Pano NC, *The People's Republic of Albania* (Johns Hopkins University Press 1968).

Posner RA, *How Judges Think* (Harvard University Press 2008).

Schmitt C, *Constitutional Theory* (Duke University Press 2008).

Schmitt C, *Political Theology: Four Chapters on the Concept of Sovereignty* (University of Chicago Press 2005).

Schmitt C, *The Concept of the Political* (bot. i zgjeruar, University of Chicago Press 2007).

Siems M, *Comparative Law* (Cambridge University Press 2018).

Solomon PH Jr, *Soviet Criminal Justice under Stalin* (Cambridge University Press 1996).

Sterio M dhe Scharf M (red), *The Legacy of Ad Hoc Tribunals in International Criminal Law* (Cambridge University Press 2019).

Trotsky L, *The Revolution Betrayed* (Pathfinder Press 1972).

Van Rhee CH, *The Law's Delay: Essays in Undue Delay in Civil Litigation* (Intersentia 2004).

Vinjau S, *E Drejta Kushtetuese* (Shtypshkronja "Nikaj", Tiranë 1923).

Wheeler R, *Judicial Administration: Its Relation to Judicial Independence* (National Center for State Courts 1988).

White A, *The Ad Hoc Tribunals: A Critical Appraisal of Their Legacy* (tezë doktorate, University of Central Lancashire 2022).

2. Kapituj librash dhe punime në vepra kolektive

Bartlett W, 'Communism in Yugoslavia and Albania' në Central and Eastern Europe Handbook (Routledge 2014) 80.

Bergoglio MI, 'Argentina: The Effects of Democratic Institutionalization' në Friedman LM dhe Pérez-Perdomo R (red), Legal Culture in the Age of Globalization: Latin America and Latin Europe (Stanford University Press 2003) 20.

Bradley C, 'International Organizations and the Production of Indicators: The Case of Freedom House' në Merry SE, Davis K dhe Kingsbury B (red), The Quiet Power of Indicators: Measuring Governance, Corruption, and the Rule of Law (Cambridge University Press 2015) 27.

Dimitrov G, Haralampiev K dhe Stoychev S, 'The Adventures of the CVM in Bulgaria and Romania' në Has the EU's Eastern Enlargement Brought Europe Together? (2016) 213.

Dimitrova D, 'Judicial Reform and Process of Vetting in Albania: An Effective Project or an Unsuccessful Experiment' në The Balkans and Europe between Integration and Particularism (Универзитет за национално и световно стопанство 2019) 299.

Dori A, 'The Supply and Demand of Justice: What Policy Implications from the EU Justice Scoreboard?' në YSEC Yearbook of Socio-Economic Constitutions 2022 (Springer Nature Switzerland 2023) 53.

Ferreira N, 'The Human Face of the European Union: Are EU Law and Policy Humane Enough? An Introduction' në Ferreira N dhe Kostakopoulou D (red), The Human Face of the European Union: Are EU Law and Policy Humane Enough? (Cambridge University Press 2015).

Ford S, 'The Impact of the Ad Hoc Tribunals on the International Criminal Court' në Sterio M dhe Scharf M (red), The Legacy of Ad Hoc Tribunals in International Criminal Law (Cambridge University Press 2019).

Gascón Inchausti F, 'Comparative Perspectives in Procedural Law: Some Remarks and Proposals' në Cadiet L dhe të tjerë (red), Approaches to Procedural Law – The Pluralism of Methods (Nomos 2017) 13.

Gjevori E, 'An Overview of the Military and Judiciary in Albania' në Democratization and Institutional Reform in Albania (Palgrave Macmillan 2018) 11.

Guerra Y, 'Measuring Justice? The EU Justice Scoreboard in the Light of the Performance-Based Approach' në EU Rule of Law Procedures at the Test Bench: Managing Dissensus in the European Constitutional Landscape (Springer Nature Switzerland 2024) 157.

Hart HLA, 'Positivism and the Separation of Law and Morals' në Law and Morality (Routledge 2017) 63.

Langbroek P dhe të tjerë, 'Performance Management of Courts and Judges: Organizational and Professional Learning versus Political Accountabilities' në Handle with Care (Deliverable 3.1, 2017) 297.

Pech L, 'The Rule of Law' në Craig P dhe de Búrca G (red), The Evolution of EU Law (bot. 3, Oxford University Press 2021) 322.

Root HL dhe Majit K, 'Judicial Systems and Economic Development' në *Rule by Law: The Politics of Courts in Authoritarian Regimes* (2008) 304.

Tepelija A dhe Milojković T, 'Vetting as a Judicial Integrity Enhancement Tool' në *Accountability of Judicial Power* (Routledge) 186.

Thaman SC, 'Europe's New Jury Systems: The Cases of Spain and Russia' në Vidmar N (red), *World Jury Systems* (Oxford University Press 2000) 319.

Thiery P, Schering dhe Muno, 'Wie Misst man Recht? Möglichkeiten und Grenzen der Messung von Rechtsstaatlichkeit' në Estermann (red), *Interdisziplinäre Rechtsforschung: Kongressbeiträge – Wie wirkt Recht* (2009).

Weder B, 'Legal Systems and Economic Performance: The Empirical Evidence' në *Judicial Reform in Latin America and the Caribbean* (Banka Botërore 1995) 21.

Braun A, 'Judges and Academics: Features of a Partnership' (Hart Publishing 2010) 227.

3. Artikuj në revista shkencore

Ahl B, 'Judicialization in Authoritarian Regimes' (2019).

Akkas SA, 'Appointment of Judges: A Key Issue of Judicial Independence' (2004) 16(2) *Bond Law Review* nen 9.

Albers P, 'Theme: Evaluation of Courts and Judicial Systems – Improvements of Judicial Systems: European Experiences' (2008) *International Journal for Court Administration* 45.

Amende RR, 'The Soviet Theory of "People's Democracy"' (1949) 1(4) *World Politics* 489.

Anastasi A, 'The Form of Government in the Republic of Albania (1925–1928)' (2026) 1 *Diritto Pubblico Comparato ed Europeo Online* 563.

Andone C dhe Greco S, 'Evading the Burden of Proof in European Union Soft Law Instruments: The Case of Commission Recommendations' (2018) 31(1) *International Journal for the Semiotics of Law* 79.

Assumpcao A dhe Trecenti J, 'Judicial Favoritism of Politicians: Evidence from Small Claims Court' (arXiv, 31 janar 2020) <https://arxiv.org>.

Ausfelder A dhe të tjerë, 'EU Soft-Law: Non-Binding but Enforceable' (2024) 30(4) *European Law Journal* 668.

Babameto E, 'The Convolutional Road of the Communist Party of Albania: 1941–1948' (2014) 3(6) *Academic Journal of Interdisciplinary Studies* 117.

Balla A, 'The Reform of Justice in Albania' (2020) 11 *Beijing Law Review* 709.

Ballauri F, 'Limitations by Law on the Private Interests of Magistrates: The Case of Albania in Preventing Conflict of Interest and Corruption in Justice System' (2025) 14(3) *Perspectives of Law and Public Administration* 454.

Bara B dhe Bara J, 'Rule of Law and Judicial Independence in Albania' (2017) 2 *University of Bologna Law Review* 25.

Basova T, 'Ideologization of Criminal Law in the Early Soviet Period' (2026).

Berdej  C dhe Yuchtman N, ‘Crime, Punishment, and Politics: An Analysis of Political Cycles in Criminal Sentencing’ (2013) *Review of Economics and Statistics*.

Bergoglio MI, ‘New Paths toward Judicial Legitimacy: The Experience of Mixed Tribunals in C rdoba’ (Southwestern Law School, Los Angeles, 25 janar 2008).

Bobek M dhe Kosa  D, ‘Global Solutions, Local Damages: A Critical Study in Judicial Councils in Central and Eastern Europe’ (College of Europe Research Paper 07/2013).

Bonina C dhe Cordella A, ‘Public Sector Reforms and the Notion of “Public Value”’ (AMCIS Proceedings 2009) 5.

Butler WE, ‘Justice in Russia: Soviet Law and Russian History’ (1993) 42 *Emory Law Journal* 433.

Caliendo G dhe Magistro E, ‘The Human Face of the European Union: A Critical Study’ (2009) *CADAAD Journal*.

Castillo-Ortiz P, ‘The Politics of Implementation of the Judicial Council Model in Europe’ (dor shkrim).

Cekaj F dhe t  tjer , ‘Succession Contracts for Family Firms in Italy and Albania: A European Private International Law Approach’ (2022) 11(2) *Osservatorio del Diritto Civile e Commerciale* 621.

Chemin M, ‘Judicial Efficiency and Firm Productivity: Evidence from a World Database of Judicial Reforms’ (2020) 102(1) *Review of Economics and Statistics* 49.

Choi SJ, Gulati GM dhe Posner EA, ‘Professionals or Politicians: The Uncertain Empirical Case for an Elected Rather than Appointed Judiciary’ (2010) *Journal of Law, Economics, & Organization*.

Contini F dhe Reiling D, ‘Double Normalization: When Procedural Law Is Made Digital’ (2022) *O nati Socio-Legal Series* 658.

De la Porte C, ‘Is the Open Method of Coordination Appropriate for Organising Activities at European Level in Sensitive Policy Areas?’ (2002) 8 *European Law Journal* 38.

De Pascalis F, ‘Free Movement and the Right of Establishment of EU Lawyers: The Special Case of Italian Abogados’ (2014) 25(3) *King’s Law Journal* 340.

Dejuan-Bitria D dhe Mora-Sanguinetti JS, ‘Which Legal Procedure Affects Business Investment Most, and Which Companies Are Most Sensitive? Evidence from Microdata’ (2021) 94 *Economic Modelling* 201.

Dimitrova D, ‘Judicial Reform and Process of Vetting in Albania: Between an Effective Project and an Unsuccessful Experiment’ (2018) 11(2) *KSI Transactions on Knowledge Society*.

Dinan D, ‘Governance and Institutions: The Insidious Effect of Chronic Crisis’ (2017) 55 *Journal of Common Market Studies* 73.

Dori A, ‘In Data We Trust? Quantifying the Costs of Adjudication in the EU Justice Scoreboard’ (2021) 14 *Erasmus Law Review* 281.

Dori A, ‘The EU Justice Scoreboard – Judicial Evaluation as a New Governance Tool’ (Max Planck Institute Luxembourg Working Paper Series 2015/2).

Gandur M, Chewning TK dhe Driscoll A, 'Awareness of Executive Interference and the Demand for Judicial Independence: Evidence from Four Constitutional Courts' (2025) 13(1) *Journal of Law and Courts* 122.

Garoupa N dhe Ginsburg T, 'Guarding the Guardians: Judicial Councils and Judicial Independence' (2009) 57(1) *American Journal of Comparative Law* 103.

Garoupa N, Rosales V dhe Spruk R, 'Assaults on Judicial Independence under the Pretense of Modernization: Evidence from Venezuela' (arXiv, 2025) <https://arxiv.org/abs/2511.10681>.

Garoupa N, 'Populist Constitutional Backsliding and Judicial Independence: Evidence from Türkiye' (2025) *International Review of Law and Economics* nen 106301.

Garunja E, 'The Effects of Constitutional Changes on the Judiciary System in Albania: The Process of Vetting' (2022) *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*.

Gianfreda G dhe Vallanti G, 'Labor Courts and Firing Costs: The Labor-Market Effects of Trial Delays' (2020) 59(1) *Industrial Relations: A Journal of Economy and Society* 40.

Gjipali D, 'Unity and Separation of Powers in Light of the Constitutional Systems in Albania'.

Guastini R, 'Gerarchie Normative' (2013) 21 *Revus* 57.

Gurbanov RA Ogly, 'CEPEJ as the Consultative Body of the Council of Europe, Granted with the Responsibility of Developing and Implementing Common Standards in the Sphere of the Delivery of Justice' (2015) 6(56) *Журнал зарубежного законодательства и сравнительного правоведения* 1056.

Hans VP, 'Jury Systems around the World' (2008) 4 *Annual Review of Law and Social Science* 275.

Hanson M dhe Thompson-Brusstar M, 'Building Socialist Legality: Political Order and Institutional Development in the Soviet and Chinese Procuracies' (2021) *Europe-Asia Studies*.

Hoxha D, 'Justice in Uniform: Profiles of Military Law in Albania during the Italian Occupation (1939–1943)' (2024) 18(2) *JUS & JUSTICIA* 108.

Hubková P, 'EU Acts without Binding Legal Force Producing Binding Legal Effects at the National Level: Enforcement of ESA Soft Law in the Czech Republic' (2022).

Ilia B dhe Ilia M, 'The Vetting of Judges and Prosecutors in Albania between Success and Failure' (2017) *Revista de Științe Juridice* 16.

Jakab A dhe Kirchmair L, 'How to Develop the EU Justice Scoreboard into a Rule of Law Index: Using an Existing Tool in the EU Rule of Law Crisis in a More Efficient Way' (2021) 22(6) *German Law Journal* 936.

Jakab A dhe Lórinč VO, 'International Indices as Models for the Rule of Law Scoreboard of the European Union: Methodological Issues' (MPIL Research Paper Series nr. 2017-21, 2017).

Jimeno-Bulnes M, 'A Different Story Line for 12 Angry Men: Verdicts Reached by Majority Rule – The Spanish Perspective' (2007) 82 *Chicago-Kent Law Review* 759.

Johnsen JT, 'The European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ): Reforming European Justice Systems – "Mission Impossible?"' (2011) 4 *International Journal for Court Administration*.

Kapopoulos P dhe Rizos A, 'Judicial Efficiency and Economic Growth: Evidence Based on European Union Data' (2024) 71(1) *Scottish Journal of Political Economy* 101.

Kasaj AL, 'Access to Justice in Albania and EU Policies' (2024) 8(3) *European Journal of Economics, Law and Social Sciences* 67.

Kasmi J, 'Confronting the Past: The Need to Recognize Albania's Communist-Era Extrajudicial Killings as Crimes against Humanity' (2025) 12 *Social Sciences & Humanities Open* 102070.

Kennedy MD dhe Galtz N, 'From Marxism to Postcommunism: Socialist Desires and East European Rejections' (1996) 22(1) *Annual Review of Sociology* 437.

Khan MA dhe të tjerë, 'Justice and Finance: Does Judicial Efficiency Contribute to Financial System Efficiency?' (2024) 24(2) *Borsa Istanbul Review* 248.

Koka E, Veshi D dhe Morina A, 'EU Impact on Albanian Medical Civil Liability: A Case Law Approach' (2025) 2 *Freedom, Security & Justice: European Legal Studies* 146.

Koka E dhe të tjerë, 'Implementation of the Commission Recommendation of 7 December 1994 on the Transfer of Small- and Medium-Sized Enterprises in Albania: A German or Italian Model?' (2024) 32(5) *European Review of Private Law*.

Kondrych V, 'Gjykata e Lartë kundër Korrupsionit në Kuadër të Standardeve Ndërkombëtare të Procedurës Gjyqësore dhe Administrimit të Drejtësisë' (2021) *Amazonia Investiga*.

Kosař D, 'Politics of Judicial Independence and Judicial Accountability in Czechia: Bargaining in the Shadow of the Law between Court Presidents and the Ministry of Justice' (2017) 13(1) *European Constitutional Law Review* 96.

Kosař D, Šipulová K dhe Kadlec O, 'Judicial Councils as Fourth-Branch Institutions' (2021) 12(2) *International Journal for Court Administration* 1.

Kovalev NP, 'Lay Adjudication of Crimes in the Commonwealth of Independent States: An Independent and Impartial Jury or a "Court of Noddors"?' (2004) 11 *Journal of East European Law* 123.

Laeven L dhe Majnoni G, 'Does Judicial Efficiency Lower the Cost of Credit?' (2005) 29(7) *Journal of Banking & Finance* 1791.

Langbein JH, 'Mixed Court and Jury Court: Could the Continental Alternative Fill the American Need?' (1981) 6 *American Bar Foundation Research Journal* 195.

Leo G, 'La Funzione Nomofilattica della Corte di Cassazione tra Sviluppi Interpretativi e Recenti Riforme' (2021) *Quaderni del Corso di Dottorato in Diritto*.

Li L, 'The Chinese Communist Party and People's Courts: Judicial Dependence in China' (2016).

Lienhard A dhe Kettiger D, 'Twenty Years of Research Into the Swiss Justice System' (2024) 15 *International Journal for Court Administration*.

Lin C-C, 'Constitutions and Courts in Chinese Authoritarian Regimes' (2016).

Llagami N, 'Building Justice in Albania from the Independence (1912) to the Communist Regime (1945): A Constitutional–Historical Perspective' (2026) 1 *Revista Aequitas* 155.

Łoś M, 'The Myth of Popular Justice under Communism: A Comparative View of the USSR and Poland' (1985) 2(4) *Justice Quarterly* 447.

Machura S, 'Interaction between Lay Assessors and Professional Judges in German Mixed Courts' (2001) 72 *International Review of Penal Law* 451.

Mandel M, 'Marxism and the Rule of Law' (1986) 35 *University of New Brunswick Law Journal* 7.

Marku Y, 'Communist Relations in Crisis: The End of Soviet-Albanian Relations, and the Sino-Soviet Split, 1960–1961' (2020) 42(4) *International History Review* 813.

Martin W, 'Court Administrators and the Judiciary – Partners in the Delivery of Justice' (2014) 6(2) *International Journal for Court Administration* <http://www.iacajournal.org>.

Maruta T, 'Of Saiban-in Seido and Criminal Trial in Japan: Idea and Reality of the Japanese Lay-Judges System' (Conference on Citizen Participation in East Asian Legal Systems, Cornell Law School, Ithaca NY, 22–23 shtator 2006).

McAleavy H, 'The People's Courts in Communist China' (1962).

Mehmeti J, 'Internal Policy Aspects of the Communist Regime of Albania (1945–1990)' (2017) 6(7) *ANGLISTICUM* 63.

Merkuri E, 'Organization and Functioning of the Justice System in Albania, 1925–1928' (2026) 1 *Diritto Pubblico Comparato ed Europeo Online* 619.

Mikuli P, 'Current Debates on the Supervision over the Administrative Activity of the Common Courts' (2014) 20(3) *European Public Law* 521.

Milios J, 'Marxist Theory and Marxism as a Mass Ideology: The Effects of the Collapse of "Really Existing Socialism" on West European Marxism' (1995) 8(4) *Rethinking Marxism* 61.

Muthoo A dhe Shepsle K, 'The Constitutional Choice of Bicameralism' (MPRA Paper nr. 5825, University Library of Munich 2007) <https://mpra.ub.uni-muenchen.de/5825/>.

Nano I, 'Avoidances from the Constitutional Principle of the Division of the Powers' *SEEU Review* 163.

Ndreu A, 'Characteristics of Local Governance after 1912 in Albania' (2016) 10(1) *Social and Natural Sciences Journal*.

Olszanowski J, 'The Model of Supervision over Administrative Courts in Poland'.

Orgad L, 'The Preamble in Constitutional Interpretation' (2010) 8(4) *International Journal of Constitutional Law* 714.

Palumbo G dhe të tjerë, 'The Economics of Civil Justice: New Cross-Country Data and Empirics' (OECD Economics Department Working Papers 2013).

Pap M, 'Socialist Democracy: Directed Democracy and Social Vision in Socialist Hungary, 1956–1989' (2023) 10(1) *Democratic Theory* 19.

Passarella C, 'Una Disarmonica Fusione di Competenze: Magistrati Togati e Giudici Popolari in Corte d'Assise negli Anni del Fascismo' (2020) *Historia et Ius*.

Pereira MA dhe të tjerë, 'An Integrative Approach to Reviewing the Literature on Judicial Efficiency in Europe' (2025) 98 *Socio-Economic Planning Sciences* 102137.

Pezone V, 'The Real Effects of Judicial Enforcement' (2023) 27(3) *Review of Finance* 889.

Piñeiro LC, 'Legal Education in Spain: Challenges and Risks in Devising Access to the Legal Professions' (2012) 19(2–3) *International Journal of the Legal Profession* 339.

Pulaj E, 'Justice System Reform in Albania: Achievements, Challenges, and the Path Forward' (2025) 12(1 S1) *Interdisciplinary Journal of Research and Development* 124.

Ripple KF, 'The Judge and the Academic Community' (1989) 50 *Ohio State Law Journal* 1237.

Salimbeni MT, 'Licenziamento Collettivo e Art. 18 Statuto dei Lavoratori: La Sanzione Applicabile alle Violazioni Procedurali' (2022) 3 *Rivista Italiana di Diritto del Lavoro* 363.

Schomburg W, 'The Role of International Criminal Tribunals in Promoting Human Rights and Accountability' (2009) 8(1) *Northwestern University Journal of International Human Rights* 1.

Sharlet R, 'Stalinism and Soviet Legal Culture' (1977) 3(1) *Journal of Soviet Law*.

